FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 150

Tiranë – E premte, 10 korrik 2026

PËRMBAJTJA

URDHËR
Nr. 583, datë 1.7.2026

PËR DISA NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 213, DATË 19.11.2025, "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES 'PËR KUSHTET, KRITERET, AFATET, SI DHE PROCEDURËN PËR KATEGORIZIMIN E STRUKTURAVE AKOMODUESE'"

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 6, të nenit 43/1, të ligjit nr. 93/2015, "Për turizmin", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Në rregulloren "Për kushtet, kriteret, afatet, si dhe procedurën për kategorizimin e strukturave akomoduese", miratuar me urdhrin nr. 213, datë 19.11.2025, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 e nenit 6 ndryshohet, si më poshtë:

"*1. Dokumentacioni që duhet të ngarkohet në portalin unik qeveritar "e-Albania" nga kërkuesi është:*

a) Dokumenti që vërteton të drejtën e pronësisë ose të përdorimit të ligjshëm të objektit ku ushtrohet veprimtaria, sipas njërit prej dokumenteve të mëposhtme:

i. certifikata e pronësisë dhe kartela e pasurisë;

ii. leja e ndërtimit dhe certifikata e përdorimit të objektit, të lëshuara nga organi kompetent;

iii. kontrata e qirasë, huapërdorimit ose një marrëveshje tjetër përdorimi me pronarin e objektit.

Dokumentacioni i paraqitur duhet të provojë të drejtën e përdorimit të ligjshëm të objektit për ushtrimin e veprimtarisë.";

b) Në fund të shkronjës "a", të pikës 2, të nenit 6 shtohet fjalia "*Adresa e deklaruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit duhet të përputhet me adresën e strukturës akomoduese për të cilën kërkohet kategorizimi*".

c) Pikat 1 dhe 2, të nenit 7, ndryshojnë si më poshtë:

"1. Pas depozitimit të kërkesës në portalin unik qeveritar "e-Albania", Sekretaria Teknike kryen verifikimin paraprak të dokumentacionit të paraqitur nga kërkuesi. Në rast se dokumentacioni rezulton i plotë, kërkesa i kalon për shqyrtim Komisionit të Standardizimit të Veprimtarive Turistike, i cili brenda 10 ditëve nga data e konfirmimit të plotësimit të dokumentacionit shqyrton dhe vlerëson përmbushjen e kushteve dhe kritereve për kategorizimin e strukturës akomoduese.

2. Kur, gjatë verifikimit paraprak, konstatohen mangësi në dokumentacion, Sekretaria Teknike njofton kërkuesin, nëpërmjet portalit unik qeveritar "e-Albania", për plotësimin e tyre, duke i lënë një afat prej 10 (dhjetë) ditësh pune nga data e njoftimit.";

ç) Pika 5 e nenit 7 ndryshohet, si më poshtë:

*"5. Afati i parashikuar në pikën 1 të këtij neni nuk përfshin periudhën e nevojshme për plotësimin e mangësive të dokumentacionit nga kërkuesi. Në raste të veçanta dhe të arsyetuara, Komisioni mund të zgjasë afatin e shqyrtimit jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë, duke njoftuar kërkuesin nëpërmjet portalit unik qeveritar "e-Albania".***".**

2. Në shtojcën nr. 3 "Kërkesë për t'u pajisur me certifikatë kategorizimi të strukturës akomoduese" që i bashkëlidhet rregullores, teksti *"Dokumentacioni shoqërues i kërkesës",* ndryshohet si më poshtë:

"*Certifikata e pronësisë dhe kartela e pasurisë ose leje ndërtimi me treguesit e ndërtimit dhe certifikata e përdorimit të objektit lëshuar nga organi kompetent;*

- Kontrata e qirasë ose e përdorimit me pronarin e objektit;

- Planimetria e strukturës akomoduese;

- Foto aktuale të ambienteve të brendshme të pajisura dhe funksionale, dhe të jashtme të strukturës;

- Vetëdeklarim që struktura plotëson kushtet për masat e mbrojtjes nga zjarri, për kategoritë "Dhomë", "Apartament", "Vilë" dhe "Bllok apartamentesh", në rastet kur përmbushja e këtyre kërkesave vetëdeklarohet sipas kësaj rregulloreje;

- Vetëdeklarim që struktura plotëson kushtet higjieno-sanitare, për kategoritë "Dhomë", "Apartament", "Vilë" dhe "Bllok apartamentesh", në rastet kur përmbushja e këtyre kërkesave vetëdeklarohet sipas kësaj rregulloreje.".

3. Në të gjithë tekstin e rregullores, fjalët "aplikim", "aplikues", "aplikon" zëvendësohen me fjalët "kërkesë", "kërkues" dhe "paraqet kërkesë".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS
DHE SPORTIT
Blendi Gonxhja

URDHËR
Nr. 693, datë 2.7.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË PSEUDOPESTIT TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E SPANJËS

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ**:**

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;

b) zogjve 24-orësh;

c) mishit të freskët;

ç) materialit biologjik të shpendëve të pashoqëruar me test diagnostik PCR-je të kryer 14 ditë përpara mbledhjes, që vërteton mosprezencën e virusit;

d) vezëve dhe produkteve të vezëve të shpendëve, ku nuk është siguruar shkatërrimi i virusit të pseudopestit, përkatësisht në vezën e plotë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 55ºC në 2,521 sekonda, në vezën e lëngshme nuk është bërë trajtimi në 55ºC në 2,278 sekonda, në të verdhën e vezës me 10% kriposje nuk është bërë trajtimi me temperaturë 55ºC në 176 sekonda dhe në të bardhën e vezës së tharë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 57ºC në 50.4 orë;

dh) produkteve të mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht, përkatësisht:

i. 65ºC në 39.8 sekonda;

ii. 70ºC në 3.6 sekonda;

iii. 74ºC në 0.5 sekonda;

iv. 80ºC në 0.03 sekonda;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Spanjës, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
1.	Comunitat Valenciana	Valencia/València	La Vall D'albaida-Castello de Rugat*
2.	Comunitat Valenciana	Valencia/València	La Vall D'albaida-Ontinyent*
3.	Castilla y León	Valladolid	Valladolid*
4.	Castilla y León	Valladolid	Olmedo*
5.	Castilla y León	Valladolid	Medina del Campo*
6.	Castilla y León	Valladolid	Peñafiel*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Importi dhe tranzitimi i shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produkteve të mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve, lejohet nga zona dhe kompartamente të shtetit të Spanjës, të cilat nuk kanë pasur njoftim të sëmundjes së pseudopestit të shpendëve për 12 muajt e fundit.

4. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produkteve të mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve që vijnë nga zonat e sipërcituara sipas pikës 2 të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjithë subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

7. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

8. Urdhri nr. 659, datë 23.6.2026, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit, të shfaqur në shtetin e Spanjës", shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 695, datë 3.7.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË GJUHËS BLU, TË SHFAQUR NË MBRETËRINË E BASHKUAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë;

b) spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e gjuhës blu, të shfaqur në Mbretërinë e Bashkuar, janë sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	**Ndarja administrative e nivelit të dytë**	**Ndarja administrative e nivelit të tretë**
England	Barnsley	Barnsley*
England	Bath and North East Somerset	Bath and North East Somerset*
England	Buckinghamshire	Buckinghamshire*
England	Bournemouth, Christchurch and Poole	Bournemouth, Christchurch and Poole*
England	Bracknell Forest	Bracknell Forest*
England	Bradford	Bradford*
England	Calderdale	Calderdale*
England	Cambridgeshire	East Cambridgeshire*
England	Cambridgeshire	South Cambridgeshire*
England	Central Bedfordshire	Central Bedfordshire*
England	Cheshire East	Cheshire East*
England	Cheshire West and Chester	Cheshire West and Chester*
England	Cornwall	Cornwall*
England	Cumberland	Cumberland Council*
England	Derbyshire	Amber Valley*
England	Derbyshire	Bolsover*
England	Derbyshire	Derbyshire Dales*
England	Derbyshire	High Peak*
England	Derbyshire	North East Derbyshire*
England	Devon	East Devon*
England	Devon	Mid Devon*
England	Devon	Teignbridge*
England	Devon	South Hams*
England	Devon	West Devon*
England	Dorset	Dorset*
England	Doncaster	Doncaster*
England	Gloucestershire	Stroud*
England	Gloucestershire	Cotswold*
England	East Riding of Yorkshire	East Riding of Yorkshire*
England	East Sussex	Rother*
England	East Sussex	Lewes*
England	East Sussex	Wealden*
England	Essex	Braintree*
England	Essex	Brentwood*
England	Essex	Chelmsford*
England	Essex	Colchester*
England	Essex	Epping Forest*
England	Essex	Maldon*
England	Essex	Harlow*
England	Essex	Tendring*
England	Greater London	Harrow*
England	Herefordshire, County of	Herefordshire, County of*
England	Hertfordshire	Dacorum*
England	Hertfordshire	East Hertfordshire*
England	Hertfordshire	Hertsmere*
England	Hertfordshire	Three Rivers*
England	Medway	Medway*
England	Milton Keynes	Milton Keynes*
England	Shropshire	Shropshire*
England	Kent	Ashford*
England	Kent	Canterbury*
England	Kent	Dover*
England	Kent	Gravesham*
England	Kent	Folkestone and Hythe*
England	Kent	Maidstone*
England	Kent	Sevenoaks*
England	Kent	Swale*
England	Kent	Tonbridge and Malling*
England	Kent	Tunbridge Wells*
England	Kirklees	Kirklees*
England	Isle of Wight	Isle of Wight*
England	Somerset	Somerset Council*
England	Suffolk	East Suffolk*
England	Suffolk	Babergh*
England	Suffolk	Mid Suffolk*
England	Suffolk	Waverley*
England	Suffolk	West Suffolk*
England	Surrey	Guildford*
England	Surrey	Runnymede*
England	Hampshire	Basingstoke and Deane*
England	Hampshire	East Hampshire*
England	Hampshire	Eastleigh*
England	Hampshire	Hart*
England	Hampshire	Test Valley*
England	Hampshire	New Forest*
England	Hampshire	Winchester*
England	Lancashire	Chorley*
England	Lancashire	Hyndburn*
England	Lancashire	Lancaster*
England	Lancashire	Ribble Valley*
England	**Lancashire**	**Wyre***
England	Leicestershire	Charnwood*
England	Leicestershire	Harborough*
England	Leicestershire	Hinckley and Bosworth*
England	Leicestershire	North West Leicestershire*
England	Lincolnshire	East Lindsey*
England	Lincolnshire	West Lindsey*
England	Lincolnshire	South Kesteven*
England	Staffordshire	East Staffordshire*
England	Staffordshire	Newcastle-under-Lyme*
England	Staffordshire	Stafford*
England	Staffordshire	Staffordshire Moorlands*
England	Staffordshire	South Staffordshire*
England	Southampton	Southampton*
England	South Gloucestershire	South Gloucestershire*

England	Stockport	Stockport*
England	Norfolk	Breckland*
England	Norfolk	Broadland*
England	Norfolk	Great Yarmouth*
England	Norfolk	King's Lynn and West Norfolk*
England	Norfolk	South Norfolk*
England	Norfolk	North Norfolk*
England	North Yorkshire	North Yorkshire Council*
England	Nottinghamshire	Bassetlaw*
England	Nottinghamshire	Newark and Sherwood*
England	Oxfordshire	South Oxfordshire*
England	Oxfordshire	Vale of White Horse*
England	Tameside	Tameside*
England	Trafford	Trafford*
England	Thurrock	Thurrock*
England	York	York*
England	West Berkshire	West Berkshire*
England	Wiltshire	Wiltshire*
England	Wokingham	Wokingham*
England	Westmorland and Furness Council	Westmorland and Furness Council*
England	West Sussex	Arun*
England	West Sussex	Chichester*
England	West Sussex	Horsham*
England	West Sussex	Mid Sussex*
Isle of Man	Glenfaba	Patrick*
Isle of Man	Middle	Braddan*
Isle of Man	Rushen	Arbory*
Isle of Man	Rushen	Rushen*
United Kingdom Exclusive Economic Zone	Brightlingsea*	
United Kingdom Exclusive Economic Zone	Middleton*	
Wales	Ceredigion	Ceredigion*
Wales	Denbighshire	Denbighshire*
Wales	Monmouthshire	Monmouthshire*
Wales	Powys	Powys*
Wales	Wrexham	Wrexham*
Northern Ireland	North Down and Ards	Ards*
Northern Ireland	Ards and North Down	North Down*
England	Wakefield	Wakefield*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që kafshët e gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë Culicoides, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë Culicoides, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupat ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë Culicoides, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) Janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjithë serotipave të demonstruar të pranishëm në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupa për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjithë serotipeve të demonstruar se janë të pranishëm në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1 të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitrupave ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo

28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

ç) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupat ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8., 4.9 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

4. Certifikata veterinare shëndetësore garanton origjinën e tyre sipas përcaktimeve në pikat 2 dhe 3 të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjitha subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

6. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

7. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht, brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

8. Urdhri nr. 658, datë 22.6.2026, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në Mbretërinë e Bashkuar", shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 608, datë 6.7.2026

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; në ligjin 23/2015, "Për shërbimin e jashtëm të RSH-së"; në nenet 22 e vijues të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; në ligjin nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore"; në ligjin nr. 162/2020, "Për prokurimin publik" dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 870, datë 14.12.2011, "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit", i ndryshuar;

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së ministrit te drejtorit i përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, nga data 6–10 korrik 2026, për dërgimin me shërbim të punonjësve të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme jashtë qendrës së punës, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, në largësi mbi 100 km, si dhe me shërbim jashtë vendit.

2. Drejtori i përgjithshëm nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca.

3. Ngarkohet drejtori i përgjithshëm i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Ferit Hoxha

NJOFTIM
Nr. 10374, datë 6.7.2026

PËR HYRJEN NË FUQI TË MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE

"Marrëveshja për zbatimin e dispozitave të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtën e Detit, të 10 dhjetorit 1982, që lidhen me ruajtjen dhe menaxhimin e burimeve peshkore ndërkufitare dhe të burimeve migruese", bërë në Nju Jork, më 4 gusht 1995, hyn në fuqi për Republikën e Shqipërisë në datën 24 korrik 2026.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
I MINISTRISË PËR EVROPËN DHE
PUNËT E JASHTME
Armand Skapi

UNITED NATIONS NATIONS UNIES

POSTAL ADDRESS—ADRESSE POSTALE: UNITED NATIONS, N.Y. 10017

Reference: C.N.257.2026.TREATIES-XXI.7 (Depositary Notification)

AGREEMENT FOR THE IMPLEMENTATION OF THE PROVISIONS OF THE UNITED NATIONS CONVENTION ON THE LAW OF THE SEA OF 10 DECEMBER 1982 RELATING TO THE CONSERVATION AND MANAGEMENT OF STRADDLING FISH STOCKS AND HIGHLY MIGRATORY FISH STOCKS
NEW YORK, 4 AUGUST 1995

ALBANIA: ACCESSION

The Secretary-General of the United Nations, acting in his capacity as depositary, communicates the following:

The above action was effected on 24 June 2026.

The Agreement shall enter into force for Albania on 24 July 2026 in accordance with its article 40 (2) which reads as follows:

"For each State or entity which ratifies the Agreement or accedes thereto after the deposit of the thirtieth instrument of ratification or accession, this Agreement shall enter into force on the thirtieth day following the deposit of its instrument of ratification or accession."

24 June 2026

VENDIM
Nr. 59, datë 28.5.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fiona Papajorgji	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahimi	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Asim Vokshi	anëtar;
Sonila Bejtja	anëtare,

me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 28.5.2026, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 3 (Xh) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Xhevat Topi, përfaqësuar nga avokati Lulzim Llangozi, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Zenepe Topi, në mungesë.

Shoqëria "Sigal Uniqa Group Austria" sh.a., përfaqësuar nga administratori i përgjithshëm Avni Ponari.

Byroja Shqiptare e Sigurimit, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-681, datë 5.2.2025, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Dërgimi i çështjes për shqyrtim në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 17, pika 2, 18, pika 1, 33, pika 1, 41, pikat 1 dhe 2, 42, 131, pika 1, shkronja "f", 134, pika 1, shkronja "i", dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 1 i Protokollit 1 të saj; neni 27, i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuesit Xhevat Topi (*kërkuesi*), që ka kërkuar pranimin e

kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, shoqërisë "Sigal Uniqa Group Austria" sh.a. ("*Sigal" sh.a.*), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e parashtrimeve të subjekteve të interesuara, Zenepe Topi dhe Byrosë Shqiptare të Sigurimit (*BShS*), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është trashëgimtar ligjor i të birit të tij të ndjerë G. T., që ka humbur jetën si pasojë e dëmtimeve të rënda të shëndetit të shkaktuara nga aksidenti automobilistik i ndodhur në datën 31.1.2011. Në lidhje me këtë ngjarje, me vendimin nr. 306, datë 25.5.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan është deklaruar fajtor dhe është dënuar shtetasi G. Y. Ky shtetas ka qenë i siguruar me sigurim TPL pranë subjektit të interesuar "Sigal" sh.a.

2. Kërkuesi dhe subjekti i interesuar Zenepe Topi, në cilësinë e trashëgimtarëve të të ndjerit (prindërit e tij), i janë drejtuar gjykatës duke kërkuar nga subjekti i interesuar "Sigal" sh.a. që t'u paguajë shpërblimin vetëm për dëmin jopasuror (dhe interesat) si rezultat i aksidentit automobilistik në të cilin ka humbur jetën i biri i tyre.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 7256, datë 23.6.2014, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë dhe detyrimin e subjektit të interesuar "Sigal" sh.a. të dëmshpërblejë prindërit e të ndjerit në shumën 4,000,000 lekë dhe interesat për këtë shumë. Në lidhje me ligjin e zbatueshëm, në rastin konkret, ajo gjykatë ka arsyetuar se aksidenti ka ndodhur në datën 31.1.2011, dhe se ligji në fuqi në atë kohë ka qenë ligji nr. 10076, datë 12.2.2009, "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", tashmë i shfuqizuar (*ligji nr. 10076/2009*). Për llogaritjen e masës së dëmit ajo gjykatë ka caktuar një ekspert vlerësues dëmesh, i cili ka bërë përllogaritje të shumës së dëmit sipas dy mënyrave: i. varianti i parë sipas vendimit unifikues nr. 12, datë 14.9.2007, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (*vendimi unifikues nr. 12/2007*); ii. varianti i dytë sipas rregullores nr. 53, datë 25.6.2009, "Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit", miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (*rregullorja e AMF-së nr. 53/2009*). Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vlerësuar se duhet të merret në konsideratë varianti i parë i përllogaritjes, pra sipas vendimit unifikues nr. 12/2007. Nga ana tjetër, ajo ka arsyetuar se rregullorja nr. 53/2009, e dalë në zbatim të ligjit nr. 10076/2009, nuk ka qenë në fuqi në momentin e ndodhjes së aksidentit, pasi është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 180, datë 25.12.2011 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas publikimit. Kundër këtij vendimi ka ushtruar të drejtën e ankimit subjekti i interesuar "Sigal" sh.a. (*shih faqen 9, të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*).

4. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2143, datë 2.11.2015, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë duke ulur vlerën e dëmshpërblimit nga 4,000,000 lekë në 800.000 lekë. Ajo gjykatë ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë ka referuar në mënyrë të gabuar kuadrin ligjor të kohës, se nuk ka përcaktuar drejt masën e dëmit dhe rrjedhimisht edhe masën e dëmshpërblimit. Sipas saj, paqartësia e gjykatës së shkallës së parë në përcaktimin e kuadrit ligjor ka çuar në zgjedhje të gabuar të variantit të përllogaritjes së përgatitur nga eksperti. Gjykata e apelit ka arsyetuar se për të gjitha aksidentet e ndodhura pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 10076/2009, llogaritja e dëmeve do të bëhet sipas përcaktimeve të atij ligji. Në këtë kuptim, ajo gjykatë ka arsyetuar se është i pabazuar përfundimi i gjykatës së shkallës së parë se "*për faktin që në datën 31.1.2011 (datën e aksidentit), për efekt botimi nuk kishte hyrë në fuqi rregullorja nr. 53/2009 e AMF-së, e cila në fakt është vetëm një metodologji vlerësimi, nuk mund të zbatohet ligji nr. 10076/2009, e duhet zbatuar vendimi unifikues nr. 12, datë 14.9.2007*". Në përfundim, gjykata e apelit ka referuar në përllogaritjet e ekspertit vlerësues në lidhje me figurat e dëmit jopasuror dhe nenit 26 të ligjit nr. 10076/2009 "Përgjegjësia e shoqërisë së sigurimit dhe shuma e siguruar (kufiri i mbulimit)", për të arritur në përfundimin se në total prindërve të të ndjerit u takonte një dëmshpërblim i barabartë me 800.000 lekë (*shih faqet 6 dhe 7, të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë*).

5. Kundër vendimit të mësipërm kanë paraqitur rekurs të dyja palët ndërgjyqëse. Kërkuesi dhe subjekti i interesuar Zenepe Topi kanë pretenduar, ndër të tjera, se gjykata e apelit ka gabuar në përzgjedhjen e variantit të dytë të përllogaritjes sipas rregullores së AMF-së nr. 53/2009, për shkak se ajo nuk kishte fuqi juridike në momentin e ndodhjes së aksidentit. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me

vendimin nr. 00-2025-681, datë 5.2.2025, ka vendosur mospranimin e rekurseve, pasi ka vlerësuar se nuk përmbanin shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*). Sipas Gjykatës së Lartë, gjykata e apelit ka interpretuar dhe zbatuar drejt ligjin material dhe atë procedural, ka bërë një cilësim të drejtë të fakteve dhe të rrethanave që lidhen me mosmarrëveshjen, ka kryer një analizë juridike të plotë të provave dhe e ka zgjidhur mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Sipas saj, vendimi i gjykatës së apelit nuk bie në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Civil ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe palëve iu është dhënë mundësia të realizojnë të drejtën e tyre të mbrojtjes, të paraqesin prova, të njihen me provat e palës kundërshtare, të debatojnë për to, të shprehin qëndrimin e tyre për zgjidhjen e mosmarrëveshjes etj., duke u respektuar të gjitha parimet bazë për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor (*shih paragrafët 17 dhe 18, të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë*).

6. Në datën 21.7.2025, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë, sipas objektit. Kolegji i Gjykatës, në datën 21.10.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

7. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimi i kundërshtuar i ka cenuar të *drejtën për një proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

7.1 *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme dhe e caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve që kërkuesi ka ngritur në rekurs, në veçanti të atij për zbatimin e gabuar të ligjit material nga gjykata e apelit në lidhje me pazbatueshmërinë dhe zbatimin me fuqi prapavepruese të rregullores së AMF-së nr. 53/2009, e cila nuk mund të shërbente si burim i së drejtës për sa kohë që nuk kishte marrë fuqi juridike të mirëfilltë.

7.2 *Parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka trajtuar pretendimet e ngritura në rekursin e kërkuesit, por vetëm ato të ngritura në rekursin e subjektit të interesuar "Sigal" sh.a.

7.3 *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka kryer një vlerësim ligjor, si gjykatë ligji, për pretendimet e ngritura në rekursin e kërkuesit. Vendimi i saj është tërësisht i paarsyetuar dhe mungon analiza ligjore.

7.4 *Parimit të sigurisë juridike*, në aspektet e mëposhtme:

7.4.1 Gjykata apelit nuk u ka dhënë përgjigje problematikave të ngritura nga kërkuesi, në kundërshtim me detyrimin që i buron nga neni 14 i KPC-së për t'u shprehur mbi gjithçka kanë kërkuar palët në gjykim, dhe as nuk ka zbatuar detyrimin e verifikimit të ligjit të zbatueshëm, i cili prevalon mbi rregulloren e AMF-së nr. 53/2009, që nuk kishte hyrë në fuqi në momentin e ndodhjes së aksidentit. As Gjykata e Lartë nuk ka marrë në shqyrtim dhe nuk ka vlerësuar shkaqet e rekursit të kërkuesit, duke mos zbatuar vendimin e saj unifikues nr. 12/2007.

7.4.2 Është cenuar *parimi i hierarkisë së akteve* sipas nenit 116 të Kushtetutës, për shkak se gjykatat nuk kanë zbatuar detyrimin e verifikimit të ligjit të zbatueshëm, i cili prevalon mbi rregulloren e AMF-së nr. 53/2009. Kjo e fundit nuk mund të zbatohej, sepse nuk kishte fuqi juridike referuar nenit 117 të Kushtetutës.

7.4.3 Është cenuar edhe *neni 118, pika 2, i Kushtetutës,* sepse ligji nr. 10076/2009 ka autorizuar Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare të nxjerrë rregulla për trajtimin e dëmeve dhe në asnjë moment nuk parashikon autorizimin e tij për të nxjerrë akte juridike që përcaktojnë masën e dëmit dhe figurat e tij. Pra, rregullorja ka dalë tej kufijve të përcaktuar në ligj edhe pse ajo duhet të dalë në bazë dhe për zbatim të ligjit. Masa e dëmit për nga pasojat që rregullon është një çështje e cila duhet të parashikohet vetëm nga ligji dhe në asnjë rast me një rregullore.

8. ***Subjekti i interesuar, "Sigal" sh.a.,*** në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se pretendimet e kërkuesit në tërësinë e tyre bazohen në themelin e çështjes të shqyrtuar nga gjykatat e faktit dhe në zbatimin e ligjit nga ana e Gjykatës së Lartë, të cilat nuk janë në juridiksionin kushtetues. Kërkesa drejtuar kësaj Gjykate është e njëjtë në përmbajtje me rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, i cili është shqyrtuar nga ajo gjykatë brenda kompetencave dhe juridiksionit të saj si gjykatë ligji.

8.1 Pretendimi për cenimin e së *drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme dhe e caktuar me ligj* nuk qëndron, pasi Gjykata e Lartë ka vlerësuar se në rekursin e kërkuesit nuk ngrihen shkaqe nga ato që

parashikohen në ligj, ndaj ka vendosur mospranimin e tij. Kjo vendimmarrje dhe modeli i përdorur në arsyetimin e mospranimit të rekursit është në kompetencë të asaj gjykate dhe nuk mund të diktohet nga kjo Gjykatë.

8.2 Për pretendimin e cenimit të *parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit,* kërkuesi nuk ka parashtruar asnjë shkelje reale të kryer nga Gjykata e Lartë, por vijon me prapësimin se nuk duhet zbatuar rregullorja e AMF-së nr. 53/2009.

8.3 Edhe pretendimi për cenimin e *parimit të sigurisë juridike* me arsyetimin se Gjykata e Lartë ka mbajtur qëndrime të ndryshme për raste të njëjta nuk qëndron, pasi ajo gjykatë e ka konsoliduar qëndrimin e saj për rastet e dëmshpërblimeve që rrjedhin nga sigurimi i detyrueshëm në sektorin e transportit (*shih vendimet nr. 00-2014-2914 (473), datë 18.9.2014; nr. 00-2023-3125, datë 19.7.2023; nr. 00-2023-3499, datë 20.9.2023, të Gjykatës së Lartë*). Ligji nr. 10076/2009 është shfuqizuar tashmë prej 3 vjetësh dhe, në këtë kuptim, nuk gjen vend as pretendimi i kërkuesit se Gjykata e Lartë duhet të unifikojë praktikën e saj në këtë lëndë. Edhe kjo Gjykatë është shprehur më parë për zbatimin e ligjit nr. 10076/2009, konkretisht në vendimin nr. 6, datë 17.2.2012 dhe, bazuar në këtë vendim, Gjykata e Lartë ka konsoliduar praktikën e saj duke zbatuar ligjin nr. 10076/2009 dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

9. ***Subjektet e interesuara, Zenepe Topi*** *dhe* ***BShS-ja***, ndonëse janë njoftuar rregullisht, nuk kanë paraqitur shpjegime me shkrim.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

10. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

11. Kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës "f", të pikës 1, të nenit 131 dhe shkronjës "i", të pikës 1, të nenit 134 të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi. Po kështu, ai plotëson edhe kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, pasi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e në substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë është i datës 5.2.2025 dhe i është komunikuar kërkuesit nëpërmjet postës elektronike në datën 26.3.2025, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 21.7.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i Ligjit Organik të Gjykatës.

12. Në drejtim të legjitimimit *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesi, pavarësisht se në objektin e kërkesës ka kundërshtuar vetëm vendimin e Gjykatës së Lartë, në përmbajtjen e saj ka ngritur pretendime edhe për vendimin e gjykatës së apelit, duke pretenduar se prej tyre i është cenuar e *drejta për proces të rregullt ligjor* në drejtim të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme dhe e caktuar me ligj, parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit, standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, si dhe *parimin e sigurisë juridike*, që janë me natyrë kushtetuese. Këto pretendime, në thelb, kanë të bëjnë me qëndrimin e mbajtur nga Gjykata e Lartë në lidhje me shkaqet e rekursit të kërkuesit në drejtim të mënyrës sesi gjykata e apelit ka identifikuar ligjin e zbatueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes konkrete dhe zbatimin e tij në atë rast. Nisur nga kjo, pretendimet e kërkuesit do të analizohen në vijim nga Gjykata në drejtim të së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Po kështu, pavarësisht se kërkuesi ka kundërshtuar për shkaqet e mësipërme edhe vendimin e gjykatës së apelit, duke pasur parasysh jo vetëm natyrën e

pretendimeve, por edhe funksionin e Gjykatës së Lartë, si gjykatë ligji, në ushtrimin e të cilit ajo kontrollon jo vetëm mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta, por edhe respektimin e standardeve kushtetuese për proces të rregullt ligjor, për shkak të natyrës subsidiare të kontrollit kushtetues, Gjykata vlerëson që, në vijim, çështja të analizohet në këndvështrim të mënyrës sesi Gjykata e Lartë ka vepruar në rastin konkret, në drejtim të së drejtës së kërkuesit për proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor

13. Kërkuesi ka pretenduar se edhe pse në rekurs janë ngritur pretendime për zbatimin e gabuar të ligjit material nga gjykata e apelit në lidhje me pazbatueshmërinë dhe zbatimin me fuqi prapavepruese të rregullores së AMF-së nr. 53/2009, si dhe për sa i përket moszbatimit nga ajo gjykatë të vendimit unifikues nr. 12/2007, Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, nuk u ka dhënë përgjigje atyre, duke mos e arsyetuar vendimin e saj.

14. Subjekti i interesuar, "Sigal" sh.a., ka prapësuar se vendimmarrja e Gjykatës së Lartë dhe modeli i përdorur nga ajo në arsyetimin e mospranimit të rekursit është në kompetencë të asaj gjykate dhe nuk mund të diktohet nga kjo Gjykatë. Gjykata e Lartë e ka konsoliduar qëndrimin e saj për rastet e dëmshpërblimeve që rrjedhin nga sigurimi i detyrueshëm në sektorin e transportit edhe në sajë të vendimit nr. 6, datë 17.2.2012, të kësaj Gjykate.

15. Gjykata ka theksuar se e drejta e aksesit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 32, datë 3.11.2022; nr. 5, datë 22.2.2022; nr. 22, datë 29.4.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Po kështu, Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, funksioni i të cilit është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 33, datë 30.5.2023; nr. 11, datë 10.3.2023, të Gjykatës Kushtetuese*). Po në këtë drejtim, Gjykata është shprehur se vendimet e mospranimit të rekursit të Gjykatës së Lartë mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Arsyetimi i kufizuar nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa në thelb shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit (*shih vendimet nr. 10, datë 7.3.2023; nr. 21, datë 16.4.2015; nr. 37, datë 19.9.2011, të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, kur në rekurs janë ngritur pretendime të natyrës kushtetuese, Gjykata e Lartë, bazuar në parimin e subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të mbajë një qëndrim të shprehur për to (*shih vendimet nr. 16, datë 12.3.2024; nr. 29, datë 1.11.2022; nr. 19, datë 7.7.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Nga ana tjetër, Gjykata ripohon se është detyra e saj të shqyrtojë dhe të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 33, datë 14.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyn atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 3, datë 21.1.2025; nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 29, datë 1.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Duke mbajtur në konsideratë thelbin e argumenteve të kërkuesit dhe bazuar në standardet kushtetuese të sipërcituara, Gjykata do të analizojë në vijim nëse vendimi i Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit të kërkuesit i ka dhënë përgjigje përfundimtare pretendimit kryesor të tij që lidhej me zbatimin e gabuar të ligjit material nga ana e gjykatës së apelit.

19. Sikurse është parashtruar edhe më sipër në rrethanat e çështjes, kërkuesi dhe subjekti i interesuar Zenepe Topi kanë nisur procesin gjyqësor për marrjen e shpërblimit për dëmin jopasuror të pësuar për shkak të aksidentit në të cilin ka humbur jetën i biri i tyre, duke ngritur në të gjitha shkallët e gjykimit pretendimin për moszbatimin e rregullores së AMF-së nr. 53/2009, me argumentin se ai ishte një akt që në momentin e ndodhjes së aksidentit nuk kishte hyrë në fuqi, pasi nuk ishte botuar në Fletoren Zyrtare. Lidhur me kërkimin e tyre, gjykata e shkallës së parë ka argumentuar se ngjarja ka ndodhur në

datën 31.1.2011 dhe se në atë kohë legjislacioni në fuqi ishte ligji nr. 10076/2009, ndaj për llogaritjen e masës së dëmit duhej të merrej në konsideratë vendimi unifikues nr. 12/2007. Ndërsa ka argumentuar se rregullorja e AMF-së nr. 53/2009, dalë në zbatim të këtij ligji, nuk mund të zbatohej për zgjidhjen e rastit konkret, pasi nuk ka qenë në fuqi në momentin e ndodhjes së aksidentit për shkak se nuk ishte botuar në Fletoren Zyrtare (*shih paragrafët 2 dhe 3 të vendimit*). Arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë për këtë çështje nuk është gjetur i drejtë nga gjykata e apelit, e cila e ka ndryshuar atë. Edhe ajo gjykatë ka vlerësuar se legjislacioni në fuqi në momentin në të cilin ka ndodhur ngjarja e sigurimit ishte ligji nr. 10076/2009, megjithatë për llogaritjen e masës së dëmit ajo gjykatë ka pranuar si të drejtë variantin e dytë të përllogaritjes që ekspertët kanë bërë duke u bazuar në rregulloren e AMF-së nr. 53/2009, për rrjedhojë ka ulur shumën e dëmshpërblimit që do të përfitonin kërkuesi dhe subjekti i interesuar Zenepe Topi (*shih paragrafin 4 të vendimit*).

20. Ndonëse kërkuesi ka ushtruar rekurs, duke parashtruar edhe shkakun që lidhej me (mos)hyrjen në fuqi të rregullores së AMF-së nr. 53/2009, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e tij, duke vlerësuar se shkaqet e parashtruara në të nuk bënin pjesë në ato të parashikuara në nenin 472 të KPC-së. Sipas Gjykatës së Lartë, gjykata e apelit ka interpretuar dhe zbatuar drejt ligjin material që ka shërbyer për zgjidhjen e mosmarrëveshjes (*shih paragrafin 5 të vendimit*).

21. Duke shqyrtuar përmbajtjen e vendimeve gjyqësore në raport me rrethanat e çështjes, Gjykata konstaton se gjykatat e faktit, në të njëjtën linjë, kanë çmuar se ligji i zbatueshëm në rastin konkret ishte ligji në fuqi në momentin e ndodhjes së aksidentit, pra ligji nr. 10076/2009. Për sa i takon përllogaritjes së masës së dëmshpërblimit që do të përfitonin kërkuesi dhe subjekti i interesuar Zenepe Topi, gjykata e shkallës së parë i është referuar përllogaritjes së bërë në bazë të vendimit unifikues nr. 12/2007, ndërsa gjykata e apelit e ka konsideruar të gabuar këtë, duke pranuar përllogaritjen e bërë në bazë të rregullores nr. 53/2009 të AMF-së, ndonëse nuk ka referuar shprehimisht në këtë të fundit. Në rekursin e kërkuesit është ngritur, ndër të tjera, edhe pretendimi për sa i përket identifikimit dhe zbatimit nga ana e gjykatës së apelit të ligjit të zbatueshëm për shkak të së cilës është krijuar mosmarrëveshja mes palëve, konkretisht për zbatimin me fuqi prapavepruese të rregullores së AMF-së nr. 53/2009, pretendime të cilat, në thelb, kanë të bëjnë me parimet e sigurisë juridike dhe të hierarkisë së akteve, ashtu sikundër edhe me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, që kanë natyrë kushtetuese. Megjithatë, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit me një arsyetim të kufizuar, duke mos i dhënë përgjigje pretendimit kryesor të kërkuesit se cili është kuadri ligjor i zbatueshëm në rastin konkret, në kushtet që ndodhej përpara dy vendimeve që përmbajnë qëndrime të kundërta lidhur me kuadrin ligjor të zbatueshëm, për pasojë edhe analizë dhe vlerësim ligjor të ndryshëm të çështjes nga ana e tyre. Kjo situatë kërkonte nga Gjykata e Lartë që në ushtrimin e rolit të saj si gjykatë e ligjit të verifikonte pikërisht mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Gjykata e Lartë ka çmuar se gjykata e apelit ka respektuar ligjin material, duke e interpretuar dhe zbatuar drejt atë, megjithatë ajo duket se ka mbajtur një qëndrim formalist dhe pa i dhënë përgjigje në substancë pretendimit kyç që lidhej me moszbatueshmërinë e një akti që, sipas kërkuesit, nuk ishte në fuqi në kohën e ngjarjes.

22. Gjykata ka vënë në dukje edhe më parë se në rastet e shpërblimit të dëmit nga aksidentet, çështjet e veprimit të ligjit në kohë ose të vendosjes respektive hierarkike të normave në konflikt hyjnë në sferën e kompetencës së gjykatave të zakonshme. Dyshimet në lidhje me veprimin në kohë të normave juridike duhet të zgjidhen nga gjykatat e zakonshme, bazuar në parashikimet kushtetuese që përcaktojnë momentin e hyrjes në fuqi të tyre (neni 117 i Kushtetutës), si edhe bazuar në parimin kushtetues të hierarkisë së akteve ligjore (nenet 4 dhe 116 të Kushtetutës), nga të cilat burojnë edhe parimet ku bazohen gjykatat për përcaktimin e ligjit të zbatueshëm në rast të përplasjeve mes normave me fuqi të njëjtë ose të ndryshme juridike (*shih vendimet nr. 31, datë 2.5.2025; nr. 82, datë 26.11.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Po kështu, Gjykata risjell në vëmendje se vetëm një vendim i arsyetuar i jep asaj mundësinë të vlerësojë nëse gjykatat e zakonshme kanë marrë në shqyrtim pretendimet kryesore të palëve dhe mënyrën sesi i kanë trajtuar ato. Veçanërisht kur bëhet fjalë për pretendime me natyrë kushtetuese, në kuadër të parimit të subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe

juridiksionit të zakonshëm gjyqësor, mungesa e arsyetimit të Gjykatës së Lartë e vë në vështirësi/pamundësi Gjykatën për të vlerësuar nëse ajo i ka marrë në shqyrtim dhe nëse i ka vlerësuar ato pretendime (*shih vendimet nr. 31, datë 2.5.2025; nr. 82, datë 26.11.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Nisur nga sa më sipër, Gjykata çmon se Gjykata e Lartë, në ushtrim të funksionit të saj, duhej të kishte mbajtur një qëndrim të shprehur dhe të arsyetuar në drejtim të kuadrit ligjor të zbatueshëm në rastin konkret, në përputhje edhe me parimet kushtetuese edhe me praktikën e kësaj Gjykate. Kjo me qëllim që kërkuesi të merrte një përgjigje për sa i takon zbatueshmërisë së kuadrit ligjor në zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi. Në këto kushte, në kontekst të rrethanave të rastit konkret, mospranimi i rekursit të kërkuesit nga Gjykata e Lartë, duke u mjaftuar vetëm me parashtrimin në vendim të shkaqeve të rekursit dhe me arsyetimin *de plano* se këto shkaqe nuk janë nga ato të parashikuara nga ligji, pa u dhënë përgjigje të arsyetuara pretendimeve me natyrë kushtetuese, të çon në përfundimin se zbatimi i ligjit nga ajo vë në dyshim të drejtën e procesit të rregullt ligjor në aspektin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

25. Në përmbledhje të argumenteve të mësipërme, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor nga Gjykata e Lartë është i bazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2025-681, datë 5.2.2025, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 28.5.2026.
Shpallur më 7.7.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji
Anëtarë: Sandër Beci, Marsida Xhaferllari, Marjana Semini, Genti Ibrahimi, Ilir Toska, Sonila Bejtja
Anëtarë kundër: Asim Vokshi

MENDIM PAKICE

1. Në shqyrtimin e çështjes që i përket kërkesës së kërkuesit Xhevat Topi, me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2025-681, datë 5.2.2025, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën, dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë, unë, gjyqtari Asim Vokshi, jam kundër vendimit të shumicës për pranimin e kërkesës, për arsyet e mëposhtme.

2. Shumica vendosi shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë dhe kthimin e çështjes për rigjykim pranë asaj gjykate, pasi gjeti cenim të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit, për shkak se Gjykata e Lartë nuk kishte mbajtur qëndrim të arsyetuar për pretendimin e kërkuesit të parashtruar në rekurs në lidhje me zbatimin e rregullores së AMF-së nr. 53/2009, e cila, sipas tyre, nuk duhej të gjente zbatim, pasi nuk kishte hyrë në fuqi në kohën e ndodhjes së aksidentit.

3. Në vlerësimin tim si gjyqtar në pakicë, siç është pranuar në jurisprudencën e Gjykatës dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, jo çdo "gabim" procedural justifikon cenimin e vendimmarrjes së gjykatave të zakonshme. Vetëm gabimet procedurale që pasjellin njëkohësisht dëmtimin serioz edhe të një të drejte substanciale mund të pasjellin cenimin e vendimmarrjes së gjykatave. Cenimi i kërkuesit nga mungesa e arsyetimit të detajuar të një kërkimi të tij, për të cilin Gjykata e Lartë ka mbajtur një qëndrim konstant në jurisprudencën e saj, nuk paraqitet i një rëndësie të tillë që të përbëjë shkak për shfuqizimin si antikushtetuese të vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë. Pala kishte mundësi të njihte jurisprudencën konstante të Kolegjit Civil, i cili, duke lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit që pranonte përllogaritjen e bërë në bazë të rregullores së AMF-

së nr. 53/2009, e ka bërë të vetin atë arsyetim, duke i dhënë kësisoj indirekt përgjigje pretendimeve të kërkuesit. Ky i fundit, nga ana e tij, ishte i detyruar që konform nenit 472 të KPC-së të identifikonte raste të praktikës njësuese ose zhvilluese të Kolegjit Civil, që mbështesnin pretendimet e veta në rekurs, në mënyrë që gjykata të shprehej në mënyrë të detajuar (çka nuk rezulton të jetë bërë bindshëm prej tij).

4. Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës, në vendimin e saj nr. 94, datë 17.7.2022, ka theksuar se: "*dyshimet për veprimin në kohë të normave juridike duhet të zgjidhen nga gjykatat e zakonshme bazuar në parashikimet kushtetuese që përcaktojnë momentin e hyrjes në fuqi të tyre (neni 117 i Kushtetutës), si dhe bazuar në parimin kushtetues të hierarkisë së akteve ligjore (nenet 4 dhe 116 të Kushtetutës), nga të cilat burojnë edhe parimet ku bazohen gjykatat për përcaktimin e ligjit të zbatueshëm në rast të përplasjeve mes normave me fuqi të njëjtë ose të ndryshme juridike*". Citimi i nenit 117 të Kushtetutës në fakt u jep përgjigje edhe pretendimeve me natyrë kushtetuese të kërkuesit dhe duhej të çonte gjykatën në rrëzimin e kërkimit të tij.

5. Në vlerësimin tim si gjyqtar në pakicë, çështja kushtetuese paraqitet më e lehtë për t'u zgjidhur nëse mbahen parasysh përcaktimet e nenit 117, pika 1, të Kushtetutës, neneve 3, pika 26, 10 dhe 58, të ligjit nr. 10076/2009 dhe sidomos të nenit 3, të ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006, "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", të ndryshuar, *(ligji nr. 9572/2006)*, sipas të cilit AMF-ja është person juridik, publik, me qendër në Tiranë, e cila është e pavarur në ushtrimin e kompetencave të përcaktuara në këtë ligj ose në legjislacionin në fuqi dhe nuk lejohet ndërhyrja në veprimtarinë e saj, që mund të cenojë pavarësinë e autoritetit. Dukshëm në këtë rast AMF-ja nuk klasifikohet brenda konceptit kushtetues të "institucioneve të tjera qendrore", për të cilat flet paragrafi i parë i nenit 117 të Kushtetutës. Ndaj, për hyrjen në fuqi të akteve nënligjore të këtij personi juridik publik të pavarur, nuk është parakusht botimi i tyre në Fletoren Zyrtare. Sipas nenit 117, pika 2, të Kushtetutës shpallja dhe botimi i akteve normative nënligjore të AMF-së bëhet sipas parashikimeve ligjore.

6. Rregullorja e AMF-së nr. 53/2009, duke qenë se sipas nenit 1, pika 2, të saj u drejtohet vetëm shoqërive të sigurimit, Byrosë Shqiptare të Sigurimit, vlerësuesve të dëmeve në sigurime dhe strukturave të specializuara për trajtimin e dëmeve dhe jo publikut të gjerë, nuk kërkon botimin e saj në Fletoren Zyrtare. Pikërisht, për këtë arsye, në nenin 51, pika 3, të kësaj rregullore parashikohet: *"Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e botimit të saj në faqen elektronike zyrtare të Autoritetit."*. Sipas nenit 114, pika 1, të Kodit të Procedurave Administrative të vitit 1999: "*1. Botimi i akteve administrative është i detyrueshëm vetëm kur një gjë e tillë kërkohet nga ligji.*". Ndërsa sipas dispozitave të ligjit nr. 10076/2009 dhe ligjit nr. 9572/2006, pikërisht sepse AMF-ja nuk është institucion qendror i administratës publike, aktet nënligjore të miratuara prej saj, të cilat u drejtohen profesionistëve, nuk kërkohet shprehimisht nga ligjet sektoriale që të botohen në Fletoren Zyrtare për efekt të hyrjes së tyre në fuqi.

7. Kushtetuta në nenin 145, pika 1, të saj detyron gjyqtarët që në zgjidhjen e çështjeve t'i nënshtrohen gjithnjë vetëm Kushtetutës dhe ligjeve, e në rast se ndonjë akt nënligjor bie ndesh me ligjin ose me Kushtetutën, ato e zgjidhin çështjen duke zbatuar drejtpërdrejt këto të fundit. Rregullorja e AMF-së nr. 53/2009 nuk është detyruese për gjykatat, por ato kanë të drejtë ta mbajnë atë parasysh, nëse binden se zbatimi i saj sjell zgjidhjen e drejtë të çështjes. Fakti që Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në rastin konkret nuk ka gjetur problematika të zbatimit të ligjit në lidhje me masën e shpërblimit, nuk prodhon mosmarrëveshje kushtetuese për sa kohë që dëmshpërblimi që ata kanë marrë është bazuar në kritere objektive e që zbatohen njësoj për të gjithë e mbi të gjitha që nuk bien ndesh me ligjin. Ndaj, në këtë rast, nuk shihet e arsyeshme që Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë të mblidhet e t'i japë përgjigje çdo pretendimi të kërkuesit, për sa kohë që pretendimet e tij lidhen me çështje fakti, domethënë me masën e shpërblimit, për të cilën nuk ka ngritur argumente bindëse, për ta trajtuar atë si çështje të mirëfilltë ligji, për shkak të caktimit të vlerave nga gjykata e apelit në kundërshtim me kriteret ligjore. Fakti që nëse zbatohej vendimi unifikues nr. 12/2007, i Gjykatës së Lartë (*i cili nuk zbatohet në këtë fushë për shkak të hyrjes në fuqi të ligjit të ri nr. 10076/2009 dhe rregullores së AMF-së nr. 53/2009, e cila nuk ka nevojë të botohet në Fletoren Zyrtare*), kërkuesi do të mund të merrte një shpërblim më të lartë, nuk përbën në vetvete çështje kushtetuese ose ligjore, por çështje fakti që lidhet me vlerësimin e rrethanave të secilës çështje dhe zbatimin e njëllojtë të metodologjisë së vlerësimit për të gjitha palët. Detajimet e rregullores së AMF-së nr. 53/2009, zbatohen nga gjykatat vetëm brenda limiteve që parashikon ligji, pasi në të kundërt ato e zgjidhin mosmarrëveshjen bazuar në kriteret dhe

kufijtë që vendos ligji, duke anashkaluar rregulloren. Kërkuesi nuk ka argumentuar bindshëm ndonjë çështje kushtetuese në këtë drejtim, ndaj kërkesa e tij duhej të ishte rrëzuar.

Anëtar: Asim Vokshi

VENDIM
Nr. 173, datë 22.6.2026

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "SPV BLUE 3" SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa "a", 38 pika 1, germa "a", 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa "a", 5, pika 1, germa "a", 13 dhe 14, pika 9, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15, të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.6.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1101/9 prot., datë 18.6.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës "Mbi kërkesën e shoqërisë 'SPV Blue 3' sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "SPV Blue 3" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1101 prot., datë 8.4.2026, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaik "Blue 3", me vendndodhje në Sheq Marinas, me kapacitet të instaluar 36 mw, për një afat 30-vjeçar.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 106, datë 21.4.2026, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 22.4.2026 dhe 23.4.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 21.5.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen e internetit të ERE-s.

- ERE, po ashtu, ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure, nëpërmjet shkresës nr. 1101/3 prot., datë 27.4.2026, ku i ka kërkuar të bëjë me dije nëse nga ana e saj ka një qëndrim ndryshe në lidhje me vlefshmërinë e marrëveshjes dhe të drejtën e shoqërisë për ndërtimin dhe shfrytëzimin e këtij burimi gjenerues. Nga ana e MIE-s nuk ka pasur një përgjigje.

- Me shkresën nr. 1101/4 prot., datë 27.4.2026, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e fillimit të procedurës dhe i ka kërkuar depozitimin e dokumentacionit/informacionit të munguar.

- Në përgjigje, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1101/5 prot., datë 5.5.2026, shoqëria ka depozituar informacion/dokumentacion shtesë, nga analizimi i të cilit u vlerësua i nevojshëm zhvillimi i komunikimit të mëtejshëm me shoqërinë, për sa i përket korrespondencës së zhvilluar me MIE-n në lidhje me krijimin e shoqërisë për qëllime të veçanta dhe nënshkrimin e marrëveshjes përfundimtare. Si e tillë, ERE iu drejtua me shkresën me nr. 1101/6 prot., datë 25.5.2026.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1101/7 prot., datë 28.5.2026 dhe *email*-in e datës 17.6.2026, shoqëria ka depozituar komunikimin e zhvilluar me MIE-n, në lidhje me krijimin e shoqërisë për qëllime të veçanta, ku MIE shprehet parimisht dakord për krijimin e shoqërisë "SPV Blue 3" sh.p.k. Rezulton se nuk është nënshkruar ende marrëveshja përfundimtare, por duke qenë se vetë shoqëria ka parashikuar se do të vendosë në punë centralin brenda muajit shtator 2028, vlerësohet t'i lihet kusht që të raportojë në ERE për nënshkrimin e Marrëveshjes Përfundimtare, brenda datës së parashikuar nga ana e saj për operimin, pra brenda datës 30.0=9.2028.

- Nga analizimi i këtij aplikimi, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar nga "Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera:

- Shoqëria "SPV Blue" sh.p.k. ka depozituar në ERE "Marrëveshjen për Zhvillimin e projektit në lidhje me projektimin, financimin, ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e Impiantit Fotovoltaik Blue 3, me një kapacitet të instaluar prej 36 mwac dhe kapacitet të mbështetur prej 36 mwac, që do vendoset në Sheq Marinas, Fier, nr. 6122/3 prot., datë 10.12.2024, nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe Bashkimit të përkohshëm të shoqërive "Blessed Investment" sh.p.k. dhe "Matrix Konstruksion" sh.p.k.

Po ashtu, rezulton se shoqëria:

- Ka nënshkruar me shoqërinë "Operatori i Sistemit të Transmetimit" (OST) sh.a. "Marrëveshjen për lidhjen në rrjetin e transmetimit të parkut fotovoltaik Blue 3", më datë 24.10.2025.

- Është pajisur me vendim për VNM paraprake nr. AN090720250011, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, më 29.10.2025, për zhvillimin e projektit "Parku Fotovoltaik – Blue 3".

Kushtet dhe afatet ligjore:

- ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, germa "a", të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Shoqëria ka depozituar garancinë për panelet nga ku rezulton se jetëgjatësia e tyre është 30 vjet, si e tillë dhe licenca e ERE-s do të ketë një vlefshmëri prej 30 vjetësh.

- Shoqëria ka kërkuar që afati 30-vjeçar të fillojë me operimin e veprës, pas kalimit të provës 72-orëshe të testimit dhe komisionimit nga OST sh.a. Sa kërkuar nga shoqëria vlerësohet se mbështetet dhe në Marrëveshjen e zhvillimit të Projektit, të nënshkruar më datë 10.12.2024 me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, ku në faqen 4 të saj referohet se data e operimit tregtar nënkupton fillimisht orën 00.00 (ora lokale) të datës që vjen menjëherë pas datës në të cilën është kryer Kolaudimi, ndaj afati i vlefshmërisë së licencës së shoqërisë vlerësohet të fillojë nga kolaudimi i veprës.

- Shoqëria disponon një VNM paraprake të vlefshme deri në datën 29.10.2027 dhe vetë shoqëria ka bërë me dije në shtojcën 2 që punimet do të fillojnë në vitin 2027, ndaj vlerësohet t'i lihet detyrë që të depozitojë në ERE informacion periodik, çdo 3 muaj, për fillimin e punimeve deri jo më vonë se afati përfundimtar i VNM-së paraprake, pra deri më 29.10.2027.

- Rezulton se shoqëria nuk ka nënshkruar ende marrëveshjen përfundimtare, por duke qenë se vetë shoqëria ka parashikuar se do të vërë në punë centralin brenda muajit shtator 2028, vlerësohet t'i lihet kusht që të raportojë në ERE për nënshkrimin e marrëveshjes përfundimtare brenda datës së parashikuar nga ana e saj për operimin, pra brenda datës 30.9.2028.

- Po ashtu, në lidhje me sa parashikuar në pikën 6.8 të marrëveshjes së zhvillimit të nënshkruar me MIE-n, në lidhje me procedurën e kolaudimit të veprës, vlerësohet që t'i lihet kusht shoqërisë që, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës.

- ERE rezervon të drejtën e rishikimit të këtij vendimi, në rast të depozitimit të sa lënë detyrë shoqërisë dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "SPV Blue 3" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaik "Blue 3", me kapacitet të instaluar 36 mw, me vendndodhje në Sheq Marinas, Bashkia Fier, për një afat 30-vjeçar, duke filluar ky afat nga kolaudimi i veprës.

2. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE informacion periodik (çdo 3 muaj) për fillimin e punimeve deri më 29.10.2027.

3. Shoqëria duhet të raportojë në ERE për nënshkrimin e marrëveshjes përfundimtare, brenda datës 30.9.2028.

4. Jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga kolaudimi i veprës, shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës të kolaudimit.

5. Ky vendim është objekt rishikimi, në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të pikave 2, 3 dhe 4 të këtij vendimi, si dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.

6. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë "SPV Blue 3" sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, OST sh.a. dhe ALPEX sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 174, datë 22.6.2026

MBI MODIFIKIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË "5GX ENERGY" SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 10 mw

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 11, pika 3 e ligjit nr. 24/2023, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme"; neneve 13, 14, pika 9 dhe 15 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.6.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1570/7 prot., datë 18.6.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës "Mbi kërkesën e shoqërisë '5GX Energy' sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 10 mw",

konstatoi se:

1. Të dhëna për shoqërinë

- Shoqëria "5GX Energy" sh.p.k. është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 135, datë 9.7.2024, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 10 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale 1020, fshati Allprenaj, Njësia Administrative Golem, Bashkia Lushnjë, qarku Fier.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1570 prot., datë 12.5.2026, shoqëria ka paraqitur kërkesën për modifikimin e aneksit A të licencës së saj, duke shtuar në të dhe sistemet e akumulimit/ depozitimit të energjisë, si vepra ndihmëse.

- Nëpërmjet vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 272, datë 4.5.2023 dhe kontratës nr. 2175 rep., nr. 484 kol., datë 23.6.2023, të nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), shoqëria është pajisur me të drejtën Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në zonën kadastrale nr. 1020, fshati Allprenaj, Njësia Administrative Golem, Bashkia Lushnjë, qarku Fier.

- Në nenin 11, pika 3, e ligjit nr. 24/2023, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", parashikohet se: "Prodhuesit me përparësi kanë të drejtë të përdorin objektet e tyre ose objekte të tjera të depozitimit duke mbuluar të gjitha kostot për të zbutur efektin e disbalancës dhe, në rast se skemat e tyre mbështetëse e lejojnë, të përfitojnë nga diferencat për orë përmes zhvendosjes së injektimit në rrjet".

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 133, datë 21.5.2026, vendosi të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 10 mw, duke shtuar veprat ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë elektrike në aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 22.5.2026 dhe 23.5.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 1.6.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen e internetit të ERE-s.

- ERE, me shkresën nr. 1570/3, datë 26.5.2026, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së saj, si dhe i ka bërë me dije në lidhje me informacionin/dokumentacionin që duhet të plotësohet për këtë aplikim.

- Për fillimin e kësaj procedure, ERE ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a. nëpërmjet shkresës nr. 1570/4, datë 26.5.2026. Me shkresën nr. 1570/6 prot., datë 2.6.2026, ERE ka njoftuar edhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a. Nga ana e tyre nuk rezulton të ketë pasur ndonjë qëndrim në lidhje me këtë procedurë.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1570/5 prot., datë 1.6.2026, shoqëria ka depozituar informacionin/dokumentacionin e kërkuar.

- Për sa argumentuar nga shoqëria në lidhje me kapacitetin e veprave ndihmëse/njësive të depozitimit të energjisë, në kushtet kur kapaciteti prodhues nuk i mbivendoset apo shtohet kapacitetit aktual të licencuar, për qëllime të modifikimit të kësaj licence dhe pasqyrimit të elementeve përkatëse në aneksin A të saj, ERE do të njohë fuqinë e instaluar prej 10 mw.

- Në këto rrethana, vlerësohet që t'i lihet kusht shoqërisë, që brenda datës 1.10.2026 të raportojë në ERE, në lidhje me ecurinë e zbatimit të projektit për vendosjen e veprave ndihmëse sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

- Nga analiza e aplikimit, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar në zbatim të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe ka shlyer pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI**:**

1. Të modifikojë licencën e shoqërisë "5GX Energy" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 135, datë 9.7.2024, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 10 mw, duke shtuar veprat ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë elektrike në aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit.

2. Brenda datës 1.10.2026, shoqëria duhet të raportojë në ERE në lidhje me ecurinë e zbatimit të projektit për vendosjen e veprave ndihmëse sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

3. Ky vendim është objekt rishikimi në varësi të plotësimit/mosplotësimit të kushtit të vendosur në pikën 2 të këtij vendimi, si dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë "5GX Energy" sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe shoqërinë "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 175, datë 22.6.2026

MBI ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË "ERSEKA SOLAR PARK 1" SHPK PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 20 mw

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 92 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave

Administrative i Republikës së Shqipërisë"; si dhe nenit 15 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.6.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1082/13 prot., datë 18.6.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Erseka Solar Park 1' sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 20 mw",

konstatoi se:

- Shoqëria "Erseka Solar Park 1" sh.p.k. është licencuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 176, datë 18.5.2023, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 20 mw, në zonën kadastrale nr. 3510, fshati Starje, Njësia Administrative Qendër Ersekë, Bashkia Kolonjë, qarku Korçë.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1082 prot., datë 3.4.2026, shoqëria ka paraqitur kërkesën për modifikim, për ndryshim në aneksin A të licencës së saj, duke shtuar në të dhe sistemet e akumulimit/depozitimit të energjisë, si vepra ndihmëse, pa ndryshuar kapacitetin total të centralit, prej 20 mw.

- Në vijim të këtij aplikimi, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 110, datë 21.4.2026, vendosi të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure në datat 22.4.2026 dhe 23.4.2026. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresat nr. 1082/4 prot., datë 24.4.2026 dhe nr. 1082/9 prot., datë 1.6.2026, ERE ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës dhe informacionin/dokumentacionin që duhet të plotësohet për këtë aplikim. Shoqëria ka kthyer përgjigje përkatësisht me shkresat nr. 1082/5 prot., datë 14.5.2026 dhe nr. 1082/10 prot., datë 8.6.2026.

- Për fillimin e kësaj procedure, ERE ka njoftuar dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 1082/3 prot., datë 24.4.2026. Nga ana e tyre nuk rezulton të ketë pasur ndonjë qëndrim në lidhje me këtë procedurë.

- Brenda afatit të pritjes së komenteve, apo objeksioneve nga palët e treta, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1082/7 prot., datë 20.5.2026, ka paraqitur objeksionet e tij z. A.Q., të cilat i janë vënë shoqërisë në dispozicion, nëpërmjet shkresës së ERE-s me nr. 1082/8 prot., datë 1.6.2026, duke i kërkuar sqarimet/argumentimet për çdo objeksion. Shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1082/12 prot., datë 11.6.2026, ka depozituar sqarimet/shpjegimet në lidhje me objeksionet e paraqitura.

- Po ashtu, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1082/11 prot., datë 10.6.2026, z. A.Q. ka depozituar objeksione/argumente shtesë në vijim të sa paraqitur më herët nga ana e tij.

Zgjatja e vendimmarrjes

- Duke u mbështetur në përcaktimet e nenit 92, të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", me qëllim shqyrtimin e objeksioneve të ardhura dhe parashtrimet e depozituara nga shoqëria për këto objeksione, vlerësohet zgjatja deri në 30 (tridhjetë) ditë të afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për aplikimin e shoqërisë "Erseka Solar Park 1" sh.p.k. për modifikimin e licencës, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 176, datë 18.5.2023, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 20 mw, për shtimin e veprave ndihmëse/njësive të depozitimit të energjisë në aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë "Erseka Solar Park 1" sh.p.k. për modifikimin e licencës, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 176, datë 18.5.2023, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 20 mw, për shtimin e veprave ndihmëse/njësive të depozitimit të energjisë në aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë z. A.Q. dhe

shoqërinë "Erseka Solar Park 1" sh.p.k., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 176, datë 22.6.2026

MBI ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË "ERSEKA SOLAR PARK 2" SHPK PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 20 mw

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 92, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.6.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1081/14 prot., datë 18.6.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Erseka Solar Park 2' sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 20 mw",

konstatoi se:

- Shoqëria "Erseka Solar Park 2" sh.p.k. është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 253, datë 23.8.2023, të ndryshuar, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 20 mw, në zonën kadastrale nr. 3510, fshati Starje, Njësia Administrative Qendër Ersekë, Bashkia Kolonjë, qarku Korçë.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1081 prot., datë 3.4.2026, shoqëria ka paraqitur kërkesën për saktësim/modifikim të aneksit A të licencës së saj, duke shtuar në të dhe sistemet e akumulimit/depozitimit të energjisë, si vepra ndihmëse, pa ndryshuar kapacitetin total të centralit, prej 20 mw.

- Në vijim të këtij aplikimi, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 109, datë 21.4.2026, vendosi të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë për prodhimin e energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure në datat 22.4.2026 dhe 23.4.2026. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresat nr. 1081/6 prot., datë 27.4.2026, dhe me nr. 1081/9 prot., datë 1.6.2026, ERE ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës dhe informacionin/dokumentacionin që duhet të plotësohet në këtë aplikim. Shoqëria ka kthyer përgjigje përkatësisht me shkresat nr. 1081/7 prot., datë 14.5.2026 dhe nr. 1081/8 prot., datë 20.5.2026.

- Për fillimin e kësaj procedure, ERE ka njoftuar dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 1081/5 prot., datë 27.4.2026. Nga ana e tyre nuk rezulton të ketë pasur ndonjë qëndrim në lidhje me këtë procedurë.

- Brenda afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga palët e treta, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1627 prot., datë 19.5.2026, ka paraqitur objeksionet e tij z. A. Q., të cilat i janë vënë shoqërisë në dispozicion, nëpërmjet shkresës së ERE-s me nr. 1627/1 prot., datë 1.6.2026, duke i kërkuar sqarimet/argumentimet për çdo objeksion. Shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1081/12 prot., datë 11.6.2026, ka depozituar sqarimet/shpjegimet në lidhje me objeksionet e paraqitura.

- Po ashtu, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1081/11 prot., datë 10.6.2026, z. A. Q. ka depozituar objeksione/argumente shtesë në vijim të sa paraqitur më herët nga ana e tij.

Zgjatja e vendimmarrjes

- Duke u mbështetur në përcaktimet e nenit 92, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", me qëllim shqyrtimin e objeksioneve të ardhura dhe parashtrimet e depozituara nga shoqëria për këto objeksione, vlerësohet zgjatja deri në 30 (tridhjetë) ditë e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për aplikimin e shoqërisë "Erseka Solar Park 2" sh.p.k. për modifikimin e licencës, në veprimtarinë e

prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 253, datë 23.8.2023, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 20 mw, për shtimin e objekteve të depozitimit të energjisë në aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë "Erseka Solar Park 2" sh.p.k. për modifikimin e licencës, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 253, datë 23.8.2023, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 20 mw, për shtimin e objekteve të depozitimit të energjisë në aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë z. A. Q. dhe shoqërinë "Erseka Solar Park 2" sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 177, datë 29.6.2026

MBI IMPLEMENTIMIN E INTERVALIT KOHOR 15 MINUTA NË OPERIMIN E PROCESEVE NË TREGUN E BALANCIMIT

Në mbështetje të nenit 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 104, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.6.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 449/11 prot., datë 22.6.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Zhvillimit të Burimeve të Rinovueshme "Mbi implementimin e intervalit kohor 15 minuta në operimin e proceseve në tregun e balancimit",

konstatoi se:

I. Vendimmarrja rregullatore në fuqi dhe intervali aktual i proceseve

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 327, datë 18.12.2025, "Mbi implementimin e intervalit kohor 15 minuta në operimin e proceseve në tregun e balancimit", ndër të tjera vendosi zgjatjen e efekteve juridike të pikës 1, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 117, datë 3.6.2025, deri më 30.6.2026, si dhe detyrimin e "OST" sh.a. që të bashkëveprojë me "ALPEX" sh.a. dhe "KESH" sh.a., si dhe të vijojë komunikimin me të gjithë pjesëtarët e tregut, lidhur me gatishmërinë e tyre për implementimin e intervalit kohor 15-minutësh. Po ashtu, në kuptim të këtij vendimi "OST" sh.a. duhet që të raportojë çdo muaj në ERE dhe të vijojë me testimet përkatëse për implementimin e intervalit kohor 15-minutësh. Po ashtu, "KESH" sh.a. dhe "ALPEX" sh.a. duhet që të raportojnë çdo dy (2) muaj në ERE, përkatësisht lidhur me zbatimin e projektit që mundëson implementimin e intervalit kohor 15-minutësh në tregun e balancimit dhe mbi ecurinë e përzgjedhjes së ofruesit të shërbimit përkatës.

- Me zgjatjen e efekteve juridike të vendimit të ERE-s nr. 117, datë 3.6.2025, deri më 30.6.2026, periudha kohore e proceseve në të cilat përfshihen edhe nominimet dhe llogaritjet respektive të disbalancave kanë vijuar të kryhen me interval kohor prej 1 ore për periudhën e sipërcituar.

- Zgjatja e efekteve juridike të vendimit të ERE-s nr. 117, datë 03.06.2025, deri më 30.06.2026, u realizua me qëllim dhënien e mundësisë për përshtatjen e "OST" sh.a. në aplikimin e intervalit me rezolucion 15-minutësh nëpërmjet realizimit të testimit *dry run* të këtij intervali në tregun shqiptar të balancimit të energjisë elektrike, realizimin nga "ALPEX" sh.a. të proceseve të nevojshme, përfshirë dhe testimin, në mënyrë që edhe bursa të aplikojë rezolucionin 15-minutësh në tregun e energjisë elektrike, angazhimin e palëve përgjegjëse të balancimit në testimin *dry run* që do të realizohet nga "OST" sh.a., me qëllim adoptimin me këtë rezolucion në tregun e balancimit, si dhe realizimin e ndërhyrjeve të nevojshme të ofertuesve të shërbimit të balancimit, me qëllim ofrimin e këtij shërbimi në tregun e balancimit me rezolucion 15-minutësh.

II. Njoftimi i vendimit dhe raportimet e subjekteve

- ERE, me shkresën nr. 2559/15 prot., datë 24.12.2025, njoftoi shoqëritë "KESH" sh.a., "FTL" sh.a., "OST" sh.a., "Devoll Hydropower" sh.a., "Ayen AS Energji" sh.a., shoqatën "AAES", shoqatën "AREA", si dhe operatorin e bursës "ALPEX" sh.a., mbi vendimin nr. 327/2025.

- Në zbatim të pikës 2, të vendimit nr. 327/2025, "OST" sh.a. ka bërë me dije se ka organizuar takime *online* me të gjitha palët e tregut, me qëllim referimin dhe diskutimin e çdo problematike të hasur gjatë procesit të testimeve, si dhe për të adresuar çështje që lidhen me gatishmërinë për implementimin e intervalit kohor 15-minutësh. Përgjatë takimeve të realizuara nga ana e OST-së është evidentuar pjesëmarrja e ulët në testime si nga ana e OSHB-ve ashtu edhe nga ana e PPB-ve, të cilët në një pjesë të konsiderueshme të rasteve nuk kanë paraqitur nominimet e tyre; kanë nominuar programe jo të plota dhe të paazhornuara me të dhënat reale.

- Në zbatim të pikës 3, të vendimit nr. 327/2025, "OST" sh.a. ka raportuar mbi testimet përkatëse të kryera për implementimin e intervalit kohor 15-minutësh, për periudhat janar–maj 2026, me shkresën nr. 1040 prot., datë 6.2.2026, protokolluar në ERE me nr. 597 prot., datë 10.2.2026; shkresën nr. 1775 prot., datë 5.3.2026, protokolluar në ERE me nr. 848 prot., datë 9.3.2026; shkresën nr. 2383 prot., datë 3.4.2026, protokolluar në ERE me nr. 1096 prot., datë 8.4.2026; shkresën nr. 3075 prot., datë 6.5.2026, protokolluar në ERE me nr. 1550 prot., datë 11.5.2026; si dhe shkresën nr. 3633 prot., datë 4.6.2026, protokolluar në ERE me nr. 1791 prot., datë 5.6.2026.

- Raportet e depozituara në ERE përmbajnë informacion të përgjithshëm për hapat e kryera në *dry run* për llogaritjet me rezolucion 15-minutësh nga ana e "OST" sh.a., dhe konsistojnë në procesin e nominimeve të skeduleve të pjesëmarrësve të Tregut Shqiptar të Balancimit; procesin e ankandit të angazhimit për disponueshmëri dhe procesin e ankandit të angazhimit për shpërndarje.

- Shoqëria "ALPEX" sh.a., në zbatim të pikës 4, të vendimit nr. 327/2025, me shkresën nr. 109 prot., datë 13.2.2026, të protokolluar në ERE me nr. 685 prot., datë 19.2.2026, ka informuar se është në hapat e fundit të procesit të paranënshkrimit të kontratës me ofruesin e ri të shërbimeve, se dorëzimi i platformave të tregtimit dhe klerimit për bashkimin e tregjeve Shqipëri–Kosovë DAM dhe IDM me rezolucion (MTU) 60 minuta, 30 minuta dhe 15 minuta pritet të zbatohet deri më 7.5.2026, se testimet me palët e treta parashikohen të realizohen nga 15.5.2026 deri më 24.6.2026, ndërsa testimet me anëtarët e bursës dhe anëtarët e klerimit parashikohet të realizohen deri më 25.6.2026.

- Shoqëria "KESH" sh.a., në zbatim të pikës 4, të vendimit nr. 327/2025, me shkresën nr. 1494 prot., datë 18.3.2026, të protokolluar në ERE me nr. 449/1 prot., datë 19.3.2026, ka informuar se në HEC "Koman" është realizuar implementimi i rezolucionit 15-minutësh dhe duke filluar prej datës 13.3.2026, njësia është gati për operim, ndërsa për HEC "Vau i Dejës", nga kontraktorët përkatës po vijohet puna për mundësimin e implementimit të rezolucionit 15-minutësh në sistemet përkatëse. Në vijim, "KESH" sh.a., me shkresën nr. 2081 prot., datë 29.4.2026, të protokolluar në ERE me nr. 449/2 prot., datë 4.5.2026, ka informuar se implementimi i intervalit kohor 15-minutësh në njësitë prodhuese të HEC "Fierzë" dhe HEC "Vau i Dejës" parashikohet të përfundojë brenda muajit qershor 2026.

III. Seanca dëgjimore dhe qëndrimet e palëve

- ERE, për të pasur një situatë më të plotë mbi ecurinë e këtij procesi edhe me palët e tjera, me shkresën nr. 449/4 prot., datë 7.5.2026, njoftoi zhvillimin e një seance dëgjimore më datë 21.5.2026, ora 11:00. Në seancën dëgjimore të zhvilluar më 21.5.2026, pranë ERE-s morën pjesë përfaqësuesit e shoqërive "OST" sh.a., "FTL" sh.a., shoqata "AREA", "Devoll Hydropower" sh.a., shoqata "AAES", "Ayen AS Energji", "SPV Blue 1" sh.p.k., dhe "ALPEX" sh.a. Shoqëria "KESH" sh.a., u njoftua sikurse subjektet e tjera nëpërmjet shkresës nr. 449/4 prot., datë 7.5.2026, për zhvillimin e kësaj seance dëgjimore, por nuk u paraqit.

- Në seancën dëgjimore të datës 21.5.2026, "FTL" sh.a. u shpreh se ka nominuar rregullisht në interval 15-minutësh dhe ka bashkëpunuar me OST-në që të rakordojë për të kuptuar efektin që ka kalimi nga rezolucioni njëorësh në 15-minutësh, si nga ana e disbalancave në sasi, ashtu edhe në kosto; shoqata "AAES" u shpreh se e konsideron shumë të rëndësishme që "ALPEX" sh.a. të fillojë testimet, në mënyrë që të ketë mundësi të shohë testimet e "OST" sh.a. dhe "ALPEX" sh.a., dhe në këto kushte të rishikohet mundësia për ta shtyrë edhe

gjashtë muaj; "Ayen AS Energji" sh.a., nuk pati asnjë qëndrim gjatë seancës; "Devoll Hydropower" sh.a., u shpreh se janë të gatshëm të marrin pjesë në tregun e balancimit të energjisë elektrike dhe me rezolucion 15-minutësh nga data 1 korrik, kur mbarojnë efektet juridike të vendimit të ERE-s nr. 327, datë 18.12.2025.

- Në të njëjtën seancë, "OST" sh.a., shprehu gatishmërinë dhe pozicionin e saj që ky proces është i realizueshëm teknikisht në çdo moment, duke bërë me dije se platformat dhe sistemet e saj janë gati për 15-minutëshin në tregun balancues dhe në tregun e brendshëm, se me palët e tregut janë kryer takime çdo muaj për këtë proces, si dhe se testimet janë të përditshme sipas proceseve të përcaktuara në tregun e energjisë elektrike dhe gatishmëria ka qenë e plotë 24/7.

- Gjithashtu, "OST" sh.a. risolli në vëmendje se pjesëmarrja, duke marrë në konsideratë vështirësinë dhe rëndësinë financiare të procesit, konsiderohet e ulët, si dhe bëri me dije se procesi i nominimeve në linjat e interkoneksionit vijon të mbetet me intervalin 60 minuta, për shkak të të cilit nuk do të ketë nominime në interkoneksion në intervalin 15 minuta dhe këto nominime do të shumëzohen apo pjesëtohen matematikisht për të rakorduar këto intervale të tregut të brendshëm me atë të skedulimit në interkoneksion.

- "ALPEX" sh.a. u shpreh se gjatë procesit të shqyrtimit të përzgjedhjes së ofruesit të bashkimit të tregjeve, pas zgjedhjes së fituesit, ofruesi i ri i shërbimit të bashkimit të tregjeve u tërhoq nga firmosja e kontratës, ndaj u detyrua të rihapë procedurën e zgjedhjes së ofruesit të ri të shërbimit të bashkimit të tregjeve. Gjithashtu, "ALPEX" sh.a. bëri me dije se e ka të pamundur të kalojë në rezolucionin 15-minutësh në datën 1 korrik 2026, për shkaqe që nuk varen prej saj dhe ishin jashtë proceseve që mund të menaxhoheshin prej saj, ndërsa i pyetur për të dhënë një afat të përfundimit të këtij procesi, përfaqësuesi i ALPEX-it nuk dha ndonjë afat kohor, pasi aktualisht ndodhej në proces të vlerësimit të ofertave.

- "SPV Blue 1" sh.p.k. u shpreh se gjatë periudhës së testimeve nga OST-ja për operimin në intervalin 15 minuta, në të cilën ka marrë pjesë në mënyrë aktive është konstatuar një rritje e volumit të disbalancave në mënyrë artificiale për shkak se një pjesë të nominimit e operon në ALPEX, duke krijuar një rritje të disbalancave; problematika e hasur gjatë këtij operimi në platformën e testit lidhet me pjesën e nominimit me ALPEX-in për katër intervale që janë të njëjta, duke qenë se në vetë parkun fotovoltaik prodhimi nuk është i njëjtë në të katër segmentet çerekorëshe, si dhe me mënyrën se si ofertojnë ofruesit e shërbimeve balancuese. Në këtë kuadër, vlerësoi se është e rëndësishme që intervali 15-minutësh në procesin e tregut balancues të harmonizohet me kalimin e ALPEX-it në 15-minutësh, të paktën gjatë këtyre periudhave të operimit, në mënyrë që faza e testimit të ALPEX-it të zhvillohet njëkohësisht me fazën e testimit të OST-së.

- Shoqata "AREA" u shpreh se duhet të bëhen testimet ashtu siç duhet dhe të mos harrohet qëllimi, duke theksuar se nuk duhet të shkohet te 15-minutëshi për të rritur sigurinë e rrjetit. Gjithashtu, u shpreh se duhet të analizohet se çfarë risie solli 15-minutëshi, nëse u zvogëluan disbalancat negative apo pozitive, nëse u rrit siguria e rrjetit, si dhe çfarë duhet bërë që çmimet të ulen. Në këtë kuadër, theksoi se tregu i disbalancave ka si qëllim rritjen e sigurisë së rrjetit nëpërmjet uljes së disbalancave dhe se mungesa e KESH-it, nga ana e çmimit, është diçka që duhet të merret parasysh.

IV. Kërkesa për informacion drejtuar "KESH" sh.a. pas seancës dëgjimore

- Në vijim të seancës dëgjimore dhe duke qenë se "KESH" sh.a., është ofruesi kryesor i shërbimeve të balancimit në Republikën e Shqipërisë, ERE, me shkresën nr. 449/7 prot., datë 2.6.2026, i kërkoi që të informojë lidhur me gatishmërinë e HEC-eve në administrim të "KESH" sh.a., për implementimin e skedulit 15-minutësh.

- "KESH" sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 2659/1 prot., datë 8.6.2026, të protokolluar në ERE me nr. 449/9 prot., datë 9.6.2026, bën me dije se për shkak të problematikave të hasura në zbatimin e kontratës nga ana e kontraktorit, vlerëson se punimet për HEC-et "Fierzë" dhe "Vau i Dejës" do të përfundojnë brenda 15-ditëshit të parë të muajit korrik.

V. Vlerësime mbi kushtet për implementimin e intervalit kohor 15-minutësh

- Sikurse evidentuar edhe më sipër, aktualisht mbeten të paplotësuara kushtet për të kaluar në një treg balancimi me rezolucion 15-minutësh.

- Ndër më kryesoret vijojnë të jenë harmonizimi i intervaleve në tregun e brendshëm të energjisë elektrike, kalimi në intervalin 15-minutësh si në tregun që operohet nga "ALPEX" sh.a., dhe në

tregun e balancimit, si dhe realizimi i një testimi të plotë nga "OST" sh.a., në *dry run* me interval 15-minutësh me pjesëmarrje sa më të gjerë të pjesëtarëve të tregut të balancimit.

- Harmonizimi i tregut të brendshëm të energjisë elektrike, respektivisht tregut të balancimit që operohet nga "OST" sh.a. dhe tregut DAM, IDM që operohet nga "ALPEX" sh.a., në të njëjtin interval kohor 15 minuta është e nevojshme për të pasur një treg balancimi efikas që synon uljen e disbalancave të kostove respektive.

- Në mënyrë që të kemi një proces testimi të plotë për implementimin e rezolucionit 15-minutësh në tregun shqiptar të balancimit të energjisë elektrike është e nevojshme një pjesëmarrje e "KESH" sh.a., me kapacitet të plotë si ofertuesi kryesor për shërbimet e balancimit në Shqipëri.

- Për rrjedhojë, shtyrja e efekteve juridike të vendimit nr. 327, datë 18.12.2025, deri më datë 31.12.2026, do të shërbejë për të arritur në realizimin e harmonizimit të intervaleve kohore në tregun e brendshëm, si dhe për të rritur efikasitetin e testimeve *dry run* nga "OST" sh.a., brenda këtij intervali kohor.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Periudha kohore e proceseve në të cilat përfshihen nominimet dhe llogaritjet respektive të disbalancave të kryhet me interval kohor prej 1 ore për periudhën 1 korrik 2026 deri më 31 dhjetor 2026.

2. Pjesëtarët e tregut kanë detyrimin të marrin pjesë në proceset e testimeve *dry run* të organizuara nga "OST" sh.a., duke kryer programimin dhe nominimin e programeve në intervale 15-minutëshe duke filluar prej datës 1 gusht 2026.

3. Brenda datës 6 nëntor 2026, shoqëria "OST" sh.a. duhet të përcjellë në ERE një raport vlerësimi për zbatimin e këtij detyrimi, për sa përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, për periudhën kohore të testimeve 1 gusht 2026–31 tetor 2026. Raporti i vlerësimit duhet të evidentojë qartë listën e pjesëmarrësve, çdo problematikë të hasur gjatë procesit të testimeve, si dhe propozimin/ argumentimin përkatës, lidhur me gatishmërinë e tregut për implementimin e intervalit kohor 15-minutësh, përpara aplikimit të tij më datë 1 janar 2027.

4. "KESH" sh.a. dhe "ALPEX" sh.a. të raportojnë çdo dy (2) muaj në ERE, përkatësisht lidhur me zbatimin e projektit që mundëson implementimin e intervalit kohor 15-minutësh në tregun e balancimit dhe mbi ecurinë e përzgjedhjes së ofruesit të shërbimit përkatës.

5. Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Zhvillimit të Burimeve të Rinovueshme të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 178, datë 29.6.2026

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË "IDI 2005" SHPK PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 8.8 mw

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 11, pika 3, të ligjit nr. 24/2023, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme"; të neneve 10, pikat 1 dhe 3, dhe 15, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.6.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1899/1 prot., datë 25.6.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës "Mbi kërkesën e shoqërisë 'IDI 2005' sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 8.8 mw",

konstatoi se:

1. Të dhëna për shoqërinë

- Shoqëria "IDI 2005" sh.p.k. është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 289, datë 13.11.2025, për prodhimin e energjisë elektrike nga

centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 8.8 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1899 prot., datë 18.6.2026, ajo ka paraqitur kërkesën për modifikimin e aneksit A të licencës së saj, duke shtuar në të dhe sistemet e akumulimit/depozitimit të energjisë, si vepra ndihmëse, pa ndryshuar kapacitetin total të centralit, prej 8.8 mw.

- Ky aplikim vjen në rrethanat kur në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 534, datë 25.9.2025, si dhe kontratën me nr. 1888 rep., nr. 1013 kol., datë 29.10.2025, të nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, referohet e drejta për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 8.8 mw, dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në zonën kadastrale 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria "IDI 2005" sh.p.k.

- Në nenin 11, pika 3, të ligjit nr. 24/2023, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", parashikohet se: "Prodhuesit me përparësi kanë të drejtë të përdorin objektet e tyre ose objekte të tjera të depozitimit, duke mbuluar të gjitha kostot për të zbutur efektin e disbalancës dhe, në rast se skemat e tyre mbështetëse e lejojnë, të përfitojnë nga diferencat për orë përmes zhvendosjes së injektimit në rrjet".

- Rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A të rregullores dhe nuk ka detyrime të pashlyera në lidhje me pagesat e rregullimit.

2. Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Në përputhje me nenin 15, pika 4, e rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për modifikimin e licencës sipas germave "a", "c", "d", "e", "f" dhe "g".

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 15, pika 4, germa "b", të rregullores, shoqëria duhet të bëjë saktësimin përkatës të veprave ndihmëse dhe të kapacitetit të secilës.

- Në lidhje me fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së shoqërisë sipas kërkesës së saj, vlerësohet që të njoftohet dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) dhe "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" (OSSH) sh.a.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI**:**

1. Të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë "IDI 2005" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 289, datë 13.11.2025, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 8.8 mw, duke shtuar veprat ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë elektrike në aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë "IDI 2005" sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe shoqërinë "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" (OSSH) sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 179, datë 29.6.2026

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 158, DATË 5.6.2026, "MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË 'GREENSOL' SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE"

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të

nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; të neneve 10, pikat 1 dhe 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.6.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1662/6 prot., datë 25.6.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës "Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 158, datë 5.6.2026, 'Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë 'Greensol' sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike"',

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë "Greensol" sh.p.k.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 158, datë 5.6.2026, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Greensol" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 49.96 mw, me vendndodhje në Njësinë Administrative Mesopotam, Bistricë, Bashkia Finiq, qarku Vlorë.

- Në vijim, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1662/5 prot., datë 19.6.2026, shoqëria ka paraqitur kërkesën për modifikimin e licencës, duke shtuar në të dhe elementet e depozitimit të energjisë, si vepra ndihmëse, pa ndryshuar asnjë element tjetër teknik të aplikimit të saj. Për këtë shoqëria ka kryer dhe pagesën përkatëse që i korrespondon modifikimit të licencës, sipas përcaktimeve të aneksit A të licencës.

- Për sa kërkuar dhe në rrethanat kur shoqëria nuk është licencuar ende, vlerësohet se kemi të bëjmë me një ka përditësuar projektin e centralit fotovoltaik të prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë "Greensol" sh.p.k., me kapacitet të instaluar 49.96 mw, me vendndodhje në Njësinë Administrative Mesopotam, Bistricë, Bashkia Finiq, qarku Vlorë, duke përfshirë tanimë dhe veprat ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë elektrike, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit.

2. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Sikurse argumentuar nga shoqëria dhe për sa konstatuar dhe nga ana jonë, nëpërmjet VKM-së nr. 770, datë 19.12.2025 dhe në kontratën nr. 602 rep., nr. 164 kol., datë 10.2.2026, të nënshkruar me MIE-n, shoqëria ka marrë të drejtën për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 49.96 mw dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, me vendndodhje në Njësinë Administrative Mesopotam, Bistricë, Bashkia Finiq, qarku Vlorë.

- Po ashtu, në nenin 11, pika 3, të ligjit nr. 24/2023, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", parashikohet se: "Prodhuesit me përparësi kanë të drejtë të përdorin objektet e tyre ose objekte të tjera të depozitimit, duke mbuluar të gjitha kostot për të zbutur efektin e disbalancës dhe, në rast se skemat e tyre mbështetëse e lejojnë, të përfitojnë nga diferencat për orë përmes zhvendosjes së injektimit në rrjet".

- Rezulton se shoqëria ka paraqitur kërkesën për përfshirjen e veprave ndihmëse për një kapacitet dukshëm më të madh se kapaciteti i instaluar i centralit, por ERE do të pranojë për shqyrtim në këtë fazë vetëm për fuqinë 49.96 mw dhe në vijim, do të zhvillohet korrespondenca përkatëse me shoqërinë për të saktësuar/sqaruar elementet dhe dokumentacionin e kësaj kërkese.

- Për gjithë sa më sipër, vlerësohet i nevojshëm ndryshimi i paragrafit të parë, në pjesën e konstatimeve, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 158/2026, si vijon:

Shoqëria "Greensol" sh.p.k. ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaik, me vendndodhje në Njësinë Administrative Mesopotam, Bistricë, Bashkia Finiq, qarku Vlorë, me kapacitet të instaluar 49.96 mw, duke përfshirë dhe veprat ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë elektrike, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit.

3. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", parashikohet se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë, ndaj sikurse parashtruar e vlerësuar, jemi

në rrethanat e ndryshimit të vendimit nr. 158, datë 5.6.2026.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e një ndryshimi në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 158, datë 5.6.2026, si vijon:

a) paragrafi i parë, pjesa e konstatimeve, i vendimit të Bordit nr. 158, datë 5.6.2026, ndryshon dhe bëhet:

- Shoqëria "Greensol" sh.p.k. ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaik, me vendndodhje në Njësinë Administrative Mesopotam, Bistricë, Bashkia Finiq, qarku Vlorë, me kapacitet të instaluar 49.96 mw, duke përfshirë dhe veprat ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë elektrike, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit.

2. ERE do të pranojë për shqyrtim në këtë fazë përfshirjen e veprave ndihmëse vetëm për fuqinë 49.96 mw.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë "Greensol" sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe shoqërinë "Operatori i Sistemit të Transmetimit" sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 30, datë 1.7.2026

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR QËNDRUESHMËRINË OPERACIONALE DIGJITALE"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 3, pika 3, nenit 12, shkronja "a", dhe nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; nenit 58 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; dhe të nenit 88 të ligjit nr. 55/2020, datë 30.4.2020, "Për shërbimet e pagesave"; Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren "Për qëndrueshmërinë operacionale digjitale", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen subjektet e rregullores për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

5. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet udhëzimi "Për raportimin e incidenteve madhore", miratuar me vendimin nr. 10, datë 7.2.2024, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko

RREGULLORE[1] PËR QËNDRUESHMËRINË OPERACIONALE DIGJITALE

KREU I
KËRKESA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

1. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave të unifikuara në lidhje me sigurinë e rrjetit dhe sistemeve të informacionit që mbështesin veprimtarinë e subjekteve financiare, me qëllim arritjen e një niveli të lartë të përbashkët të qëndrueshmërisë operacionale digjitale, për:

a) kërkesat e zbatueshme për subjektet financiare në lidhje me:

i. administrimin e rrezikut të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK);

ii. raportimin e incidenteve madhore të lidhura me TIK-un dhe njoftimin mbi baza vullnetare për kërcënimet kibernetike të rëndësishme, në Bankën e Shqipërisë;

iii. raportimin në Bankën e Shqipërisë, të incidenteve madhore operacionale ose të sigurisë të lidhura me pagesat, nga subjektet financiare të parashikuara në shkronjat "a" deri në "d" të pikës 1 të nenit 2 të kësaj rregulloreje;

iv. testimin e qëndrueshmërisë operacionale digjitale;

v. shkëmbimin e informacionit dhe inteligjencës, në lidhje me kërcënimet dhe vulnerabilitetet kibernetike;

vi. masat për një administrim të shëndoshë nga subjektet financiare të rrezikut të TIK-ut nga palët e treta;

b) kërkesat në lidhje me marrëveshjet kontraktuale të lidhura ndërmjet ofruesve të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut dhe subjekteve financiare;

c) rregullat për ngritjen dhe funksionimin e kuadrit të mbikëqyrjes për ofruesit kritikë të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, kur ofrojnë shërbime për subjektet financiare;

d) rregullat për bashkëpunimin ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe autoriteteve të tjera përgjegjëse, si dhe rregullat për mbikëqyrjen dhe ndjekjen e zbatimit nga Banka e Shqipërisë, të kërkesave të kësaj rregulloreje.

Neni 2
Subjektet

1. Subjekte të kësaj rregulloreje janë:

a) bankat, të cilat në vijim do të referohen si institucione të kreditit, sipas parashikimeve në legjislacionin e zbatueshëm për bankat;

b) institucionet e pagesave, përfshirë edhe ato që përjashtohen sipas parashikimeve të nenit 27 të ligjit "Për shërbimet e pagesave";

c) ofruesit e shërbimit të informimit të llogarisë, siç parashikohen në nenit 28 të ligjit "Për shërbimet e pagesave";

d) institucionet e parasë elektronike, përfshirë edhe ato që përjashtohen sipas parashikimeve të ligjit "Për shërbimet e pagesave";

e) emetuesit e tokenave të aseteve dhe emetuesit e tokenave të parasë elektronike, sipas parashikimeve të legjislacionit për tregjet e kriptoaseteve;

f) ofruesit e shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut.

---

[1] Kjo rregullore përafron aktet e mëposhtme të Bashkimit Evropian:

- Rregulloren (BE) 2022/2554 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, e datës 14 dhjetor 2022, për qëndrueshmërinë operacionale digjitale të sektorit financiar dhe për ndryshimin e Rregulloreve (KE) nr. 1060/2009, (BE) Nr. 648/2012, (BE) nr. 600/2014, (BE) nr. 909/2014 dhe (BE) 2016/1011.

- Rregulloren e Deleguar të Komisionit (BE) 2024/1772 që plotëson Rregulloren (BE) 2022/2554 në lidhje me standardet teknike, rregullatore që specifikojnë kriteret për klasifikimin e incidenteve të lidhur me TIK-un dhe kërcënimet kibernetike, duke caktuar kufijtë e materialitetit dhe specifikuar detajet e raporteve të incidenteve madhore.

- Rregulloren e Deleguar të Komisionit (BE) 2024/1773 që plotëson Rregulloren (BE) 2022/2554 në lidhje me standardet teknike, rregullatore që specifikojnë përmbajtjen e detajuar të politikës për marrëveshjet kontraktuale mbi përdorimin e shërbimeve të TIK-ut që mbështesin funksionet kritike ose të rëndësishme, të ofruara nga ofruesit e shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut.

- Rregulloren e Deleguar të Komisionit (BE) 2025/301 që plotëson Rregulloren (BE) 2022/2554 në lidhje me standardet teknike, rregullatore që specifikojnë përmbajtjen dhe afatet kohore për njoftimin fillestar dhe raportin e ndërmjetëm dhe përfundimtar mbi incidentet madhore të lidhur me TIK-un dhe për përmbajtjen e njoftimit vullnetar të kërcënimeve kibernetike të rëndësishme.

- Rregulloren Implementuese të Komisionit (BE) 2025/302 që përcakton standardet teknike implementuese për zbatimin e Rregullores (BE) 2022/2554 në lidhje me format, formularët dhe procedurat standarde për subjektet financiare për raportimin e incidenteve madhore të lidhur me TIK-un dhe për njoftimin e kërcënimeve kibernetike të rëndësishme.

- Udhëzimet e Përbashkëta 2024 34 mbi vlerësimin e kostove të agreguara vjetore dhe humbjeve të shkaktuara nga incidentet madhore të lidhura me TIK-un, sipas Rregullores (BE) 2022/2554.

2. Për qëllime të kësaj rregulloreje, subjektet e parashikuara në shkronjat "a" deri në "e" të pikës 1 të këtij neni, do të referohen në vijim në këtë rregullore, me termin "subjekte financiare".

3. Kjo rregullore nuk zbatohet për institucionet e shërbimeve postare të parashikuara në nenin 2(5), pika 3, të Direktivës (BE) 2013/36.

4. Banka e Shqipërisë mund të përjashtojë nga fusha e zbatimit të kësaj rregulloreje subjektet e parashikuara në nenin 2 (5), pikat 4 deri në 23, të Direktivës (BE) 2013/36 që ndodhen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Banka e Shqipërisë informon Komisionin Evropian kur vendos përjashtimin e një subjekti sipas kësaj pike, si dhe për çdo ndryshim pasues. Komisioni Evropian publikon informacionin në faqen e tij të internetit ose në mënyra të tjera lehtësisht të aksesueshme.

Neni 3
Baza ligjore

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të nenit 3, pika 3, nenit 12, shkronja "a", dhe nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; nenit 58 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe të nenit 88 të ligjit nr. 55/2020, datë 30.4.2020, "Për shërbimet e pagesave".

Neni 4
Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me ata të përdorur në ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar (i cili për thjeshtësi në këtë rregullore do të quhet ligji "Për bankat") dhe në ligjin nr. 55/2020, datë 30.4.2020, "Për shërbimet e pagesave" (i cili për thjeshtësi në këtë rregullore do të quhet ligji "Për shërbimet e pagesave").

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1) "qëndrueshmëri operacionale digjitale" – nënkupton aftësinë e një subjekti financiar për të ndërtuar, siguruar dhe rishikuar integritetin dhe besueshmërinë operacionale, duke siguruar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nëpërmjet përdorimit të ofruesve të shërbimeve të palëve të treta të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), aftësitë e lidhura me TIK-un, të nevojshme për të adresuar sigurinë e rrjetit dhe sistemeve të informacionit që përdor subjekti financiar dhe që mbështesin ofrimin e vazhdueshëm të shërbimeve financiare dhe cilësinë e tyre, përfshirë edhe gjatë ndërprerjeve;

2) "rrjet dhe sistem i informacionit" – është një rrjet dhe sistem informacioni, siç përcaktohet në nenin 5, pika 35, të ligjit 25/2024 "Për sigurinë kibernetike";

3) "sistem i vjetër i TIK-ut *(legacy ICT system)"* - nënkupton një sistem TIK që ka arritur fundin e ciklit të tij jetësor, që nuk është më i përshtatshëm për përmirësime ose rregullime, për arsye teknologjike ose tregtare, ose që nuk mbështetet më nga ofruesi i tij ose nga një ofrues shërbimi i palëve të treta të TIK-ut, por që është ende në përdorim dhe mbështet funksionet e subjektit financiar;

4) "siguri e rrjetit dhe e sistemeve të informacionit" – nënkupton sigurinë e rrjetit dhe sistemeve të informacionit, siç përcaktohet në nenin 5, pika 42, të ligjit 25/2024, "Për sigurinë kibernetike";

5) "rrezik i TIK" – nënkupton çdo rrethanë të identifikueshme në mënyrë të arsyeshme, në lidhje me përdorimin e rrjetit dhe sistemeve të informacionit, e cila, nëse materializohet, mund të rrezikojë sigurinë e rrjetit dhe sistemeve të informacionit, të çdo mjeti apo procesi të varur nga teknologjia, të operacioneve dhe proceseve, ose të ofrimit të shërbimeve, duke prodhuar efekte të kundërta në mjedisin digjital ose fizik;

6) "aset informacioni" – nënkupton një koleksion informacioni, të prekshëm ose të paprekshëm, që ia vlen të mbrohet;

7) "aset i TIK-ut" – nënkupton një aset *software* ose *hardware* në rrjetin dhe sistemet e informacionit të përdorur nga subjekti financiar;

8) "incident i lidhur me TIK-un" – nënkupton një ngjarje të vetme ose një seri ngjarjesh të lidhura, të paplanifikuara nga subjekti financiar, që kompromenton sigurinë e rrjetit dhe të sistemeve të informacionit, dhe që ka një ndikim negativ në disponueshmërinë, autenticitetin, integritetin ose konfidencialitetin e të dhënave ose mbi shërbimet e ofruara nga subjekti financiar;

9) "incident madhor i lidhur me TIK-un" – nënkupton një incident të lidhur me TIK-un, që ka

një ndikim negativ të lartë në rrjet dhe sistemet e informacionit që mbështesin funksionet kritike ose të rëndësishme të subjektit financiar;

10) "incident operacional ose i sigurisë i lidhur me pagesat" – është një ngjarje e vetme ose një seri ngjarjesh të lidhura, të paplanifikuara nga subjektet financiare të parashikuara në shkronjat "a" deri në "d" të pikës 1 të nenit 2 të kësaj rregulloreje, pavarësisht nëse është ose jo i lidhur me TIK-un, që ka një ndikim negativ në disponueshmërinë, autenticitetin, integritetin ose konfidencialitetin e të dhënave të lidhura me pagesat ose mbi shërbimet e lidhura me pagesat, të ofruara nga subjekti financiar;

11) "incident madhor operacional ose i sigurisë i lidhur me pagesat" – nënkupton një incident operacional ose të sigurisë të lidhur me pagesat, që ka një ndikim negativ të lartë në shërbimet e lidhura me pagesat të ofruara nga subjekti financiar;

12) "kërcënim kibernetik" – ka të njëjtin kuptim siç përcaktohet në nenin 5, pika 16, të ligjit 25/2024 "Për sigurinë kibernetike";

13) "kërcënim i rëndësishëm kibernetik" – është një kërcënim kibernetik, karakteristikat teknike të të cilit tregojnë se ka mundësinë që të rezultojë në një incident madhor të lidhur me TIK-un, ose në një incident madhor operacional ose të sigurisë të lidhur me pagesat;

14) "sulm kibernetik" – nënkupton një incident me synime keqdashëse të lidhur me TIK-un, të shkaktuar me anë të një përpjekjeje të kryer nga çdo aktor kërcënues, për të shkatërruar, ekspozuar, ndryshuar, çaktivizuar, vjedhur ose për të fituar akses të paautorizuar në një aset ose për të përdorur në mënyrë të paautorizuar një aset;

15) "inteligjencë kërcënimi" – nënkupton informacionin që është grumbulluar, transformuar, analizuar, interpretuar ose pasuruar për të ofruar kontekstin e nevojshëm për vendimmarrje dhe për të mundësuar të kuptuarit e përshtatshëm dhe të mjaftueshëm, për zbutjen e efektit të një incidenti të lidhur me TIK-un, ose të një kërcënimi kibernetik, duke përfshirë detajet teknike të një sulmi kibernetik, personat përgjegjës për sulmin, mënyrën specifike që përdoret nga këta persona për të kryer sulmin, si dhe motivimet e tyre;

16) "vulnerabilitet" – nënkupton një dobësi, ndjeshmëri ose defekt të një aseti, sistemi, procesi ose kontrolli që mund të shfrytëzohet nga një kërcënim;

17) "testimi i depërtueshmërisë i udhëhequr nga kërcënimi (*TLPT*)" – nënkupton një kuadër që imiton taktikat, teknikat dhe procedurat e aktorëve të kërcënimit në jetën reale, të perceptuar sikur paraqesin një kërcënim të vërtetë kibernetik, që ofron një test të kontrolluar, të porositur, të udhëhequr nga inteligjenca (ekip i kuq) të sistemeve kritike *live* të prodhimit të subjektit financiar;

18) "rrezik i TIK-ut i palës së tretë" – nënkupton rrezikun e TIK-ut që mund të lindë për një subjekt financiar, në lidhje me përdorimin e shërbimeve të TIK-ut të ofruara nga ofruesit e shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut ose nga nënkontraktorë të këtyre të fundit, përfshirë edhe nëpërmjet marrëveshjeve me palët e treta *(outsourcing);*

19) "ofrues shërbimi i palëve të treta të TIK-ut" – nënkupton një kompani që ofron shërbime të TIK-ut;

20) "ofrues shërbimesh të TIK-ut brenda grupit" – nënkupton një kompani që është pjesë e një grupi financiar dhe që ofron kryesisht shërbime të TIK-ut për subjektet financiare brenda të njëjtit grup ose subjektet financiare që i përkasin së njëjtës skemë të mbrojtjes institucionale, duke përfshirë bankat apo institucionet financiare mëmë, filialet, degët ose subjektet e tjera që janë nën pronësi ose kontroll të përbashkët;

21) "shërbime të TIK-ut" – janë shërbimet digjitale dhe të të dhënave, të ofruara në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet sistemeve TIK-ut, për një ose më shumë përdorues të brendshëm ose të jashtëm, duke përfshirë *hardware* si shërbim dhe shërbimet e *hardware,* që përfshin ofrimin e mbështetjes teknike nëpërmjet përditësimeve të *software* ose *firmware* nga ofruesi i *hardware*, duke përjashtuar shërbimet tradicionale telefonike analoge;

22) "funksion kritik ose i rëndësishëm" – është një funksion, ndërprerja e të cilit do të dëmtonte materialisht performancën financiare të subjektit financiar, ose qëndrueshmërinë apo vazhdimësinë e shërbimeve dhe aktiviteteve të tij, ose performanca e ndërprerë, e mangët ose e dështuar e atij funksioni do të dëmtonte materialisht pajtueshmërinë e vazhdueshme të subjektit financiar me kushtet dhe detyrimet e përcaktuara për licencimin e tij, ose me detyrime të tjera sipas legjislacionit përkatës për subjektet financiare;

23) "ofrues kritik i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut" – nënkupton një ofrues të shërbimeve të

palëve të treta të TIK-ut, të caktuar si kritik në përputhje me nenin 31 të Rregullores (BE) 2022/2554 dhe sipas parashikimeve të nenit 60 të kësaj rregulloreje;

24) "ofrues shërbimi i palëve të treta të TIK-ut i themeluar në një shtet tjetër" – nënkupton një ofrues shërbimi të palëve të treta të TIK-ut që është një person juridik i themeluar në një shtet tjetër dhe që ka lidhur një marrëveshje kontraktuale me një subjekt financiar për ofrimin e shërbimeve të TIK-ut;

25) "nënkontraktor i TIK-ut i themeluar në një shtet tjetër" – nënkupton një nënkontraktor TIK që është një person juridik i themeluar në një shtet tjetër dhe që ka lidhur një marrëveshje kontraktuale me një ofrues shërbimi të palëve të treta TIK, ose me një ofrues shërbimi të palës së tretë të TIK-ut, të vendosur në një shtet tjetër;

26) "rrezik i përqendrimit të TIK-ut" – nënkupton një ekspozim ndaj një ose disa ofruesve kritikë të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut të lidhur, duke krijuar një shkallë varësie nga ofruesit e tillë, në mënyrë që mosdisponueshmëria, dështimi ose çdo lloj tjetër mungese i këtyre të fundit, mund të rrezikojë potencialisht aftësinë e një subjekti financiar, për të kryer funksione kritike ose të rëndësishme, ose për të vuajtur efekte të tjera negative, duke përfshirë humbje të mëdha ose cenimin e stabilitetit financiar të vendit;

27) "organ drejtues" – nënkupton organin ose organet e subjektit financiar, të cilët kanë përgjegjësinë për të vendosur/përcaktuar strategjinë, objektivat dhe drejtimin e përgjithshëm të subjektit financiar dhe për të mbikëqyrur dhe monitoruar vendimmarrjen e administratorëve dhe përfshijnë personat që drejtojnë në mënyrë efektive veprimtarinë e subjektit financiar, ose që janë drejtues të funksioneve kryesore;

28) "mikrondërmarrje" – në kuptim të kësaj rregulloreje, nënkupton një subjekt financiar, i cili ka të punësuar më pak se 10 persona dhe xhiroja vjetore dhe/ose totali i bilancit të tij vjetor nuk tejkalon vlerën ekuivalente në Lek të 2 milionë eurove;

29) "ndërmarrje e vogël" – në kuptim të kësaj rregulloreje, nënkupton një subjekt financiar që ka të punësuar 10 ose më shumë persona, por më pak se 50 persona, dhe xhiroja vjetore dhe/ose një totali i bilancit të tij vjetor tejkalon vlerën ekuivalente në Lek të 2 milionë eurove, por nuk tejkalon vlerën ekuivalente në Lek të 10 milionë eurove;

30) "ndërmarrje e mesme" – në kuptim të kësaj rregulloreje, nënkupton një subjekt financiar që nuk është një ndërmarrje e vogël dhe që ka të punësuar më pak se 250 persona dhe një xhiro vjetore që nuk tejkalon vlerën ekuivalente në Lek të 50 milionë eurove dhe/ose një total bilanci vjetor që nuk tejkalon vlerën ekuivalente në Lek të 43 milionë eurove;

31) "EBA" (*European Banking Authority*) – është Autoriteti Bankar Evropian;

32) "EIOPA" (*European Insurance and Occupational Pensions Authority*) – është Autoriteti Evropian Mbikëqyrës për Sigurimet dhe Pensionet Profesionale;

33) "ECB" (*European Central Bank*) – është Banka Qendrore Evropiane;

34) "ESMA" (*European Securities and Markets Authority*) – është Autoriteti Evropian Mbikëqyrës për Titujt dhe Tregjet e Kapitalit;

35) "ESA" – janë Autoritetet Mbikëqyrëse Evropiane si EBA-ja, ESMA dhe EIOPA;

36) "ENISA" – është Agjencia për Sigurinë Kibernetike e Bashkimit Evropian;

37) "Mbikëqyrës Kryesor" *(Lead Overseer)* – është Autoriteti Mbikëqyrës Evropian i caktuar në përputhje me nenin 31(1), shkronja "b", të Rregullores (BE) 2022/2554 dhe sipas parashikimeve të nenit 60 të kësaj rregulloreje;

38) "Komiteti i Përbashkët *(Joint Committee)"* – nënkupton komitetin e referuar në nenin 54 të Rregulloreve (BE) nr. 1093/2010, (BE) nr. 1094/2010 dhe (BE) nr. 1095/2010.

Neni 5
Parimi i proporcionalitetit

1. Subjektet financiare zbatojnë kërkesat e kreut II të kësaj rregulloreje, në përputhje me parimin e proporcionalitetit, duke konsideruar madhësinë dhe profilin e rrezikut, si dhe natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e shërbimeve, aktivitetit dhe operacioneve të tyre.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, zbatimi i kërkesave të krerëve III, IV dhe nënkreut I të kreut V të kësaj rregulloreje nga subjektet financiare, do të jetë në proporcion me madhësinë dhe profilin e rrezikut, si dhe me natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e shërbimeve, aktivitetit dhe

operacioneve të tyre, siç përcaktohet në kërkesat përkatëse të atyre krerëve.

3. Banka e Shqipërisë merr në konsideratë zbatimin e parimit të proporcionalitetit nga subjektet financiare, kur shqyrton konsistencën e kuadrit të administrimit të rrezikut të TIK-ut, në bazë të raporteve të paraqitura nga subjektet me kërkesë të Bankës së Shqipërisë, siç përcaktohet në nenin 7, pika 6, dhe nenin 17, pika 3, të kësaj rregulloreje.

KREU II
ADMINISTRIMI I RREZIKUT TË TIK-ut

NËNKREU I
QEVERISJA DHE ORGANIZIMI I SUBJEKTEVE FINANCIARE

Neni 6
Qeverisja dhe organizimi

1. Subjektet financiare krijojnë sistemin e brendshëm të qeverisjes dhe të kontrollit që siguron një administrim efektiv dhe të kujdesshëm të të gjitha rreziqeve të TIK-ut, në përputhje me nenin 7, pikat 4 dhe 5, të kësaj rregulloreje, me qëllim sigurimin e një niveli të lartë të qëndrueshmërisë operacionale digjitale. Ky sistem duhet t'u referohet dhe të përshtatet me standardet më të mira të fushës së teknologjisë së informacionit dhe sigurisë së informacionit.

2. Organi drejtues i subjektit përcakton, miraton, mbikëqyr dhe është përgjegjës për zbatimin e të gjitha marrëveshjeve që lidhen me sistemin e administrimit të rrezikut të TIK-ut, të parashikuar në nenin 7, pika 1, të kësaj rregulloreje.

3. Për qëllime të pikës 2 të këtij neni, organi drejtues:

a) ka përgjegjësinë përfundimtare për administrimin e rrezikut të TIK-ut të subjektit financiar;

b) harton politika që sigurojnë standarde të larta të disponueshmërisë, autenticitetit, integritetit dhe konfidencialitetit të të dhënave;

c) përcakton role dhe përgjegjësi të qarta për të gjitha funksionet që lidhen me TIK-un dhe krijon sisteme të përshtatshme qeverisëse për të siguruar një komunikim, bashkëpunim dhe koordinim efektiv dhe në kohë, midis këtyre funksioneve;

d) ka përgjegjësinë për përcaktimin dhe miratimin e strategjisë për qëndrueshmërinë operacionale digjitale, siç parashikohet në nenin 7, pika 9, të kësaj rregulloreje, përfshirë edhe përcaktimin e nivelit të duhur të tolerancës ndaj rrezikut të TIK-ut të subjektit financiar, siç parashikohet në nenin 7, pika 9, shkronja "b", të kësaj rregulloreje;

e) miraton, mbikëqyr *(oversee)* dhe rishikon periodikisht zbatimin e politikës së vazhdimësisë së biznesit të TIK-ut dhe planit të rimëkëmbjes nga fatkeqësitë e TIK-ut të subjektit financiar, të parashikuara përkatësisht në pikat 1 dhe 3 të nenit 12 të kësaj rregulloreje, që mund të përshtatet si një politikë e veçantë, pjesë integrale e politikës së përgjithshme të vazhdimësisë së biznesit të subjektit financiar dhe planeve të rimëkëmbjes të tij;

f) miraton dhe rishikon periodikisht planet e auditit të brendshëm të subjektit financiar për TIK, auditimet e TIK-ut dhe modifikimet materiale të tyre;

g) shpërndan dhe rishikon periodikisht buxhetin e duhur për të përmbushur nevojat e subjektit financiar për qëndrueshmërinë operacionale digjitale të tij, në lidhje me të gjitha llojet e burimeve, duke përfshirë programet e ndërgjegjësimit për sigurinë e TIK-ut, trajnimin mbi qëndrueshmërinë operacionale digjitale të parashikuar në nenin 15, pika 7, të kësaj rregulloreje, si dhe për aftësitë në fushën e TIK-ut për të gjithë stafin e subjektit financiar;

h) miraton dhe rishikon periodikisht politikën e subjektit financiar për marrëveshjet në lidhje me përdorimin e shërbimeve të TIK-ut të ofruara nga ofruesit e shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut;

i) krijon kanale raportimi në nivel subjekti, për të qenë të informuar siç duhet, për:

i. marrëveshjet e lidhura me ofruesit e shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut për përdorimin e shërbimeve të TIK-ut;

ii. çdo ndryshim material përkatës të planifikuar, në lidhje me ofruesit e shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut;

iii. ndikimin e mundshëm të këtyre ndryshimeve në funksionet kritike ose të rëndësishme që janë subjekt i atyre marrëveshjeve, duke përfshirë një përmbledhje të analizës së rrezikut, për të vlerësuar ndikimin e këtyre ndryshimeve, për incidentet madhore të lidhura me TIK-un dhe ndikimin e tyre, si dhe për reagimin, rimëkëmbjen dhe masat korrigjuese të subjektit financiar.

4. Subjektet financiare, me përjashtim të mikrondërmarrjeve, caktojnë një funksion ose person përgjegjës për monitorimin e marrëveshjeve të lidhura me ofruesit e shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut për përdorimin e shërbimeve të TIK-ut, ose caktojnë një anëtar të drejtimit të lartë, si përgjegjës për mbikëqyrjen e ekspozimit përkatës ndaj rrezikut dhe të dokumentacionit përkatës.

5. Anëtarët e organit drejtues të subjektit financiar duhet të trajnohen rregullisht për t'u përditësuar me njohuritë dhe aftësitë e përshtatshme, për të kuptuar dhe vlerësuar rrezikun e TIK-ut dhe ndikimin e tij në veprimtarinë e subjektit financiar, në përputhje edhe me nivelin e rrezikut të TIK-ut që duhet të administrohet.

NËNKREU II
SISTEMI I ADMINISTRIMIT TË RREZIKUT TË TIK-ut

Neni 7
Sistemi i administrimit të rrezikut të TIK-ut

1. Subjektet financiare krijojnë një sistem të shëndoshë, gjithëpërfshirës dhe të mirë-dokumentuar të administrimit të rrezikut të TIK-ut, si pjesë të sistemit të përgjithshëm të administrimit të rrezikut të subjektit, i cili iu mundëson adresimin/administrimin e rrezikut të TIK-ut, në mënyrë të shpejtë, efikase dhe gjithëpërfshirëse, si dhe sigurimin e një niveli të lartë të qëndrueshmërisë operacionale digjitale.

2. Sistemi i administrimit të rrezikut të TIK-ut, i parashikuar në pikën 1 të këtij neni, përfshin strategjitë, politikat, procedurat, protokollet e TIK-ut dhe mekanizmat e nevojshme për të mbrojtur në mënyrë të duhur dhe efektive të gjitha asetet e informacionit dhe asetet e TIK-ut, duke përfshirë programet dhe pajisjet kompjuterike, serverët, si dhe për të mbrojtur të gjithë komponentët dhe infrastrukturat fizike përkatëse, të tilla si: ambientet, qendrat e të dhënave dhe zonat e caktuara të ndjeshme (sensitive), për të siguruar që të gjitha asetet e informacionit dhe asetet e TIK-ut janë të mbrojtura në mënyrë të përshtatshme nga rreziqet, duke përfshirë edhe nga dëmtimi dhe aksesi ose përdorimi i paautorizuar.

3. Subjektet financiare, në përputhje me sistemin e administrimit të rrezikut, minimizojnë efektet e rrezikut të TIK-ut, duke hartuar strategji, politika, procedura, protokolle të TIK-ut dhe mekanizma të përshtatshme. Subjektet i paraqesin Bankës së Shqipërisë, me kërkesën e kësaj të fundit, një informacion të plotë dhe të përditësuar mbi rreziqet e TIK-ut dhe mbi sistemin e administrimit të rrezikut të TIK-ut.

4. Subjektet financiare, me përjashtim të mikrondërmarrjeve, i caktojnë funksionit të kontrollit, përgjegjësinë për administrimin dhe mbikëqyrjen e rrezikut të TIK-ut dhe sigurojnë një nivel të përshtatshëm pavarësie të këtij funksioni, për të shmangur konfliktin e interesit.

5. Subjektet financiare sigurojnë ndarjen e duhur dhe pavarësinë midis funksioneve të administrimit të rrezikut të TIK-ut, funksioneve të kontrollit dhe funksioneve të auditit të brendshëm, sipas modelit të tri linjave të mbrojtjes.

6. Sistemi i administrimit të rrezikut të TIK-ut dokumentohet dhe rishikohet të paktën një herë në vit, ose në mënyrë periodike për mikrondërmarrjet, dhe në çdo rast kur ndodhin incidente madhore të lidhura me TIK-un, si dhe në përputhje me rekomandimet mbikëqyrëse ose konkluzionet që rrjedhin nga testimi i qëndrueshmërisë operacionale digjitale ose nga proceset e kontrollit. Sistemi i administrimit të rrezikut të TIK-ut duhet të përmirësohet vazhdimisht në bazë të mësimeve të nxjerra nga zbatimi dhe monitorimi. Subjektet i paraqesin Bankës së Shqipërisë, me kërkesën e kësaj të fundit, një raport mbi rishikimin e sistemit të administrimit të rrezikut të TIK-ut.

7. Sistemi i administrimit të rrezikut të TIK-ut të subjekteve financiare, me përjashtim të mikrondërmarrjeve, do të jetë subjekt i auditit të brendshëm në mënyrë të rregullt, në përputhje me planin e auditit të brendshëm të subjektit. Punonjësit e njësisë së auditit të brendshëm duhet të zotërojnë njohuri, aftësi dhe ekspertizë të mjaftueshme për rrezikun e TIK-ut, si dhe pavarësinë e duhur. Frekuenca dhe fokusi i auditimeve të TIK-ut duhet të jetë në përputhje me rrezikun e TIK-ut të subjektit financiar.

8. Bazuar në gjetjet e auditit të brendshëm, subjektet financiare krijojnë një proces formal për ndjekjen e gjetjeve, duke përfshirë rregullat për verifikimin në kohë dhe korrigjimin e gjetjeve kritike të auditit të brendshëm në lidhje me TIK-un.

9. Sistemi i administrimit të rrezikut të TIK-ut përfshin një strategji të qëndrueshmërisë operacionale digjitale, që përcakton se si zbatohet ky

sistem i administrimit të rrezikut. Për këtë qëllim, strategjia e qëndrueshmërisë operacionale digjitale do të përfshijë metodat për të adresuar rrezikun e TIK-ut dhe për të realizuar objektivat specifikë të TIK-ut, duke:

a) shpjeguar se si sistemi i administrimit të rrezikut të TIK-ut mbështet strategjinë dhe objektivat e veprimtarisë së subjektit financiar;

b) përcaktuar nivelin e tolerancës ndaj rrezikut për rrezikun e TIK-ut, në përputhje me oreksin për rrezik të subjektit, dhe duke analizuar tolerancën ndaj ndikimit të ndërprerjeve të TIK-ut;

c) vendosur objektiva të qartë të sigurisë së informacionit, përfshirë treguesit kyç të performancës dhe metrikat kyçe të rrezikut;

d) shpjeguar arkitekturën e referencës së TIK-ut dhe çdo ndryshim të nevojshëm për të arritur objektivat specifikë të subjektit;

e) përshkruar mekanizmat e ndryshëm të krijuar nga subjekti, për të zbuluar incidentet e lidhura me TIK-un, për të parandaluar dhe për t'u mbrojtur nga efektet e tyre;

f) evidentuar situatën aktuale të qëndrueshmërisë operacionale digjitale, bazuar në numrin e incidenteve madhore të raportuara të lidhura me TIK-un dhe efektivitetin e masave parandaluese të ndërmarra;

g) zbatuar testimin e qëndrueshmërisë operacionale digjitale, në përputhje me kreun IV të kësaj rregulloreje;

h) planifikuar një strategji komunikimi në rast incidentesh të lidhura me TIK-un, publikimi i të cilave kryhet në përputhje me nenin 16 të kësaj rregulloreje.

10. Subjektet financiare, në kuadër të strategjisë së qëndrueshmërisë operacionale digjitale të parashikuar në pikën 9 të këtij neni, mund të përcaktojnë një strategji gjithëpërfshirëse të TIK-ut me shumë shitës *(multivendor strategy),* në nivel grupi ose subjekti, që paraqet varësitë kryesore nga ofruesit e shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut dhe që shpjegon arsyetimin për prokurimin e disa ofruesve të shërbimeve të palëve të treta.

11. Subjektet financiare, në përputhje me kërkesat përkatëse ligjore e nënligjore për marrëveshjet me të tretët, mund të transferojnë detyrimin për verifikimin e përputhshmërisë me kërkesat e administrimit të rrezikut të TIK-ut, te subjekte të tjera brenda grupit ose palë të treta të jashtme. Në rastin e këtij transferimi, subjekti financiar mbetet plotësisht përgjegjës për verifikimin e përputhshmërisë me kërkesat e administrimit të rrezikut të TIK-ut.

Neni 8

Sistemet, protokollet dhe mekanizmat e TIK-ut

1. Subjektet financiare, për të adresuar dhe administruar rrezikun e TIK-ut, përdorin dhe mbajnë sisteme, protokolle dhe mekanizma të përditësuara të TIK-ut, të cilat:

a) janë të përshtatshme për madhësinë e operacioneve që mbështesin zhvillimin e veprimtarisë të tyre, në përputhje me parimin e proporcionalitetit të parashikuar në nenin 5 të kësaj rregulloreje;

b) janë të besueshme;

c) kanë kapacitet të mjaftueshëm për të përpunuar me saktësi të dhënat e nevojshme për kryerjen e aktiviteteve dhe ofrimin e shërbimeve në kohë, dhe për t'u marrë me urdhrat, mesazhet ose vëllimet e transaksioneve gjatë kohës së pikut, sipas nevojës, përfshirë edhe rastet e prezantimit të teknologjive të reja;

d) janë teknologjikisht fleksibël, për t'u përballur në mënyrë të përshtatshme me nevojat shtesë të përpunimit të informacionit, siç kërkohet në kushte të stresuara të tregut ose në situata të tjera të pafavorshme.

Neni 9

Identifikimi

1. Si pjesë të sistemit të administrimit të rrezikut të TIK-ut të parashikuar në nenin 7, pika 1, të kësaj rregulloreje, subjektet financiare identifikojnë, klasifikojnë dhe dokumentojnë në mënyrë të përshtatshme, të gjitha funksionet e biznesit, rolet dhe përgjegjësitë e mbështetura nga TIK-u, asetet e informacionit dhe asetet e TIK-ut që mbështesin këto funksione, si dhe rolet dhe ndërvarësitë në lidhje me rrezikun e TIK-ut. Subjektet financiare rishikojnë sipas nevojës dhe të paktën çdo vit, përshtatshmërinë e këtij klasifikimi dhe të çdo dokumentacioni përkatës.

2. Subjektet financiare identifikojnë në mënyrë të vazhdueshme, të gjitha burimet e rrezikut të TIK-ut, në veçanti ekspozimin ndaj rrezikut drejt dhe nga subjektet e tjera financiare, dhe vlerësojnë

kërcënimet kibernetike dhe vulnerabilitetet e TIK-ut që lidhen me funksionet e tyre të biznesit të mbështetura nga TIK-u, me asetet e informacionit dhe me asetet e TIK-ut. Subjektet financiare rishikojnë në baza të rregullta dhe të paktën çdo vit, skenarët e rrezikut që ndikojnë në to.

3. Subjektet financiare, me përjashtim të mikrondërmarrjeve, kryejnë një vlerësim të rrezikut, për çdo ndryshim të rëndësishëm në infrastrukturën e rrjetit dhe sistemeve të informacionit, në proceset ose procedurat që prekin funksionet e tyre të biznesit të mbështetura nga TIK-u, asetet e informacionit ose asetet e TIK-ut.

4. Subjektet financiare identifikojnë të gjitha asetet e informacionit dhe asetet e TIK-ut, duke përfshirë edhe faqet në distancë *(remote sites),* burimet e rrjetit dhe pajisjet kompjuterike *(hardware),* dhe caktojnë ato asete që konsiderohen si kritike. Subjektet financiare hartojnë konfigurimin e aseteve të informacionit dhe aseteve të TIK-ut, si dhe lidhjet dhe ndërvarësinë ndërmjet aseteve të ndryshme të informacionit dhe të TIK-ut.

5. Subjektet financiare identifikojnë dhe dokumentojnë të gjitha proceset që varen nga ofruesit e shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut dhe identifikojnë ndërlidhjet me ofruesit e shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut që mbështetin funksionet kritike ose të rëndësishme.

6. Për qëllime të pikave 1, 4 dhe 5 të këtij neni, subjektet financiare duhet të mbajnë inventarët përkatës dhe t'i përditësojnë rregullisht dhe sa herë që ndodhin ndryshime të rëndësishme, siç parashikohet në pikën 3 të këtij neni.

7. Subjektet financiare, me përjashtim të mikrondërmarrjeve, kryejnë rregullisht dhe të paktën një herë në vit, një vlerësim specifik të rrezikut të TIK-ut, për të gjitha sistemet e vjetra të TIK-ut, veçanërisht para dhe pas lidhjes së teknologjive, aplikacioneve ose sistemeve.

Neni 10

Mbrojtja dhe parandalimi

1. Për qëllime të mbrojtjes së përshtatshme të sistemeve të TIK-ut dhe të organizimit të masave të reagimit, subjektet financiare monitorojnë dhe kontrollojnë vazhdimisht sigurinë dhe funksionimin e sistemeve dhe mekanizmave të TIK-ut, si dhe minimizojnë ndikimin e rrezikut të TIK-ut mbi sistemet e TIK-ut, nëpërmjet angazhimit të mekanizmave, politikave dhe procedurave të duhura të sigurisë të TIK-ut.

2. Subjektet financiare hartojnë, prokurojnë dhe zbatojnë politikat, procedurat, protokollet dhe mekanizmat e sigurisë së TIK-ut, që synojnë sigurimin e qëndrueshmërisë, vazhdimësisë dhe disponueshmërisë së sistemeve të TIK-ut, në veçanti për ata që mbështetin funksionet kritike ose të rëndësishme, si dhe ruajtjen e standardeve të larta të disponueshmërisë, autenticitetit, integritetit dhe konfidencialitetit të të dhënave, qoftë në qetësi, në përdorim apo në tranzit.

3. Për të arritur objektivat e parashikuar në pikën 2 të këtij neni, subjektet financiare përdorin teknologjinë (zgjidhjet) dhe proceset e TIK-ut, të cilat janë të përshtatshme për to, në përputhje me parimin e proporcionalitetit të parashikuar në nenin 5 të kësaj rregulloreje. Këto teknologji (zgjidhje) dhe procese të TIK-ut:

a) garantojnë sigurinë e mjeteve të transferimit të informacionit/të dhënave;

b) minimizojnë rrezikun e korruptimit ose humbjes së të dhënave, aksesit të paautorizuar dhe të defekteve teknike që mund të pengojnë aktivitetin e biznesit;

c) parandalojnë mungesën e disponueshmërisë, dëmtimin e autenticitetit dhe integritetit, shkeljet e konfidencialitetit dhe humbjen e të dhënave;

d) sigurojnë që të dhënat mbrohen nga rreziqet që lidhen me administrimin e të dhënave/të informacionit, përfshirë administrimin e dobët, rreziqet që lidhen me përpunimin e të dhënave dhe gabimet njerëzore.

4. Si pjesë të sistemit të administrimit të rrezikut të TIK-ut të parashikuar në nenin 7, pika 1, të kësaj rregulloreje, subjektet financiare:

a) zhvillojnë dhe dokumentojnë një politikë të sigurisë së informacionit që përcakton rregullat për të mbrojtur disponueshmërinë, autenticitetin, integritetin dhe konfidencialitetin e të dhënave, aseteve të informacionit dhe aseteve të TIK-ut, përfshirë edhe të klientëve të tyre, ku është e zbatueshme;

b) duke ndjekur një qasje të bazuar në rrezik, krijojnë një rrjet të shëndoshë dhe strukturë të qëndrueshme të administrimit të infrastrukturës, duke përdorur teknikat, metodat dhe protokollet e duhura, që mund të përfshijnë zbatimin e mekanizmave të automatizuar, për të izoluar asetet e

informacionit të prekur në rast të sulmeve kibernetike;

c) zbatojnë politika që kufizojnë aksesin fizik ose logjik në asetet e informacionit dhe asetet e TIK-ut, në nivelin që kërkohet vetëm për funksionet dhe aktivitetet legjitime dhe të miratuara, si dhe krijojnë për këtë qëllim një sërë politikash, procedurash dhe kontrollesh që adresojnë të drejtat për akses dhe sigurojnë një administrim të shëndoshë të tyre;

d) zbatojnë politika dhe protokolle për mekanizma autentifikimi të thelluar, bazuar në standardet përkatëse dhe sisteme të dedikuara kontrolli, si dhe masa mbrojtëse për të parandaluar aksesin në çelësat kriptografikë, ku të dhënat enkriptohen (kodohen) bazuar në rezultatet e klasifikimit të miratuar të të dhënave dhe proceseve të vlerësimit të rrezikut të TIK-ut;

e) zbatojnë politika, procedura dhe kontrolle të dokumentuara për administrimin e ndryshimeve të TIK-ut, duke përfshirë ndryshimet në programet dhe pajisjet kompjuterike (*software* dhe *hardware*), komponentët *firmware*, ndryshime të parametrave të sistemeve ose të sigurisë, që bazohen në një metodë/qasje të vlerësimit të rrezikut dhe janë pjesë integrale e procesit të përgjithshëm të administrimit të ndryshimeve të subjektit financiar, në mënyrë që të sigurohet që të gjitha ndryshimet në sistemet e TIK-ut, regjistrohen, testohen, vlerësohen, miratohen, zbatohen dhe verifikohen në mënyrë të kontrolluar;

f) kanë politika të dokumentuara të përshtatshme dhe gjithëpërfshirëse për rishikimet dhe përditësimet.

5. Për qëllime të shkronjës "b" të pikës 4 të këtij neni, subjektet financiare projektojnë infrastrukturën e lidhjes së rrjetit në mënyrë të tillë që të lejojë ndarjen dhe segmentimin e saj në mënyrë të menjëhershme, për të minimizuar dhe parandaluar përhapjen *(contagion)* e problemit, veçanërisht për proceset financiare të ndërlidhura.

6. Për qëllime të shkronjës "e" të pikës 4 të këtij neni, procesi i administrimit të ndryshimeve të TIK-ut, miratohet nga organet drejtuese përkatëse dhe ka protokolle specifike në fuqi.

Neni 11
Zbulimi

1. Subjektet financiare duhet të kenë mekanizma për zbulimin e menjëhershëm të aktiviteteve anormale, në përputhje me nenin 18 të kësaj rregulloreje, duke përfshirë çështjet e performancës së rrjetit të TIK-ut dhe incidentet e lidhura me TIK-un, si dhe për të identifikuar të gjitha pikat e vetme materiale të mundshme të dështimit.

2. Subjektet financiare testojnë rregullisht të gjithë mekanizmat e zbulimit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, në përputhje me nenin 42 të kësaj rregulloreje.

3. Mekanizmat e zbulimit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni mundësojnë nivele të shumëfishta kontrolli, përcaktojnë kufij alarmi dhe kritere për të aktivizuar dhe iniciuar proceset e përgjigjes/reagimit ndaj incidenteve të lidhura me TIK-un, përfshirë edhe mekanizma automatikë alarmi për punonjësit përkatës përgjegjës për reagimin ndaj incidenteve të lidhur me TIK-un.

4. Subjektet financiare dedikojnë burime dhe aftësi të mjaftueshme për të monitoruar aktivitetin e përdoruesve, shfaqjen e anomalive të TIK-ut dhe incidenteve të lidhura me TIK-un, në veçanti, sulmeve kibernetike.

Neni 12
Reagimi dhe rimëkëmbja

1. Subjektet financiare hartojnë një politikë gjithëpërfshirëse të vazhdimësisë së biznesit të TIK-ut, si pjesë të sistemit të administrimit të rrezikut të TIK-ut të parashikuar në pikën 1 të nenit 7 të kësaj rregulloreje dhe bazuar në kërkesat e identifikimit të përcaktuara në nenin 9 të kësaj rregulloreje, e cila mund të përshtatet si një politikë e veçantë, pjesë integrale e politikës së përgjithshme të vazhdimësisë së biznesit të subjektit financiar.

2. Subjektet financiare zbatojnë politikën e vazhdimësisë së biznesit të TIK-ut të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, nëpërmjet marrëveshjeve, planeve, procedurave dhe mekanizmave të dedikuar, të përshtatshëm dhe të dokumentuar që synojnë:

a) sigurimin e vazhdimësisë së funksioneve kritike ose të rëndësishme të subjektit financiar;

b) reagimin, në mënyrë të shpejtë, të përshtatshme dhe efektive, dhe zgjidhjen e të gjitha incidenteve të lidhura me TIK-un, në një mënyrë që kufizon dëmet dhe i jep përparësi rifillimit të aktiviteteve dhe masave të rimëkëmbjes;

c) aktivizimin pa vonesë të planeve të dedikuara që mundësojnë masat e kontrollit, proceset dhe teknologjitë e përshtatshme për çdo lloj incidenti të

lidhur me TIK-un dhe parandalimin e dëmeve të mëtejshme, si dhe procedurat e përshtatura të reagimit dhe rimëkëmbjes, të krijuara në përputhje me nenin 14 të kësaj rregulloreje;

d) vlerësimin paraprak të ndikimit, dëmeve dhe humbjeve;

e) vendosjen e masave të komunikimit dhe menaxhimit të krizave, që sigurojnë që informacioni i përditësuar t'i transmetohet të gjithë stafit përkatës të brendshëm dhe palëve të jashtme të interesuara, në përputhje me nenin 16 të kësaj rregulloreje, dhe t'i raportohet Bankës së Shqipërisë, në përputhje me nenin 30 të kësaj rregulloreje.

3. Subjektet financiare zbatojnë plane të reagimit dhe të rimëkëmbjes të lidhura me TIK-un, si pjesë të sistemit të administrimit të rrezikut të TIK-ut të parashikuar në pikën 1 të nenit 7 të kësaj rregulloreje, të cilët, në rastin e subjekteve financiare që nuk janë mikrondërmarrje, do të jenë subjekt i rishikimeve të pavarura të auditit të brendshëm.

4. Subjektet financiare hartojnë, mirëmbajnë dhe testojnë periodikisht planet e duhura të vazhdimësisë së biznesit të TIK-ut, veçanërisht në lidhje me funksionet kritike ose të rëndësishme të deleguara te palë të treta, ose të kontraktuara nëpërmjet marrëveshjeve me ofruesit e shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut.

5. Subjektet financiare, si pjesë të politikës së përgjithshme të vazhdimësisë së biznesit, duhet të kryejnë një analizë të ndikimit në biznes (ANB) të ekspozimeve të tyre ndaj ndërprerjeve të rënda të aktivitetit/biznesit. Sipas analizës së ndikimit në biznes, subjektet financiare vlerësojnë ndikimin e mundshëm të ndërprerjeve të rënda të aktivitetit/biznesit, me anë të kritereve sasiore dhe cilësore, duke përdorur të dhëna të brendshme dhe të jashtme dhe analiza të skenarëve, sipas rastit. Analiza e ndikimit në biznes duhet të konsiderojë kritikalitetin e funksioneve të biznesit të identifikuar dhe të përcaktuar, proceset mbështetëse, varësitë ndaj palëve të treta dhe asetet e informacionit, si dhe ndërvarësinë e tyre. Subjektet financiare duhet të sigurojnë që asetet e TIK-ut dhe shërbimet e TIK-ut janë projektuar dhe përdorur në përputhje të plotë me analizën e ndikimit në biznes, veçanërisht në lidhje me sigurimin në mënyrë të mjaftueshme të tepricës së të gjithë komponentëve kritikë.

6. Si pjesë të administrimit gjithëpërfshirës të rrezikut të TIK-ut, subjektet financiare duhet të:

a) testojnë planet e vazhdimësisë së biznesit të TIK-ut dhe planet e reagimit dhe të rimëkëmbjes së TIK-ut, në lidhje me sistemet e TIK-ut që mbështetin të gjitha funksionet, të paktën çdo vit, si dhe pas ndryshimeve thelbësore në sistemet e TIK-ut që mbështetin funksionet kritike ose të rëndësishme;

b) testojnë planet e komunikimit në situata krize, të hartuara në përputhje me nenin 16 të kësaj rregulloreje.

7. Për qëllime të shkronjës "a" të pikës 6 të këtij neni, subjektet financiare, me përjashtim të mikrondërmarrjeve, do të përfshijnë në planet e testimit skenarë të sulmeve kibernetike dhe kalimeve ndërmjet infrastrukturës parësore të TIK-ut dhe infrastrukturës dytësore (*redundant capacity*), *backups* dhe objekteve dytësore, të nevojshme për të përmbushur detyrimet e përcaktuara në nenin 14 të kësaj rregulloreje.

8. Subjektet financiare duhet të rishikojnë rregullisht politikën e tyre të vazhdimësisë së biznesit të TIK-ut dhe planin e reagimit dhe rimëkëmbjes nga fatkeqësitë e TIK-ut, duke marrë parasysh rezultatet e testeve të kryera në përputhje me pikën 6 të këtij neni dhe rekomandimet që rrjedhin nga kontrollet e auditimit ose rishikimet mbikëqyrëse.

9. Subjektet financiare, me përjashtim të mikrondërmarrjeve, krijojnë një funksion të menaxhimit të krizave, i cili, në rast të aktivizimit të planit të tyre të vazhdimësisë së biznesit të TIK-ut ose planit të reagimit dhe rimëkëmbjes nga fatkeqësitë e TIK-ut, përcakton procedura të qarta për administrimin e komunikimeve të brendshme dhe të jashtme në situata krize, në përputhje me nenin 16 të kësaj rregulloreje.

10. Subjektet financiare duhet të mbajnë regjistrime lehtësisht të aksesueshme të aktiviteteve para dhe gjatë ngjarjeve të ndërprerjes së aktivitetit, kur aktivizohet plani i vazhdimësisë së biznesit të TIK-ut ose plani i reagimit dhe rimëkëmbjes nga fatkeqësitë e TIK-ut.

11. Subjektet financiare, me përjashtim të mikrondërmarrjeve, raportojnë në Bankën e Shqipërisë, me kërkesë të kësaj të fundit, një vlerësim të të gjitha kostove dhe humbjeve të shkaktuara nga incidentet madhore të lidhura me TIK-un, sipas përcaktimeve të nenit 13 të kësaj rregulloreje.

Neni 13

Vlerësimi i kostove dhe humbjeve të shkaktuara nga incidentet madhore të lidhura me TIK-un

1. Për qëllime të pikës 11 të nenit 12 të kësaj rregulloreje, subjektet financiare duhet të vlerësojnë kostot dhe humbjet vjetore të agreguara, të shkaktuara nga incidentet madhore të lidhura me TIK-un, duke përfshirë të gjitha kostot dhe humbjet që lidhen me incidentet madhore të TIK-ut që kanë ndodhur brenda vitit referencë, për të cilin Banka e Shqipërisë ka kërkuar vlerësimin. Subjekti financiar mund të zgjedhë nëse viti referencë do të korrespondojë me vitin kalendarik ose me vitin kontabël të përfunduar të subjektit financiar, për të cilin ky i fundit ka finalizuar pasqyrat financiare. Pasi subjekti financiar të ketë vendosur nëse do të bazojë vlerësimin në vitin kalendarik apo në vitin kontabël, ky vendim duhet të zbatohet edhe për vlerësimet e ardhshme të kostove dhe humbjeve vjetore të agreguara. Subjekti financiar mund ta ndryshojë këtë vendim duke njoftuar Bankën e Shqipërisë, me kusht që Banka e Shqipërisë të mos ketë kundërshtime brenda dy muajve nga marrja e njoftimit. Subjektet financiare nuk duhet të përfshijnë kostot dhe humbjet që lidhen me incidente që kanë ndodhur përpara ose pas vitit referencë.

2. Subjektet financiare duhet të përfshijnë në vlerësim, të gjitha incidentet që lidhen me TIK-un, të cilat, pavarësisht shkakut, janë klasifikuar si madhore, në përputhje me nënkreun II të kreut III të kësaj rregulloreje dhe:

a) për të cilat subjekti financiar ka paraqitur një raport përfundimtar, në përputhje me nenin 30, pika 6, shkronja "c", të kësaj rregulloreje gjatë vitit referencë përkatës; ose

b) çdo incident për të cilin subjekti financiar ka paraqitur në vitet referencë të mëparshme një raport përfundimtar, në përputhje me nenin 30, pika 6, shkronja "c", të kësaj rregulloreje, që ka pasur një ndikim financiar të matshëm mbi subjektin financiar gjatë vitit referencë përkatës.

3. Subjektet financiare duhet të vlerësojnë kostot dhe humbjet vjetore të agreguara, duke ndjekur hapat e mëposhtëm në mënyrë të njëpasnjëshme:

a) të vlerësojnë kostot dhe humbjet e çdo incidenti madhor që lidhet me TIK-un, siç përcaktohet në pikën 2 të këtij neni, individualisht. Këto vlerësime duhet të japin kostot dhe humbjet bruto, duke marrë parasysh llojet e kostove dhe humbjeve të përcaktuara në nenin 26, pikat 1 dhe 2, të kësaj rregulloreje;

b) për secilin incident madhor të lidhur me TIK-un, subjektet financiare duhet, gjithashtu, të vlerësojnë vlerat e rikuperuara *(financial recoveries),* siç përcaktohet në Aneksin 2 të kësaj rregulloreje;

c) subjektet financiare agregojnë kostot dhe humbjet bruto dhe vlerat e rikuperuara për të gjitha incidentet madhore që lidhen me TIK-un.

4. Si bazë për vlerësimet, subjektet financiare duhet t'u referohen kostove, humbjeve dhe vlerave të rikuperuara që pasqyrohen në pasqyrat e tyre financiare, si për shembull pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, ose, kur është e zbatueshme, në raportimet mbikëqyrëse, për vitin referencë përkatës.

Në vlerësimin e tyre, subjektet financiare duhet të përfshijnë, gjithashtu, provigjionet kontabël që pasqyrohen në pasqyrat financiare të vitit referencë përkatës.

Në rastet kur të dhënat e sakta nuk janë të disponueshme, subjektet financiare duhet të bazojnë vlerësimin e tyre në të dhëna dhe informacione të tjera të disponueshme, sa më shumë që të jetë e mundur.

5. Subjektet financiare duhet të përfshijnë rregullimet mbi kostot dhe humbjet e një vlerësimi të paraqitur për një vit të mëparshëm, në vlerësimin e vitit referencë përkatës, në të cilin janë bërë këto rregullime.

6. Subjektet financiare duhet të përfshijnë në raportin e tyre të vlerësimit të kostove dhe humbjeve vjetore të përmbledhura edhe ndarjen e kostove dhe humbjeve bruto dhe të vlerave të rikuperuara për secilin incident madhore të lidhur me TIK-un, që është përfshirë në agregim.

7. Subjektet financiare duhet të përdorin formularin në Aneksin 5 të kësaj rregulloreje, për të paraqitur në Bankën e Shqipërisë vlerësimin e kostove dhe humbjeve të tyre vjetore të agreguara për vitin referencë.

Për çdo element të përfshirë në vlerësimin e vitit referencë, në përputhje me pikat 2 dhe 5 të këtij neni, subjektet financiare duhet të përdorin të njëjtat kode reference të incidenteve që kanë përdorur në raportin përfundimtar, në përputhje me nenin 30, pika 6, shkronja "c", të kësaj rregulloreje.

Neni 14

Politikat dhe procedurat e *backup*-it dhe procedurat dhe metodat e rikuperimit dhe rimëkëmbjes

1. Me qëllim sigurimin e rikuperimit (rikthimit në gjendjen e mëparshme) të sistemeve të TIK-ut dhe të dhënave në një kohë sa më të shkurtër, si dhe kufizimin në maksimum të kohëzgjatjes së padisponueshmërisë, ndërprerjeve dhe humbjeve, si pjesë e sistemit të tyre të administrimit të rrezikut të TIK-ut, subjektet financiare hartojnë dhe dokumentojnë:

a) politika dhe procedura *backup*-i që specifikojnë shtrirjen e të dhënave që i nënshtrohen *backup*-it dhe frekuencën minimale të *backup*-it, bazuar në kritikalitetin e informacionit ose konfidencialitetin e të dhënave;

b) procedura dhe metoda të rikuperimet dhe rimëkëmbjes.

2. Subjektet financiare krijojnë sisteme të *backup*-it, të cilat aktivizohen në përputhje me politikat dhe procedurat e *backup*-it, si dhe me procedurat dhe metodat e rikuperimit dhe rimëkëmbjes. Aktivizimi i sistemeve të *backup*-it nuk duhet të rrezikojë sigurinë e rrjetit dhe sistemeve të informacionit, ose disponueshmërinë, autenticitetin, integritetin ose konfidencialitetin e të dhënave. Subjektet financiare testojnë periodikisht procedurat e *backup*-it, si dhe procedurat dhe metodat e rikuperimet dhe rimëkëmbjes.

3. Gjatë rikuperimet të të dhënave të *backup*-it, duke përdorur sistemet e veta, subjektet financiare duhet të përdorin sisteme TIK që janë fizikisht dhe logjikisht të ndara nga sistemi kryesor i TIK-ut. Sistemet e TIK-ut duhet të jenë të mbrojtur në mënyrë të sigurt nga çdo akses i paautorizuar ose korruptim i TIK-ut dhe të lejojnë rikuperimin në kohë të shërbimeve, duke përdorur të dhënat dhe *backup*-et (kopjet rezervë) të sistemit sipas nevojës.

4. Subjektet financiare, me përjashtim të mikrondërmarrjeve, duhet të mbajnë infrastruktura dytësore të TIK-ut, të pajisura me burime, kapacitete dhe funksionalitete që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar nevojat e biznesit. Mikrondërmarrjet vlerësojnë nevojat për të mbajtur infrastruktura dytësore të TIK-ut, bazuar në profilin e tyre të rrezikut.

5. Subjektet financiare, në përcaktimin e kohës së rimëkëmbjes dhe objektivave të pikës së rimëkëmbjes për çdo funksion, duhet të marrin parasysh nëse një funksion është apo jo kritik ose i rëndësishëm, si dhe ndikimin e përgjithshëm të mundshëm në eficiencën e tregut. Këta objektiva kohorë duhet të sigurojnë që, në skenarë ekstremë, të përmbushen nivelet e dakorduara të shërbimit.

6. Subjektet financiare, pasi rimëkëmben nga një incident i lidhur me TIK-un, duhet të kryejnë kontrollet e nevojshme, duke përfshirë rakordimet, në mënyrë që të sigurohet që integriteti i të dhënave është i nivelit më të lartë. Këto kontrolle do të kryhen, gjithashtu, gjatë rindërtimit të të dhënave nga palët e jashtme të interesuara, në mënyrë që të sigurohet që të gjitha të dhënat të jenë të përputhshme ndërmjet sistemeve të ndryshme.

Neni 15

Mësimet e nxjerra dhe zhvillimi

1. Subjektet financiare duhet të disponojnë aftësi të përshtatshme dhe personel të mjaftueshëm për të mbledhur informacion mbi vulnerabilitetet dhe kërcënimet kibernetike, incidentet e lidhura me TIK-un, veçanërisht sulmet kibernetike, dhe të analizojnë ndikimet e mundshme në qëndrueshmërinë e tyre operacionale digjitale.

2. Subjektet financiare duhet të kryejnë rishikime pas incidenteve të lidhura me TIK-un, pasi një incident i lidhur me TIK-un ndërpret aktivitetet e tyre kryesore, duke analizuar shkaqet e ndërprerjes dhe duke identifikuar përmirësimet e nevojshme në operacionet e TIK-ut ose brenda politikës së vazhdimësisë së biznesit të TIK-ut të parashikuar në nenin 12 të kësaj rregulloreje. Subjektet financiare, me përjashtim të mikrondërmarrjeve, i komunikojnë Bankës së Shqipërisë, me kërkesë të kësaj të fundit, ndryshimet e implementuara si rrjedhojë e rishikimeve pas ndodhjes së incidenteve të lidhura me TIK-un.

3. Rishikimet pas incidentit të lidhur me TIK-un, të parashikuara në pikën 2 të këtij neni, përcaktojnë nëse janë ndjekur procedurat e vendosura dhe veprimet e ndërmarra kanë qenë efektive, duke përfshirë në lidhje me:

a) shpejtësinë në përgjigjen ndaj alarmeve të sigurisë dhe përcaktimin e ndikimit të incidenteve të lidhura me TIK-un dhe ashpërsinë e tyre;

b) cilësinë dhe shpejtësinë në kryerjen e analizave forensike, kur është e përshtatshme;

c) efektivitetin e përshkallëzimit të incidentit brenda subjektit financiar;

d) efektivitetin e komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm.

4. Subjektet konsiderojnë dhe përfshijnë në mënyrë të vazhdueshme në procesin e vlerësimit të rrezikut të TIK-ut, konkluzionet (mësimet) e nxjerra nga testimi i qëndrueshmërisë operacionale digjitale i kryer në përputhje me nenet 43 dhe 44 të kësaj rregulloreje dhe nga incidentet reale të ndodhura të lidhura me TIK-un, veçanërisht sulmet kibernetike, së bashku me sfidat me të cilat përballet aktivizimi i planeve të vazhdimësisë së biznesit ose rimëkëmbjes, së bashku me informacionin përkatës të shkëmbyer me palët dhe të vlerësuar gjatë rishikimeve mbikëqyrëse. Këto gjetje do të shërbejnë si bazë për rishikimet e përshtatshme të elementeve përkatëse të sistemit të administrimit të rrezikut të TIK-ut të parashikuar në nenin 7, pika 1, të kësaj rregulloreje.

5. Subjektet financiare monitorojnë efektivitetin e zbatimit të strategjisë së tyre të qëndrueshmërisë operacionale digjitale, të përcaktuar në nenin 7, pika 9, të kësaj rregulloreje. Subjektet hartëzojnë evolucionin në kohë të rreziqeve të TIK-ut, analizojnë frekuencën, llojet, madhësinë dhe evolucionin e incidenteve të lidhura me TIK-un, në veçanti sulmeve kibernetike dhe strukturave të tyre, me qëllim që të kuptojnë nivelin e ekspozimit ndaj rrezikut të TIK-ut, veçanërisht në lidhje me funksionet kritike ose të rëndësishme, dhe të përmirësojnë maturinë dhe gatishmërinë kibernetike të subjektit financiar.

6. Drejtuesit e TIK-ut raportojnë të paktën një herë në vit në organet drejtuese të subjektit financiar, mbi gjetjet e parashikuara në pikën 4 të këtij neni dhe paraqesin edhe rekomandimet e tyre.

7. Subjektet financiare zhvillojnë programe ndërgjegjësimi për sigurinë e TIK-ut dhe trajnime për qëndrueshmërinë operacionale digjitale, si module të detyrueshme në skemat e trajnimit të punonjësve. Këto programe dhe trajnime do të zbatohen për të gjithë punonjësit dhe për drejtuesit e subjektit dhe duhet të kenë një nivel kompleksiteti në proporcion me detyrat dhe funksionet e tyre. Kur është e përshtatshme, subjektet financiare përfshijnë në skemat përkatëse të trajnimit edhe ofruesit e shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, në përputhje me nenin 47, pika 2, shkronja "i", të kësaj rregulloreje.

8. Subjektet financiare, me përjashtim të mikrondërmarrjeve, monitorojnë zhvillimet teknologjike përkatëse, në mënyrë të vazhdueshme, edhe me synimin për të kuptuar ndikimet e mundshme të këtyre teknologjive të reja mbi kërkesat e sigurisë së TIK-ut dhe qëndrueshmërinë operacionale digjitale. Subjektet duhet të përditësohen me proceset më të fundit të administrimit të rrezikut të TIK-ut, për të luftuar në mënyrë efektive format aktuale ose të reja të sulmeve kibernetike.

Neni 16
Komunikimi

1. Si pjesë të sistemit të administrimit të rrezikut të TIK-ut të parashikuar në nenin 7, pika 1, të kësaj rregulloreje, subjektet financiare duhet të kenë plane komunikimi në situata krize, që u mundësojnë një njoftim të përgjegjshëm, për të paktën incidentet madhore ose vulnerabilitetet e lidhura me TIK-un, për klientët dhe kundërpartitë, si dhe për publikun, sipas rastit.

2. Si pjesë të sistemit të administrimit të rrezikut të TIK-ut, subjektet financiare zbatojnë politika komunikimi për punonjësit dhe për palët e jashtme të interesuara. Politikat e komunikimit për punonjësit duhet të konsiderojnë që të bëhet dallimi ndërmjet punonjësve të përfshirë në administrimin e rrezikut të TIK-ut, në veçanti punonjësve përgjegjës për reagimin dhe rimëkëmbjen, dhe pjesës tjetër të personelit që duhet të informohet.

3. Subjekti financiar cakton të paktën një person për zbatimin e strategjisë së komunikimit për incidentet e lidhura me TIK-un dhe për të përmbushur rolin e zëdhënësit të publikut dhe medias për këtë qëllim.

Neni 17
Sistemi i thjeshtuar i administrimit të rrezikut të TIK-ut

1. Nenet 6 deri në 16 të kësaj rregulloreje nuk zbatohen për institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike që përjashtohen sipas parashikimeve të ligjit "Për shërbimet e pagesave", të cilët krijojnë një sistem të thjeshtuar të administrimit të rrezikut të TIK-ut, siç parashikohet në pikën 2 të këtij neni.

2. Pa cenuar pikën 1 të këtij neni, subjektet e listuara në atë pikë:

a) krijojnë dhe mbajnë një sistem të shëndoshë dhe të dokumentuar të administrimit të rrezikut të TIK-ut, që detajon mekanizmat dhe masat që synojnë një administrim të shpejtë, efikas dhe gjithëpërfshirës të rrezikut të TIK-ut, duke përfshirë mbrojtjen e komponentëve dhe infrastrukturave fizike përkatëse;

b) monitorojnë vazhdimisht sigurinë dhe funksionimin e të gjitha sistemeve të TIK-ut;

c) minimizojnë ndikimin e rrezikut të TIK-ut nëpërmjet përdorimit të sistemeve, protokolleve dhe mekanizmave të shëndoshë, të qëndrueshëm dhe të përditësuar të TIK-ut, të cilat janë të përshtatshëm për të mbështetur performancën e aktiviteteve të tyre dhe ofrimin e shërbimeve dhe për të mbrojtur në mënyrë adekuate disponueshmërinë, autenticitetin, integritetin dhe konfidencialitetin e të dhënave në rrjet dhe sistemet e informacionit;

d) lejojnë që burimet e rrezikut dhe anomalitë e TIK-ut në rrjet dhe sistemet e informacionit të identifikohen dhe zbulohen menjëherë, dhe incidentet e lidhura me TIK-un të trajtohen me shpejtësi;

e) identifikojnë ndërvarësitë kryesore nga ofruesit e shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut;

f) sigurojnë vazhdimësinë e funksioneve kritike ose të rëndësishme, nëpërmjet planeve të vazhdimësisë së biznesit dhe masave të reagimit dhe rimëkëmbjes, të cilat përfshijnë, të paktën, *backup*-in dhe masat e rikuperimit;

g) testojnë rregullisht planet dhe masat e parashikuara në shkronjën "f", si dhe efektivitetin e kontrolleve të zbatuara në përputhje me shkronjat "a" dhe "c" të kësaj pike;

h) zbatojnë, sipas rastit, konkluzionet përkatëse operacionale që rezultojnë nga testet e parashikuara në shkronjën "g" dhe nga analiza pas incidentit në procesin e vlerësimit të rrezikut të TIK-ut, si dhe zhvillojnë, sipas nevojave dhe profilit të rrezikut të TIK-ut, programet e ndërgjegjësimit për sigurinë e TIK-ut dhe trajnimin mbi qëndrueshmërinë operacionale digjitale për punonjësit dhe drejtuesit e subjektit.

3. Sistemi i administrimit të rrezikut të TIK-ut i parashikuar në pikën 2, shkronja "a", të këtij neni, duhet të dokumentohet dhe rishikohet periodikisht nga subjektet dhe pas ndodhjes së incidenteve madhore të lidhura me TIK-un, në përputhje me udhëzimet mbikëqyrëse. Subjektet e përmirësojnë vazhdimisht sistemin e administrimit të rrezikut të TIK-ut, në bazë të mësimeve të nxjerra nga zbatimi dhe monitorimi. Subjektet i komunikojnë Bankës së Shqipërisë, me kërkesë të kësaj të fundit, raportin mbi rishikimin e sistemit të administrimit të rrezikut të TIK-ut.

KREU III
ADMINISTRIMI, KLASIFIKIMI DHE RAPORTIMI I INCIDENTEVE TË LIDHUR ME TIK-un

NËNKREU I
ADMINISTRIMI DHE KLASIFIKIMI I INCIDENTEVE TË LIDHUR ME TIK-un

Neni 18
Procesi i administrimit të incidenteve të lidhura me TIK-un

1. Subjektet financiare përcaktojnë, krijojnë dhe zbatojnë një proces të administrimit të incidenteve të lidhura me TIK-un, për të zbuluar, administruar dhe njoftuar incidentet e lidhura me TIK-un.

2. Subjektet financiare regjistrojnë të gjitha incidentet e lidhura me TIK-un dhe kërcënimet kibernetike të rëndësishme. Subjektet financiare krijojnë procedura dhe procese të përshtatshme për të siguruar një monitorim, trajtim dhe ndjekje të vazhdueshme dhe të integruar të incidenteve të lidhura me TIK-un, për të siguruar që shkaqet kryesore të incidentit janë identifikuar, dokumentuar dhe adresuar, për të parandaluar përsëritjen e incidenteve të tilla.

3. Procesi i administrimit të incidenteve të lidhura me TIK-un, i parashikuar në pikën 1 të këtij neni:

a) përcakton tregues të paralajmërimit të hershëm;

b) krijon procedura për identifikimin, gjurmimin, regjistrimin, kategorizimin dhe klasifikimin e incidenteve të lidhura me TIK-un, sipas prioritetit të tyre dhe ashpërsisë, si dhe sipas kritikalitetit të shërbimeve të ndikuara nga incidenti, në përputhje me kriteret e parashikuara në nenin 19, pika 1, të kësaj rregulloreje;

c) përcakton rolet dhe përgjegjësitë që duhet të aktivizohen për lloje dhe skenarë të ndryshëm incidentesh të lidhura me TIK-un;

d) përcakton planet për komunikimin me punonjësit, me palët e jashtme të interesuara dhe me median, në përputhje me nenin 16 të kësaj rregulloreje, për njoftimin e klientëve, për procedurat e brendshme të përshkallëzimit, duke përfshirë ankesat e klientëve lidhur me TIK-un, si dhe për dhënien e informacionit subjekteve financiare që veprojnë si kundërparti të subjektit në fjalë, sipas rastit;

e) siguron që të paktën incidentet madhore të lidhura me TIK-un të raportohen te drejtuesit përkatës dhe të informohet organi drejtues, të paktën për incidentet madhore të lidhura me TIK-un, duke shpjeguar ndikimin, reagimin dhe kontrollet shtesë që do të vendosen si rezultat i incidenteve të lidhura me TIK-un;

f) krijon procedura të reagimit ndaj incidenteve të lidhura me TIK-un, për të zbutur ndikimet dhe për të siguruar që shërbimet të bëhen funksionale dhe të sigurta në kohën e duhur.

Neni 19
Klasifikimi i incidenteve të lidhura me TIK-un dhe i kërcënimeve kibernetike

1. Subjektet financiare klasifikojnë incidentet e lidhura me TIK-un dhe përcaktojnë ndikimin e tyre bazuar në kriteret e mëposhtme:

a) numrin dhe/ose rëndësinë e klientëve ose e kundërpartive financiare të prekur dhe, ku është e zbatueshme, vlerën ose numrin e transaksioneve të prekur nga incidenti i lidhur me TIK-un, si dhe nëse incidenti i lidhur me TIK-un ka pasur ndikim reputacional për subjektin;

b) kohëzgjatjen e incidentit të lidhur me TIK-un, duke përfshirë edhe kohën e ndërprerjes së shërbimeve;

c) shtrirjen gjeografike në lidhje me zonat e prekura nga incidenti i lidhur me TIK-un, veçanërisht nëse ai prek më shumë se dy shtete;

d) humbjet e të dhënave që shkakton incidenti i lidhur me TIK-un, në lidhje me disponueshmërinë, autenticitetin, integritetin ose konfidencialitetin e të dhënave;

e) kritikalitetin e shërbimeve të prekura, duke përfshirë transaksionet dhe operacionet e subjektit financiar;

f) ndikimin ekonomik të incidentit të lidhur me TIK-un, në terma absolutë dhe relativë, në veçanti në kostot direkte e indirekte dhe humbjet.

2. Subjektet financiare klasifikojnë kërcënimet kibernetike si të rëndësishme, bazuar në kritikalitetin e shërbimeve në rrezik, duke përfshirë transaksionet dhe operacionet e subjektit financiar, numrin dhe/ose rëndësinë e klientëve ose të kundërpartive financiare të synuar, si dhe shtrirjen gjeografike të zonave në rrezik.

NËNKREU II
KRITERET E KLASIFIKIMIT TË INCIDENTEVE TË LIDHURA me TIK-un DHE TË KËRCËNIMEVE KIBERNETIKE

Neni 20
Klientët, kundërpartitë financiare dhe transaksionet

1. Për qëllime të pikës 1, shkronja "a", të nenit 19 të kësaj rregulloreje, numri i klientëve të prekur nga incidenti, pasqyron numrin e të gjithë klientëve të prekur, persona fizikë apo juridikë, që nuk janë ose nuk kanë qenë në gjendje të përdorin shërbimin e ofruar nga subjekti financiar gjatë incidentit, ose që janë ndikuar negativisht nga incidenti. Ky numër duhet të përfshijë edhe palët e treta të mbuluara në mënyrë eksplicite nga marrëveshja kontraktuale ndërmjet subjektit financiar dhe klientit, si përfitues të shërbimit të prekur.

2. Për qëllime të pikës 1, shkronja "a", të nenit 19 të kësaj rregulloreje, numri i kundërpartive financiare të prekura nga incidenti pasqyron numrin e të gjitha kundërpartive financiare të prekura nga incidenti, që kanë lidhur një marrëveshje kontraktuale me subjektin financiar.

3. Për të vlerësuar rëndësinë e klientëve dhe kundërpartive financiare të prekura nga incidenti, siç parashikohet në pikën 1, shkronja "a", të nenit 19 të kësaj rregulloreje, subjekti financiar merr në konsideratë masën në të cilën ndikimi mbi një klient ose një kundërparti financiare do të ndikojë në zbatimin e objektivave të biznesit të subjektit financiar, si dhe në efektin e mundshëm të incidentit në efektivitetin e tregut.

4. Për shumën ose numrin e transaksioneve të prekura nga incidenti, siç parashikohet në pikën 1, shkronja "a", të nenit 19 të kësaj rregulloreje, subjekti financiar merr në konsideratë të gjitha transaksionet e prekura që përfshijnë një shumë monetare, ku të paktën një pjesë e transaksionit kryhet në Shqipëri.

5. Në rastet kur nuk disponohen të dhëna reale mbi numrin e klientëve ose kundërpartive financiare të prekur ose mbi numrin ose shumën e transaksioneve të prekura, subjekti financiar i vlerëson këta numra ose shuma bazuar në të dhënat e disponueshme nga periudha të krahasueshme reference.

Neni 21
Ndikimi reputacional

1. Për qëllime të përcaktimit të ndikimit reputacional të incidentit, siç parashikohet në pikën 1, shkronja "a", të nenit 19 të kësaj rregulloreje, subjekti financiar merr në konsideratë se incidenti ka pasur një ndikim reputacional, kur plotësohet të paktën një nga kriteret e mëposhtme:

a) ngjarja është pasqyruar në media;

b) incidenti ka rezultuar në ankesa të përsëritura nga klientë të ndryshëm ose kundërpartitë financiare, për shërbimet që përballen me klientët ose marrëdhëniet kritike të biznesit;

c) subjekti financiar nuk do të jetë në gjendje ose ka të ngjarë të mos jetë në gjendje të përmbushë kërkesat rregullatore si rezultat i incidentit;

d) subjekti financiar do të humbasë ose ka të ngjarë të humbasë klientët ose kundërpartitë financiare, me një ndikim material në biznesin e tij, si rezultat i incidentit.

2. Gjatë vlerësimit të ndikimit reputacional të incidentit, subjektet financiare marrin në konsideratë nivelin e shikueshmërisë që incidenti ka fituar ose ka të ngjarë të fitojë, në lidhje me secilën nga kriteret e renditura në pikën 1 të këtij neni.

Neni 22
Kohëzgjatja dhe koha e ndërprerjes së shërbimeve

1. Për qëllime të pikës 1, shkronja "b", të nenit 19 të kësaj rregulloreje, subjektet financiare llogaritin kohëzgjatjen e një incidenti, nga momenti kur ndodh incidenti deri në momentin kur ai zgjidhet.

2. Kur subjektet financiare nuk janë në gjendje të përcaktojnë momentin kur ka ndodhur incidenti, ato do të matin kohëzgjatjen e incidentit nga momenti i zbulimit të tij. Kur subjektet financiare marrin dijeni se incidenti ka ndodhur përpara zbulimit të tij, ata do të matin kohëzgjatjen nga momenti kur incidenti është regjistruar në regjistrat (*log*-et) e rrjetit ose të sistemit ose në burime të tjera të dhënash.

3. Kur subjektet financiare nuk e dinë ende se kur do të zgjidhet incidenti ose nuk janë në gjendje të verifikojnë të dhënat e regjistruara në regjistrat (*log*-et) ose në burimet e tjera të të dhënave, ato përdorin vlerësimet e tyre.

4. Për qëllime të pikës 1, shkronja "b", të nenit 19 të kësaj rregulloreje, subjektet financiare llogaritin kohën e ndërprerjes së shërbimit të një incidenti, nga momenti kur shërbimi është plotësisht ose pjesërisht i padisponueshëm për klientët, kundërpartitë financiare ose përdoruesit e tjerë të brendshëm ose të jashtëm, deri në momentin kur aktivitetet ose operacionet e rregullta janë rikthyer në nivelin e shërbimit që ofrohej para incidentit. Kur ndërprerja e shërbimit shkakton një vonesë në ofrimin e shërbimit pas rikthimit/rikuperimit të aktiviteteve ose operacioneve të rregullta, koha e ndërprerjes do të llogaritet që nga fillimi i incidentit deri në momentin kur ky shërbim i vonuar ofrohet plotësisht.

5. Në rastet kur subjektet financiare nuk janë në gjendje të përcaktojnë momentin e fillimit të ndërprerjes së shërbimit, ato do të matin kohën e ndërprerjes së shërbimit që nga momenti i zbulimit të tij.

Neni 23
Shtrirja gjeografike

1. Për qëllime të përcaktimit të shtrirjes gjeografike në lidhje me zonat e prekura nga incidenti, siç parashikohet në pikën 1, shkronja "c", të nenit 19 të kësaj rregulloreje, subjektet financiare vlerësojnë nëse incidenti ka apo ka pasur ndikim në shtete të tjera, dhe në veçanti vlerësojnë rëndësinë e ndikimit në lidhje me një nga sa vijon:

a) klientët dhe kundërpartitë financiare në shtete të tjera;

b) degët ose subjektet e tjera financiare të grupit, që kryejnë veprimtari në shtete të tjera;

c) infrastrukturat e tregut financiar ose ofruesit e palëve të treta, të cilët mund të prekin subjektet financiare në shtete të tjera, ku ofrojnë shërbime, për aq sa një informacion i tillë është i disponueshëm.

Neni 24
Humbja e të dhënave

1. Për qëllime të përcaktimit të humbjes së të dhënave që shkakton incidenti, siç parashikohet në

pikën 1, shkronja "d", të nenit 19 të kësaj rregulloreje, subjektet financiare marrin parasysh:

a) në lidhje me disponueshmërinë e të dhënave, nëse incidenti i ka bërë të dhënat sipas kërkesës së subjektit financiar, klientëve ose kundërpartive të tij, të paaksesueshme ose të papërdorshme, në mënyrë të përkohshme ose të përhershme;

b) në lidhje me autenticitetin e të dhënave, nëse incidenti ka cenuar besueshmërinë e burimit të të dhënave;

c) në lidhje me integritetin e të dhënave, nëse incidenti ka rezultuar në modifikim të paautorizuar të të dhënave që e bën atë të pasaktë ose të paplotë;

d) në lidhje me konfidencialitetin e të dhënave, nëse incidenti ka rezultuar në aksesimin ose zbulimin e të dhënave nga një palë ose sistem i paautorizuar.

Neni 25
Kritikaliteti i shërbimeve të prekura

1. Për qëllime të përcaktimit të kritikalitetit të shërbimeve të prekura, siç parashikohet në pikën 1, shkronja "e", të nenit 19 të kësaj rregulloreje, subjektet financiare vlerësojnë nëse incidenti:

a) prek ose ka prekur shërbimet e TIK-ut ose rrjetet dhe sistemet e informacionit që mbështesin funksione kritike ose të rëndësishme të subjektit financiar;

b) prek ose ka prekur shërbimet financiare të ofruara nga subjekti financiar, për të cilat është licencuar/regjistruar nga Banka e Shqipërisë;

c) ka krijuar një akses të suksesshëm, keqdashës dhe të paautorizuar në rrjetin dhe sistemet e informacionit të subjektit financiar.

Neni 26
Ndikimi ekonomik

1. Për qëllime të përcaktimit të ndikimit ekonomik të incidentit, siç parashikohet në pikën 1, shkronja "f", të nenit 19 të kësaj rregulloreje, subjektet financiare, pa llogaritur vlerat e rikuperuara, marrin parasysh llojet e mëposhtme të kostove direkte dhe indirekte, si dhe humbjeve që janë shkaktuar si rezultat i incidentit:

a) fondet ose aktivet financiare të përvetësuara *(expropriated),* për të cilat ato janë përgjegjëse, duke përfshirë aktivet e humbura për shkak të vjedhjes;

b) kostot për zëvendësimin ose zhvendosjen e pajisjeve *(hardware),* programeve kompjuterike *(software)* ose infrastrukturës;

c) kostot e personelit, përfshirë edhe kostot që lidhen me zëvendësimin ose zhvendosjen e personelit, rekrutimin e personelit shtesë, shpërblimet për punën jashtë orarit dhe rikuperimin e aftësive të humbura ose të dëmtuara;

d) tarifat për mosrespektimin e detyrimeve kontraktuale;

e) kostot për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe kompensimin e klientëve;

f) humbjet për shkak të të ardhurave të munguara;

g) kostot që lidhen me komunikimin e brendshëm dhe të jashtëm;

h) kostot e konsulencës, duke përfshirë kostot që lidhen me këshillimin ligjor, shërbimet mjekoligjore dhe shërbimet e rehabilitimit.

2. Kostot dhe humbjet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, nuk përfshijnë kostot që janë të nevojshme për funksionimin e përditshëm të biznesit, veçanërisht sa vijon:

a) kostot për mirëmbajtjen e përgjithshme të infrastrukturës, pajisjeve, pajisjeve *hardware*, programeve kompjuterike *(software),* si dhe kostot për mbajtjen të përditësuara të aftësive të personelit;

b) kostot e brendshme ose të jashtme për të përmirësuar biznesin pas incidentit, duke përfshirë përmirësimet dhe iniciativat e vlerësimit të rrezikut;

c) primet e sigurimit.

3. Subjektet financiare llogaritin vlerën e kostove dhe të humbjeve, bazuar në të dhënat e disponueshme në momentin e raportimit. Subjektet financiare përdorin vlerësimet e tyre, nëse nuk mund të përcaktojnë vlerat reale të kostove dhe humbjeve.

4. Subjektet financiare mbledhin të gjitha kostot dhe humbjet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, për të vlerësuar ndikimin ekonomik të incidentit.

Neni 27
Incidentet madhore

1. Për qëllime të pikës 1 të nenit 30 të kësaj rregulloreje, një incident do të konsiderohet si incident madhor, kur ai ka prekur shërbimet kritike që parashikohen në nenin 25 të kësaj rregulloreje, si dhe nëse plotësohet ndonjë nga kushtet e mëposhtme:

a) është arritur kufiri i materialitetit i përcaktuar në nenin 28, pika 6, shkronja "b", të kësaj rregulloreje;

b) janë arritur dy ose më shumë nga kufijtë e tjerë të materialitetit të përcaktuar në pika 1 deri në 7 të nenit 28 të kësaj rregulloreje.

2. Incidentet e përsëritura që individualisht nuk konsiderohen si incident madhor në përputhje me pikën 1 të këtij neni, do të konsiderohen si një incident madhor nëse plotësojnë të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) incidentet kanë ndodhur të paktën dy herë brenda 6 muajve;

b) incidentet kanë të njëjtin shkak bazë të dukshëm;

c) incidentet së bashku plotësojnë kriteret për t'u konsideruar si një incident madhor, siç përcaktohet në pikën 1 të këtij neni.

3. Subjektet financiare do të vlerësojnë ekzistencën e incidenteve të përsëritura, në baza mujore.

4. Subjektet financiare që kanë informacion për incidentet jo madhore të përsëritura të lidhura me TIK-un, që plotësojnë në mënyrë kumulative kushtet për t'u konsideruar incident madhor i lidhur me TIK-un, siç parashikohet në pikën 2 të këtij neni, e paraqesin këtë informacion në një formë të përmbledhur (agreguar).

5. Kërkesat e parashikuara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni, nuk zbatohen për mikrondërmarrjet dhe për subjektet e parashikuara në nenin 17 të kësaj rregulloreje.

6. Nëse pas vlerësimeve të mëtejshme, subjekti financiar arrin në përfundimin se incidenti i lidhur me TIK-un, i cili është raportuar më parë si incident madhor, në asnjë moment nuk ka përmbushur kriteret dhe kufijtë e klasifikimit të përcaktuar në këtë nen, subjekti financiar njofton Bankën e Shqipërisë se e ka riklasifikuar incidentin e lidhur me TIK-un, nga incident madhor në jomadhor, duke i paraqitur informacionin për këtë klasifikim në formularin e parashikuar në Aneksin 2 të kësaj rregulloreje në lidhje me fushat "lloji i raportit" dhe "informacione të tjera".

Neni 28

Kufijtë e materialitetit për përcaktimin e incidenteve madhore

1. Kufiri i materialitetit për kriterin "klientët, kundërpartitë financiare dhe transaksionet" arrihet, kur plotësohet një nga kushtet e mëposhtme:

a) numri i klientëve të prekur është më i lartë se 10% e të gjithë klientëve që përdorin shërbimin e prekur;

b) numri i klientëve të prekur që përdorin shërbimin e prekur nga incidenti, është më i lartë se 100,000;

c) numri i kundërpartive financiare të prekura nga incidenti është më i lartë se 30% e të gjitha kundërpartive financiare që kryejnë aktivitete të lidhura me ofrimin e shërbimit të prekur nga incidenti;

d) numri i transaksioneve të prekura është më i lartë se 10% e numrit mesatar ditor të transaksioneve të kryera nga subjekti financiar, në lidhje me shërbimin e prekur nga incidenti;

e) vlera e transaksioneve të prekura është më e lartë se 10% e vlerës mesatare ditore të transaksioneve të kryera nga subjekti financiar, në lidhje me shërbimin e prekur nga incidenti;

f) janë prekur klientët ose kundërpartitë financiare që janë identifikuar si të rëndësishëm në përputhje me nenin 20, pika 3, të kësaj rregulloreje.

2. Për qëllime të pikës 1 të këtij neni, nëse numri real i klientëve ose kundërpartive financiare të prekur nga incidenti, ose numri apo vlera reale e transaksioneve të prekura nga incidenti nuk mund të përcaktohet, subjekti financiar vlerëson numrin apo vlerat, bazuar në të dhënat e disponueshme nga periudhat e krahasueshme të referencës.

3. Kufiri i materialitetit për kriterin "ndikimi reputacional" arrihet kur plotësohet ndonjë nga kushtet e parashikuara në nenin 21, pika 1, shkronjat "a" deri në "d", të kësaj rregulloreje.

4. Kufiri i materialitetit për kriterin "kohëzgjatja dhe koha e ndërprerjes së shërbimeve" arrihet kur plotësohet një nga kushtet e mëposhtme:

a) kohëzgjatja e incidentit është më e gjatë se 24 orë;

b) koha e ndërprerjes së shërbimit është më e gjatë se 2 orë për shërbimet e TIK-ut që mbështesin funksione kritike ose të rëndësishme.

5. Kufiri i materialitetit për kriterin "shtrirja gjeografike" arrihet kur incidenti ka ndikim në dy

ose më shumë shtete, në përputhje me nenin 23 të kësaj rregulloreje.

6. Kufiri i materialitetit për kriterin "humbjet e të dhënave" arrihet kur plotësohet ndonjë nga kushtet e mëposhtme:

a) çdo ndikim i përmendur në nenin 24 të kësaj rregulloreje, mbi disponueshmërinë, autenticitetin, integritetin ose konfidencialitetin e të dhënave ka ose do të ketë një ndikim negativ në zbatimin e objektivave të biznesit të subjektit financiar, ose në aftësinë e tij për të përmbushur kërkesat rregullatore;

b) çdo akses i suksesshëm, keqdashës dhe i paautorizuar, që nuk mbulohet nga parashikimet e shkronjës "a" të kësaj pike, ndodh në rrjet dhe sistemet e informacionit, ku një akses i tillë mund të rezultojë në humbje të të dhënave.

7. Kufiri i materialitetit për kriterin "ndikim ekonomik" arrihet kur kostot dhe humbjet e shkaktuara subjektit financiar nga incidenti, kanë tejkaluar ose ka të ngjarë të tejkalojnë vlerën ekuivalente në Lek të shumës 100,000 euro.

Neni 29

Kufijtë për përcaktimin e kërcënimeve kibernetike të rëndësishme

1. Për qëllime të pikës 2 të nenit 19 të kësaj rregulloreje, një kërcënim kibernetik do të konsiderohet i rëndësishëm kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) kërcënimi kibernetik, nëse materializohet, mund të ndikojë ose mund të ketë ndikuar në funksionet kritike ose të rëndësishme të subjektit financiar, ose mund të prekë subjekte të tjera financiare, ofrues të palëve të treta, klientë ose kundërparti financiare, bazuar në informacionin në dispozicion të subjektit financiar;

b) kërcënimi kibernetik ka një probabilitet të lartë për t'u materializuar te subjekti financiar ose te subjekte të tjera financiare, duke marrë në konsideratë të paktën elementet e mëposhtme:

i. rreziqet e aplikueshme që lidhen me kërcënimin kibernetik të parashikuar në shkronjën "a" të kësaj pike, duke përfshirë edhe vulnerabilitetet e mundshme të sistemeve të subjektit financiar që mund të shfrytëzohen;

ii. aftësitë dhe synimet e aktorëve të kërcënimit në masën e njohur nga subjekti financiar;

iii. vazhdimësinë e kërcënimit dhe çdo njohuri të grumbulluar në lidhje me incidentet që kanë ndikuar te njësia ekonomike ose ofruesi i saj palë e tretë, klientët ose homologët financiarë;

c) kërcënimi kibernetik, nëse materializohet, plotëson një nga elementet e mëposhtme:

i. kriterin në lidhje me kritikalitetin e shërbimeve të prekura të parashikuar në nenin 19, pika 1, shkronja "e", dhe të detajuar në nenin 25 të kësaj rregulloreje;

ii. kufirin e materialitetit të përcaktuar në nenin 28, pika 1, të kësaj rregulloreje;

iii. kufirin e materialitetit të përcaktuar në nenin 28, pika 5, të kësaj rregulloreje.

2. Subjekti financiar, në varësi të llojit të kërcënimit kibernetik dhe informacionit të disponueshëm, nëse arrin në përfundimin se mund të arrihen/plotësohen kufijtë e materialitetit të përcaktuar në nenin 28, pikat 3, 4, 6 dhe 7 të kësaj rregulloreje, mund të konsiderojë, gjithashtu, edhe këta kufij, kur përcakton një kërcënim kibernetik si të rëndësishëm.

NËNKREU III
RAPORTIMI I INCIDENTEVE TË LIDHURA me TIK-un DHE NJOFTIMI VULLNETAR PËR KËRCËNIMET KIBERNETIKE

Neni 30

Raportimi i incidenteve madhore të lidhura me TIK-un dhe njoftimi vullnetar për kërcënimet kibernetike të rëndësishme

1. Subjektet financiare raportojnë në Bankën e Shqipërisë incidentet madhore të lidhura me TIK-un, sipas kërkesave të përcaktuara në pikën 6 të këtij neni. Pa cenuar raportimin në Bankën e Shqipërisë në përputhje me këtë pikë, subjektet financiare paraqesin njoftimin fillestar dhe çdo raport të përmendur në pikën 6 të këtij neni, sipas formularëve të raportimit të parashikuar në nenin 36 të kësaj rregulloreje, edhe tek autoriteti përgjegjës për sigurinë kibernetike dhe/ose tek ekipet e përgjigjes ndaj incidenteve të sigurisë kibernetike (CSIRT), të ngritura në përputhje me ligjin "Për sigurinë kibernetike".

2. Për qëllime të pikës 1 të këtij neni, subjektet financiare, pasi mbledhin dhe analizojnë të gjithë informacionin përkatës, përgatitin njoftimin dhe raportet e parashikuara në pikën 6 të këtij neni, sipas formularëve të raportimit të parashikuar në nenin 36

të kësaj rregulloreje, dhe i paraqesin pranë Bankës së Shqipërisë. Në rastet kur një pamundësi teknike pengon paraqitjen e njoftimit fillestar sipas formularëve të raportimit, subjektet financiare duhet të njoftojnë Bankën e Shqipërisë me mjete alternative.

3. Njoftimi fillestar dhe raportet e parashikuara në pikën 6 të këtij neni, do të përfshijnë të gjithë informacionin e nevojshëm për Bankën e Shqipërisë, për të përcaktuar rëndësinë e incidentit madhor të lidhur me TIK-un, si dhe për të vlerësuar ndikimet e mundshme në shtete të tjera (ndërkufitare).

4. Subjektet financiare njoftojnë vullnetarisht Bankën e Shqipërisë për kërcënime kibernetike, të rëndësishme për sistemin financiar, përdoruesit e shërbimeve ose klientët. Banka e Shqipërisë mund ta përcjellë këtë informacion edhe tek autoritete të tjera përkatëse. Subjektet financiare që njoftojnë Bankën e Shqipërisë sipas kërkesave të kësaj pike, paraqesin këtë njoftim edhe tek ekipet e përgjigjes ndaj incidenteve të sigurisë kibernetike (CSIRT), të ngritura në përputhje me ligjin "Për sigurinë kibernetike".

5. Kur ndodh një incident madhor i lidhur me TIK-un dhe ka ndikim në interesat financiarë të klientëve, subjektet financiare, menjëherë dhe pa vonesa të panevojshme sapo vihen në dijeni të incidentit, informojnë klientët e tyre për incidentin madhor të lidhur me TIK-un, si dhe për të gjitha masat që janë marrë për të zbutur efektet negative të një incidenti të tillë. Në rast të një kërcënimi kibernetik të rëndësishëm, subjektet financiare, aty ku është e zbatueshme, informojnë klientët e tyre që mund të preken, për çdo masë të përshtatshme mbrojtëse që subjektet mund të ndërmarrin.

6. Subjektet financiare i paraqesin Bankës së Shqipërisë, sipas afateve kohore të parashikuara në nenin 35 të kësaj rregulloreje:

a) një njoftim fillestar;

b) një raport të ndërmjetëm, pas njoftimit fillestar të parashikuar në shkronjën "a" të kësaj pike, sapo statusi i incidentit origjinal të ketë ndryshuar ndjeshëm ose trajtimi i incidentit madhor të lidhur me TIK-un ka ndryshuar në bazë të informacionit të ri të disponueshëm, i ndjekur, sipas rastit, nga njoftime të përditësuara sa herë që disponohet një përditësim përkatës i statusit, si dhe sipas kërkesave specifike të Bankës së Shqipërisë;

c) një raport përfundimtar, kur ka përfunduar analiza e shkakut bazë, pavarësisht nëse masat zbutëse janë zbatuar apo jo, dhe kur shifrat reale të ndikimit janë të disponueshme për të zëvendësuar vlerësimet e paraqitura nga subjekti.

7. Subjektet financiare do të përdorin kanale të sigurta komunikimi për të dorëzuar njoftimin fillestar dhe raportet e ndërmjetme dhe përfundimtare. Subjektet financiare që nuk janë në gjendje të përdorin kanalet e sigurta të komunikimit, duhet të informojnë Bankën e Shqipërisë për incidentin madhor të lidhur me TIK-un, nëpërmjet mjeteve të tjera të sigurta të komunikimit, të dakorduara me Bankën e Shqipërisë. Nëse kërkohet nga Banka e Shqipërisë, subjektet financiare duhet të riparaqesin njoftimin fillestar, raportin e ndërmjetëm ose raportin përfundimtar, nëpërmjet kanalit të sigurt të komunikimit, pasi të jenë në gjendje ta bëjnë këtë.

8. Subjektet financiare mund të lidhin marrëveshje me të tretët për transferimin e detyrimeve për raportim sipas kërkesave të këtij neni. Pavarësisht nga transferimi i detyrimeve për raportim, subjekti financiar mbetet plotësisht përgjegjës për përmbushjen e kërkesave për raportimin e incidenteve.

9. Subjektet financiare që kanë lidhur marrëveshje me të tretët për transferimin e detyrimeve për raportim të incidenteve madhore të lidhura me TIK-un, në përputhje me pikën 8 të këtij neni, njoftojnë Bankën e Shqipërisë për atë marrëveshje, sapo të jetë nënshkruar marrëveshja dhe në çdo rast, jo më vonë se para njoftimit ose raportimit të parë.

10. Subjektet financiare i paraqesin Bankës së Shqipërisë emrin, detajet e kontaktit dhe kodin e identifikimit të palës së tretë që do të dorëzojë në emër të tyre njoftimet ose raportet e incidenteve madhore të lidhur me TIK-un.

11. Subjektet financiare informojnë menjëherë Bankën e Shqipërisë nëse nuk vijojnë të transferojnë detyrimin për raportim të incidenteve madhore të lidhura me TIK-un te palë të treta, siç parashikohet në pikën 8 të këtij neni.

12. Pas marrjes së njoftimit fillestar dhe të çdo raporti të përmendur në pikën 6 të këtij neni, Banka e Shqipërisë, brenda një kohe të arsyeshme, vë në dispozicion detaje të incidentit madhor të lidhur me TIK-un, edhe tek autoriteti përgjegjës për sigurinë kibernetike, pikat e vetme të kontaktit ose tek ekipet

e përgjigjes ndaj incidenteve të sigurisë kibernetike (CSIRT), të ngritura në përputhje me ligjin "Për sigurinë kibernetike", si dhe tek autoritete të tjera publike përkatëse.

13. Pas marrjes së njoftimit fillestar dhe të çdo raporti të përmendur në pikën 6 të këtij neni, Banka e Shqipërisë, brenda një kohe të arsyeshme dhe në përputhje me nenin 19(6) të Rregullores (BE) 2022/2554, vë në dispozicion detaje të incidentit madhor të lidhur me TIK-un, edhe tek EBA-ja dhe ECB-ja në rastin e subjekteve financiare të parashikuara në nenin 2, pika 1, shkronjat "a", "b" dhe "d" të kësaj rregulloreje, si dhe te SRB-ja *(Single Resolution Board)* për subjektet e referuara në nenin 7(2) dhe 7(4)(b) e 7(5) të Rregullores (BE) 806/2014, nëse incidentet krijojnë rreziqe për garantimin e funksioneve kritike.

14. Pas marrjes së informacionit në përputhje me nenin 19(6) të Rregullores (BE) 2022/2554, EBA-ja dhe ECB-ja, në konsultim me ENISA-n dhe në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, vlerësojnë nëse incidenti madhor i lidhur me TIK-un është i rëndësishëm për autoritetet përgjegjëse në shtetet e tjera anëtare. Pas këtij vlerësimi, EBA-ja njofton sa më shpejt që të jetë e mundur autoritetet përgjegjëse përkatëse në shtetet e tjera anëtare. ECB-ja njofton anëtarët e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore mbi çështje të rëndësishme për sistemin e pagesave. Bazuar në njoftimin e marrë, autoritetet përgjegjëse të shteteve të tjera anëtare, kur është e përshtatshme, marrin të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur qëndrueshmërinë e menjëhershme të sistemit financiar.

15. Vlerësimi nëse incidenti madhor është i rëndësishëm për autoritetet përgjegjëse në shtetet e tjera anëtare, siç parashikohet në nenin 19(7) të Rregullores (BE) 2022/2554, bazohet në faktin nëse incidenti ka një shkak bazë që buron nga një shtet tjetër anëtar ose nëse incidenti ka ose ka pasur një ndikim të rëndësishëm në një shtet tjetër anëtar, në lidhje me cilindo nga elementet e mëposhtme:

a) klientët ose kundërpartitë financiare;

b) një degë të subjektit financiar ose një subjekt tjetër financiar brenda grupit;

c) një infrastrukturë të tregut financiar ose një ofrues të palës së tretë që mund të ndikojë në subjektet financiare të cilave iu ofron shërbime.

16. Detajet e incidenteve madhore që Banka e Shqipërisë i paraqet autoriteteve të tjera përgjegjëse në përputhje me pikën 12 të këtij neni, përmbajnë të njëjtin nivel informacioni, pa asnjë anonimizim, si njoftimet dhe raportet e incidenteve madhore të marra nga subjektet financiare në përputhje me pikën 6 të këtij neni.

17. Detajet e incidenteve madhore që Banka e Shqipërisë i paraqet autoriteteve të tjera përgjegjëse në përputhje me pikën 13 të këtij neni, si dhe njoftimet që do të bëhen nga EBA-ja dhe BQE tek autoritetet përkatëse përgjegjëse në shtetet e tjera anëtare në përputhje me nenin 19(7) të Rregullores (BE) 2022/2554, duhet të përmbajnë të njëjtin nivel informacioni, pa asnjë anonimizim, si njoftimet dhe raportet e incidenteve madhore të marra nga subjektet financiare në përputhje me nenin 19(4) të Rregullores (BE) 2022/2554.

18. Institucionet e kreditit të klasifikuara si "të rëndësishme" sipas nenit 6(4) të Rregullores (BE) nr. 1024/2013, raportojnë incidentet madhore të lidhur me TIK-un pranë Bankës së Shqipërisë, e cila ia transmeton menjëherë këtë raportim, Bankës Qendrore Evropiane (ECB).

19. Institucionet e kreditit të klasifikuara si "të rëndësishme" sipas nenit 6(4) të Rregullores (BE) nr. 1024/2013, mund të njoftojnë vullnetarisht Bankën e Shqipërisë për kërcënime kibernetike të rëndësishme, e cila ia transmeton menjëherë këtë njoftim Bankës Qendrore Evropiane (ECB).

Neni 31

Informacioni i përgjithshëm që përfshihet në njoftimin fillestar dhe raportet e ndërmjetme dhe përfundimtare mbi incidentet madhore të lidhura me TIK-un

1. Subjektet financiare përfshijnë në njoftimin fillestar, raportin e ndërmjetëm dhe raportin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 30, pika 6, të kësaj rregulloreje, informacionin e përgjithshëm të mëposhtëm:

a) llojin e raportit (njoftim fillestar, raport i ndërmjetëm ose raport përfundimtar);

b) emrin e subjektit financiar, kodin NUIS/LEI të tij dhe llojin e subjektit financiar, siç përcaktohet në nenin 2, pika 1 të kësaj rregulloreje;

c) emrin dhe kodin e identifikimit të subjektit që paraqet njoftimin fillestar, raportin e ndërmjetëm ose përfundimtar, për subjektin financiar;

d) sipas rastit, emrat dhe kodet NUIS/LEI të të gjitha subjekteve financiare të përfshira në njoftimin

fillestar ose raportin e ndërmjetëm ose përfundimtar të agreguar;

e) detajet e kontaktit të personave përgjegjës për komunikimin me Bankën e Shqipërisë për incidentin madhor të lidhur me TIK-un;

f) sipas rastit, identifikimin e shoqërisë mëmë të grupit të cilit i përket subjekti financiar;

g) aty ku ka efekt monetar, paraqitet edhe monedha ku bazohen shumat e raportuara.

Neni 32

Informacioni specifik për t'u përfshirë në njoftimin fillestar

1. Njoftimi fillestar i parashikuar në nenin 30, pika 6, shkronja "a", të kësaj rregulloreje, përmban të paktën të gjithë informacionin specifik të mëposhtëm:

a) kodin e referencës të incidentit, të caktuar nga subjekti financiar;

b) datën e zbulimit, kohën e zbulimit dhe të klasifikimit të incidentit, në përputhje me nenin 27 të kësaj rregulloreje;

c) një përshkrim të incidentit të lidhur me TIK-un;

d) kriteret, të përcaktuara në nenet 20 deri në 27 të kësaj rregulloreje, në bazë të të cilave subjekti financiar e klasifikon incidentin e lidhur me TIK-un, si incident madhor;

e) shtetet e tjera që ndikohen nga incidenti i lidhur me TIK-un;

f) informacion se si u zbulua incidenti i lidhur me TIK-un;

g) kur është e mundur, informacion në lidhje me origjinën e incidentit të lidhur me TIK-un;

h) informacion nëse subjekti financiar ka aktivizuar një plan të vazhdimësisë së biznesit;

i) kur është e aplikueshme, informacion në lidhje me riklasifikimin e incidentit të lidhur me TIK-un nga incident madhor në jomadhor;

j) kur disponohet, çdo informacion tjetër përkatës.

Neni 33

Informacioni specifik për t'u përfshirë në raportet e ndërmjetme

1. Raportet e ndërmjetme siç parashikohen në nenin 30, pika 6, shkronja "b", të kësaj rregulloreje, përmbajnë të paktën të gjithë informacionin specifik të mëposhtëm:

a) aty ku është e aplikueshme, kodin e referencës së incidentit të caktuar nga Banka e Shqipërisë;

b) datën dhe orën e ndodhjes së incidentit të lidhur me TIK-un;

c) sipas rastit, datën dhe orën kur subjekti financiar ka rikuperuar aktivitetet e tij të rregullta;

d) informacion se si janë përmbushur kriteret e përcaktuara në nenet 20 deri në 27 të kësaj rregulloreje, në bazë të të cilave subjekti financiar e ka klasifikuar incidentin e lidhur me TIK-un si incident madhor;

e) llojin e incidentit të lidhur me TIK-un;

f) aty ku është e aplikueshme, kërcënimet dhe teknikat e përdorura nga aktori i kërcënimit;

g) zonat funksionale dhe proceset e biznesit të prekura;

h) komponentët e infrastrukturës së prekur që mbështesin proceset e biznesit;

i) ndikimi në interesat financiarë të klientëve;

j) informacion në lidhje me raportimin për incidentin e lidhur me TIK-un tek autoritete të tjera;

k) veprimet ose masat e përkohshme të ndërmarra ose të planifikuara për t'u ndërmarrë nga subjekti financiar, për t'u rikuperuar nga incidenti i lidhur me TIK-un;

l) aty ku është e aplikueshme, informacion mbi treguesit e kompromentimit.

Neni 34

Informacioni specifik për t'u përfshirë në raportet përfundimtare

1. Raportet përfundimtare siç parashikohen në nenin 30, pika 6, shkronja "c", të kësaj rregulloreje, përmbajnë të paktën të gjithë informacionin specifik të mëposhtëm:

a) informacion rreth shkaqeve bazë të incidentit të lidhur me TIK-un;

b) datën dhe orën kur incidenti i lidhur me TIK-un u zgjidh dhe shkaku/shkaqet bazë u adresuan;

c) informacion mbi zgjidhjen e incidentit të lidhur me TIK-un;

d) aty ku është e aplikueshme, informacione të rëndësishme për autoritetin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme;

e) informacion në lidhje me kostot dhe humbjet direkte dhe indirekte që rrjedhin nga incidenti i lidhur me TIK-un, si dhe informacion për vlerat e rikuperuara;

f) aty ku është e aplikueshme, informacion në lidhje me incidentet e përsëritura të lidhura me TIK-un.

Neni 35

Afatet kohore për njoftimin fillestar dhe paraqitjen e raporteve të ndërmjetme dhe përfundimtare

1. Subjektet financiare paraqesin pranë Bankës së Shqipërisë njoftimin fillestar dhe raportet e ndërmjetme dhe përfundimtare të parashikuara në nenin 30, pika 6, shkronjat "a", "b" dhe "c" të kësaj rregulloreje, brenda afateve kohore të mëposhtme:

a) për raportin fillestar: sa më shpejt që të jetë e mundur, por në çdo rast, brenda 4 orëve nga momenti i klasifikimit të incidentit të lidhur me TIK-un, si incident madhor i lidhur me TIK-un, dhe jo më vonë se 24 orë nga momenti kur subjekti financiar ka marrë dijeni për incidentin e lidhur me TIK-un;

b) për raportin e ndërmjetëm: jo më vonë se brenda 72 orëve nga paraqitja e njoftimit fillestar, edhe nëse statusi ose trajtimi i incidentit nuk ka ndryshuar, siç parashikohet në nenin 30, pika 6, shkronja "b", të kësaj rregulloreje. Subjektet financiare duhet të paraqesin një raport të ndërmjetëm të përditësuar pa vonesa të panevojshme dhe në çdo rast kur veprimtaria e tyre e rregullt (e zakonshme) është rikuperuar;

c) për raportin përfundimtar: jo më vonë se një muaj pas paraqitjes së raportit të ndërmjetëm, ose, sipas rastit, pas paraqitjes së raportit të ndërmjetëm të përditësuar më të fundit.

2. Kur subjekti financiar nuk e ka klasifikuar një incident të lidhur me TIK-un si incident madhor brenda 24 orëve nga momenti kur subjekti financiar ka marrë dijeni për incidentin e lidhur me TIK-un, por e klasifikon atë incident të lidhur me TIK-un si incident madhor në një fazë të mëvonshme, subjekti financiar duhet të paraqesë njoftimin fillestar brenda 4 orëve nga klasifikimi i incidentit të lidhur me TIK-un si incident madhor.

3. Subjektet financiare që nuk janë në gjendje të dorëzojnë njoftimin fillestar, raportin e ndërmjetëm ose raportin përfundimtar brenda afateve kohore të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të njoftojnë Bankën e Shqipërisë pa vonesa të panevojshme, por jo më vonë se afatet kohore përkatëse për paraqitjen e njoftimit ose raportit, si dhe të shpjegojnë arsyet e vonesës.

4. Kur afati kohor për dorëzimin e njoftimit fillestar, raportit të ndërmjetëm ose raportit përfundimtar bie në një ditë fundjave ose një feste zyrtare, subjekti financiar mund të paraqesë njoftimin fillestar, raportet e ndërmjetme ose përfundimtare deri në mesditën e ditës pasuese të punës.

5. Pika 4 e këtij neni nuk zbatohet për paraqitjen e një njoftimi fillestar ose një raporti të ndërmjetëm nga institucionet e kreditit dhe subjektet e tjera financiare të identifikuara si infrastruktura kritike dhe të rëndësishme, në përputhje me ligjin "Për sigurinë kibernetike".

6. Banka e Shqipërisë mund të vendosë që pika 4 e këtij neni të mos zbatohet për paraqitjen e njoftimit fillestar ose të raportit të ndërmjetëm, edhe nga subjekte financiare të ndryshme nga ato të parashikuara në pikën 5 të këtij neni, të cilat janë të rëndësishme ose kanë karakter sistemik për sektorin financiar. Banka e Shqipërisë njofton vendimin e saj te subjektet financiare të identifikuara. Vendimi i Bankës së Shqipërisë do të zbatohet vetëm për incidentet e raportuara pas datës së njoftimit të vendimit të Bankës së Shqipërisë.

7. Subjektet financiare mund të kombinojnë paraqitjen e njoftimit fillestar, raportit të ndërmjetëm dhe raportit përfundimtar, duke i paraqitur pranë Bankës së Shqipërisë të dy ose të gjitha raportet në të njëjtën kohë, nëse aktivitetet e rregullta të subjektit janë rikuperuar ose analiza e shkakut bazë të incidentit është përfunduar dhe me kusht që të respektohen afatet kohore të përcaktuara në këtë nen.

Neni 36

Formularët e raportimit të incidenteve madhore të lidhura me TIK-un

1. Subjektet financiare do të përdorin formularët e raportimit të parashikuar në Aneksin 1 të kësaj rregulloreje, për të paraqitur pranë Bankës së Shqipërisë njoftimin fillestar, raportin e ndërmjetëm dhe raportin përfundimtar, siç përcaktohet në nenin 30, pika 6, të kësaj rregulloreje, si vijon:

a) subjektet financiare që paraqesin njoftimin fillestar duhet të plotësojnë fushat e formularit që i korrespondojnë informacionit që duhet të paraqitet në përputhje me nenin 32 të kësaj rregulloreje dhe, në rastet kur e disponojnë tashmë informacionin përkatës, mund të plotësojnë edhe ato fusha,

plotësimi i të cilave nuk kërkohet për njoftimin fillestar, por kërkohet për një raport të ndërmjetëm ose përfundimtar;

b) subjektet financiare që paraqesin raportin e ndërmjetëm duhet të plotësojnë fushat e formularit që i korrespondojnë informacionit që duhet të paraqitet në përputhje me nenin 33 të kësaj rregulloreje dhe, në rastet kur e disponojnë tashmë informacionin përkatës, mund të plotësojnë edhe ato fusha, plotësimi i të cilave nuk kërkohet për raportin e ndërmjetëm, por kërkohet për raportin përfundimtar;

c) subjektet financiare që paraqesin raportin përfundimtar duhet të plotësojnë fushat e formularit që i korrespondojnë informacionit që duhet të paraqitet në përputhje me nenin 34 të kësaj rregulloreje.

2. Subjektet financiare sigurojnë që informacioni që përmban njoftimi fillestar, raporti i ndërmjetëm dhe përfundimtar, të jetë i plotë dhe i saktë.

3. Subjektet financiare paraqesin vlera/shuma të vlerësuara, bazuar në të dhëna dhe informacione të tjera të disponueshme, për aq sa është e mundur, nëse nuk disponohen të dhëna të sakta në momentin e raportimit për njoftimin fillestar ose raportin e ndërmjetëm.

4. Subjektet financiare, kur paraqesin një raport të ndërmjetëm ose përfundimtar, përdorin formularët e parashikuar në Aneksin 1 të kësaj rregulloreje, paraqesin të gjithë informacionin e kërkuar dhe përditësojnë, sipas rastit, informacionin që kanë paraqitur më parë në njoftimin fillestar ose në raportin e ndërmjetëm.

5. Subjektet financiare plotësojnë formularët e parashikuar në Aneksin 1, sipas udhëzimeve të përcaktuara në Aneksin 2 të kësaj rregulloreje.

Neni 37

Përmbajtja e njoftimit për kërcënimet kibernetike të rëndësishme

1. Përmbajtja e njoftimit për kërcënimet kibernetike të rëndësishme, të parashikuar në nenin 30, pika 4, të kësaj rregulloreje, përfshin:

a) informacione të përgjithshme për subjektin financiar që po njofton, siç përcaktohet në nenin 31 të kësaj rregulloreje;

b) datën dhe orën e zbulimit të kërcënimit kibernetik të rëndësishëm dhe çdo vulë tjetër kohore përkatëse në lidhje me kërcënimin kibernetik të rëndësishëm;

c) një përshkrim të kërcënimit kibernetik të rëndësishëm;

d) informacion në lidhje me ndikimin e mundshëm të kërcënimit kibernetik të rëndësishëm mbi subjektin financiar, klientët e tij ose kundërpartitë financiare;

e) kriteret e klasifikimit që do të kishin shkaktuar një raport incidenti madhor të përcaktuar në nenet 20 deri në 27 të kësaj rregulloreje, nëse kërcënimi kibernetik do të ishte materializuar;

f) informacion në lidhje me statusin e kërcënimit kibernetik të rëndësishëm dhe çdo ndryshim në aktivitetin e kërcënimit;

g) sipas rastit, një përshkrim të veprimeve të ndërmarra nga subjekti financiar për të parandaluar materializimin e kërcënimeve kibernetike të rëndësishme;

h) informacion në lidhje me çdo njoftim të kërcënimit kibernetik të rëndësishëm ndaj subjekteve financiare ose autoriteteve të tjera;

i) aty ku është e aplikueshme, informacion mbi treguesit e kompromentimit;

j) kur disponohet, çdo informacion tjetër përkatës.

2. Subjektet financiare që njoftojnë Bankën e Shqipërisë për kërcënimet kibernetike të rëndësishme sipas kërkesave të nenit 30, pika 4, të kësaj rregulloreje, plotësojnë formularët e parashikuar në Aneksin 3, sipas udhëzimeve të përcaktuara në Aneksin 4 të kësaj rregulloreje.

3. Subjektet financiare sigurojnë që informacioni që përmban njoftimi për kërcënimet kibernetike të rëndësishme të jetë i plotë dhe i saktë.

Neni 38

Raportimi i agreguar

1. Një ofrues shërbimi i palëve të treta, të cilit i janë transferuar detyrimet e raportimit, siç parashikohet në nenin 30, pika 8, të kësaj rregulloreje, mund të përdorë formularët e parashikuar në Aneksin 1 të kësaj rregulloreje për të raportuar informacion të agreguar në lidhje me një incident madhor të lidhur me TIK-un, që prek disa subjekte financiare, në një njoftim ose raport të vetëm, dhe ta paraqesë atë njoftim ose raport te Banka e Shqipërisë në emër të të gjitha subjekteve

financiare të prekura, me kusht që të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) incidenti madhor i lidhur me TIK-un që duhet raportuar buron nga ose shkaktohet nga një ofrues shërbimi i palëve të treta të TIK-ut;

b) ai ofrues shërbimi i palëve të treta të TIK-ut ofron shërbimin përkatës TIK për më shumë se një subjekt financiar, ose për një grup;

c) incidenti i lidhur me TIK-un klasifikohet si madhor nga secili subjekt financiar i përfshirë në njoftimin ose raportin e agreguar;

d) incidenti madhor i lidhur me TIK-un prek subjektet financiare brenda Shqipërisë dhe raporti i agreguar lidhet me subjektet financiare që mbikëqyren nga Banka e Shqipërisë;

e) Banka e Shqipërisë i ka lejuar në mënyrë të qartë këto lloj subjektesh financiare të agregojnë raportimet e tyre.

2. Pika 1 e këtij neni nuk zbatohet për institucionet e kreditit të klasifikuara si "të rëndësishme", sipas nenit 2, pika (16) e Rregullores (BE) nr. 468/2014 të Bankës Qendrore Evropiane (BQE), ku këto institucione do të përdorin formularët e parashikuar në Aneksin 1 të kësaj rregulloreje për të raportuar vetëm mbi baza individuale, informacionin në lidhje me një incident madhor të lidhur me TIK-un pranë Bankës së Shqipërisë.

3. Kur Banka e Shqipërisë kërkon informacion mbi ndikimin individual të incidentit madhor të lidhur me TIK-un mbi një subjekt të vetëm financiar, me kërkesë të saj, subjekti financiar duhet të paraqesë një njoftim ose një raport individual mbi incidentin madhor të lidhur me TIK-un.

Neni 39

Roli mbikëqyrës

1. Pa cenuar kontributin teknik, këshillat ose mjetet për korrigjimin dhe ndjekjen e mëtejshme që mund të sigurohen nga CSIRT-të, në përputhje me ligjin "Për sigurinë kibernetike", Banka e Shqipërisë, me marrjen e njoftimit fillestar dhe të çdo raporti të parashikuar në nenin 30, pika 6, të kësaj rregulloreje, pranon marrjen e njoftimit apo të raportit dhe, ku është e mundur, i jep subjektit financiar komentet ose udhëzimet e nevojshme dhe proporcionale, në veçanti duke i vënë në dispozicion çdo informacion dhe inteligjencë anonime përkatëse për kërcënime të ngjashme, dhe mund të diskutojë zgjidhjet e aplikuara në nivel të subjektit financiar dhe mënyrat për të minimizuar dhe zbutur ndikimin negativ në të gjithë sektorin financiar. Në çdo rast, pavarësisht komenteve mbikëqyrëse të marra, subjektet financiare do të mbeten plotësisht përgjegjëse për trajtimin dhe për pasojat e incidenteve të lidhura me TIK-un, të raportuara në përputhje me nenin 30, pika 1, të kësaj rregulloreje.

Neni 40

Incidentet operacionale ose të sigurisë të lidhura me pagesat për bankat, institucionet e pagesave, ofruesit e shërbimit të informimit të llogarisë dhe institucionet e parasë elektronike

1. Kërkesat e përcaktuara në këtë kre do të zbatohen në të njëjtën mënyrë edhe për incidentet operacionale ose të sigurisë të lidhura me pagesat të parashikuara në nenin 89 të ligjit "Për shërbimet e pagesave", përfshirë edhe incidentet madhore operacionale ose të sigurisë të lidhura me pagesat, për bankat, institucionet e pagesave, ofruesit e shërbimit të informimit të llogarisë dhe institucionet e parasë elektronike.

KREU IV

TESTIMI I QËNDRUESHMËRISË OPERACIONALE DIGJITALE

Neni 41

Kërkesa të përgjithshme për kryerjen e testimit të qëndrueshmërisë operacionale digjitale

1. Për qëllime të vlerësimit të shkallës së përgatitjes për trajtimin e incidenteve të lidhura me TIK-un, të identifikimit të dobësive, mangësive ose boshllëqeve në qëndrueshmërinë operacionale digjitale, si dhe të zbatimit të menjëhershëm të masave korrigjuese, subjektet financiare, me përjashtim të mikrondërmarrjeve, duke marrë parasysh kriteret e parashikuara në nenin 5, pika 2, të kësaj rregulloreje, krijojnë, mirëmbajnë dhe rishikojnë, një program të shëndoshë dhe gjithëpërfshirës të testimit të qëndrueshmërisë operacionale digjitale, si pjesë integrale të sistemit të administrimit të rrezikut të TIK-ut të parashikuar në nenin 7 të kësaj rregulloreje.

2. Programi i testimit të qëndrueshmërisë operacionale digjitale përfshin një sërë vlerësimesh,

testesh, metodologjish, praktikash dhe mekanizmash që do të zbatohen në përputhje me kërkesat e neneve 42 dhe 43 të kësaj rregulloreje.

3. Subjektet financiare, me përjashtim të mikrondërmarrjeve, gjatë hartimit të programit të testimit të qëndrueshmërisë operacionale digjitale të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, ndjekin një qasje të bazuar në rrezik, marrin parasysh kriteret e parashikuara në nenin 5, pika 2, të kësaj rregulloreje, si dhe duke konsideruar ambientin në zhvillim të rreziqeve të TIK-ut, çdo rrezik specifik ndaj të cilit është i ekspozuar ose mund të ekspozohet subjekti financiar, kritikalitetin e aseteve të informacionit dhe shërbimeve të ofruara, si dhe çdo faktor tjetër që subjekti financiar e gjykon të përshtatshëm.

4. Subjektet financiare, me përjashtim të mikrondërmarrjeve, sigurojnë që testimet të kryhen nga palë të pavarura, qofshin ato të brendshme apo të jashtme. Kur testimet kryhen nga një testues i brendshëm, subjektet financiare i përkushtojnë burime të mjaftueshme dhe sigurojnë që konfliktet e interesit të shmangen gjatë fazave të projektimit dhe kryerjes së testimit.

5. Subjektet financiare, me përjashtim të mikrondërmarrjeve, hartojnë politika dhe procedura për të përcaktuar prioritetet, për të klasifikuar dhe korrigjuar të gjitha çështjet e identifikuara gjatë kryerjes së testimeve, si dhe hartojnë metodologji të brendshme të vlerësimit, për të siguruar që të gjitha dobësitë, mangësitë ose boshllëqet e identifikuara janë adresuar plotësisht.

6. Subjektet financiare me përjashtim të mikrondërmarrjeve, të paktën çdo vit, kryejnë testimet përkatëse për të gjitha sistemet e TIK-ut dhe aplikacionet që mbështetin funksionet kritike ose të rëndësishme.

Neni 42

Testimi i mekanizmave dhe sistemeve të TIK-ut

1. Programi i testimit të qëndrueshmërisë operacionale digjitale i parashikuar në nenin 41 të kësaj rregulloreje, në përputhje me kriteret e parashikuara në nenin 5, pika 2, duhet të parashikojë kryerjen e testeve të përshtatshme, që përfshijnë vlerësimet dhe skanimet e cenueshmërisë, analizat e bazuara në burime të hapura *(open source analyses),* vlerësimet e sigurisë së rrjetit, analizat e mangësive *(gap analyses),* rishikimet e sigurisë fizike, pyetësorët dhe zgjidhjet e *software* të skanimit, rishikimet e kodit burimor *(source code)* aty ku është e mundur, testet e bazuara në skenarë, testimin e përputhshmërisë, testimin e performancës, testimin nga fundi në fund *(end-to-end testing)* ose testimin e depërtueshmërisë *(penetration testing).*

2. Mikrondërmarrjet kryejnë testet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duke kombinuar një qasje të bazuar në rrezik me një planifikim strategjik të testimit të TIK-ut, duke marrë në konsideratë nevojën për të mbajtur një qasje të balancuar ndërmjet shkallës së burimeve dhe kohës që nevojitet për testimin e TIK-ut të parashikuar në këtë nen, nga njëra anë, dhe urgjencës, llojit të rrezikut, kritikalitetit të aseteve të informacionit dhe shërbimeve të ofruara, si dhe faktorëve të tjerë të rrezikut, përfshirë edhe aftësinë e subjektit financiar për të ndërmarrë rreziqe të llogaritura, nga ana tjetër.

Neni 43

Testimi i avancuar i mekanizmave, sistemeve dhe proceseve të TIK-ut, bazuar në testimin e depërtueshmërisë të udhëhequr nga kërcënimi

1. Subjektet financiare, me përjashtim të mikrondërmarrjeve, dhe subjektet e parashikuara në pikën 1 të nenit 17 të kësaj rregulloreje, të identifikuara në përputhje me pikën 11 të këtij neni, duhet të kryejnë të paktën çdo 3 vjet testim të avancuar, nëpërmjet testimit të depërtueshmërisë të udhëhequr nga kërcënimi. Banka e Shqipërisë, bazuar në profilin e rrezikut të subjektit financiar dhe duke marrë në konsideratë rrethanat operacionale, kur e gjykon të nevojshme, mund t'i kërkojë subjektit financiar të reduktojë ose të rritë shpeshtësinë e kryerjes së këtij testimi.

2. Testimi i depërtueshmërisë i udhëhequr nga kërcënimi duhet të mbulojë disa funksione ose të gjitha funksionet kritike ose të rëndësishme të subjektit financiar dhe duhet të kryhet në sistemet *live* të prodhimit që mbështesin funksione të tilla.

3. Subjektet financiare duhet të identifikojnë të gjitha sistemet, proceset dhe teknologjitë përkatëse bazë të TIK-ut që mbështesin funksionet kritike ose të rëndësishme dhe shërbimet e TIK-ut, duke përfshirë edhe ata që mbështesin funksionet kritike ose të rëndësishme, të cilat i janë transferuar ose kontraktuar ofruesve të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut.

4. Subjektet financiare vlerësojnë se cilat funksione kritike ose të rëndësishme duhet të mbulohen nga testimi i depërtueshmërisë i udhëhequr nga kërcënimi. Rezultati i këtij vlerësimi do të përcaktojë objektin/fushën e saktë të testimit të depërtueshmërisë të udhëhequr nga kërcënimi dhe duhet të miratohet nga Banka e Shqipërisë.

5. Në rastet kur ofruesit e shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut përfshihen në fushën e testimit të depërtueshmërisë të udhëhequr nga kërcënimi, subjekti financiar duhet të marrë masat dhe garancitë e të nevojshme për të siguruar pjesëmarrjen e këtyre ofruesve të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut në testimin e depërtueshmërisë të udhëhequr nga kërcënimi dhe do të mbajë në çdo kohë përgjegjësinë e plotë për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat e kësaj rregulloreje.

6. Pa rënë ndesh me parashikimet e pikës 2 dhe 3 të këtij neni, kur pjesëmarrja e një ofruesi të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut në testimin e depërtueshmërisë të udhëhequr nga kërcënimi, të parashikuar në pikën 5 të këtij neni, pritet në mënyrë të arsyeshme të ketë një ndikim negativ në cilësinë ose sigurinë e shërbimeve të ofruara nga ofruesi i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut për klientët që janë subjekte jashtë objektit të kësaj rregulloreje, ose në konfidencialitetin e të dhënave që lidhen me shërbime të tilla, subjekti financiar dhe ofruesi i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut mund të bien dakord me shkrim që ofruesi i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut të hyjë drejtpërdrejt në marrëdhënie kontraktuale me një testues të jashtëm, me qëllim kryerjen, nën drejtimin e një subjekti financiar të caktuar, të një testimi të përbashkët të depërtueshmërisë të udhëhequr nga kërcënimi, që përfshin disa subjekte financiare *(pooled testing),* të cilave ofruesi i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut iu ofron shërbime të TIK-ut.

7. Testimi i përbashkët i parashikuar në pikën 6 të këtij neni duhet të mbulojë gamën përkatëse të shërbimeve të TIK-ut që mbështesin funksione kritike ose të rëndësishme të kontraktuara nga subjektet financiare, me ofruesit përkatës të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut. Testimi i përbashkët duhet të konsiderohet si testim i depërtueshmërisë i udhëhequr nga kërcënimi, i kryer nga subjektet financiare që marrin pjesë në testimin e përbashkët. Numri i subjekteve financiare që marrin pjesë në testimin e përbashkët duhet të kalibrohet në mënyrën e duhur, duke marrë parasysh kompleksitetin dhe llojet e shërbimeve të përfshira.

8. Subjektet financiare, në bashkëpunim me ofruesit e shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut dhe palët e tjera të përfshira, duke përfshirë edhe testuesit, por duke përjashtuar Bankën e Shqipërisë, duhet të zbatojnë kontrolle efektive të administrimit të rrezikut, për të zbutur rreziqet e çdo ndikimi të mundshëm në të dhënat, dëmtimin e aseteve dhe ndërprerjen e funksioneve, shërbimeve ose operacioneve kritike ose të rëndësishme, në vetë subjektin financiar, kundërpartitë e tjera të tij ose në sektorin financiar në tërësi.

9. Në përfundim të testimit, pasi të jetë rënë dakord për raportet dhe planet e korrigjimit *(remediation plan),* subjekti financiar dhe, kur është e aplikueshme, testuesit e jashtëm i vënë në dispozicion Bankës së Shqipërisë një përmbledhje të gjetjeve përkatëse, planet e korrigjimit dhe dokumentacionin që konfirmon se testimi i depërtueshmërisë i udhëhequr nga kërcënimi është kryer në përputhje me kërkesat rregullative. Banka e Shqipërisë i jep subjekteve financiare një konfirmim që testi është kryer në përputhje me kërkesat e paraqitura në dokumentacion, me qëllim që të lejohet njohja reciproke e testeve të depërtueshmërisë të udhëhequra nga kërcënimet midis autoriteteve të ndryshme përgjegjëse.

Pa cenuar një konfirmim të tillë, subjektet financiare mbeten në çdo kohë plotësisht përgjegjëse për ndikimin e testeve të përmendura në pikën 6 dhe 7 të këtij neni.

10. Subjektet financiare kontraktojnë testuesit në përputhje me nenin 44 të kësaj rregulloreje, për qëllime të kryerjes së testimit të depërtueshmërisë të udhëhequr nga kërcënimi. Nëse subjektet financiare përdorin testues të brendshëm për kryerjen e testimit të depërtueshmërisë të udhëhequr nga kërcënimi, ata duhet të kontraktojnë testues të jashtëm për çdo tri teste të kryera.

11. Bankat me rëndësi sistemike, sipas përcaktimeve të Bankës së Shqipërisë, përdorin vetëm testues të jashtëm, në përputhje me nenin 44, pika 1, shkronjat "a" deri në "e" të kësaj rregulloreje.

12. Banka e Shqipërisë identifikon subjektet financiare që duhet të kryejnë testimin e depërtueshmërisë të udhëhequr nga kërcënimi, duke marrë parasysh kriteret e parashikuara në nenin 5, pika 2, të kësaj rregulloreje, bazuar në vlerësimin e elementeve të mëposhtme:

a) faktorët e lidhur me ndikimin, veçanërisht masën në të cilën shërbimet e ofruara dhe aktivitetet e ndërmarra nga subjekti financiar ndikojnë në sektorin financiar;

b) çështjet e mundshme të lidhura me stabilitetin financiar, duke përfshirë karakterin sistemik të subjektit financiar;

c) profilin specifik të rrezikut të TIK-ut, nivelin e pjekurisë së TIK-ut të subjektit financiar ose veçoritë teknologjike të tij.

Neni 44

Kërkesat për testuesit për kryerjen e testimit të depërtueshmërisë të udhëhequr nga kërcënimi

1. Subjektet financiare, për kryerjen e testimit të depërtueshmërisë të udhëhequr nga kërcënimi, do të përdorin vetëm testues që:

a) kanë përshtatshmëri dhe reputacion të lartë;

b) zotërojnë aftësi teknike dhe organizative dhe demonstrojnë ekspertizë specifike në inteligjencën e kërcënimit, testimin e depërtueshmërisë dhe testimin e ekipit të kuq *(red team testing);*

c) janë të certifikuar nga një organ akreditimi në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian ose që respektojnë kodet formale të sjelljes ose etike;

d) ofrojnë një siguri të pavarur ose një raport auditimi, në lidhje me administrimin e shëndoshë të rreziqeve që lidhen me kryerjen e testimit të depërtueshmërisë të udhëhequr nga kërcënimi, duke përfshirë mbrojtjen e duhur të informacionit konfidencial të subjektit financiar dhe korrigjimin për rreziqet e veprimtarisë të subjektit financiar;

e) mbulohen në mënyrën e duhur dhe plotësisht nga sigurimet përkatëse të dëmshpërblimit profesional, duke përfshirë rreziqet e sjelljes së keqe dhe neglizhencës.

2. Në rastet kur subjektet financiare përdorin testues të brendshëm, ata duhet të sigurohen që, përveç plotësimit të kërkesave në pikën 1 të këtij neni, plotësohen edhe kushtet e mëposhtme:

a) përdorimi i këtyre testuesve është miratuar nga Banka e Shqipërisë;

b) Banka e Shqipërisë ka verifikuar që subjekti financiar ka burime të mjaftueshme të dedikuara dhe ka siguruar që konfliktet e interesit janë shmangur gjatë gjithë fazave të projektimit dhe ekzekutimit të testit; dhe

c) ofruesi i kërcënimeve të inteligjencës është i jashtëm për subjektin financiar.

3. Subjektet financiare duhet të sigurojnë që marrëveshjet e lidhura me testues të jashtëm të kërkojnë një administrim të shëndoshë të rezultateve të testimit të depërtueshmërisë të udhëhequr nga kërcënimi dhe që çdo përpunim i të dhënave prej tyre, duke përfshirë çdo gjenerim, ruajtje, agregim, hartim, raportim, komunikim ose shkatërrim, të mos krijojë rreziqe për subjektet financiare.

KREU V

ADMINISTRIMI I RREZIKUT TË TIK-ut NGA PALËT E TRETA

NËNKREU I

PARIMET KRYESORE PËR NJË ADMINISTRIM TË SHËNDETSHËM TË RREZIKUT TË TIK-ut NGA PALËT E TRETA

Neni 45

Parimet e përgjithshme

1. Subjektet financiare administrojnë rrezikun e TIK-ut nga palët e treta, si një komponent integral të rrezikut të TIK-ut brenda sistemit të tyre të administrimit të rrezikut të TIK-ut, siç përcaktohet në nenin 7, pika 1, të kësaj rregulloreje dhe në përputhje me parimet e mëposhtme:

a) subjektet financiare që kanë marrëveshje kontraktuale për përdorimin e shërbimeve të TIK-ut, për të kryer operacionet e tyre të biznesit do të mbeten në çdo kohë plotësisht përgjegjës për respektimin dhe përmbushjen e të gjitha detyrimeve sipas legjislacionit në fuqi dhe kësaj rregulloreje;

b) administrimi i rrezikut të TIK-ut nga palët e treta nga ana e subjekteve financiare do të bazohet në parimin e proporcionalitetit, duke marrë parasysh:

i. natyrën, shkallën, kompleksitetin dhe rëndësinë e varësisë të lidhur me TIK-un,

ii. rreziqet që lindin nga marrëveshjet kontraktuale për përdorimin e shërbimeve të TIK-ut të lidhura me ofruesit e shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, duke marrë parasysh kritikalitetin ose rëndësinë e shërbimit, procesit ose funksionit përkatës dhe ndikimin e mundshëm në vazhdimësinë dhe disponueshmërinë e shërbimeve

dhe veprimtarive financiare, në nivel individual dhe në nivel grupi.

2. Si pjesë të sistemit të tyre të administrimit të rrezikut të TIK-ut, subjektet financiare me përjashtim të mikrondërmarrjeve, si dhe subjektet e parashikuara në pikën 1 të nenit 17 të kësaj rregulloreje, miratojnë dhe rishikojnë rregullisht një strategji për rrezikun e TIK-ut nga palët e treta, duke marrë parasysh strategjinë me shumë shitës *(multivendor strategy),* të parashikuar në pikën 10 të nenit 7 të kësaj rregulloreje. Kjo strategji do të përfshijë një politikë për përdorimin e shërbimeve të TIK-ut që mbështesin funksionet kritike ose të rëndësishme, të ofruara nga ofruesit e shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut dhe do të zbatohet individualisht dhe, sipas rastit, në baza të nënkonsoliduara dhe të konsoliduara. Organi drejtues i subjektit shqyrton rregullisht rreziqet e identifikuara në lidhje me marrëveshjet kontraktuale për përdorimin e shërbimeve të TIK-ut që mbështesin funksionet kritike ose të rëndësishme, bazuar në shkallën dhe kompleksitetin e shërbimeve të subjektit.

3. Si pjesë të sistemit të tyre të administrimit të rrezikut të TIK-ut, subjektet financiare mbajnë dhe përditësojnë rregullisht, në nivel subjekti dhe në nivele të nënkonsoliduara dhe të konsoliduara, një regjistër që përmban informacion në lidhje me të gjitha marrëveshjet kontraktuale për përdorimin e shërbimeve të TIK-ut, të ofruara nga ofruesit e shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut.

4. Marrëveshjet kontraktuale të përmendura në pikën 3 të këtij neni duhet të dokumentohen në mënyrën e duhur, duke bërë dallimin midis marrëveshjeve që mbulojnë shërbimet e TIK-ut që mbështesin funksionet kritike ose të rëndësishme dhe atyre që nuk mbulojnë këto shërbime.

5. Subjektet financiare raportojnë të paktën çdo vit në Bankën e Shqipërisë, informacion mbi numrin e marrëveshjeve të reja për përdorimin e shërbimeve të TIK-ut, kategoritë e ofruesve të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, llojet e marrëveshjeve kontraktuale, si dhe shërbimet dhe funksionet e TIK-ut që ofrohen.

6. Subjektet financiare vënë në dispozicion të Bankës së Shqipërisë, sipas kërkesës së saj, regjistrin e plotë të informacionit ose sipas kërkesës, seksione të specifikuara të tij, së bashku me çdo informacion që konsiderohet i nevojshëm për të mundësuar mbikëqyrjen efektive të subjektit financiar.

7. Subjektet financiare informojnë Bankën e Shqipërisë në kohën e duhur për çdo marrëveshje kontraktuale të planifikuar për përdorimin e shërbimeve të TIK-ut që mbështesin funksionet kritike ose të rëndësishme, si dhe në rastet kur një funksion është bërë kritik ose i rëndësishëm.

8. Para se të lidhin një marrëveshje kontraktuale për përdorimin e shërbimeve të TIK-ut, subjektet financiare duhet të:

a) vlerësojnë nëse marrëveshja kontraktuale mbulon përdorimin e shërbimeve të TIK-ut që mbështesin funksionet kritike ose të rëndësishme;

b) vlerësojnë nëse janë përmbushur kërkesat mbikëqyrëse për kontraktimin;

c) identifikojnë dhe vlerësojnë të gjitha rreziqet përkatëse në lidhje me marrëveshjen kontraktuale, duke përfshirë edhe mundësinë që marrëveshje të tilla kontraktuale mund të kontribuojnë në përforcimin e rrezikut të përqendrimit të TIK-ut, siç parashikohet në nenin 46 të kësaj rregulloreje;

d) kryejnë verifikimin e kujdesshëm *(due diligence)* për ofruesit e mundshëm të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut dhe të sigurojnë përgjatë procesit të përzgjedhjes dhe vlerësimit që ofruesi i shërbimit të palës së tretë të TIK-ut është i përshtatshëm;

e) identifikojnë dhe vlerësojnë konfliktet e interesit që mund të shkaktojë marrëveshja kontraktuale.

9. Subjektet financiare mund të hyjnë në marrëveshje kontraktuale vetëm me ofrues të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut që janë në përputhje me standardet e duhura të sigurisë së informacionit. Kur këto marrëveshje kontraktuale janë të lidhura me funksione kritike ose të rëndësishme, subjektet financiare, përpara se të lidhin marrëveshjet, duhet të marrin në konsideratë përdorimin nga ofruesit e shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, të standardeve më të përditësuara dhe me cilësinë më të lartë të sigurisë së informacionit.

10. Në ushtrimin e të drejtave të aksesit, inspektimit dhe auditimit mbi ofruesin e shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, subjektet financiare, duke ndjekur një qasje të bazuar në rrezik, përcaktojnë frekuencën e auditimeve dhe inspektimeve dhe fushat që do të auditohen nëpërmjet respektimit të standardeve të auditimit përgjithësisht të pranuara, në përputhje edhe me çdo udhëzim mbikëqyrës për përdorimin dhe përfshirjen e këtyre standardeve të auditimit.

11. Në rastet kur marrëveshjet kontraktuale për përdorimin e shërbimeve të TIK-ut sjellin një nivel të lartë kompleksiteti teknologjik, subjekti financiar duhet të verifikojë që auditorët e brendshëm apo të jashtëm, ose një grup auditorësh, zotërojnë aftësitë dhe njohuritë e duhura për të kryer në mënyrë efektive auditimet dhe vlerësimet përkatëse.

12. Subjektet financiare duhet të sigurojnë që marrëveshjet kontraktuale për përdorimin e shërbimeve të TIK-ut të ndërpriten, nëse vërehen/ndodhin situatat e mëposhtme:

a) shkelje të rënda nga ofruesi i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, të ligjeve, rregulloreve ose kushteve kontraktuale;

b) situatat e identifikuara gjatë monitorimit të rrezikut të TIK-ut nga palët e treta, që konsiderohen të afta të ndryshojnë performancën e funksioneve të ofruara nëpërmjet marrëveshjes kontraktuale, duke përfshirë ndryshimet materiale që ndikojnë në marrëveshjen ose situatën e ofruesit të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut;

c) dobësi të evidentuara të ofruesit të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut që lidhen me administrimin e tij të përgjithshëm të rrezikut të TIK-ut dhe veçanërisht me mënyrën se si ai siguron disponueshmërinë, autenticitetin, integritetin dhe konfidencialitetin e të dhënave, qofshin këto të dhëna personale ose të dhëna të tjera të ndjeshme ose të dhëna jopersonale;

d) situata kur Banka e Shqipërisë nuk mund të mbikëqyrë më efektivisht subjektin financiar si rezultat i marrëveshjes kontraktuale përkatëse.

13. Subjektet financiare duhet të hartojnë strategji daljeje *(exit strategies)* për shërbimet e TIK-ut që mbështesin funksionet kritike ose të rëndësishme. Këto strategji duhet të marrin parasysh rreziqet që mund të shfaqen në nivel të ofruesit të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, veçanërisht një dështim i mundshëm i këtij të fundit, një përkeqësim i cilësisë së shërbimeve të TIK-ut të ofruara, çdo ndërprerje e veprimtarisë për shkak të ofrimit të papërshtatshëm ose të dështuar të shërbimeve të TIK-ut, ose çdo rrezik material që lind në lidhje me vendosjen e duhur dhe të vazhdueshme të shërbimit përkatës të TIK-ut, ose ndërprerjen e marrëveshjeve kontraktuale me ofruesit e shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut në ndonjë nga situatat e parashikuara në pikën 12 të këtij neni.

14. Subjektet financiare duhet të sigurojnë që janë në gjendje të ndërpresin marrëveshjet kontraktuale pa:

a) ndërprerje të veprimtarisë së tyre;

b) kufizuar/ndikuar përputhshmërinë me kërkesat rregullative;

c) dëmtuar vazhdimësinë dhe cilësinë e ofrimit të shërbimeve për klientët.

15. Planet e daljes *(exit plans)* duhet të jenë gjithëpërfshirëse, të dokumentuara dhe, në përputhje me kriteret e parashikuara në nenin 5, pika 2, të kësaj rregulloreje, duhet të testohen mjaftueshëm dhe të rishikohen në mënyrë periodike.

16. Subjektet financiare duhet të identifikojnë zgjidhje alternative dhe të zhvillojnë plane tranzicioni që u mundësojnë atyre zhvendosjen e funksioneve të kontraktuara dhe të dhënave përkatëse nga ofruesi i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut dhe transferimin e tyre në mënyrë të sigurt dhe integrale tek ofruesit alternativë ose riinkorporimin e tyre brenda vetë subjektit.

17. Subjektet financiare marrin masat e duhura të emergjencës për të ruajtur vazhdimësinë e biznesit në të gjitha situatat e parashikuara në pikën 13 të këtij neni.

Neni 46

Vlerësimi paraprak i rrezikut të përqendrimit të TIK-ut në nivel subjekti

1. Subjektet financiare, kur kryejnë identifikimin dhe vlerësimin e rrezikut të përqendrimit të TIK-ut të përmendur në shkronjën "c" të pikës 8 të nenit 45 të kësaj rregulloreje, duhet të marrin parasysh edhe nëse lidhja e një marrëveshjeje kontraktuale për shërbimet e TIK-ut që mbështesin funksionet kritike ose të rëndësishme, do të çonte në ndonjë nga situatat e mëposhtme:

a) kontraktimin me një ofrues shërbimi të palëve të treta të TIK-ut, i cili nuk është lehtësisht i zëvendësueshëm; ose

b) krijimin e marrëveshjeve të shumta kontraktuale për ofrimin e shërbimeve të TIK-ut që mbështesin funksionet kritike ose të rëndësishme, me të njëjtin ofrues shërbimi të palëve të treta të TIK-ut ose me ofrues të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin.

2. Subjektet financiare vlerësojnë përfitimet dhe kostot e zgjidhjeve alternative, të tilla si përdorimi i

ofruesve të ndryshëm të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, duke marrë parasysh nëse dhe si zgjidhjet e parashikuara përputhen me nevojat dhe objektivat e biznesit të përcaktuar në strategjinë e tyre të qëndrueshmërisë digjitale.

3. Në rastet kur marrëveshja kontraktuale për përdorimin e shërbimeve të TIK-ut që mbështesin funksionet kritike ose të rëndësishme, përfshin mundësinë që një ofrues i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut të nënkontraktojë më tej shërbime të TIK-ut që mbështesin funksionet kritike ose të rëndësishme me ofrues të tjerë të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, subjektet financiare do të vlerësojnë përfitimet dhe rreziqet që mund të lindin nga ky nënkontraktim, veçanërisht në rastin kur nënkontraktori i TIK është i themeluar në një shtet tjetër.

4. Në rastet kur marrëveshjet kontraktuale lidhen me shërbimet e TIK-ut që mbështesin funksione kritike ose të rëndësishme, subjektet financiare duhet të marrin në konsideratë edhe parashikimet ligjore mbi falimentimin, që do të zbatoheshin në rast të falimentimit të ofruesit të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, si dhe çdo kufizim që mund të lindë në lidhje me rikuperimin urgjent të të dhënave të subjektit financiar.

5. Në rastet kur marrëveshjet kontraktuale mbi përdorimin e shërbimeve të TIK-ut që mbështesin funksione kritike ose të rëndësishme, lidhen me një ofrues të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut të themeluar në një shtet tjetër, subjektet financiare, përveç kërkesave të parashikuara në pikën 4 të këtij neni, duhet të marrin në konsideratë edhe përputhshmërinë me kërkesat për mbrojtjen e të dhënave të parashikuar në legjislacionin shqiptar dhe zbatimin efektiv të ligjit në atë shtet.

6. Në rastet kur marrëveshjet kontraktuale mbi përdorimin e shërbimeve të TIK-ut që mbështesin funksione kritike ose të rëndësishme parashikojnë nënkontraktimin, subjektet financiare duhet të vlerësojnë nëse dhe si zinxhirët potencialisht të gjatë ose kompleksë të nënkontraktimit mund të ndikojnë në aftësinë e tyre për të monitoruar plotësisht funksionet e kontraktuara dhe në aftësinë e Bankës së Shqipërisë për të mbikëqyrur në mënyrë efektive subjektin financiar në këtë drejtim.

Neni 47

Kërkesat kryesore për marrëveshjet kontraktuale

1. Marrëveshja kontraktuale përcakton në mënyrë të qartë dhe me shkrim, të drejtat dhe detyrimet e subjektit financiar dhe të ofruesit të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut. Kontrata e plotë duhet të përfshijë edhe marrëveshjet mbi nivelin e shërbimeve dhe duhet të dokumentohet në një dokument të shkruar, i cili i vihet në dispozicion palëve në letër ose në një format tjetër i cili është i shkarkueshëm, i qëndrueshëm dhe i aksesueshëm.

2. Marrëveshjet kontraktuale për përdorimin e shërbimeve të TIK-ut përfshijnë të paktën elementet e mëposhtme:

a) një përshkrim të qartë dhe të plotë të të gjitha funksioneve dhe shërbimeve të TIK-ut që do të ofrohen nga ofruesi i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, duke përcaktuar nëse lejohet nënkontraktimi i një shërbimi të TIK-ut që mbështet një funksion kritik ose të rëndësishëm, ose pjesë të rëndësishme të këtij shërbimi dhe, nëse lejohet, kushtet që do të zbatohen për një nënkontraktim të tillë;

b) vendndodhjet (rajonet apo shtetet) ku do të ofrohen funksionet dhe shërbimet e TIK-ut të kontraktuara ose të nënkontraktuara dhe ku do të përpunohen të dhënat, duke përfshirë vendndodhjen e ruajtjes së tyre dhe kërkesën që ofruesi i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut të njoftojë subjektin financiar, nëse parashikon ndryshimin e këtyre vendndodhjeve;

c) parashikimet për aksesin, disponueshmërinë, autenticitetin, integritetin dhe konfidencialitetin në lidhje me mbrojtjen e të dhënave, përfshirë edhe të dhënat personale;

d) parashikimet për sigurimin e aksesit, rikuperimit dhe kthimit, në një format lehtësisht të aksesueshëm të të dhënave personale dhe jopersonale të përpunuara nga subjekti financiar, në rast falimentimi, ndërhyrjeje të jashtëzakonshme ose ndërprerjeje të operacioneve të biznesit të ofruesit të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, ose në rast të përfundimit të marrëveshjes kontraktuale;

e) përshkrime të plota të nivelit të shërbimit, duke përfshirë përditësimet dhe rishikimet e tyre;

f) detyrimin e ofruesit të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, për t'i ofruar ndihmë subjektit financiar, pa kosto shtesë ose me një kosto që është

e përcaktuar paraprakisht, në rast se ndodh një incident TIK i lidhur me shërbimin e TIK-ut që i ofrohet subjektit financiar;

g) detyrimin e ofruesit të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, për të bashkëpunuar plotësisht me Bankën e Shqipërisë në rolin e autoritetit mbikëqyrës dhe të autoritetit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme të subjektit financiar, duke përfshirë edhe me personat e caktuar prej saj;

h) të drejtën e përfundimit të marrëveshjes kontraktuale dhe periudhën minimale të njoftimit për përfundimin e kësaj marrëveshje, në përputhje me pritshmëritë e Bankës së Shqipërisë në rolin e autoritetit mbikëqyrës dhe të autoritetit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme;

i) kushtet për pjesëmarrjen e ofruesve të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut në programet e ndërgjegjësimit për sigurinë e TIK-ut dhe trajnimet për qëndrueshmërinë operacionale digjitale të subjekteve financiare, në përputhje me nenin 15, pika 7, të kësaj rregulloreje.

3. Marrëveshjet kontraktuale për përdorimin e shërbimeve të TIK-ut që mbështesin funksione kritike ose të rëndësishme, përveç sa parashikohet në pikën 2 të këtij neni, përfshijnë të paktën edhe elementet e mëposhtme:

a) përshkrime të plota të nivelit të shërbimit, duke përfshirë përditësimet dhe rishikimet e tyre me objektiva të saktë sasiorë dhe cilësorë të performancës brenda niveleve të dakorduara të shërbimit, për të lejuar monitorimin efektiv të shërbimeve të TIK-ut nga subjekti financiar, si dhe për të mundësuar ndërmarrjen e masave të duhura korrigjuese, pa vonesa të panevojshme, kur nivelet e shërbimit të rëna dakord nuk përmbushen;

b) periudhat e njoftimit dhe detyrimet e raportimit të ofruesit të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut ndaj subjektit financiar, duke përfshirë njoftimin për çdo zhvillim që mund të ketë një ndikim material në aftësinë e ofruesit të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, për të ofruar në mënyrë efektive shërbimet e TIK-ut që mbështesin funksione kritike ose të rëndësishme, në përputhje me nivelet e dakorduara të shërbimit;

c) kërkesat për ofruesin e shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, për të zbatuar dhe testuar planet e emergjencës së biznesit dhe për të disponuar masa, mekanizma dhe politika të sigurisë të TIK-ut, që garantojnë një nivel të mjaftueshëm sigurie për ofrimin e shërbimeve nga subjekti financiar, në përputhje me kuadrin e tij rregullator;

d) detyrimin e ofruesit të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, për të marrë pjesë dhe për të bashkëpunuar plotësisht në testimin e depërtueshmërisë të udhëhequr nga kërcënimi të subjektit financiar, siç parashikohet në nenet 43 dhe 44 të kësaj rregulloreje;

e) të drejtën për të monitoruar në mënyrë të vazhdueshme performancën e ofruesit të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, që përfshin:

i. të drejtat e pakufizuara të aksesit, inspektimin dhe auditimin nga subjekti financiar ose nga një palë e tretë e caktuar, si dhe nga Banka e Shqipërisë, si dhe të drejtën për të marrë në vend (*on-site*) kopje të dokumentacionit përkatës, nëse janë kritike për veprimtarinë e ofruesit të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, ushtrimi efektiv i së cilës nuk pengohet ose kufizohet nga marrëveshje të tjera kontraktuale ose politika të zbatimit;

ii. të drejtën për të rënë dakord për nivelet alternative të sigurimit nëse preken të drejtat e klientëve të tjerë;

iii. detyrimin e ofruesit të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, për të bashkëpunuar plotësisht gjatë inspektimeve në vend dhe auditimeve të kryera nga Banka e Shqipërisë, Autoriteti Mbikëqyrës Kryesor *(Lead Overseer),* subjekti financiar ose një palë e tretë e përcaktuar, dhe

iv. detyrimin për të paraqitur detaje mbi qëllimin, procedurat që do të ndiqen dhe shpeshtësinë e këtyre inspektimeve dhe auditimeve;

f) strategjitë e daljes *(exit strategies),* në veçanti përcaktimin e një periudhe tranzicioni të përshtatshme të detyrueshme:

i. gjatë së cilës ofruesi i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut do të vazhdojë të ofrojë funksionet ose shërbimet përkatëse të TIK-ut, me synimin për të zvogëluar rrezikun e ndërprerjes së veprimtarisë *(risk of disruption)* të subjektit financiar, ose për të siguruar ndërhyrjen e jashtëzakonshme dhe ristrukturimin e saj efektiv;

ii. që i lejon subjektit të zhvendoset në një ofrues tjetër të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, ose në zgjidhje të brendshme, në përputhje me kompleksitetin e shërbimit të ofruar.

4. Pa rënë ndesh me parashikimet e shkronjës "e" të pikës 3 të këtij neni, ofruesi i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut dhe subjekti financiar që është një mikrondërmarrje, mund të bien dakord që të drejtat

e aksesit, inspektimit dhe auditimit nga subjekti financiar të mund të delegohen te një palë e tretë e pavarur, e caktuar nga ofruesi i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, dhe që subjekti financiar është në gjendje të kërkojë informacion dhe garantimin e performancës së ofruesit të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, në çdo kohë nga pala e tretë.

5. Subjektet financiare dhe ofruesit e shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, kur negociojnë marrëveshjet kontraktuale, marrin në konsideratë përdorimin e klauzolave standarde kontraktuale të zhvilluara nga autoritetet publike për shërbime specifike.

NËNKREU II
POLITIKA PËR PËRDORIMIN E SHËRBIMEVE TË TIK-ut QË MBËSHTESIN FUNKSIONET KRITIKE OSE TË RËNDËSISHME, TË OFRUARA NGA OFRUESIT E SHËRBIMEVE TË PALËVE TË TRETA TË TIK-ut

Neni 48
Profili i përgjithshëm i rrezikut dhe kompleksiteti

1. Si pjesë të sistemit të tyre të administrimit të rrezikut të TIK-ut, subjektet financiare miratojnë dhe rishikojnë rregullisht një politikë për përdorimin e shërbimeve të TIK-ut që mbështesin funksionet kritike ose të rëndësishme, të ofruara nga ofruesit e shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, siç parashikohet në nenin 45, pika 2, të kësaj rregulloreje.

2. Politika për përdorimin e shërbimeve të TIK-ut që mbështesin funksionet kritike ose të rëndësishme, të ofruara nga ofruesit e shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut (e cila për thjeshtësi në këtë nënkre do të quhet "politika"), duhet të marrë në konsideratë madhësinë dhe profilin e përgjithshëm të rrezikut të subjektit financiar, si dhe natyrën, shkallën dhe elementet e kompleksitetit të shtuar ose të reduktuar të shërbimeve, aktiviteteve dhe operacioneve të tij, përfshirë elementet që lidhen me:

a) llojin e shërbimeve të TIK-ut të përfshira në marrëveshjen kontraktuale për përdorimin e shërbimeve të TIK-ut që mbështesin funksionet kritike ose të rëndësishme, të ofruara nga ofruesit e shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut (e cila për thjeshtësi në këtë nënkre do të quhet "marrëveshja kontraktuale"), ndërmjet subjektit financiar dhe ofruesit të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut;

b) vendndodhjen e ofruesit të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut ose të shoqërisë mëmë të tij;

c) nëse shërbimet e TIK-ut që mbështesin funksionet kritike ose të rëndësishme ofrohen nga një ofrues i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut i vendosur brenda Shqipërisë ose në një vend tjetër, duke marrë, gjithashtu, në konsideratë edhe vendin nga ku ofrohen shërbimet e TIK-ut, si dhe vendin ku përpunohen dhe ruhen të dhënat;

d) natyrën e të dhënave që shkëmbehen me ofruesin e shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut;

e) nëse ofruesi i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut është pjesë e të njëjtit grup me subjektin financiar të cilit i ofrohen shërbimet;

f) përdorimin e ofruesve të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut që janë të licencuar, të regjistruar ose subjekt i mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë ose një autoriteti tjetër mbikëqyrës brenda Shqipërisë, si dhe përdorimin e ofruesve të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut që nuk janë të tillë;

g) përdorimin e ofruesve të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut që janë të licencuar, të regjistruar ose subjekt i mbikëqyrjes së një autoriteti mbikëqyrës në një vend të tjetër, si dhe përdorimin e ofruesve të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut që nuk janë të tillë;

h) nëse ofrimi i shërbimeve të TIK-ut që mbështesin funksionet kritike ose të rëndësishme është përqendruar te një ofrues i vetëm i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut ose te një numër i vogël ofruesish të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut;

i) transferueshmërinë e shërbimeve të TIK-ut që mbështesin funksionet kritike ose të rëndësishme te një ofrues tjetër shërbimesh i palëve të treta të TIK-ut, përfshirë edhe si pasojë e veçorive teknologjike;

j) ndikimin e mundshëm të ndërprerjeve në ofrimin e shërbimeve të TIK-ut që mbështesin funksionet kritike ose të rëndësishme, mbi vazhdimësinë e aktiviteteve të subjektit financiar dhe mbi disponueshmërinë e shërbimeve të tij.

Neni 49
Zbatimi në nivel grupi

Në rastet kur kjo rregullore zbatohet në baza të konsoliduara ose nënkonsoliduara, shoqëria mëmë që është përgjegjëse për përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara ose nënkonsoliduara të grupit, duhet të sigurojë që politika të zbatohet në mënyrë të njëtrajtshme në të gjitha subjektet financiare që janë pjesë e grupit dhe të jetë e përshtatshme për zbatimin efektiv të kësaj rregulloreje në të gjitha nivelet përkatëse të grupit.

Neni 50
Mekanizmat e qeverisjes

1. Organet drejtuese rishikojnë politikën të paktën një herë në vit dhe e përditësojnë atë, kur është e nevojshme. Ndryshimet e bëra në politikë zbatohen në kohën e duhur dhe sa më shpejt të jetë e mundur brenda kuadrit të marrëveshjeve kontraktuale përkatëse. Subjekti financiar dokumenton afatin kohor të planifikuar për zbatimin e këtyre ndryshimeve.

2. Politika përcakton ose i referohet një metodologjie për përcaktimin e shërbimeve të TIK-ut që mbështesin funksionet kritike ose të rëndësishme. Politika duhet, gjithashtu, të përcaktojë kohën kur ky vlerësim duhet të kryhet dhe të rishikohet.

3. Politika përcakton qartë përgjegjësitë e brendshme për miratimin, administrimin, kontrollin dhe dokumentimin e marrëveshjeve përkatëse kontraktuale dhe siguron që brenda subjektit financiar të disponohen aftësitë, përvoja dhe njohuritë e duhura për të mbikëqyrur *(oversee)* në mënyrë efektive këto marrëveshje kontraktuale, përfshirë shërbimet e TIK-ut që ofrohen në bazë të tyre.

4. Pa cenuar përgjegjësinë përfundimtare të subjektit financiar për mbikëqyrjen efektive të marrëveshjeve kontraktuale përkatëse, politika duhet të përmbajë kërkesa për vlerësimin nëse ofruesi i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut disponon burime të mjaftueshme për të garantuar që subjekti financiar i përmbush të gjitha kërkesat ligjore dhe rregullative që lidhen me shërbimet e TIK-ut që mbështesin funksionet kritike ose të rëndësishme të ofruara.

5. Politika identifikon qartë rolin/funksionin ose personin nga drejtimi i lartë i subjektit financiar, që është përgjegjës për monitorimin e marrëveshjeve kontraktuale përkatëse. Politika përcakton mënyrën se si ky rol/funksion ose person nga drejtimi i lartë, bashkëpunon me funksionet e kontrollit, përveç rasteve kur është pjesë e tyre, dhe përcakton linjat e raportimit ndaj organit drejtues, përfshirë natyrën e informacionit që do të raportohet dhe dokumentet që do të paraqiten, si dhe shpeshtësinë e raportimeve të tilla.

6. Politika duhet të sigurojë që marrëveshjet kontraktuale të jenë në përputhje me:

a) sistemin e administrimit të rrezikut të TIK-ut, të parashikuar në nenin 7 të kësaj rregulloreje;

b) politikën e sigurisë së informacionit, të parashikuar në nenin 10, pika 4, të kësaj rregulloreje;

c) politikën e vazhdimësisë së biznesit të TIK-ut, të parashikuar në nenin 12 të kësaj rregulloreje;

d) kërkesat për raportimin e incidenteve, të përcaktuara në nenin 30 të kësaj rregulloreje.

7. Politika përmban kërkesa që shërbimet e TIK-ut që mbështesin funksionet kritike ose të rëndësishme, të ofruara nga ofrues të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, t'i nënshtrohen rishikimit të pavarur dhe të përfshihen në planin e auditit.

8. Politika duhet të përcaktojë në mënyrë të qartë që marrëveshjet kontraktuale:

a) nuk e përjashtojnë subjektin financiar dhe organet e tij drejtuese, nga detyrimet rregullatore dhe përgjegjësitë ndaj klientëve të tij;

b) nuk duhet të pengojnë mbikëqyrjen efektive të subjektit financiar dhe nuk duhet të bien ndesh me kufizimet mbikëqyrëse mbi shërbimet dhe veprimtaritë e subjektit;

c) duhet të parashikojnë kërkesa që ofruesit e shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut të bashkëpunojnë me Bankën e Shqipërisë;

d) duhet të parashikojnë kërkesa që subjekti financiar, audituesit e jashtëm të tij dhe Banka e Shqipërisë të kenë akses efektiv në të dhënat dhe ambientet që lidhen me përdorimin e shërbimeve të TIK-ut që mbështesin funksionet kritike ose të rëndësishme.

Neni 51
Fazat kryesore të ciklit jetësor për hartimin dhe zbatimin e marrëveshjeve kontraktuale

Politika përcakton kërkesat, përfshirë rregullat, përgjegjësitë dhe proceset, për secilën fazë kryesore të ciklit jetësor të marrëveshjeve kontraktuale, duke përfshirë të paktën sa vijon:

a) përgjegjësitë e organit drejtues, përfshirë pjesëmarrjen e tij, sipas rastit, në procesin e vendimmarrjes mbi përdorimin e shërbimeve të TIK-ut që mbështesin funksionet kritike ose të rëndësishme, të ofruara nga ofruesit e shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut;

b) planifikimin e marrëveshjeve kontraktuale, duke përfshirë vlerësimin e rrezikut, verifikimin e kujdesshëm *(due diligence),* sipas përcaktimeve në nenet 52 dhe 53 të kësaj rregulloreje, si dhe procesin e miratimit të marrëveshjeve të reja ose të ndryshimeve të rëndësishme në marrëveshjet ekzistuese, sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 4, të kësaj rregulloreje;

c) përfshirjen e njësive të biznesit, funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe njësive të tjera përkatëse në lidhje me marrëveshjet kontraktuale;

d) zbatimin, monitorimin dhe administrimin e marrëveshjeve kontraktuale, sipas përcaktimeve në nenet 54, 55 dhe 56 të kësaj rregulloreje, duke përfshirë edhe në nivel të konsoliduar dhe nënkonsoliduar, kur është e zbatueshme;

e) dokumentimin dhe ruajtjen e të dhënave, duke marrë parasysh kërkesat që lidhen me regjistrin e informacionit, të përcaktuara në nenin 45 të kësaj rregulloreje;

f) strategjitë e daljes *(exit strategies)* dhe proceset e ndërprerjes së marrëveshjeve kontraktuale, sipas përcaktimeve në nenin 57 të kësaj rregulloreje.

Neni 52
Vlerësimi paraprak i rrezikut

1. Politika parashikon kërkesa që subjekti financiar të përcaktojë nevojat e biznesit, përpara se të lidhet një marrëveshje kontraktuale.

2. Politika parashikon kërkesa që vlerësimi i rrezikut të kryhet në baza individuale të subjektit financiar dhe, kur është e zbatueshme, në nivel të konsoliduar dhe nënkonsoliduar, përpara se të lidhet një marrëveshje kontraktuale.

3. Vlerësimi i rrezikut duhet të marrë në konsideratë të gjitha kërkesat përkatëse të përcaktuara në këtë rregullore dhe në legjislacionin përkatës të fushës për subjektin financiar. Ky vlerësim duhet të marrë në konsideratë, në mënyrë të veçantë, ndikimin e ofrimit të shërbimeve të TIK-ut që mbështesin funksionet kritike ose të rëndësishme nga ofruesit e shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, mbi subjektin financiar, si dhe të gjitha rreziqet që burojnë nga këto shërbime, duke përfshirë:

a) rrezikun operacional;

b) rrezikun ligjor;

c) rrezikun e TIK-ut;

d) rrezikun reputacional;

e) rrezikun e lidhur me mbrojtjen e të dhënave konfidenciale ose personale;

f) rrezikun e lidhur me disponueshmërinë e të dhënave;

g) rrezikun e lidhur me vendndodhjen ku përpunohen dhe ruhen të dhënat;

h) rrezikun e lidhur me vendndodhjen e ofruesit të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut;

i) rrezikun e përqendrimit të shërbimeve të TIK-ut në nivel subjekti.

Neni 53
Verifikimi i kujdesshëm *(due diligence)*

1. Politika parashikon një proces të përshtatshëm dhe proporcional për përzgjedhjen dhe vlerësimin e ofruesve potencialë të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, duke marrë parasysh nëse ofruesi i shërbimit të TIK-ut është ose jo një ofrues brenda grupit. Politika duhet të parashikojë kërkesa që subjekti financiar, përpara lidhjes së marrëveshjes kontraktuale, të vlerësojë nëse ofruesi i shërbimit i palëve të treta të TIK-ut:

a) ka reputacion të mirë, aftësi, ekspertizë dhe burime të mjaftueshme financiare, njerëzore dhe teknike, standarde të sigurisë së informacionit, strukturë organizative të përshtatshme, sistem të administrimit të rrezikut dhe kontrolle të brendshme, si dhe, kur është e zbatueshme, autorizimet ose regjistrimet përkatëse për ofrimin e shërbimeve të TIK-ut që mbështesin funksionet kritike ose të rëndësishme në mënyrë të besueshme dhe profesionale;

b) ka aftësinë për të monitoruar zhvillimet përkatëse teknologjike, për të identifikuar praktikat

kryesore të sigurisë së TIK-ut dhe për t'i zbatuar ato, kur është e përshtatshme, për të siguruar një sistem efektiv dhe të shëndetshëm të qëndrueshmërisë operacionale digjitale;

c) përdor ose synon të përdorë nënkontraktorë të TIK-ut, për të kryer shërbimet e TIK-ut që mbështesin funksionet kritike ose të rëndësishme, ose pjesë të rëndësishme të tyre;

d) është i vendosur ose përpunon apo ruan të dhënat në një shtet tjetër dhe, nëse po, nëse kjo praktikë ndikon në nivelin e rrezikut operacional ose reputacional, apo rrezikun e ndikimit nga masa kufizuese, përfshirë embargot dhe sanksionet, që mund të ndikojnë në aftësinë e ofruesit të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, për të ofruar shërbimet ose në aftësinë e subjektit financiar për të marrë këto shërbime të TIK-ut;

e) pranon marrëveshjet kontraktuale që sigurojnë mundësinë efektive për kryerjen e auditimeve tek ofruesi i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, përfshirë auditimet në vend, nga vetë subjekti financiar, palë të treta të caktuara prej tij, ose Banka e Shqipërisë;

f) vepron në mënyrë etike dhe me përgjegjësi sociale, respekton të drejtat e njeriut dhe të fëmijëve, përfshirë ndalimin e punës së fëmijëve, respekton parimet e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit dhe garanton kushte të përshtatshme pune.

2. Politika përcakton nivelin e kërkuar të garancisë lidhur me efektivitetin e sistemit të administrimit të rrezikut të ofruesve të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, për shërbimet e TIK-ut që mbështesin funksionet kritike ose të rëndësishme. Politika duhet të përmbajë kërkesa që procesi i verifikimit të kujdesshëm *(due diligence)* të përfshijë një vlerësim të ekzistencës së masave për zbutjen e rrezikut dhe të masave për vazhdimësinë e biznesit, si dhe të mënyrës se si sigurohet funksionimi i tyre brenda ofruesit të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut.

3. Politika duhet të përcaktojë procesin e verifikimit të kujdesshëm *(due diligence)* për përzgjedhjen dhe vlerësimin e ofruesve potencialë të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut dhe të tregojë se cilat nga elementet e mëposhtme do të përdoren për nivelin e nevojshëm të sigurisë mbi performancën e ofruesit të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut:

a) auditime ose vlerësime të pavarura të kryera nga vetë subjekti financiar ose në emër të tij;

b) përdorimi i raporteve të pavarura të auditimit të përgatitura me kërkesë të ofruesit të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut;

c) përdorimi i raporteve të auditimit të kryera nga funksioni i auditit të brendshëm të ofruesit të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut;

d) përdorimi i certifikimeve të përshtatshme nga palë të treta;

e) përdorimi i çdo informacioni tjetër përkatës, të disponueshëm nga subjekti financiar, ose i çdo informacioni tjetër të ofruar nga ofruesi i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut.

4. Subjektet financiare duhet të sigurojnë një nivel të përshtatshëm garancie mbi performancën e ofruesit të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, duke marrë parasysh elementet e përcaktuara në shkronjat nga "a" deri në "e" të pikës 3 të këtij neni. Kur është e përshtatshme, mund të përdoret më shumë se një nga elementet e parashikuara në këto shkronja.

Neni 54
Konflikti i interesit

1. Politika duhet të specifikojë masat e përshtatshme për identifikimin, parandalimin dhe administrimin e konflikteve aktuale ose të mundshme të interesit, që mund të lindin nga përdorimi i ofruesve të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut. Këto masa duhet të ndërmerren përpara lidhjes së marrëveshjeve kontraktuale përkatëse dhe të sigurojnë një monitorim të vazhdueshëm të këtyre konflikteve të interesit.

2. Kur shërbimet e TIK-ut që mbështesin funksionet kritike ose të rëndësishme, ofrohen nga ofrues shërbimesh të TIK-ut brenda grupit, politika duhet të specifikojë që vendimmarrja mbi kushtet përkatëse të shërbimeve të TIK-ut, përfshirë kushtet financiare, të bëhet në mënyrë objektive.

Neni 55
Klauzolat kontraktuale

1. Politika duhet të specifikojë që çdo marrëveshje kontraktuale përkatëse të jetë në formë të shkruar dhe të përfshijë të gjitha elementet e parashikuara në nenin 47, pikat 2 dhe 3 të kësaj rregulloreje. Politika duhet, gjithashtu, të përfshijë elemente që lidhen me kërkesat e përcaktuara në nenin 1, pika 1, shkronja "a", të kësaj rregulloreje, si

dhe me çdo dispozitë tjetër përkatëse ligjore, sipas rastit.

2. Politika duhet të specifikojë që marrëveshjet kontraktuale përkatëse të përfshijnë të drejtën e subjektit financiar për të pasur akses në informacion, për të kryer inspektime dhe auditime, si dhe për të zhvilluar testime për TIK-un. Për këtë qëllim, politika duhet të parashikojë kërkesa që subjekti financiar të përdorë metodat e mëposhtme, pa cenuar përgjegjësinë përfundimtare të tij:

a) auditin e brendshëm të vetë subjektit financiar ose auditimin nga një palë e tretë e caktuar prej tij;

b) kur është e përshtatshme, auditime të përbashkëta dhe testime të përbashkëta të TIK-ut, përfshirë testimin e depërtueshmërisë të udhëhequr nga kërcënimi (*TLPT*), të organizuara në mënyrë të përbashkët me subjekte të tjera financiare ose me shoqëri të kontraktuara që përdorin shërbimet e TIK-ut të të njëjtit ofrues shërbimesh të palëve të treta të TIK-ut, dhe që kryhen nga ato subjekte financiare ose shoqëri të kontraktuara ose nga një palë e tretë e caktuar prej tyre;

c) kur është e përshtatshme, certifikime nga palë të treta;

d) kur është e përshtatshme, raporte auditimi të brendshme ose të palëve të treta, të vëna në dispozicion nga ofruesi i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut.

3. Subjekti financiar nuk duhet të mbështetet gjatë gjithë kohës vetëm mbi certifikimet e parashikuara në pikën 2, shkronja "c", të këtij neni, apo mbi raportet e auditimit të parashikuara në shkronjën "d" të pikës 2 të këtij neni. Politika duhet të lejojë përdorimin e metodave të parashikuara në pikën 2, shkronjat "c" dhe "d" të këtij neni, vetëm nëse subjekti financiar:

a) është i kënaqur me planin e auditimit të ofruesit të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, për marrëveshjet kontraktuale përkatëse;

b) siguron që shtrirja e certifikimeve ose raporteve të auditimit mbulon sistemet dhe kontrollet kryesore të identifikuara prej tij dhe siguron përputhshmërinë me kërkesat rregullatore përkatëse;

c) vlerëson në mënyrë tërësore përmbajtjen e certifikimeve ose raporteve të auditimit dhe verifikon që ato të mos jenë të vjetruara;

d) siguron që sistemet dhe kontrollet kryesore të jenë të përfshira në versionet e ardhshme të certifikimit ose të raportit të auditimit;

e) është i kënaqur me kompetencën profesionale të palës certifikuese ose audituesit;

f) është i kënaqur që certifikimet janë lëshuar dhe auditimet janë kryer në përputhje me standarde profesionale të pranuara gjerësisht dhe që përfshijnë testimin e efektivitetit operacional të kontrolleve kryesore në fuqi;

g) ka të drejtën kontraktuale për të kërkuar, me një frekuencë të arsyeshme dhe të justifikuar nga pikëpamja e administrimit të rrezikut, ndryshime në shtrirjen e certifikimeve ose të raporteve të auditimit, edhe në sisteme dhe kontrolle të tjera përkatëse;

h) ka të drejtën kontraktuale për të kryer auditime individuale dhe të përbashkëta sipas diskrecionit të tij, në lidhje me marrëveshjet kontraktuale dhe për ta ushtruar këtë të drejtë në përputhje me frekuencën e rënë dakord.

4. Politika duhet të sigurojë që çdo ndryshim thelbësor i marrëveshjes kontraktuale të formalizohet në një dokument të shkruar, të datuar dhe të nënshkruar nga të gjitha palët, si dhe duhet të përcaktojë procesin e rinovimit të marrëveshjeve kontraktuale.

Neni 56

Monitorimi i marrëveshjeve kontraktuale

1. Politika duhet të parashikojë kërkesa që marrëveshjet kontraktuale të përcaktojnë masat dhe treguesit kryesorë për monitorimin e vazhdueshëm të performancës së ofruesve të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, duke përfshirë masat për monitorimin e përputhshmërisë me kërkesat që lidhen me konfidencialitetin, disponueshmërinë, integritetin dhe autenticitetin e të dhënave dhe informacionit, si dhe përputhshmërisë së ofruesve të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, me politikat dhe procedurat përkatëse të subjektit financiar. Politika duhet, gjithashtu, të specifikojë masat që do të zbatohen, në rastet kur nuk arrihen nivelet e dakorduara të shërbimit, përfshirë, kur është e përshtatshme, aplikimin e penaliteteve kontraktuale.

2. Politika përcakton mënyrën se si subjekti financiar vlerëson nëse ofruesit e shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, të përdorur për shërbimet e TIK-ut që mbështesin funksionet kritike ose të rëndësishme, përmbushin standarde të përshtatshme të performancës dhe cilësisë, në përputhje me marrëveshjen kontraktuale dhe

politikat e vetë subjektit financiar. Politika, në veçanti, duhet të sigurojë që:

a) ofruesit e shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut t'i paraqesin subjektit financiar raporte të rregullta mbi veprimtarinë dhe shërbimet e tyre, duke përfshirë raporte periodike, raporte incidentesh, raporte mbi ofrimin e shërbimeve, raporte mbi sigurinë e TIK-ut dhe raporte mbi masat dhe testimet e vazhdimësisë së biznesit;

b) performanca e ofruesve të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, vlerësohet nëpërmjet treguesve kryesorë të performancës (KPI), treguesve kryesorë të kontrollit (KCI), auditimeve, vetëcertifikimeve dhe rishikimeve të pavarura, në përputhje me sistemin e administrimit të rrezikut të TIK-ut të subjektit financiar;

c) subjekti financiar merr informacione të tjera përkatëse nga ofruesit e shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut;

d) subjekti financiar të njoftohet, kur është e përshtatshme, për incidentet e lidhura me TIK-un dhe incidentet operacionale ose të sigurisë që lidhen me pagesat;

e) të kryhen rishikime dhe auditime të pavarura për verifikimin e përputhshmërisë me kërkesat ligjore dhe rregullative dhe me politikat përkatëse të subjektit financiar.

3. Politika duhet të përcaktojë që vlerësimi i parashikuar në pikën 2 të këtij neni të dokumentohet dhe rezultatet e tij të përdoren për përditësimin e vlerësimit të rrezikut të subjektit financiar të parashikuar në nenin 53 të kësaj rregulloreje.

4. Politika duhet të përcaktojë masat e përshtatshme që subjekti financiar duhet të ndërmarrë, nëse identifikohen mangësi nga ana e ofruesve të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, përfshirë incidentet e lidhura me TIK-un dhe incidentet operacionale ose të sigurisë që lidhen me pagesat, në ofrimin e shërbimeve të TIK-ut që mbështesin funksionet kritike ose të rëndësishme, ose në përputhshmërinë me marrëveshjet kontraktuale apo kërkesat ligjore. Politika duhet, gjithashtu, të specifikojë mënyrën e monitorimit të zbatimit të këtyre masave, për të siguruar që ato të zbatohen në mënyrë efektive brenda një afati të përcaktuar, duke marrë në konsideratë edhe rëndësinë e mangësive të konstatuara.

Neni 57

Dalja nga marrëveshjet kontraktuale dhe ndërprerja e marrëveshjeve kontraktuale

1. Politika duhet të përmbajë kërkesa për hartimin e një plani daljeje *(exit plan)* të dokumentuar për çdo marrëveshje kontraktuale, si dhe për rishikimin dhe testimin periodik të këtij plani. Gjatë hartimit të planit të daljes duhet të merren parasysh këto elemente:

a) ndërprerjet e papritura dhe të vazhdueshme të shërbimit;

b) ofrimi i papërshtatshëm ose i dështuar i shërbimit;

c) ndërprerja e papritur e marrëveshjes kontraktuale.

2. Plani i daljes *(exit plan)* duhet të jetë realist, i zbatueshëm, i bazuar në skenarë të besueshëm dhe në supozime të arsyeshme, dhe duhet të përfshijë një afat të planifikuar zbatimi që të jetë në përputhje me kushtet e daljes dhe të ndërprerjes të përcaktuara në marrëveshjet kontraktuale.

KREU VI

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR DHE SHKËMBIMI I INFORMACIONIT

Neni 58

Bashkëpunimi ndërkombëtar

1. Banka e Shqipërisë mund të lidhë marrëveshje administrative me Autoritetin Bankar Evropian, me kërkesë të këtij të fundit, për qëllime të bashkëpunimit ndërkombëtar mbi rrezikun e palëve të treta të TIK-ut në sektorë të ndryshëm financiarë, në veçanti duke zhvilluar praktikat më të mira për shqyrtimin e praktikave dhe kontrolleve të administrimit të rrezikut të TIK-ut, masave zbutëse dhe reagimit ndaj incidenteve.

Neni 59

Shkëmbimi i informacionit mbi të dhënat dhe inteligjencën për kërcënimet kibernetike

1. Subjektet financiare mund të shkëmbejnë ndërmjet tyre informacion dhe inteligjencë për kërcënimet kibernetike, duke përfshirë treguesit e kompromentimit, taktikat, teknikat dhe procedurat, sinjalizimet e sigurisë kibernetike dhe mjetet e

konfigurimit, në masën që një shkëmbim i tillë i informacionit dhe inteligjencës:

a) synon rritjen e qëndrueshmërisë operacionale digjitale të subjekteve financiare, veçanërisht nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit në lidhje me kërcënimet kibernetike, kufizimit ose pengimit të aftësisë së kërcënimeve kibernetike për t'u përhapur, mbështetjes së aftësive mbrojtëse të subjekteve financiare, teknikave të zbulimit të kërcënimeve, strategjive zbutëse ose fazave të reagimit dhe të rikuperimit;

b) kryhet brenda komuniteteve të besuara të subjekteve financiare;

c) zbatohet përmes marrëveshjeve për shkëmbimin e informacionit që mbrojnë natyrën potencialisht të ndjeshme të informacionit të shkëmbyer dhe që rregullohen nga rregullat e sjelljes, duke respektuar plotësisht konfidencialitetin e biznesit, mbrojtjen e të dhënave personale, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe rregullat mbi politikën e konkurrencës.

2. Për qëllime të zbatimit të shkronjës "c" të pikës 1 të këtij neni, marrëveshjet për shkëmbimin e informacionit duhet të përcaktojnë kushtet për pjesëmarrje dhe, sipas rastit, duhet të përcaktojnë edhe detajet mbi përfshirjen e autoriteteve publike dhe kapacitetin në të cilin këto të fundit mund të lidhen me marrëveshjet për shkëmbimin e informacionit, mbi përfshirjen e ofruesve të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, si dhe mbi elementet operacionale, duke përfshirë përdorimin e platformave të dedikuara të teknologjisë së informacionit.

3. Subjektet financiare njoftojnë Bankën e Shqipërisë për pjesëmarrjen e tyre në marrëveshjet për shkëmbimin e informacionit të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, pas vërtetimit për anëtarësimin e tyre, ose, sipas rastit, për përfundimin e anëtarësimit të tyre, pasi ky të hyjë në fuqi.

KREU VII
KUADRI I MBIKËQYRJES PËR OFRUESIT KRITIKË TË SHËRBIMEVE TË PALËVE TË TRETA TË TIK-ut

NËNKREU I
KUADRI I MBIKËQYRJES PËR OFRUESIT KRITIKË TË SHËRBIMEVE TË PALËVE TË TRETA TË TIK-ut NË NIVEL BASHKIMI EVROPIAN

Neni 60
Përcaktimi i ofruesve kritikë të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut

1. Autoritetet Evropiane Mbikëqyrëse (*ESA-t*), nëpërmjet Komitetit të Përbashkët *(Joint Committee)* dhe bazuar në rekomandimin e Forumit të Mbikëqyrjes të ngritur sipas nenit 32(1) të Rregullores (BE) 2022/2554:

a) përcaktojnë ofruesit e shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, që konsiderohen kritikë për subjektet financiare, pas një vlerësimi bazuar në kriteret e përcaktuara në nenin 31(2), të Rregullores (BE) 2022/2554 dhe sipas parashikimeve të pikës 2 të këtij neni;

b) caktojnë si Mbikëqyrës Kryesor *(Lead Overseer)* për secilin ofrues kritik të shërbimeve të TIK-ut, ESA që është përgjegjëse, në përputhje me Rregulloret (BE) nr. 1093/2010, (BE) nr. 1094/2010 ose (BE) nr. 1095/2010, për subjektet financiare që zotërojnë së bashku pjesën më të madhe të vlerës totale të aktiveve, nga totali i aktiveve të të gjitha subjekteve financiare që përdorin shërbimet e ofruesit përkatës të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, vërtetuar nga bilancet individuale të atyre subjekteve financiare.

2. Përcaktimi i përmendur në pikën 1, shkronja "a", të këtij neni, bazohet në të gjitha kriteret e mëposhtme që lidhen me shërbimet e TIK-ut të ofruara nga ofruesi përkatës i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut:

a) ndikimi sistemik mbi stabilitetin, vazhdimësinë ose cilësinë e ofrimit të shërbimeve financiare, në rast se ofruesi i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut do të përballej me një dështim operacional në shkallë të gjerë për ofrimin e shërbimeve të tij, duke marrë parasysh numrin e subjekteve financiare dhe

vlerën totale të aktiveve të subjekteve financiare që përdorin shërbimet e këtij ofruesi;

b) karakteri ose rëndësia sistemike e subjekteve financiare që mbështeten tek ofruesi përkatës i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, i vlerësuar në përputhje me parametrat e mëposhtëm:

i. numri i institucioneve me rëndësi sistemike globale (G-SII) ose institucioneve të tjera me rëndësi sistemike (O-SII) që mbështeten tek ofruesi përkatës i shërbimeve TIK,

ii. ndërvarësia midis G-SII-ve ose O-SII-ve të përmendura në nënpikën "i" dhe subjekteve të tjera financiare, përfshirë rastet kur këto institucione ofrojnë shërbime të infrastrukturës financiare për subjekte të tjera financiare;

c) varësia e subjekteve financiare nga shërbimet e ofruara nga ofruesi përkatës i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, në lidhje me funksione kritike ose të rëndësishme, përfshirë rastet kur këto funksione mbështeten te i njëjti ofrues i shërbimeve TIK-ut, pavarësisht nëse kjo varësi është e drejtpërdrejtë apo e tërthortë, përmes marrëveshjeve të nënkontraktimit;

d) shkalla e zëvendësueshmërisë së ofruesit të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, duke marrë në konsideratë kriteret e mëposhtme:

i. mungesën e alternativave reale, qoftë edhe të pjesshme, për shkak të numrit të kufizuar të ofruesve aktivë në një treg të caktuar, pjesës së tregut që zotëron ofruesi përkatës, ose kompleksitetit teknik apo nivelit të sofistikimit, përfshirë në lidhje me çdo teknologji pronësore, si dhe veçoritë specifike të organizimit apo aktivitetit të ofruesit të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut,

ii. vështirësitë në migrimin pjesor ose të plotë të të dhënave dhe ngarkesave përkatëse nga ofruesi ekzistues te një tjetër, për shkak të kostove financiare të konsiderueshme, kohës ose burimeve të tjera të nevojshme, apo për shkak të rrezikut të shtuar të TIK-ut ose rreziqeve të tjera operacionale që mund të lindin gjatë këtij procesi të migrimit.

3. Në rastet kur ofruesi i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut i përket një grupi, kriteret e përmendura në pikën 2 të këtij neni merren në konsideratë në lidhje me shërbimet e TIK-ut të ofruara nga grupi në tërësi.

4. Ofruesit kritikë të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut që janë pjesë e një grupi, caktojnë një person juridik si pikë koordinimi për të siguruar përfaqësimin dhe komunikimin e duhur me Mbikëqyrësin Kryesor.

5. Mbikëqyrësi Kryesor njofton ofruesin e shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, për rezultatin e vlerësimit që çon në përcaktimin e tij si kritik, sipas nenit 31(1), shkronja "a", të Rregullores (BE) 2022/2554.

Brenda 6 javëve nga data e njoftimit, ofruesi i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut mund të paraqesë pranë Mbikëqyrësit Kryesor një deklaratë të arsyetuar, e cila mund të shoqërohet me çdo informacion përkatës për qëllime të vlerësimit. Mbikëqyrësi Kryesor shqyrton deklaratën e arsyetuar dhe mund të kërkojë informacione shtesë, të cilat duhet të dorëzohen brenda 30 ditëve kalendarike nga marrja e kërkesës.

Pas përcaktimit të një ofruesi të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut si kritik, ESA-t, nëpërmjet Komitetit të Përbashkët, njoftojnë zyrtarisht ofruesin për këtë përcaktim dhe për datën e fillimit nga e cila ai do t'i nënshtrohet aktivitetit të mbikëqyrjes.

Kjo datë nuk mund të jetë më vonë se një muaj nga njoftimi. Ofruesi i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut njofton të gjitha subjektet financiare që u ofron shërbime, për përcaktimin e tij si ofrues kritik.

6. Përcaktimi i përmendur në pikën 1, shkronja "a", të këtij neni, nuk aplikohet për rastet e mëposhtme:

a) subjektet financiare që ofrojnë shërbime të TIK-ut për subjekte të tjera financiare;

b) ofruesit e shërbimeve të TIK-ut që i nënshtrohen kuadrit mbikëqyrës të krijuar për qëllimet e mbështetjes së detyrave të përmendura në nenin 127, paragrafi 2, të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian;

c) ofruesit e shërbimeve të TIK-ut brenda grupit;

d) ofruesit e shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut që ofrojnë shërbime të TIK-ut vetëm në një shtet anëtar për subjekte financiare që janë aktive vetëm në atë shtet.

7. ESA-t, nëpërmjet Komitetit të Përbashkët, krijojnë, publikojnë dhe përditësojnë çdo vit listën e ofruesve kritikë të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, në nivel Bashkimi Evropian.

8. Për qëllimet e nenit 31(1), shkronja "a", të Rregullores (BE) 2022/2554, Banka e Shqipërisë i përcjell çdo vit dhe në mënyrë të përmbledhur raportet e përmendura në nenin 45, pika 5, të kësaj rregulloreje, te Forumi i Mbikëqyrjes i krijuar sipas

nenit 32 të Rregullores (BE) 2022/2554. Forumi i Mbikëqyrjes vlerëson varësitë e subjekteve financiare nga ofruesit e shërbimeve të TIK-ut, bazuar në informacionin e marrë nga Banka e Shqipërisë dhe autoritetet e tjera përgjegjëse.

9. Ofruesit e shërbimeve të palëve treta të TIK-ut që nuk janë përfshirë në listën e përmendur në pikën 7 të këtij neni, mund të kërkojnë të përcaktohen si kritikë, në përputhje me pikën 1, shkronja "a", të këtij neni.

Për këtë qëllim, ofruesi i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut paraqet një kërkesë të arsyetuar pranë EBA-së, ESMA-s ose EIOPA-s, të cilat, nëpërmjet Komitetit të Përbashkët, vendosin nëse do ta përcaktojnë ofruesin përkatës të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut si kritik, në përputhje me nenin 31(1), shkronja "a", të Rregullores (BE) 2022/2554.

Vendimi i përmendur në nënparagrafin e dytë të kësaj pike miratohet dhe i njoftohet ofruesit të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, brenda 6 muajve nga marrja e kërkesës.

10. Subjektet financiare mund të përdorin shërbimet e një ofruesi të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut të vendosur në një vend të tretë dhe që është përcaktuar si kritik sipas nenit 31(1), shkronja "a", të Rregullores (BE) 2022/2554, vetëm nëse ky ofrues ka krijuar një filial në Bashkimin Evropian brenda 12 muajve pas përcaktimit.

11. Ofruesi kritik i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut i përmendur në pikën 10 të këtij neni, njofton Mbikëqyrësin Kryesor për çdo ndryshim në strukturën e menaxhimit të filialit të krijuar në Bashkimin Evropian.

Neni 61

Struktura e Kuadrit të Mbikëqyrjes

1. Komiteti i Përbashkët *(Joint Committee),* në përputhje me nenin 57(1) të Rregulloreve (BE) nr. 1093/2010, (BE) nr. 1094/2010 dhe (BE) nr. 1095/2010, krijon Forumin e Mbikëqyrjes si një nënkomitet, me qëllim mbështetjen e punës së Komitetit të Përbashkët *(Joint Committee)* dhe të Mbikëqyrësit Kryesor *(Lead Overseer)* të referuar në nenin 31(1), shkronja "b", të Rregullores (BE) 2022/2554, në fushën e rrezikut të TIK-ut nga palët e treta në të gjithë sektorët financiarë. Forumi i Mbikëqyrjes përgatit draft-qëndrimet dhe draft-aktet e përbashkëta të këtij Komiteti në këtë fushë.

Komiteti i përbashkët diskuton rregullisht zhvillimet mbi rrezikun dhe vulnerabilitetet e TIK-ut dhe nxit një qasje të qëndrueshme në monitorimin e rrezikut të TIK-ut nga palët e treta në nivel Bashkimi Evropian.

2. Forumi i Mbikëqyrjes kryen çdo vit një vlerësim kolektiv të rezultateve dhe gjetjeve të aktiviteteve të mbikëqyrjes të kryera për të gjithë ofruesit kritikë të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, dhe promovon masa koordinimi për forcimin e qëndrueshmërisë operacionale digjitale të subjekteve financiare, nxitjen e praktikave më të mira në adresimin e rrezikut të përqendrimit të TIK-ut dhe identifikimin dhe vlerësimin e masave për zbutjen e rreziqeve ndërsektoriale.

3. Forumi i Mbikëqyrjes paraqet kritere vlerësimi gjithëpërfshirëse për ofruesit kritikë të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, të cilat miratohen nga Komiteti i Përbashkët, si qëndrim i përbashkët të ESA-ve, në përputhje me nenin 56(1) të Rregulloreve (BE) nr. 1093/2010, (BE) nr. 1094/2010 dhe (BE) nr. 1095/2010.

4. Forumi i Mbikëqyrjes përbëhet nga:

a) Kryetarët e ESA-ve;

b) një përfaqësues në nivel drejtues nga stafi aktual i autoritetit përgjegjës përkatës, siç përcaktohet në nenin 46 të Rregullores (BE) 2022/2554, për secilin shtet anëtar;

c) Drejtorët Ekzekutivë të secilës ESA dhe një përfaqësues nga Komisioni Evropian, nga Bordi Evropian i Rrezikut Sistemik (*ESRB*), nga Banka Qendrore Evropiane (BQE) dhe nga ENISA, me statusin e vëzhguesit;

d) kur është e nevojshme, një përfaqësues shtesë nga një autoritet përgjegjës i përcaktuar në nenin 46 të Rregullores (BE) 2022/2554, për secilin shtet anëtar, me statusin e vëzhguesit;

e) kur është e aplikueshme, një përfaqësues me status vëzhguesi, i autoriteteve përgjegjëse të caktuara ose të krijuara në përputhje me Direktivën (BE) 2022/2555, përgjegjëse për mbikëqyrjen e një subjekti thelbësor ose të rëndësishëm sipas asaj direktive, që është përcaktuar si ofrues kritik i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut.

Forumi i Mbikëqyrjes, kur e konsideron të përshtatshme, kërkon këshillim nga ekspertë të pavarur, të emëruar në përputhje me nenin 32(6) të Rregullores (BE) 2022/2554.

5. Çdo shtet anëtar cakton autoritetin përgjegjës përkatës, i cilit emëron përfaqësuesin e vet në nivel

drejtues, i referuar në pikën 4, shkronja "b", dhe njofton Mbikëqyrësin Kryesor për këtë emërim.

ESA-t publikojnë në faqet e tyre zyrtare të internetit listën e përfaqësuesve të nivelit të lartë drejtues nga stafi aktual i autoriteteve përgjegjëse të caktuara nga shtetet anëtare.

6. Ekspertët e pavarur të përmendur në pikën 4, paragrafi i dytë të këtij neni, emërohen nga Forumi i Mbikëqyrjes të përzgjedhur nga një grup ekspertësh nëpërmjet një procesi publik dhe transparent aplikimi.

Ekspertët e pavarur emërohen mbi bazën e ekspertizës së tyre në çështjet e stabilitetit financiar, qëndrueshmërisë operacionale digjitale dhe sigurisë së TIK-ut. Ata veprojnë në mënyrë të pavarur dhe objektive, në interes të vetëm të Bashkimit Evropian si një i tërë, dhe nuk kërkojnë e as marrin udhëzime nga institucionet ose organet e BE-së, nga ndonjë qeveri e një shteti anëtar apo nga ndonjë organ tjetër publik ose privat.

7. Kërkesat e përcaktuara në këtë kre nuk cenojnë zbatimin e Direktivës (BE) 2022/2555 dhe të rregullave të tjera të Bashkimit Evropian mbi mbikëqyrjen e ofruesve të shërbimeve të *"cloud computing"*.

8. ESA-t, nëpërmjet Komitetit të Përbashkët dhe mbi bazën e punës përgatitore të kryer nga Forumi i Mbikëqyrjes, paraqesin çdo vit një raport mbi zbatimin e seksionit II të kreut V të Rregullores (BE) 2022/2554 në Parlamentin Evropian, Këshillin Evropian dhe Komisionin Evropian.

Neni 62

Detyrat e Mbikëqyrësit Kryesor *(Lead Overseer)*

1. Mbikëqyrësi Kryesor, i përcaktuar në përputhje me nenin 31(1), shkronja "b", të Rregullores (BE) 2022/2554, ushtron mbikëqyrjen ndaj ofruesve kritikë të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, dhe për të gjitha çështjet që lidhen me mbikëqyrjen, vepron si pikë kryesore kontakti për këta ofrues.

2. Për qëllime të nenit 33(1) të Rregullores (BE) 2022/2554, Mbikëqyrësi Kryesor vlerëson nëse ofruesi kritik i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut ka vendosur rregulla, procedura dhe mekanizma, si dhe ka marrë masa të plota, të qëndrueshme dhe efektive për të administruar rrezikun e TIK-ut që mund t'iu shkaktojë subjekteve financiare. Ky vlerësim përqendrohet kryesisht në shërbimet e TIK-ut të ofruara nga ofruesit kritikë të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut që mbështesin funksione kritike ose të rëndësishme të subjekteve financiare.

Kur është e nevojshme për të adresuar të gjitha rreziqet përkatëse, vlerësimi zgjerohet edhe mbi shërbimet e TIK-ut që mbështesin funksione të tjera, përveç atyre kritike ose të rëndësishme.

3. Vlerësimi i përmendur në pikën 2 të këtij neni, përfshin:

a) kërkesat e TIK-ut për të garantuar sigurinë, disponueshmërinë, vazhdimësinë, shkallëzimin dhe cilësinë e shërbimeve që ofruesi kritik i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut u ofron subjekteve financiare, si dhe aftësinë për të ruajtur në çdo kohë standarde të larta të disponueshmërisë, autenticitetit, integritetit dhe konfidencialitetit të të dhënave;

b) masat e sigurisë fizike që kontribuojnë në mbrojtjen e sigurisë së TIK-ut, përfshirë sigurinë e ndërtesave, objekteve dhe bazës së të dhënave;

c) proceset e administrimit të rrezikut, përfshirë politikat e administrimit të rrezikut të TIK-ut, politikën e vazhdimësisë së biznesit të TIK-ut dhe planet e reagimit dhe rimëkëmbjes të TIK-ut;

d) mekanizmat e qeverisjes, përfshirë një strukturë organizative me linja të qarta, transparente dhe të qëndrueshme përgjegjësie dhe llogaridhënieje, që mundësojnë një administrim efektiv të rrezikut të TIK-ut;

e) identifikimin, monitorimin dhe raportimin e menjëhershëm të incidenteve të rëndësishme të lidhur me TIK-un ndaj subjekteve financiare, si dhe menaxhimin dhe zgjidhjen e këtyre incidenteve, në veçanti të sulmeve kibernetike;

f) mekanizmat për transferimin e të dhënave *(data portability)* dhe aplikacioneve për ndërveprueshmërinë e aplikacioneve që sigurojnë ushtrim efektiv të të drejtave të përfundimit të marrëdhënieve kontraktuale nga subjektet financiare;

g) testimin e sistemeve, infrastrukturës dhe kontrolleve të TIK-ut;

h) auditimet e TIK;

i) përdorimin e standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare përkatëse që zbatohen për ofrimin e shërbimeve të TIK-ut ndaj subjekteve financiare.

4. Bazuar në vlerësimin e referuar në pikën 2 të nenit 33 të Rregullores (BE) 2022/2554, dhe në bashkëpunim me Rrjetin e Përbashkët të Mbikëqyrjes *(Joint Oversight Network – JON)* të referuar në nenin 34(1) të Rregullores (BE)

2022/2554, Mbikëqyrësi Kryesor miraton një plan mbikëqyrjeje individual të qartë**,** të detajuar dhe të arsyetuar, që përshkruan objektivat vjetorë të mbikëqyrjes dhe veprimet kryesore të planifikuar për secilin ofrues kritik të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut.

Ky plan i komunikohet çdo vit ofruesit përkatës të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut.

Para miratimit të planit të mbikëqyrjes, Mbikëqyrësi Kryesor i dërgon ofruesit kritik të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut një draft të planit të mbikëqyrjes.

Pas marrjes së këtij drafti, ofruesi kritik i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut mund të paraqesë brenda 15 ditëve kalendarike një deklaratë të arsyetuar, duke paraqitur ndikimin e mundshëm mbi klientët që janë subjekte jashtë fushës së Rregullores (BE) 2022/2554 dhe, kur është e aplikueshme, duke propozuar zgjidhje për zbutjen e rreziqeve.

5. Pasi planet vjetore të mbikëqyrjes të përmendura në pikën 4 janë miratuar dhe iu janë njoftuar ofruesve kritikë të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, Banka e Shqipërisë mund të marrë masa ndaj këtyre ofruesve vetëm me marrëveshje me Mbikëqyrësin Kryesor.

Neni 63

Koordinimi operacional ndërmjet Mbikëqyrësve Kryesorë *(Lead Overseers)*

1. Për të siguruar një qasje të qëndrueshme ndaj aktiviteteve të mbikëqyrjes dhe me qëllim mundësimin e strategjive të përgjithshme të mbikëqyrjes, të koordinuara, si dhe qasjeve operacionale dhe metodologjive të punës të bashkërenduara, tre Mbikëqyrësit Kryesorë të përcaktuar në përputhje me nenin 31(1), shkronja "b", të rregullores (BE) 2022/2554, do të krijojnë një Rrjet të Përbashkët të Mbikëqyrjes (*JON*). Ky rrjet ka për qëllim koordinimin ndërmjet fazave përgatitore dhe kryerjen e aktiviteteve të mbikëqyrjes mbi ofruesit kritikë përkatës të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, si dhe gjatë çdo veprimi që mund të jetë i nevojshëm në zbatim të nenit 42 të Rregullores (BE) 2022/2554 dhe sipas parashikimeve të nenit 71 të kësaj rregulloreje.

2. Për qëllime të pikës 1 të nenit 34 të Rregullores (BE) 2022/2554, Mbikëqyrësit Kryesorë hartojnë një protokoll të përbashkët mbikëqyrjeje që specifikon në mënyrë të detajuar procedurat që duhen ndjekur për koordinimin e përditshëm dhe për të siguruar shkëmbime dhe reagime të shpejta. Ky protokoll do të rishikohet periodikisht për të pasqyruar nevojat operacionale, në veçanti zhvillimet në praktikat e mbikëqyrjes.

3. Mbikëqyrësit Kryesorë, mbi baza *ad hoc*, mund t'i bëjnë thirrje Bankës Qendrore Evropiane dhe ENISA-s për të ofruar këshilla teknike, për të ndarë përvojën praktike ose për t'u përfshirë në takime të caktuara të koordinimit të Rrjetit të Përbashkët të Mbikëqyrjes (*JON*).

Neni 64

Kompetencat e Mbikëqyrësit Kryesor *(Lead Overseer)*

1. Mbikëqyrësi Kryesor, me qëllim kryerjen e detyrave të përcaktuara në seksionin II të kreut V të Rregullores (BE) 2022/2554, në lidhje me ofruesit kritikë të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, ka kompetencat e mëposhtme:

a) kërkon të gjithë informacionin dhe dokumentacionin sipas parashikimeve në nenin 37 të Rregullores (BE) 2022/2554;

b) kryen hetime të përgjithshme dhe inspektime në përputhje me nenet 38 dhe 39 të Rregullores (BE) 2022/2554;

c) kërkon, pas përfundimit të aktivitetit mbikëqyrës, raporte që specifikojnë veprimet që janë ndërmarrë ose masat korrigjuese që janë zbatuar nga ofruesit kritikë të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, në lidhje me rekomandimet e referuara në shkronjën "d" të nenit 35(1) të Rregullores (BE) 2022/2554;

d) jep rekomandime mbi fushat e parashikuara në nenin 33(3) të Rregullores (BE) 2022/2554, veçanërisht në lidhje me:

i. përdorimin e kërkesave ose proceseve specifike të sigurisë dhe cilësisë së TIK-ut, veçanërisht në lidhje me implementimin e *patch*-eve, përditësimeve, enkriptimit dhe masave të tjera të sigurisë, të cilat Mbikëqyrësi Kryesor i vlerëson si të nevojshme për garantimin e sigurisë së shërbimeve të TIK-ut të ofruara ndaj subjekteve financiare;

ii. përdorimin e kushteve dhe termave, përfshirë zbatimin teknik të tyre, sipas të cilave ofruesit kritikë të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut i ofrojnë shërbime të TIK-ut subjekteve financiare, të cilat Mbikëqyrësi Kryesor i vlerëson si të rëndësishme

për parandalimin e krijimit të pikave të vetme të dështimit, për shmangien e përhapjes së tyre, ose për minimizimin e ndikimit të mundshëm sistemik në të gjithë sektorin financiar të Bashkimit Evropian, në rast të rrezikut të përqendrimit të TIK-ut;

iii. çdo nënkontraktim të planifikuar, ku Mbikëqyrësi Kryesor gjykon se nënkontraktimi i mëtejshëm, përfshirë marrëveshjet e nënkontraktimit që ofruesit kritikë të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut planifikojnë të lidhin me ofrues të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut ose me nënkontraktorë të TIK-ut të themeluar në një vend të tretë, mund të shkaktojë rreziqe për ofrimin e shërbimeve nga subjekti financiar, ose rreziqe për stabilitetin financiar, bazuar në shqyrtimin e informacionit të mbledhur në përputhje me nenet 37 dhe 38 të Rregullores (BE) 2022/2554;

iv. mos hyrjen në një marrëveshje të mëtejshme nënkontraktimi, kur plotësohen njëkohësisht të gjitha kushtet e mëposhtme:

- nënkontraktori i parashikuar është një ofrues i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut ose një nënkontraktor i TIK-ut i themeluar në një vend të tretë;

- nënkontraktimi lidhet me funksione kritike ose të rëndësishme të subjektit financiar, dhe

- Mbikëqyrësi Kryesor vlerëson se përdorimi i një nënkontraktimi të tillë paraqet një rrezik të qartë dhe serioz për stabilitetin financiar të Bashkimit Evropian ose për subjektet financiare, përfshirë aftësinë e tyre për të përmbushur kërkesat mbikëqyrëse.

Për qëllime të nënpikës "iv" të shkronjës "b" të nenit 35(1) të Rregullores (BE) 2022/2554, ofruesit e shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, i transmetojnë Mbikëqyrësit Kryesor informacionin lidhur me nënkontraktimin, duke përdorur formularët e parashikuar në nenin 41(1), shkronja "b" të Rregullores (BE) 2022/2554.

2. Gjatë ushtrimit të kompetencave të parashikuara në nenin 35 të Rregullores (BE) 2022/2554, Mbikëqyrësi Kryesor:

a) siguron koordinim të rregullt brenda Rrjetit të Përbashkët të Mbikëqyrjes (*JON*), dhe në veçanti, kërkon qasje të qëndrueshme sipas rastit, lidhur me mbikëqyrjen e ofruesve kritikë të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut;

b) merr në konsideratë kuadrin e vendosur nga Direktiva (BE) 2022/2555 dhe, kur është e nevojshme, konsultohet me autoritetet përgjegjëse përkatëse të caktuara ose të krijuara në përputhje me atë Direktivë, më qëllim shmangien e dublikimit të masave teknike dhe organizative që mund të zbatohen ndaj ofruesve kritikë të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut në zbatim të asaj Direktive;

c) synon minimizimin, për aq sa është e mundur, të rrezikut të ndërprerjes së shërbimeve të ofruara nga ofruesit kritikë të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, për klientët që janë subjekte të ndryshme nga ata që përfshihen në fushën e zbatimit të Rregullores (BE) 2022/2554.

3. Mbikëqyrësi Kryesor konsultohet me Forumin e Mbikëqyrjes *(Oversight Forum)* përpara se të ushtrojë kompetencat e parashikuara në pikën 1 të nenit 35 të Rregullores (BE) 2022/2554. Përpara se të japë rekomandime në përputhje me pikën 1, shkronja "d", të nenit 35 të Rregullores (BE) 2022/2554, Mbikëqyrësi Kryesor u jep mundësi ofruesve të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut të paraqesin brenda 30 ditëve kalendarike, informacion që dëshmon ndikimin e pritshëm mbi klientët që janë subjekte jashtë fushës së zbatimit të Rregullores (BE) 2022/2554 dhe, kur është e përshtatshme, të formulojnë zgjidhje për zbutjen e rreziqeve.

4. Mbikëqyrësi Kryesor informon Rrjetin e Përbashkët të Mbikëqyrjes (*JON*) mbi rezultatet e ushtrimit të kompetencave të parashikuara në pikën 1, shkronjat "a" dhe "b" të nenit 35 të Rregullores (BE) 2022/2554. Mbikëqyrësi Kryesor, pa vonesë të pajustifikuar, përcjell raportet e përmendura në pikën 1, shkronja "c", të nenit 35 të Rregullores (BE) 2022/2554, te *JON* dhe tek autoritetet përgjegjëse të subjekteve financiare që përdorin shërbimet e TIK-ut të ofruesit kritik të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut.

5. Ofruesit kritikë të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut bashkëpunojnë me mirëbesim me Mbikëqyrësin Kryesor dhe e asistojnë në përmbushjen e detyrave.

6. Në rast të moszbatimit të plotë ose të pjesshëm të masave që kërkohet të merren në zbatim të ushtrimit të kompetencave sipas pikës 1, shkronjat "a", "b" dhe "c" të nenit 35 të Rregullores (BE) 2022/2554 dhe pas përfundimit të afatit prej të paktën 30 ditësh kalendarike nga data kur ofruesi kritik i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut ka marrë njoftimin për masat përkatëse, Mbikëqyrësi Kryesor vendos një gjobë periodike për të detyruar ofruesin kritik të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut të përmbushë këto masa.

7. Gjoba periodike e parashikuar në pikën 6 vendoset mbi baza ditore, derisa të arrihet përputhshmëria, por jo më gjatë se gjashtë muaj nga njoftimi i vendimit tek ofruesi kritik i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, për vendosjen e gjobës periodike.

8. Shuma e gjobës periodike, e llogaritur nga data e përcaktuar në vendimin për vendosjen e saj, arrin deri në 1% të të ardhurave të përditshme mesatare në nivel botëror të ofruesit kritik të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut gjatë vitit të mëparshëm financiar. Gjatë përcaktimit të shumës së gjobës, Mbikëqyrësi Kryesor merr parasysh kriteret e mëposhtme:

a) rëndësinë dhe kohëzgjatjen e mospërputh-shmërisë;

b) nëse mospërputhshmëria është kryer me dashje ose nga pakujdesia;

c) nivelin e bashkëpunimit të ofruesit kritik të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut me Mbikëqyrësin Kryesor.

Për qëllimet e nënparagrafit të parë, për të siguruar qasje të qëndrueshme, Mbikëqyrësi Kryesor konsultohet me Rrjetin e Përbashkët të Mbikëqyrjes (*JON*).

9. Sipas parashikimeve të pikës 9 të nenit 35 të Rregullores (BE) 2022/2554, gjobat periodike kanë natyrë administrative dhe janë të ekzekutueshme. Ekzekutimi do të rregullohet sipas procedurave civile në territorin e Republikës së Shqipërisë, ku do të kryhen inspektimet dhe aksesi. Gjykata kompetente për shqyrtimin e ankimit lidhur me sjelljen e parregullt të ekzekutimit do të jetë gjykata e përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi në territorin e Republikës së Shqipërisë. Shumat e mbledhura nga gjobat do t'i alokohen buxhetit të përgjithshëm të Bashkimit Evropian.

10. Mbikëqyrësi Kryesor publikon çdo gjobë periodike që është vendosur, përveç rastit kur një publikim i tillë do të rrezikonte seriozisht tregjet financiare ose do t'u shkaktonte dëm jo proporcional palëve të përfshira.

11. Para vendosjes së një gjobe periodike sipas të nenit 35(6) të Rregullores (BE) 2022/2554, Mbikëqyrësi Kryesor u jep përfaqësuesve të ofruesit kritik të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut që i nënshtrohet procedurës, mundësinë për t'u dëgjuar lidhur me gjetjet dhe bazon vendimin e tij vetëm mbi gjetjet për të cilat ofruesi ka pasur mundësi të japë komente.

12. Të drejtat e mbrojtjes së palëve që i nënshtrohen procedurës, respektohen plotësisht gjatë procesit. Ofruesi kritik i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut ka të drejtë të ketë akses në dosje, duke respektuar interesin legjitim të palëve të tjera për mbrojtjen e sekreteve tregtare të tyre. E drejta e aksesit në dosje nuk shtrihet mbi informacionin konfidencial ose dokumentet e brendshme përgatitore të Mbikëqyrësit Kryesor.

Neni 65

Ushtrimi i kompetencave të Mbikëqyrësit Kryesor *(Lead Overseer)* jashtë Bashkimit Evropian

1. Kur objektivat e mbikëqyrjes nuk mund të arrihen me anë të ndërveprimit me filialin e krijuar për qëllime të nenit 31(12) të Rregullores (BE) 2022/2554, ose nëpërmjet ushtrimit të aktiviteteve të mbikëqyrjes në ambiente të vendosura brenda Bashkimit Evropian, Mbikëqyrësi Kryesor mund të ushtrojë kompetencat e përcaktuara në dispozitat e mëposhtme, në çdo ambient të vendosur në Republikën e Shqipërisë që është në pronësi ose përdoret për ofrimin e shërbimeve ndaj subjekteve financiare të Bashkimit Evropian, nga një ofrues kritik i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, lidhur me veprimtarinë e tij tregtare, funksionet ose shërbimet, përfshirë çdo zyrë administrative, tregtare ose operacionale, ndërtesa, tokë, objekte apo prona të tjera:

a) në nenin 35(1), shkronja "a", të Rregullores (BE) 2022/2554; dhe

b) në nenin 35(1), shkronja "b", të Rregullores (BE) 2022/2554, në përputhje me nenin 38(2), shkronjat "a", "b" dhe "d", dhe në nenin 39(1) dhe (2), shkronja "a", të Rregullores (BE) 2022/2554.

2. Kompetencat e parashikuara në nënparagrafin e parë të nenit 36(1) të Rregullores (BE) 2022/2554, mund të ushtrohen duke iu nënshtruar të gjitha kushteve të mëposhtme:

i. kryerja e inspektimit në Republikën e Shqipërisë konsiderohet e nevojshme nga Mbikëqyrësi Kryesor për t'i lejuar atij të kryejë plotësisht dhe me efektivitet detyrat e tij sipas Rregullores (BE) 2022/2554;

ii. inspektimi në Republikën e Shqipërisë lidhet drejtpërdrejt me ofrimin e shërbimeve të TIK-ut për subjektet financiare në Bashkimin Evropian;

iii. ofruesi kritik përkatës i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut jep pëlqimin për kryerjen e një inspektimi në ambientet e tij, të vendosura në Republikën e Shqipërisë; dhe

iv. Banka e Shqipërisë është njoftuar zyrtarisht nga Mbikëqyrësi Kryesor dhe nuk ka ngritur asnjë kundërshtim ndaj tij.

3. Pa cenuar kompetencat e institucioneve përkatëse të Bashkimit Evropian dhe të shteteve anëtare, për qëllimet e pikës 1 të Rregullores (BE) 2022/2554, EBA-ja lidh marrëveshje administrative bashkëpunimi me Bankën e Shqipërisë për të mundësuar inspektime në Republikën e Shqipërisë nga Mbikëqyrësi Kryesor dhe ekipi i caktuar prej tij për misionin e tij në Republikën e Shqipërisë. Marrëveshja e bashkëpunimit nuk krijon detyrime ligjore lidhur me Bashkimin Evropian dhe shtetet e tij anëtare dhe as nuk pengon shtetet anëtare dhe autoritetet e tyre përgjegjëse të lidhin marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe me Bankën e Shqipërisë.

Marrëveshja e bashkëpunimit specifikon të paktën elementet e mëposhtme:

a) procedurat për koordinimin e aktiviteteve të mbikëqyrjes të kryera sipas Rregullores (BE) 2022/2554 dhe çdo monitorim analog të rrezikut të TIK-ut nga palët e treta në sektorin financiar të kryer nga Banka e Shqipërisë, përfshirë detajet për transmetimin e dakordësisë së saj, për të lejuar kryerjen nga Mbikëqyrësi Kryesor dhe ekipi i caktuar prej tij, të hetimeve të përgjithshme dhe inspektimeve në vend, siç referohet në pikën 1, nënparagrafi i parë i shkronjës b të nenit 36 të Rregullores (BE) 2022/2554, në territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) mekanizmin për transmetimin e çdo informacioni ndërmjet EBA-së dhe Bankës së Shqipërisë, veçanërisht lidhur me informacionin që mund të kërkohet nga Mbikëqyrësi Kryesor në zbatim të nenit 37 të Rregullores (BE) 2022/2554;

c) mekanizmat për njoftim të menjëhershëm nga Banka e Shqipërisë tek EBA-ja, të rasteve kur një ofrues i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut i themeluar në Republikën e Shqipërisë dhe i përcaktuar si kritik në përputhje me nenin 31(1), shkronja "a", të Rregullores (BE) 2022/2554, konsiderohet se ka shkelur detyrimet ligjore sipas ligjeve të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë gjatë ofrimit të shërbimeve për institucionet financiare atje, si dhe për masat korrigjuese dhe sanksionet e zbatuara;

d) transmetimin periodik të përditësimeve mbi zhvillimet rregullatore ose mbikëqyrëse lidhur me monitorimin e rrezikut të TIK-ut nga palët e treta, për institucionet financiare në Republikën e Shqipërisë;

e) detajet lidhur me autorizimin e pjesëmarrjes, sipas rastit, të një përfaqësuesi të Bankës së Shqipërisë në inspektimet e kryera nga Mbikëqyrësi Kryesor dhe ekipi i autorizuar.

4. Kur Mbikëqyrësi Kryesor nuk është në gjendje të kryejë aktivitete mbikëqyrjeje jashtë Bashkimit Evropian, të parashikuara në pikat 1 dhe 2 të nenit 36 të Rregullores (BE) 2022/2554, Mbikëqyrësi Kryesor:

a) ushtron kompetencat e tij sipas nenit 35 të Rregullores (BE) 2022/2554, duke u bazuar në të gjitha faktet dhe dokumentet që disponon;

b) dokumenton dhe shpjegon çdo pasojë që rrjedh nga pamundësia për të zhvilluar aktivitetet e mbikëqyrjes sipas nenit 36 të Rregullores (BE) 2022/2554.

5. Në hartimin e rekomandimeve të Mbikëqyrësit Kryesor, të nxjerra në bazë të nenit 35(1), shkronja "d", të Rregullores (BE) 2022/2554, do të merren në konsideratë pasojat e mundshme të përmendura në shkronjën "b" të pikës 4 të këtij neni.

Neni 66

Kërkesa për informacion

1. Mbikëqyrësi Kryesor, me kërkesë ose me vendim, mund të kërkojë nga ofruesit kritikë të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, t'i vënë në dispozicion të gjitha informacionet e nevojshme për ushtrimin e detyrave, në bazë të Rregullores (BE) 2022/2554, përfshirë dokumentet tregtare ose operacionale, kontratat, politikat, dokumentacionin teknik, raportet e auditimit të sigurisë së TIK-ut, raportet e incidenteve të lidhura me TIK-un, si dhe çdo informacion që lidhet me palët ndaj të cilave ofruesi kritik i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut ka nënkontraktuar funksione operacionale ose aktivitete.

2. Kur Mbikëqyrësi Kryesor bën kërkesë për informacion sipas pikës 1 të nenit 37 të Rregullores (BE) 2022/2554, ai:

a) referon nenin 37 të Rregullores (BE) 2022/2554, si bazë ligjore të kërkesës;

b) deklaron qëllimin e kërkesës;

c) specifikon se çfarë informacioni kërkohet;

d) vendos një afat kohor brenda të cilit duhet të ofrohet informacioni;

e) informon përfaqësuesin e ofruesit kritik të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut nga i cili kërkohet informacioni, se nuk është i detyruar të ofrojë informacionin, por në rast se përgjigjet në mënyrë vullnetare ndaj kërkesës, informacioni i ofruar duhet të jetë i saktë dhe orientues.

3. Kur Mbikëqyrësi Kryesor kërkon me vendim dhënien e informacionit sipas pikës 1 të nenit 37 të Rregullores (BE) 2022/2554, ai:

a) referon nenin 37 të Rregullores (BE) 2022/2554, si bazë ligjore të kërkesës;

b) deklaron qëllimin e kërkesës;

c) specifikon se cili informacion kërkohet;

d) vendos një afat kohor brenda të cilit duhet të ofrohet informacioni;

e) tregon gjobat periodike të parashikuara në nenin 35(6) të Rregullores (BE) 2022/2554, në rast se informacioni i kërkuar është i paplotë ose kur ky informacion nuk ofrohet brenda afatit kohor të referuar në shkronjën "d";

f) tregon të drejtën për të ankimuar vendimin përpara Bordit të Apelimit të ESA *(ESA's Board of Appeal)* dhe për të kërkuar rishikimin e vendimit nga Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian *(Court of Justice),* në përputhje me nenet 60 dhe 61 të Rregulloreve (BE) nr. 1093/2010, (BE) nr. 1094/2010 dhe (BE) nr. 1095/2010.

4. Përfaqësuesit e ofruesve kritikë të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut do të japin informacionin e kërkuar. Avokatët e autorizuar mund të veprojnë në emër të klientëve të tyre për dorëzimin e informacionit. Ofruesi kritik i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut është plotësisht përgjegjës nëse informacioni i dhënë është i paplotë, i pasaktë ose çorientues.

5. Mbikëqyrësi Kryesor, pa vonesë, i transmeton një kopje të vendimit për dhënien e informacionit, Bankës së Shqipërisë, si autoritet përgjegjës i subjekteve financiare që përdorin shërbimet e ofruesve kritikë përkatës të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut dhe Rrjetit të Përbashkët të Mbikëqyrjes *(JON).*

Neni 67

Hetimet e përgjithshme

1. Për të ushtruar detyrat sipas Rregullores (BE) 2022/2554, Mbikëqyrësi Kryesor, i asistuar nga ekipi i përbashkët i inspektimit sipas nenit 40(1) të Rregullores (BE) 2022/2554, kur është e nevojshme, mund të zhvillojë hetime ndaj ofruesve kritikë të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut.

2. Mbikëqyrësi Kryesor, në përputhje me pikën 2 të nenit 38 të Rregullores (BE) 2022/2554, ka kompetencën për të:

a) inspektuar regjistra *(records),* të dhëna, procedura dhe çdo material tjetër të rëndësishëm për ushtrimin e detyrave të tij, pavarësisht nga forma ose mjeti në të cilin ruhen ato;

b) marrë ose siguruar kopje të certifikuara ose ekstrakte nga këta regjistra, të dhëna, procedura të dokumentuara dhe çdo material tjetër;

c) thirrur përfaqësues të ofruesit kritik të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, për të dhënë shpjegime me gojë ose me shkrim mbi fakte ose dokumente që lidhen me objektin dhe qëllimin e hetimit, si dhe për të regjistruar përgjigjet;

d) intervistuar çdo person fizik ose juridik që pranon të intervistohet, me qëllim mbledhjen e informacionit lidhur me objektin e hetimit;

e) kërkuar regjistrime të komunikimeve telefonike dhe qarkullimit të të dhënave.

3. Zyrtarët dhe personat e autorizuar nga Mbikëqyrësi Kryesor, me qëllim kryerjen e hetimit të parashikuar në pikën 1 të nenit 38 të Rregullores (BE) 2022/2554, do të ushtrojnë kompetencat e tyre pas paraqitjes së një autorizimi me shkrim që specifikon objektin dhe qëllimin e hetimit. Autorizimi duhet, gjithashtu, të përmbajë gjobat periodike të parashikuara në nenin 35(6) të Rregullores (BE) 2022/2554, në rast se dorëzimi i regjistrimeve të kërkuara, të dhënat, procedurat e dokumentuara ose çdo material tjetër, ose përgjigjet ndaj pyetjeve të bëra përfaqësuesve të ofruesit të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, nuk ofrohen ose janë të paplota.

4. Përfaqësuesit e ofruesve kritikë të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut janë të detyruar t'u nënshtrohen hetimeve në bazë të një vendimi të Mbikëqyrësit Kryesor. Vendimi specifikon objektin dhe qëllimin e hetimit, gjobat periodike të parashikuara në nenin 35(6) të Rregullores (BE) 2022/2554, mjetet juridike të disponueshme sipas

Rregulloreve (BE) nr. 1093/2010, (BE) nr. 1094/2010 dhe (BE) nr. 1095/2010, dhe të drejtën për të ankimuar vendimin pranë Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian (*Court of Justice*).

5. Përpara fillimit të hetimit, brenda një afati të arsyeshëm, Mbikëqyrësi Kryesor informon Bankën e Shqipërisë, si autoritet përgjegjës i subjekteve financiare që përdorin shërbimet e TIK-ut të ofruesit kritik të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, për hetimin e parashikuar dhe për identitetin e personave të autorizuar. Mbikëqyrësi Kryesor i komunikon Rrjetit të Përbashkët të Mbikëqyrjes (*JON*) të gjithë informacionin e transmetuar në përputhje me këtë pikë.

Neni 68
Inspektimet

1. Me qëllim përmbushjen e detyrave sipas Rregullores (BE) 2022/2554, Mbikëqyrësi Kryesor, i asistuar nga ekipet e përbashkëta të inspektimit të referuara në nenin 40(1) të Rregullores (BE) 2022/2554, kryen të gjitha inspektimet e nevojshme në vend, në çdo mjedis biznesi, tokë ose pronë të ofruesve të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, të tilla si zyrat qendrore, qendrat e operimit, mjediset dytësore, si dhe kryen inspektime në distancë *(off-site)*. Për qëllimet e ushtrimit të kompetencave të referuara në këtë pikë, Mbikëqyrësi Kryesor konsultohet edhe me Rrjetin e Përbashkët të Mbikëqyrjes (*JON).*

2. Zyrtarët dhe personat e autorizuar nga Mbikëqyrësi Kryesor për të kryer një inspektim në vend kanë kompetencën për të:

a) hyrë në çdo mjedis biznesi, tokë ose pronë; dhe

b) bllokuar çdo ambient biznesi, libër apo regjistër të tillë, për periudhën e inspektimit dhe në masën e nevojshme për kryerjen e tij. Zyrtarët dhe personat e tjerë të autorizuar nga Mbikëqyrësi Kryesor ushtrojnë kompetencat e tyre pas paraqitjes së një autorizimi me shkrim, në të cilin përcaktohen objekti dhe qëllimi i inspektimit, si dhe gjobat periodike të parashikuara në nenin 35(6) të Rregullores (BE) 2022/2554, në rast se përfaqësuesit e ofruesve kritikë të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut në fjalë, nuk i nënshtrohen inspektimit.

3. Përpara fillimit të inspektimit, Mbikëqyrësi Kryesor informon Bankën e Shqipërisë, si autoritet përgjegjës i subjekteve financiare që përdorin atë ofrues shërbimesh të palëve të treta të TIK-ut.

4. Objekti i inspektimeve shtrihet mbi të gjitha sistemet, rrjetet, pajisjet, informacionin dhe të dhënat përkatëse të TIK-ut, që përdoren për ose që kontribuojnë në ofrimin e shërbimeve të TIK-ut për subjektet financiare.

5. Para zhvillimit të çdo inspektimi të planifikuar në vend, Mbikëqyrësi Kryesor u jep ofruesve kritikë të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut një njoftim paraprak, përveç rasteve kur një njoftim i tillë nuk është i mundur për shkak të një situate emergjente ose krize, apo kur dhënia e tij do të ndikonte në efektivitetin e inspektimit ose auditimit.

6. Ofruesi kritik i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut iu nënshtrohet inspektimeve në vend me vendim të Mbikëqyrësit Kryesor. Vendimi specifikon objektin dhe qëllimin e inspektimit, cakton datën në të cilën do të fillojë inspektimi dhe tregon gjobat periodike të parashikuara në nenin 35(6) të Rregullores (BE) 2022/2554, mjetet juridike të disponueshme sipas Rregulloreve (BE) nr. 1093/2010, (BE) nr. 1094/2010 dhe (BE) nr. 1095/2010, si dhe të drejtën për rishikim të vendimit nga Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian.

7. Kur zyrtarët dhe personat e tjerë të autorizuar nga Mbikëqyrësi Kryesor konstatojnë se një ofrues kritik i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut kundërshton një inspektim të urdhëruar në zbatim të nenit 39 të Rregullores (BE) 2022/2554, Mbikëqyrësi Kryesor informon ofruesin kritik të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut për pasojat e kundërshtimit, përfshirë mundësinë që Banka e Shqipërisë, si autoritet përgjegjës i subjekteve financiare përkatëse, t'u kërkojë subjekteve financiare të zgjidhin marrëveshjet kontraktuale të lidhura me atë ofrues kritik të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut.

Neni 69
Mbikëqyrja e vazhdueshme

1. Gjatë kryerjes së aktiviteteve mbikëqyrëse, veçanërisht hetimeve të përgjithshme ose inspektimeve, Mbikëqyrësi Kryesor asistohet nga një ekip i përbashkët inspektimi *(joint examination team),* i cili krijohet për secilin ofrues kritik të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut.

2. Ekipi i përbashkët i inspektimit, i përmendur në pikën 1 të nenit 40 të Rregullores (BE) 2022/2554, përbëhet nga anëtarë të stafit të:

a) Autoriteteve Mbikëqyrëse Evropiane (ESA);

b) Bankës së Shqipërisë, si autoritet përgjegjës për mbikëqyrjen e subjekteve financiare, të cilave ofruesi kritik i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut u ofron shërbime të TIK-ut;

c) autoritetit kombëtar përgjegjës sipas nenit 32(4), shkronja "e", të Rregullores (BE) 2022/2554, mbi baza vullnetare;

d) një autoriteti kombëtar përgjegjës nga shteti anëtar, ku është themeluar ofruesi kritik i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, mbi baza vullnetare.

3. Anëtarët e ekipit të përbashkët të inspektimit kanë ekspertizë në çështjet e TIK-ut dhe në rrezikun operacional. Ekipi i përbashkët i inspektimit, do të punojnë nën koordinimin e një anëtari të caktuar të stafit të Mbikëqyrësit Kryesor (*the "Lead Overseer coordinator").*

4. Brenda 3 muajve nga përfundimi i një hetimi ose inspektimi, Mbikëqyrësi Kryesor, pas konsultimit me Forumin e Mbikëqyrjes, miraton rekomandime që do t'i drejtohen ofruesit kritik të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, në zbatim të kompetencave të parashikuara në nenin 35 të Rregullores (BE) 2022/2554.

5. Rekomandimet e parashikuara në pikën 4 i komunikohen menjëherë ofruesit kritik të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut dhe Bankës së Shqipërisë, si autoritet përgjegjës i subjekteve financiare të cilave ai u ofron shërbime të TIK-ut.

6. Me qëllim përmbushjen e aktiviteteve mbikëqyrëse, Mbikëqyrësi Kryesor mund të marrë në konsideratë çdo certifikim të palëve të treta ose raporte të auditimit të brendshëm ose të jashtëm të palëve të treta të TIK-ut, të vëna në dispozicion nga ky ofrues.

Neni 70

Ndjekja *(Follow-up)* nga Banka e Shqipërisë

1. Brenda 60 ditëve kalendarike nga marrja e rekomandimeve të dhëna nga Mbikëqyrësi Kryesor në përputhje me nenin 35(1), shkronja "d", të Rregullores (BE) 2022/2554, ofruesit kritikë të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut do të njoftojnë Mbikëqyrësin Kryesor për qëndrimin e tyre lidhur me ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve ose do të ofrojnë një shpjegim të arsyetuar për mosndjekjen e rekomandimeve. Mbikëqyrësi Kryesor ia transmeton këtë informacion menjëherë Bankës së Shqipërisë, si autoritet përgjegjës i subjekteve financiare në fjalë.

2. Mbikëqyrësi Kryesor publikon rastet kur një ofrues kritik i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut nuk njofton Mbikëqyrësin Kryesor në përputhje me pikën 1, ose kur shpjegimi i paraqitur nga ofruesi kritik i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut nuk konsiderohet i mjaftueshëm. Informacioni i publikuar duhet të përmbajë identitetin e ofruesit kritik të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, si dhe llojin dhe natyrën e mospërputhjes. Informacioni i publikuar duhet të kufizohet vetëm për sa është e nevojshme dhe proporcionale, për të siguruar transparencë publike, përveç rasteve kur një publikim i tillë do të shkaktonte dëme jo proporcionale për palët e përfshira, ose do të rrezikonte seriozisht funksionimin e rregullt dhe integritetin e tregjeve financiare, stabilitetin e pjesshëm ose të plotë të sistemit financiar të Bashkimit Evropian.

Mbikëqyrësi Kryesor njofton ofruesin e shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut për publikimin.

3. Banka e Shqipërisë informon subjektet financiare përkatëse për rreziqet e identifikuara në rekomandimet drejtuar ofruesve kritikë të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, në përputhje me nenin 35(1), shkronja "d", të Rregullores (BE) 2022/2554. Gjatë administrimit të rrezikut të TIK-ut nga palë të treta, subjektet financiare marrin parasysh rreziqet e referuara në këtë pikë.

4. Kur Banka e Shqipërisë vlerëson se një subjekt financiar nuk ka marrë parasysh ose ka trajtuar në mënyrë të pamjaftueshme rreziqet specifike të identifikuara në rekomandime dhe gjetje, në kuadër të administrimit të rrezikut të TIK-ut nga palë të treta, si dhe në mungesë të dispozitave kontraktuale që adresojnë këto rreziqe, ajo njofton subjektin financiar për mundësinë e marrjes së një vendimi, në përputhje me pikën 6, brenda 60 ditëve kalendarike nga marrja e njoftimit.

5. Pas marrjes së raporteve të parashikuara në nenin 35(1), shkronja "c", të Rregullores (BE) 2022/2554 dhe para marrjes së një vendimi siç parashikohet në pikën 6 të këtij neni, Banka e Shqipërisë, mbi baza vullnetare, mund të

konsultohet me autoritetet e caktuara në përputhje me ligjin "Për sigurinë kibernetike", si përgjegjëse për mbikëqyrjen e një subjekti thelbësor ose të rëndësishëm sipas përcaktimeve të atij ligji, që është përcaktuar si një ofrues kritik i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut.

6. Banka e Shqipërisë, si masë e fundit, pas njoftimit dhe konsultimit sipas pikave 4 dhe 5 të këtij neni, dhe në përputhje me nenin 50 të Rregullores (BE) 2022/2554, mund të vendosë që subjektet financiare të pezullojnë përkohësisht, pjesërisht ose plotësisht, përdorimin apo vendosjen e një shërbimi të ofruar nga një ofrues kritik i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, deri në adresimin e rreziqeve të identifikuara në rekomandimet përkatëse. Kur është e nevojshme, Banka e Shqipërisë mund të kërkojë, gjithashtu, zgjidhjen, pjesërisht ose plotësisht, të marrëveshjeve kontraktuale përkatëse me këta ofrues.

7. Kur një ofrues kritik i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, refuzon të zbatojë rekomandimet e Mbikëqyrësit Kryesor, duke ndjekur një qasje që mund të ketë ndikim negativ mbi një numër të madh subjektesh financiare ose mbi një pjesë të konsiderueshme të sektorit financiar, dhe paralajmërimet individuale të Bankës së Shqipërisë, si autoritet përgjegjës i subjekteve, nuk rezultojnë efektive për zbutjen e rrezikut të mundshëm ndaj stabilitetit financiar, Mbikëqyrësi Kryesor, pas konsultimit me Forumin e Mbikëqyrjes, mund të japë opinione jodetyruese dhe jopublike për Bankën e Shqipërisë, me qëllim promovimin e masave të qëndrueshme dhe konverguese mbikëqyrëse.

8. Pas marrjes së raporteve sipas nenit 35(1), shkronja "c", të Rregullores (BE) 2022/2554, Banka e Shqipërisë, kur merr një vendim siç parashikohet në pikën 6 të këtij neni, merr në konsideratë llojin dhe madhësinë e rrezikut që nuk është adresuar nga ofruesi kritik i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, si dhe seriozitetin e mospërputhjes, duke pasur parasysh kriteret e mëposhtme:

a) rëndësia dhe kohëzgjatja e mospërputhjes;

b) nëse mospërputhja ka zbuluar dobësi serioze në procedurat, sistemet e menaxhimit, administrimin e rrezikut dhe kontrollet e brendshme të ofruesit kritik të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut;

c) nëse mospërputhja ka kontribuuar, ka shkaktuar ose ka krijuar lehtësi për kryerjen e një krimi financiar;

d) nëse mospërputhja ka qenë e qëllimshme ose nga pakujdesia;

e) nëse pezullimi ose zgjidhja e marrëveshjeve kontraktuale krijon rrezik për vazhdimësinë e veprimtarisë së biznesit të subjektit financiar, pavarësisht përpjekjeve të subjektit financiar për të shmangur ndërprerjet në ofrimin e shërbimeve të tij;

f) kur është e zbatueshme, opinionin vullnetar të autoriteteve të caktuara në përputhje me ligjin "Për sigurinë kibernetike", si përgjegjëse për mbikëqyrjen e një subjekti thelbësor ose të rëndësishëm sipas përcaktimeve të atij ligji, që është caktuar si ofrues kritik i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, siç parashikohet në pikën 5 të këtij neni.

Banka e Shqipërisë i jep subjekteve financiare kohën e nevojshme për të rishikuar marrëveshjet me ofruesit kritikë të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, me qëllim shmangien e efekteve në qëndrueshmërinë e tyre operacionale digjitale dhe duke mundësuar vendosjen e strategjive dalëse *(exit strategies)* dhe planeve të tranzicionit, sipas nenit 45 të kësaj rregulloreje.

9. Vendimi i parashikuar në pikën 6 të këtij neni, u njoftohet anëtarëve të Forumit të Mbikëqyrjes të referuar në nenin 32(4), shkronjat "a", "b" dhe "c" të Rregullores (BE) 2022/2554, dhe Rrjetit të Përbashkët të Mbikëqyrjes (*JON).* Ofruesit kritikë të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut që preken nga vendimi bashkëpunojnë plotësisht me subjektet financiare të prekura, për pezullimin ose zgjidhjen e marrëveshjeve kontraktuale.

10. Banka e Shqipërisë informon rregullisht Mbikëqyrësin Kryesor mbi qasjet dhe masat e marra në detyrat e saj mbikëqyrëse, lidhur me subjektet financiare si dhe mbi marrëveshjet kontraktuale të lidhura nga subjektet financiare ku ofruesit kritikë të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, nuk kanë mbështetur pjesërisht ose plotësisht rekomandimet e drejtuara atyre nga Mbikëqyrësi Kryesor.

11. Mbikëqyrësi Kryesor, sipas kërkesës, mund të ofrojë sqarime të mëtejshme mbi rekomandimet e dhëna, për të udhëzuar Bankën e Shqipërisë mbi masat e mëtejshme për ndjekjen e tyre.

Neni 71

Tarifat e mbikëqyrjes

1. Mbikëqyrësi Kryesor, në përputhje me aktin e deleguar të parashikuar në pikën 2 të nenit 43 të Rregullores (BE) 2022/2554, tarifon ofruesit kritikë

të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut. Këto tarifa mbulojnë plotësisht shpenzimet e nevojshme të Mbikëqyrësit Kryesor lidhur me kryerjen e detyrave mbikëqyrëse në zbatim të Rregullores (BE) 2022/2554, përfshirë rimbursimin e çdo kostoje që mund të shkaktohet si rezultat i punës së kryer nga ekipi i përbashkët i inspektimit parashikuar në nenin 40 të Rregullores (BE) 2022/2554, si dhe kostot e këshillimeve të ofruara nga ekspertët e pavarur siç parashikohet në nenin 32(4), nënparagrafi i dytë, të Rregullores (BE) 2022/2554, lidhur me çështjet që bien nën kompetencën e aktiviteteve të drejtpërdrejta të mbikëqyrjes.

2. Shuma e tarifës së ngarkuar ndaj një ofruesi kritik të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut do të mbulojë të gjitha kostot që rrjedhin nga ekzekutimi i detyrave të përcaktuara në seksionin II të kreut V të Rregullores (BE) 2022/2554, si dhe do të jetë proporcionale me xhiron e tij.

NËNKREU II
KUADRI I MBIKËQYRJES PËR OFRUESIT KRITIKË TË SHËRBIMEVE TË PALËVE TË TRETA TË TIK-ut NGA BANKA E SHQIPËRISË

Neni 72
Përcaktimi i ofruesve kritikë të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut nga Banka e Shqipërisë

1. Banka e Shqipërisë përcakton ofruesit e shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut që konsiderohen kritikë për subjektet financiare, pas një vlerësimi që merr në konsideratë kriteret e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni.

2. Përcaktimi i parashikuar në pikën 1 të këtij neni, bazohet në të gjitha kriteret e mëposhtme, në lidhje me shërbimet e TIK-ut të ofruara nga ofruesi i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut:

a) ndikimi sistemik mbi stabilitetin, vazhdimësinë ose cilësinë e ofrimit të shërbimeve financiare, në rast se ofruesi përkatës i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut do të përballej me një dështim operacional në shkallë të gjerë, duke marrë parasysh numrin e subjekteve financiare dhe vlerën totale të aktiveve të subjekteve financiare që përdorin shërbimet e këtij ofruesi;

b) karakteri ose rëndësia sistemike e subjekteve financiare që mbështeten tek ofruesi përkatës i shërbimeve të TIK-ut, e vlerësuar në përputhje me parametrat e mëposhtëm:

i. numri i institucioneve të kreditit me rëndësi sistemike që mbështeten tek ofruesi përkatës i shërbimeve të TIK-ut;

ii. shkalla e ndërvarësisë midis institucioneve të përmendura në nënpikën "i" dhe subjekteve të tjera financiare;

c) varësia e subjekteve financiare nga shërbimet e ofruara nga ofruesi përkatës i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, në lidhje me funksione kritike ose të rëndësishme, përfshirë rastet kur këto funksione mbështeten tek i njëjti ofrues i shërbimeve të TIK-ut, pavarësisht nëse kjo varësi është e drejtpërdrejtë apo e tërthortë, nëpërmjet marrëveshjeve të nënkontraktimit;

d) shkalla e zëvendësueshmërisë së ofruesit të shërbimeve të TIK-ut, duke marrë në konsideratë kriteret e mëposhtme:

i. mungesa e alternativave reale, qoftë edhe të pjesshme, për shkak të numrit të kufizuar të ofruesve aktivë në një treg të caktuar, pjesës së tregut që zotëron ofruesi përkatës, ose kompleksitetit teknik apo nivelit të sofistikimit, përfshirë në lidhje me çdo teknologji pronësore, si dhe veçoritë specifike të organizimit apo aktivitetit të ofruesit të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut;

ii. vështirësitë në migrimin pjesor ose të plotë të të dhënave dhe ngarkesave përkatëse nga ofruesi ekzistues te një tjetër, për shkak të kostove financiare të konsiderueshme, kohës ose burimeve të tjera të nevojshme, apo për shkak të rrezikut të shtuar të TIK-ut ose rreziqeve të tjera operacionale që mund të lindin gjatë këtij procesi të migrimit.

3. Në rastet kur ofruesi i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut i përket një grupi, kriteret e përmendura në pikën 2 të këtij neni merren në konsideratë në lidhje me shërbimet e TIK-ut të ofruara nga grupi në tërësi.

4. Ofruesit kritikë të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut që janë pjesë e një grupi, caktojnë një person juridik si pikë koordinimi për të siguruar përfaqësimin dhe komunikimin e duhur me Bankën e Shqipërisë.

5. Përcaktimi i përmendur në pikën 1 të këtij neni nuk zbatohet për:

a) subjektet financiare që ofrojnë shërbime të TIK-ut për subjekte të tjera financiare;

b) ofruesit e shërbimeve të TIK-ut brenda grupit.

Neni 73
Kompetencat e Bankës së Shqipërisë për mbikëqyrjen e ofruesve kritikë të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut të përcaktuar sipas nenit 72 të kësaj rregulloreje

Në përmbushje të detyrimeve të parashikuara në këtë nënkre, Banka e Shqipërisë ka të drejtë:

a) të kërkojë informacion periodik teknik dhe operacional nga ofruesit kritikë të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, përfshirë strukturën organizative, planet e reagimit ndaj incidenteve, kontratat e nënkontraktimit dhe zinxhirët e varësisë;

b) të kryejë vlerësime dhe inspektime në vend *(on site)* ose në distance *(off site),* në hapësirat, sistemet dhe dokumentacionin e ofruesve kritikë;

c) të japë rekomandime ose urdhra mbikëqyrës me afate detyruese për zbatim, kur konstatohen mangësi ose rreziqe serioze;

d) të vendosë një mekanizëm formal ndjekjeje të përmbushjes së këtyre rekomandimeve nga ana e ofruesit kritik të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, duke përfshirë plane masash dhe verifikim progresi;

e) të kërkojë kufizimin ose ndërprerjen e marrëveshjeve me një ofrues kritik të shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, në rast të vazhdimit të shkeljeve, pengimit të mbikëqyrjes ose rrezikimit të qëndrueshmërisë operacionale digjitale të sektorit financiar;

f) të kërkojë që ofruesi kritik i shërbimeve të palëve të treta të TIK-ut, me seli jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të caktojë një përfaqësues ligjor në Shqipëri ose të pranojë shprehimisht juridiksionin e Bankës së Shqipërisë, si kusht për të ofruar shërbime ndaj subjekteve financiare të mbikëqyrura prej saj.

KREU VIII
TË TJERA

Neni 74
Masat mbikëqyrëse dhe ndëshkimore

Banka e Shqipërisë, në rast të mosplotësimit të kërkesave të kësaj rregulloreje, zbaton masat mbikëqyrëse dhe/ose ndëshkimore të parashikuara në ligjin "Për bankat" dhe në ligjin "Për shërbimet e pagesave".

Neni 75
Hyrja në fuqi dhe zbatimi i rregullores

1. Kjo rregullore hyn në fuqi në datë 1 janar 2028.

2. Dispozitat e nenit 2, pikat 3 dhe 4; nenit 30, pikat 13 deri në 15 dhe pikat 17 deri në 19; nenit 38, pika 2; neneve 60 deri në 64 dhe neneve 66 deri në 71 të kësaj rregulloreje, nuk zbatohen dhe nuk prodhojnë efekte juridike deri në datën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Duke filluar nga kjo datë, këto dispozita zbatohen nëpërmjet rregullores (BE) 2022/2554 të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit "Për qëndrueshmërinë operacionale digjitale të sektorit financiar".

3. Subjektet e rregullores, deri në datën 1 janar 2028, marrin masa për plotësimin e kërkesave të rregullores dhe raportojnë në Bankën e Shqipërisë çdo 3 muaj për këto masa të marra prej tyre, duke filluar nga data 1 janar 2027.

4. Kjo rregullore do të qëndrojë në fuqi deri në datën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Neni 76
Shfuqizime

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet udhëzimi "Për raportimin e incidenteve madhore", miratuar me vendimin nr. 10, datë 7.2.2024, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Neni 77
Nxjerrja e standardeve rregullatore teknike për plotësimin e kuadrit të qëndrueshmërisë operacionale digjitale

Banka e Shqipërisë, me qëllim plotësimin e mëtejshëm të kuadrit për qëndrueshmërinë operacionale digjitale, nxjerr standarde rregullatore teknike në plotësim të kërkesave të kësaj rregulloreje.

Neni 78
Dispozitë e fundit

Anekset bashkëlidhur kësaj rregulloreje janë pjesë përbërëse e saj.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Gent Sejko

ANEKSI 1
FORMULARËT E RAPORTIMIT TË INCIDENTEVE MADHORE

Numri i fushës	Fusha e të dhënave	
Informacion i përgjithshëm mbi subjektin financiar		
1.1	Lloji i raportimit	
1.2	Emri i subjektit raportues	
1.3	Kodi i identifikimit të subjektit raportues	
1.4	Lloji i subjektit financiar të prekur nga incidenti	
1.5	Emri i subjektit financiar të prekur nga incidenti	
1.6	Kodi NUIS/LEI i subjektit financiar të prekur nga incidenti	
1.7	Emri i personit kryesor të kontaktit	
1.8	Posta elektronike e personit kryesor të kontaktit	
1.9	Numri i telefonit të personit kryesor të kontaktit	
1.10	Emri i personit dytësor të kontaktit	
1.11	Posta elektronike e personit dytësor të kontaktit	
1.12	Numri i telefonit të personit dytësor të kontaktit	
1.13	Emri i shoqërisë mëmë	
1.14	Kodi NUIS/LEI i shoqërisë mëmë	
1.15	Monedha raportuese	
Përmbajtja e njoftimit fillestar mbi incidentin madhor të lidhur me TIK-un		
2.1	Kodi i referencës së incidentit, i caktuar nga subjekti financiar	
2.2	Data dhe ora e zbulimit të incidentit madhor të lidhur me TIK-un	
2.3	Data dhe ora e klasifikimit të incidentit të lidhur me TIK-un si madhor	
2.4	Përshkrimi i incidentit madhor të lidhur me TIK-un	
2.5	Kriteri i klasifikimit që shkaktoi raportimin e incidentit	
2.6	Kufijtë e materialitetit për kriterin e klasifikimit "Shtrirja gjeografike"	
2.7	Zbulimi i incidentit madhor të lidhur me TIK	
2.8	Informacion nëse incidenti madhor i lidhur me TIK-un e ka origjinën nga një ofrues shërbimi i palëve të treta ose nga një subjekt tjetër financiar	
2.9	Aktivizimi i planit të vazhdimësisë së biznesit, nëse aktivizohet	
2.10	Informacione të tjera në lidhje me incidentin	
Përmbajtja e raportit të ndërmjetëm		
3.1	Kodi i referencës së incidentit i caktuar nga Banka e Shqipërisë	
3.2	Data dhe ora e ndodhjes së incidentit madhor të lidhur me TIK-un	
3.3	Data dhe ora kur shërbimet, aktivitetet ose operacionet u rikuperuan nga subjekti	
3.4	Numri i klientëve të prekur nga incidenti	
3.5	Përqindja e klientëve të prekur nga incidenti	
3.6	Numri i kundërpartive financiare të prekura nga incidenti	
3.7	Përqindja e kundërpartive financiare të prekura nga incidenti	
3.8	Ndikimi në klientët ose kundërpartitë financiare përkatëse	
3.9	Numri i transaksioneve të prekura nga incidenti	
3.10	Përqindja e transaksioneve të prekura nga incidenti	
3.11	Vlera e transaksioneve të prekura nga incidenti	
3.12	Informacion nëse vlerat janë reale, vlerësime, apo nëse nuk ka pasur ende ndonjë ndikim	
3.13	Ndikimi reputacional	
3.14	Informacion kontekstual mbi ndikimin reputacional	
3.15	Kohëzgjatja e incidentit madhor të lidhur me TIK-un	
3.16	Kohëzgjatja e ndërprerjes së shërbimeve	
3.17	Informacion nëse të dhënat për kohëzgjatjen e incidentit dhe kohëzgjatjen e ndërprerjes së shërbimeve janë reale apo vlerësime	
3.18	Llojet e ndikimit në shtete të tjera	
3.19	Përshkrim se si incidenti madhor i lidhur me TIK-un ka ndikim në shtete të tjera	
3.20	Kufiri i materialitetit për kriterin "Humbjet e të dhënave"	
3.21	Përshkrim i humbjes së të dhënave	
3.22	Kriteret e klasifikimit për "Shërbimet kritike të prekura"	
3.23	Llojet e incidenteve madhore të lidhura me TIK-un	
3.24	Lloje të tjera incidentesh	
3.25	Kërcënimet dhe teknikat e përdorura nga aktorët e kërcënimeve	
3.26	Lloje të tjera teknikash	
3.27	Informacion rreth zonave funksionale dhe proceseve të biznesit të prekura	
3.28	Komponentët e infrastrukturës së prekur që mbështesin proceset e biznesit	

3.29	Informacion mbi komponentët e infrastrukturës së prekur që mbështesin proceset e biznesit	
3.30	Ndikimi në interesat financiarë të klientëve	
3.31	Raportimi tek autoritete të tjera	
3.32	Specifikimi i autoriteteve "të tjera"	
3.33	Veprime/masa të përkohshme të ndërmarra apo të planifikuara për t'u ndërmarrë, për rikuperim nga incidenti	
3.34	Përshkrim i veprimeve/masave të përkohshme të ndërmarra apo të planifikuara për t'u ndërmarrë, për rikuperim nga incidenti	
3.35	Treguesit e kompromentimit	
Përmbajtja e raportit përfundimtar		
4.1	Klasifikimi në nivel të lartë i shkaqeve bazë të incidentit	
4.2	Klasifikim i detajuar i shkaqeve bazë të incidentit	
4.3	Klasifikim shtesë mbi shkaqet bazë të incidentit	
4.4	Lloje të tjera të shkaqeve bazë	
4.5	Informacione mbi shkaqet bazë të incidentit	
4.6	Përmbledhje e zgjidhjes së incidentit	
4.7	Data dhe ora kur shkaku bazë i incidentit u adresua	
4.8	Data dhe ora kur incidenti u zgjidh	
4.9	Informacion nëse data e zgjidhjes përfundimtare të incidentit ndryshon nga data fillestare e planifikuar për implementim	
4.10	Vlerësimi i rrezikut në funksionet me rëndësi kritike për qëllime të ndërhyrjes së jashtëzakonshme	
4.11	Informacion i vlefshëm për autoritetin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme	
4.12	Kufijtë e materialitetit për klasifikimin e kriterit "Ndikimi ekonomik"	
4.13	Shuma e humbjeve dhe kostove bruto direkte dhe indirekte	
4.14	Shuma e rikuperuar	
4.15	Informacion nëse incidentet madhore kanë qenë të përsëritura	
4.16	Data dhe ora e ndodhjes së incidenteve të përsëritura	

ANEKSI 2
UDHËZIME MBI PLOTËSIMIN E FORMULARËVE TË RAPORTIMIT TË INCIDENTEVE MADHORE

Fusha e të dhënave	Përshkrimi	I detyrueshëm për njoftimin fillestar?	I detyrueshëm për raportimin e ndërmjetëm?	I detyrueshëm për raportimin përfundimtar?	Lloji i fushës
Informacion i përgjithshëm mbi subjektin financiar					
1.1 Lloji i raportimit	Tregoni llojin e njoftimit ose raportit të incidentit që po dorëzohet te Banka e Shqipërisë.	Po	Po	Po	Opsione: - Njoftim fillestar; - Raport i ndërmjetëm; - Raport përfundimtar; - Incident madhor i riklasifikuar si jomadhor
1.2 Emri i subjektit raportues	Emri i plotë ligjor i subjektit raportues.	Po	Po	Po	Alfanumerik
1.3 Kodi i identifikimit të subjektit raportues	Kodi identifikimit të subjektit raportues Nëse njoftimin/raportimin e bën subjekti financiar, kodi i identifikimit duhet të jetë NUIS ose Identifikuesi Ligjor i Subjektit (LEI), i cili është një kod unik alfanumerik prej 20 karakteresh i bazuar në standardet ISO 17442-1:2020. Një ofrues i shërbimeve të palëve të treta që raporton për një subjekt financiar, mund të përdorë një kod identifikimi të specifikuar sipas standardeve teknike të parashikuara në kuadrin nënligjor të Bankës së Shqipërisë, për regjistrin e informacionit në lidhje me marrëveshjet kontraktuale për përdorimin e shërbimeve të TIK-ut, të parashikuara në nenin 45 të kësaj rregulloreje.	Po	Po	Po	Alfanumerik
1.4 Lloji i subjektit financiar të prekur nga incidenti	Lloji i subjektit të parashikuar në pikën 1 të nenit 2 të kësaj rregulloreje, për të cilin paraqitet raportimi. Në rastet e raportimit të agreguar sipas nenit 38 të kësaj rregulloreje, duhet të përzgjidhen të	Po	Po	Po	Opsionet (mund të zgjidhen disa opsione): - institucionet e kreditit; - institucionet e pagesave; - institucionet e pagesave që

	gjitha llojet e subjekteve financiare të mbuluara nga raportimi i agreguar.				përjashtohen sipas ligjit "Për shërbimet e pagesave"; - ofruesit e shërbimit të informimit të llogarisë; - institucionet e parasë elektronike; - institucionet e parasë elektronike që përjashtohen sipas ligjit "Për shërbimet e pagesave"; - emetuesit e tokenave të aseteve dhe emetuesit e tokenave të parasë elektronike.
1.5 Emri i subjektit financiar të prekur nga incidenti	Emri i plotë ligjor i subjektit financiar të prekur nga incidenti madhor i lidhur me TIK-un dhe që kërkohet të raportojë incidentin madhor te Banka e Shqipërisë, sipas nenit 30 të kësaj rregulloreje. Në rast të raportimit të agreguar: a)një listë të të gjithë emrave të subjekteve financiare të prekur nga incidentet madhore të lidhur me TIK-un, duke i ndarë me pikëpresje; b)ofruesin e shërbimeve të palëve të treta që njofton ose raporton për një incident madhor në mënyrë të agreguar, sipas nenit 38 të kësaj rregulloreje, duke listuar emrat e subjekteve financiare të prekura nga incidenti (të ndara me pikëpresje).	Po, nëse subjekti financiar i prekur nga incidenti është i ndryshëm nga subjekti që raporton dhe në rast të një raportimi të agreguar	Po, nëse subjekti financiar i prekur nga incidenti është i ndryshëm nga subjekti që raporton dhe në rast të një raportimi të agreguar	Po, nëse subjekti financiar i prekur nga incidenti është i ndryshëm nga subjekti që raporton dhe në rast të një raportimi të agreguar	Alfanumerik
1.6 Kodi NUIS/LEI i subjektit financiar të prekur nga incidenti	Kodi NUIS ose Identifikuesi Ligjor i Subjektit (LEI) të prekur nga incidenti madhor i lidhur me TIK-un, i caktuar në përputhje me Organizatën Ndërkombëtare të Standardizimit. Në rastin e raportimeve të agreguara: a) një listë me të gjitha kodet NUIS/LEI të subjekteve financiare të prekura nga incidentet madhore të lidhur me TIK-un, të ndara me pikëpresje; b) ofruesi i shërbimeve të palëve të treta që njofton ose raporton për një incident madhor në mënyrë të agreguar, sipas nenit 38 të kësaj rregulloreje, duke listuar emrat e subjekteve financiare të prekur nga incidenti (të ndara me pikëpresje). Renditja e kodeve dhe emrave të subjekteve financiare duhet të jetë e njëjtë.	Po, nëse subjekti financiar i prekur nga incidenti madhor është i ndryshëm nga subjekti që raporton dhe në rast të një raportimi të agreguar	Po, nëse subjekti financiar i prekur nga incidenti madhor është i ndryshëm nga subjekti që raporton dhe në rast të një raportimi të agreguar	Po, nëse subjekti financiar i prekur nga incidenti madhor është i ndryshëm nga subjekti që raporton dhe në rast të një raportimi të agreguar	Kod unik alfanumerik prej 20 karakteresh i bazuar në standardet ISO 17442-1:2020.
1.7 Emri i personit kryesor të kontaktit	Emri dhe mbiemri i personit kryesor të kontaktit të subjektit financiar. Në rastin e raportimit të agreguar sipas nenit 38 të kësaj rregulloreje, emri i personit kryesor të kontaktit që paraqet raportimin e agreguar.	Po	Po	Po	Alfanumerik
1.8 Adresa e postës elektronike të personit kryesor të kontaktit	Adresa e postës elektronike të personit kryesor të kontaktit që mund të përdoret nga Banka e Shqipërisë për të ndjekur komunikimin. Në rastin e raportimit të agreguar sipas nenit 38 të kësaj rregulloreje, adresa e postës elektronike të personit kryesor të kontaktit që paraqet raportimin e agreguar.	Po	Po	Po	Alfanumerik
1.9 Numri i telefonit të personit kryesor të kontaktit	Numri i telefonit të personit kryesor të kontaktit që mund të përdoret nga Banka e Shqipërisë për të ndjekur komunikimin. Në rastin e raportimit të agreguar sipas nenit 38 të kësaj rregulloreje, numri i telefonit të personit kryesor të kontaktit që paraqet raportimin e agreguar. Numri i telefonit që raportohet duhet të jetë i formatit si p.sh. +3556XXXXXXXX (përfshirë edhe prefiksin e shtetit përkatës).	Po	Po	Po	Alfanumerik
1.10 Emri i personit dytësor të kontaktit	Emri dhe mbiemri i personit dytësor të kontaktit, ose emri i grupit përgjegjës të subjektit financiar, ose subjektit që paraqet raportin në emër të subjektit financiar.	Po	Po	Po	Alfanumerik

1.11 Adresa e postës elektronike të personit dytësor të kontaktit	Adresa e postës elektronike të personit dytësor të kontaktit ose një adresë funksionale e grupit përgjegjës, që mund të përdoret nga Banka e Shqipërisë për të ndjekur komunikimin.	Po	Po	Po	Alfanumerik
1.12 Numri i telefonit të personit dytësor të kontaktit	Numri i telefonit të personit dytësor të kontaktit ose grupit përgjegjës, që mund të përdoret nga Banka e Shqipërisë për të ndjekur komunikimin. Numri i telefonit që raportohet duhet të jetë i formatit si p.sh. +3556XXXXXXXX (përfshirë edhe prefiksin e shtetit përkatës).	Po	Po	Po	Alfanumerik
1.13 Emri i shoqërisë mëmë	Emri i shoqërisë mëmë fundore të grupit, të cilit i përket subjekti financiar i prekur nga incidenti, nëse është e aplikueshme.	Po, nëse subjekti financiar i përket një grupi	Po, nëse subjekti financiar i përket një grupi	Po, nëse subjekti financiar i përket një grupi	Alfanumerik
1.14 Kodi NUIS/LEI i shoqërisë mëmë	Kodi NUIS ose LEI i shoqërisë mëmë fundore të grupit, të cilit i përket subjekti financiar i prekur nga incidenti, nëse është e aplikueshme. Kodi caktohet në përputhje me Organizatën Ndërkombëtare të Standardizimit.	Po, nëse subjekti financiar i përket një grupi	Po, nëse subjekti financiar i përket një grupi	Po, nëse subjekti financiar i përket një grupi	Kod unik alfanumerik prej 20 karakteresh i bazuar në standardet ISO 17442-1:2020.
1.15 Monedha raportuese	Monedha e përdorur për raportimin e incidentit.	Po	Po	Po	Opsionet plotësohen duke përdorur kodet e monedhave ISO 4217.
Përmbajtja e njoftimit fillestar mbi incidentin madhor të lidhur me TIK					
2.1 Kodi i referencës së incidentit, i caktuar nga subjekti financiar	Kodi unik i referencës i caktuar nga subjekti financiar, për të identifikuar incidentet madhore të lidhur me TIK-un. Në rastin e raportimit të agreguar sipas nenit 38 të kësaj rregulloreje, kodi i referencës së incidentit, i caktuar ofruesi i shërbimeve të palëve të treta.	Po	Po	Po	Alfanumerik
2.2. Data dhe ora e zbulimit të incidentit madhor të lidhur me TIK	Data dhe ora kur subjekti financiar vihet në dijeni të incidentit të lidhur me TIK-un. Në rastet e incidenteve të përsëritura, data dhe ora kur u zbulua incidenti më i fundit i lidhur me TIK-un.	Po	Po	Po	Standardi ISO 8601 (VVVV-MM-DD Ora: minutat: sekondat)
2.3 Data dhe ora e klasifikimit të incidentit të lidhur me TIK-un si madhor	Data dhe ora kur incidenti i lidhur me TIK-un u klasifikua si incident madhor, sipas kritereve të klasifikimit të parashikuara në këtë rregullore.	Po	Po	Po	Alfanumerik
2.4 Përshkrimi i incidentit madhor të lidhur me TIK	Përshkrimi i aspekteve më relevante të incidentit madhor të lidhur me TIK-un. Subjektet financiare duhet të ofrojnë një përmbledhje të nivelit të lartë të informacionit të mëposhtëm, si për shembull mbi shkaqet e mundshme, ndikimet e menjëhershme, sistemet e prekura dhe të tjera. Subjektet financiare duhet të përfshijnë, kur dihet ose pritet në mënyrë të arsyeshme që incidenti të ndikojë tek ofruesit e shërbimeve të palëve të treta ose te subjektet e tjera financiare, llojin e ofruesit ose subjektit financiar, emrin e tyre, kodet e tyre përkatëse të identifikimit dhe llojin e kodit të identifikimit (p.sh. LEI ose NUIS). Në raportet pasuese, përmbajtja e fushës mund të ndryshojë me kalimin e kohës për të pasqyruar të kuptuarin e vazhdueshëm të incidentit të lidhur me TIK-un dhe për të përshkruar çdo informacion tjetër relevant në lidhje me incidentin e lidhur me TIK-un, që nuk është përfshirë në fushat e të dhënave, duke përfshirë vlerësimin e brendshëm të ashpërsisë nga subjekti financiar (p.sh. shumë e ulët, e ulët, mesatare, e lartë, shumë e lartë) dhe një tregues të nivelit dhe emrit të strukturave më të larta vendimmarrëse, që janë përfshirë në përgjigje të incidentit të lidhur me TIK-un.	Po	Po	Po	Standardi ISO 8601 (VVVV-MM-DD Ora: minutat: sekondat)
2.5 Kriteri i klasifikimit që shkaktoi	Kriteret e klasifikimit sipas kësaj rregulloreje, që kanë përcaktuar incidentin e lidhur me TIK-	Po	Po	Po	Zgjedhje (e shumëfishtë):

raportimin e incidentit	un si madhor dhe kanë shkaktuar më pas njoftimin dhe raportimin. Në rastin e raportimit të agreguar sipas nenit 38 të kësaj rregulloreje, kriteret e klasifikimit që kanë përcaktuar incidentin e lidhur me TIK-un si madhor, për të paktën një ose më shumë subjekte financiare.				- klientët, kundërpartitë financiare dhe transaksionet e prekura; - ndikimi reputacional; - kohëzgjatja e incidentit dhe kohëzgjatja e ndërprerjes së shërbimeve; - shtrirja gjeografike; - humbja e të dhënave; - shërbimet kritike të prekura; - ndikimi ekonomik.
2.6 Kufijtë e materialitetit për kriterin e klasifikimit "Shtrirja gjeografike"	Shtetet e tjera të prekura nga incidenti madhor i lidhur me TIK-un. Kur vlerësojnë ndikimin e incidentit madhor në shtete të tjera, subjektet financiare duhet të marrin në konsiderate nenin 23 të kësaj rregulloreje.	Po, nëse është arritur kufiri i shtrirjes gjeografike	Po, nëse është arritur kufiri i shtrirjes gjeografike	Po, nëse është arritur kufiri i shtrirjes gjeografike	Zgjedhje e shumëfishtë duke përdorur ISO 3166 ALPHA -2 për shtetet e prekura.
2.7 Zbulimi i incidentit madhor të lidhur me TIK	Tregohet se si u zbulua incidenti madhor i lidhur me TIK-un.	Po	Po	Po	Opsione: - siguria e teknologjisë së informacionit; - stafi; - auditi i brendshëm; - auditi i jashtëm; - klientët; - kundërpartitë financiare; - ofruesit e shërbimeve të palëve të treta; - sulmuesit; - sistemet e monitorimit; - autoritetet/agjencitë/ organet ligjzbatuese; - të tjera.
2.8 Informacion nëse incidenti madhor i lidhur me TIK-un e ka origjinën nga një ofrues shërbimi i palëve të treta ose nga një subjekt tjetër financiar	Tregues nëse incidenti madhor i lidhur me TIK-un e ka origjinën nga një ofrues shërbimi i palëve të treta ose nga një subjekt tjetër. Subjektet financiare duhet të tregojnë nëse incidentet madhore të lidhur me TIK-un e kanë origjinën nga një ofrues shërbimi i palëve të treta ose nga një subjekt tjetër (duke përfshirë subjektet që i përkasin të njëjtit grup të subjektit raportues), si dhe emrin, kodin e identifikimit të ofruesit të shërbimit të palëve të treta ose subjektit financiar dhe llojin e kodit të identifikimit (p.sh. LEI apo NUIS).	Po, nëse incidenti e ka origjinën nga një ofrues shërbimi i palëve të treta ose nga një subjekt tjetër financiar	Po, nëse incidenti e ka origjinën nga një ofrues shërbimi i palëve të treta ose nga një subjekt tjetër financiar	Po, nëse incidenti e ka origjinën nga një ofrues shërbimi i palëve të treta ose nga një subjekt tjetër financiar	Alfanumerik
2.9 Aktivizimi i planit të vazhdimësisë së biznesit, nëse aktivizohet	Tregues nëse ka pasur një aktivizim formal të planit të vazhdimësisë së biznesit nga subjekti financiar.	Po	Po	Po	Po/ Jo
2.10 Informacione të tjera në lidhje me incidentin	Informacione të tjera jo të përfshira në këtë formular. Subjektet financiare që kanë riklasifikuar një incident madhor të lidhur me TIK-un, si incident jomadhor, duhet të përshkruajnë arsyet përse ky incident nuk i përmbush dhe nuk pritet më t'i përmbushë kriteret për t'u klasifikuar si një incident madhor i lidhur me TIK-un.	Po, nëse ka informacione të tjera jo të përfshira në këtë formular ose incidenti madhor i lidhur me TIK-un është riklasifikuar si incident jomadhor.	Po, nëse ka informacione të tjera jo të përfshira në këtë formular ose incidenti madhor i lidhur me TIK-un është riklasifikuar si incident jomadhor.	Po, nëse ka informacione të tjera jo të përfshira në këtë formular ose incidenti madhor i lidhur me TIK-un është riklasifikuar si incident jomadhor.	Alfanumerike
Përmbajtja e raportit të ndërmjetëm					
3.1 Kodi i referencës së incidentit i caktuar nga Banka e Shqipërisë	Kodi i referencës së incidentit i caktuar nga Banka e Shqipërisë, në kohën kur është marrë njoftimi fillestar, për të identifikuar në mënyrë të pangatërrueshme incidentin madhor të lidhur me TIK-un.	Jo	Po, nëse aplikohet	Po, nëse aplikohet	Alfanumerik
3.2 Data dhe ora e ndodhjes së incidentit madhor të lidhur me TIK	Data dhe ora kur ka ndodhur incidenti madhor i lidhur me TIK-un, nëse është e ndryshme nga ora kur subjekti financiar është vënë në dijeni të incidentit. Në rastet e incidenteve të përsëritura, data dhe ora kur u zbulua incidenti më i fundit i lidhur me TIK-un.	Jo	Po	Po	Standardi ISO 8601 (VVVV-MM-DD Ora: minutat:sekondat)

3.3 Data dhe ora kur shërbimet, aktivitetet ose operacionet u rikuperuan nga subjekti	Informacion mbi datën dhe orën e rikuperimit të shërbimeve, aktiviteteve apo operacioneve të prekura nga incidenti madhor i lidhur me TIK-un.	Jo	Po, nëse është plotësuar fusha 3.16 "Kohëzgjatja e ndërprerjes së shërbimeve"	Po, nëse është plotësuar fusha 3.16 "Kohëzgjatja e ndërprerjes së shërbimeve"	Standardi ISO 8601 (VVVV-MM-DD Ora: minutat:sekondat)
3.4 Numri i klientëve të prekur nga incidenti	Numri i klientëve të prekur nga incidenti madhor i lidhur me TIK-un që përdorin shërbimin e ofruar nga subjekti financiar Kur vlerësojnë numrin e klientëve të prekur, subjektet financiare duhet të kenë parasysh nenin 20, pika 1, dhe nenin 28, pika 1, shkronja "b", të kësaj rregulloreje. Një subjekt financiar që nuk mund të përcaktojë numrin real të klientëve të prekur, duhet të përdorë vlerësimet bazuar në të dhënat e disponueshme nga periudha të krahasueshme reference. Në rastin e raportimit të agreguar sipas nenit 38 të kësaj rregulloreje, numri total i klientëve të prekur në të gjitha subjektet financiare.	Jo	Po	Po	Numër i plotë
3.5 Përqindja e klientëve të prekur nga incidenti	Përqindja e klientëve të prekur nga incidenti madhor i lidhur me TIK-un, në raport me numrin total të klientëve që përdorin shërbimin e prekur nga incidenti, të ofruar nga subjekti financiar. Në rastet kur incidenti ka prekur më shumë se një shërbim, shërbimet do të paraqiten në mënyrë të përmbledhur. Gjatë vlerësimit, subjektet financiare duhet të kenë parasysh nenin 20, pika 1, dhe nenin 28, pika 1, shkronja "a", të kësaj rregulloreje. Një subjekt financiar që nuk mund të përcaktojë përqindjen reale të klientëve të prekur, duhet të përdorë vlerësimet bazuar në të dhënat e disponueshme nga periudha të krahasueshme reference. Në rastin e raportimit të agreguar sipas nenit 38 të kësaj rregulloreje, një subjekt financiar duhet të pjesëtojë numrin total të të gjithë klientëve të prekur nga incidenti, me numrin e përgjithshëm të klientëve të të gjitha subjekteve financiare.	Jo	Po	Po	Shprehur si përqindje – çdo vlerë deri në 5 karaktere numerike, deri në 1 shifër dhjetore, e shprehur si përqindje (p.sh. 2,4 në vend të 2,4 %). Nëse vlera ka më shumë se 1 shifër pas presjes dhjetore, subjektet raportuese do ta rrumbullakosin në vlerën gjysmë lart.
3.6 Numri i kundërpartive financiare të prekura nga incidenti	Numri i kundërpartive financiare të prekura nga incidenti madhor i lidhur me TIK-un, që kanë një kontratë me subjektin financiar. Kur vlerësojnë kundërpartive financiare të prekura nga incidenti, subjektet financiare duhet të kenë parasysh nenin 20, pika 2, të kësaj rregulloreje. Një subjekt financiar që nuk mund të përcaktojë numrin real të kundërpartive financiare të prekura nga incidenti, duhet të përdorë vlerësimet, bazuar në të dhënat e disponueshme nga periudha të krahasueshme reference. Në rastin e raportimit të agreguar sipas nenit 38 të kësaj rregulloreje, numri total i kundërpartive financiare të prekura nga incidenti, në të gjitha subjektet financiare.	Jo	Po	Po	Numër i plotë
3.7 Përqindja e kundërpartive financiare të prekura nga incidenti	Përqindja e kundërpartive financiare të prekura nga incidenti madhor i lidhur me TIK-un, në raport me numrin total të kundërpartive financiare që kanë një kontratë me subjektin financiar. Gjatë vlerësimit të përqindjes së kundërpartive financiare të prekura nga incidenti madhor i lidhur me TIK-un, subjektet financiare duhet të kenë parasysh nenin 20, pika 1, dhe nenin 28, pika 1, shkronja "c", të kësaj rregulloreje. Një subjekt financiar që nuk mund të përcaktojë përqindjen reale të kundërpartive financiare të prekura nga incidenti, duhet të përdorë vlerësimet, bazuar në të dhënat e disponueshme nga periudha të krahasueshme reference. Në rastin e raportimit të agreguar sipas nenit 38	Jo	Po	Po	Shprehur si përqindje – çdo vlerë deri në 5 karaktere numerike, deri në 1 shifër dhjetore, e shprehur si përqindje (p.sh. 2,4 në vend të 2,4 %). Nëse vlera ka më shumë se 1 shifër pas presjes dhjetore, subjektet raportuese do ta rrumbullakosin në vlerën gjysmë lart.

	të kësaj rregulloreje, një subjekt financiar duhet të pjesëtojë numrin total të të gjitha kundërpartive financiare të prekura nga incidenti, me numrin e përgjithshëm të kundërpartive financiare të të gjitha subjekteve financiare.				
3.8 Ndikimi në klientët ose kundërpartitë financiare përkatëse	Çdo ndikim te klientët ose kundërpartitë financiare, siç referohet në nenin 20, pika 3, dhe nenin 28, pika 1, shkronja "f", të kësaj rregulloreje.	Jo	Po, nëse është arritur kufiri i treguesit "Rëndësia e klientëve dhe kundërpartive financiare"	Po, nëse është arritur kufiri i treguesit "Rëndësia e klientëve dhe kundërpartive financiare"	Po/Jo
3.9 Numri i transaksioneve të prekura nga incidenti	Numri i transaksioneve të prekura nga incidenti madhor i lidhur me TIK-un. Kur vlerësohet ndikimi në transaksione, subjektet financiare duhet të marrin parasysh nenin 20, pika 4, të kësaj rregulloreje, duke përfshirë të gjitha transaksionet e prekura vendase ose ndërkufitare, që përfshijnë një shumë monetare, ku të paktën një pjesë e transaksionit kryhet në Shqipëri. Një subjekt financiar që nuk mund të përcaktojë numrin real të transaksioneve të prekura nga incidenti, duhet të përdorë vlerësimet, bazuar në të dhënat e disponueshme nga periudha të krahasueshme reference. Në rastin e raportimit të agreguar sipas nenit 38 të kësaj rregulloreje, një subjekt financiar duhet të paraqesë numrin total të të gjitha transaksioneve të prekura nga incidenti, në të gjitha subjektet financiare.	Jo	Po, nëse transaksionet janë prekur nga incidenti	Po, nëse transaksionet janë prekur nga incidenti	Numër i plotë
3.10 Përqindja e transaksioneve të prekura nga incidenti	Përqindja e transaksioneve të prekura në raport me numrin mesatar ditor të transaksioneve vendase dhe ndërkufitare të kryera nga subjekti financiar në lidhje me shërbimin e prekur. Subjektet financiare duhet të marrin parasysh kërkesat e nenit 20, pika 4, dhe nenit 28, pika 1, shkronja "d", të kësaj rregulloreje. Një subjekt financiar që nuk mund të përcaktojë përqindjen reale të transaksioneve të prekura nga incidenti, duhet të përdorë vlerësimet. Në rastin e raportimit të agreguar sipas nenit 38 të kësaj rregulloreje, një subjekt financiar duhet të pjesëtojë numrin total të të gjitha transaksioneve të prekura nga incidenti, me numrin total të transaksioneve të të gjitha subjekteve financiare të prekura.	Jo	Po, nëse transaksionet janë prekur nga incidenti	Po, nëse transaksionet janë prekur nga incidenti	Shprehur si përqindje – çdo vlerë deri në 5 karaktere numerike, deri në 1 shifër dhjetore, e shprehur si përqindje (p.sh. 2,4 në vend të 2,4 %). Nëse vlera ka më shumë se 1 shifër pas presjes dhjetore, subjektet raportuese do ta rrumbullakosin në vlerën gjysmë lart.
3.11 Vlera e transaksioneve të prekura nga incidenti	Vlera totale e transaksioneve të prekura nga incidenti madhor i lidhur me TIK-un vlerësohet në përputhje me nenin 20, pika 4, dhe nenin 28, pika 1, shkronja "e", të kësaj rregulloreje. Një subjekt financiar që nuk mund të përcaktojë vlerën reale të transaksioneve të prekura nga incidenti, duhet të përdorë vlerësimet, bazuar në të dhënat e disponueshme nga periudha të krahasueshme reference. Një subjekt financiar raporton shumën monetare si vlerë pozitive. Në rastin e raportimit të agreguar sipas nenit 38 të kësaj rregulloreje, një subjekt financiar duhet të paraqesë vlerën totale të transaksioneve të prekura nga incidenti, në të gjitha subjektet financiare.	Jo	Po, nëse transaksionet janë prekur nga incidenti	Po, nëse transaksionet janë prekur nga incidenti	Monetare Subjektet financiare duhet të raportojnë shifrat në mijë njësi (p.sh. 2,5 në vend të 2 500).
3.12 Informacion nëse vlerat janë reale, vlerësime, apo nëse nuk ka	Informacion nëse vlerat e raportuara në fushat e të dhënave 3.4 deri në 3.11 janë reale ose vlerësime, ose nëse nuk ka pasur ende ndonjë ndikim.	Jo	Po	Po	Zgjedhje e shumëfishtë: -Shifra reale për klientët e prekur nga incidenti;

pasur ende ndonjë ndikim					-Shifra reale për kundërpartitë financiare të prekura nga incidenti; -Shifra reale për transaksionet e prekura nga incidenti; -Vlerësime për klientët e prekur nga incidenti; -Vlerësime për kundërpartitë financiare të prekura nga incidenti; -Vlerësime për transaksionet e prekura nga incidenti; -Pa ndikim te klientët; -Pa ndikim te kundërpartitë financiare; -Pa ndikim te transaksionet.
3.13 Ndikimi reputacional	Informacion në lidhje me ndikimin reputacional që rezulton nga incidenti madhor i lidhur me TIK-un, siç parashikohet në nenin 21 dhe nenin 29 të kësaj rregulloreje. Në rastin e raportimit të agreguar sipas nenit 38 të kësaj rregulloreje, kategoritë e ndikimit reputacional që zbatohen për të paktën një subjekt financiar.	Jo	Po, nëse plotësohet kriteri "Ndikimi reputacional"	Po, nëse plotësohet kriteri "Ndikimi reputacional"	Zgjedhje e shumëfishtë: -incidenti madhor i lidhur me TIK-un është pasqyruar në media; -incidenti madhor i lidhur me TIK-un ka rezultuar në ankesa të përsëritura nga klientë të ndryshëm ose kundërpartitë financiare, për shërbimet që përballen me klientët ose marrëdhëniet kritike të biznesit; -subjekti financiar nuk do të jetë në gjendje ose ka të ngjarë të mos jetë në gjendje të përmbushë kërkesat rregullatore si rezultat i incidentit madhor të lidhur me TIK-un; -subjekti financiar do të humbasë ose ka të ngjarë të humbasë klientët ose kundërpartitë financiare, me një ndikim material në biznesin e tij, si rezultat i incidentit madhor të lidhur me TIK-un.
3.14 Informacion kontekstual mbi ndikimin reputacional	Informacion që përshkruan se si incidenti madhor i lidhur me TIK-un ka ndikuar ose mund të ndikojë në reputacionin e subjektit financiar, duke përfshirë shkeljet e ligjit, mospërmbushjen e kërkesave rregullative, numrin e ankesave të klientëve dhe të tjera. Informacioni duhet të përfshijë llojin e mediave (p.sh. media tradicionale dhe digjitale, bloget, platforma transmetimi) dhe mbulimin mediatik, duke përfshirë shtrirjen e mediave (lokale, kombëtare, ndërkombëtare). Mbulimi mediatik në këtë kontekst nuk nënkupton vetëm disa komente negative nga ndjekësit ose përdoruesit e rrjeteve sociale. Subjekti financiar, gjithashtu, do të tregojë nëse mbulimi mediatik nxori në pah rreziqe të rëndësishme për klientët e tij në lidhje me incidentin madhor të lidhur me TIK-un, duke përfshirë rrezikun e falimentimit të subjektit financiar ose rrezikun e humbjes së fondeve. Subjektet financiare, gjithashtu, tregojnë nëse kanë dhënë informacion për mediat që kanë shërbyer për të informuar në mënyrë të besueshme publikun për incidentit madhor të lidhur me TIK-un dhe pasojat e tij. Subjektet financiare, gjithashtu, mund të tregojnë nëse ka pasur informacion të rremë në media në lidhje me incidentin e lidhur me TIK-un, duke përfshirë informacione të bazuara në disinformimit të qëllimshëm të përhapur nga aktorët e kërcënimit, ose informacione në lidhje	Jo	Po, nëse plotësohet kriteri "Ndikimi reputacional"	Po, nëse plotësohet kriteri "Ndikimi reputacional"	Alfanumerik

	me ose ilustrimin e shpërfytyrimit të faqes së internetit të subjektit financiar.				
3.15 Kohëzgjatja e incidentit madhor të lidhur me TIK	Subjektet financiare do të matin kohëzgjatjen e incidentit madhor të lidhur me TIK-un, nga momenti kur ndodhi incidenti, deri në momentin e zgjidhjes së tij. Subjektet financiare që nuk janë në gjendje të përcaktojnë momentin kur ka ndodhur incidenti madhor i lidhur me TIK-un, do të matin kohëzgjatjen e incidentit duke filluar nga momenti më i hershëm midis kohës së zbulimit të incidentit dhe kohës kur subjekti financiar e regjistroi incidentin në regjistrat e rrjetit ose sistemit ose burime të tjera të të dhënave. Subjektet financiare që nuk e dinë ende momentin kur do të zgjidhet incidenti madhor i lidhur me TIK-un, duhet të aplikojnë vlerësime. Vlera do të shprehet në ditë, orë dhe minuta. Në rastin e raportimit të agreguar sipas nenit 38 të kësaj rregulloreje, subjektet financiare matin kohëzgjatjen më të gjatë të incidentit madhor të lidhur me TIK-un, në rast të diferencave në kohëzgjatjen e incidentit midis subjekteve të ndryshme financiare.	Jo	Po	Po	Ditë: Orë: Minuta
3.16 Kohëzgjatja e ndërprerjes së shërbimeve	Kohëzgjatja e ndërprerjes së shërbimeve e matur nga momenti kur shërbimi është plotësisht ose pjesërisht i padisponueshëm për klientët, kundërpartitë financiare ose përdoruesit e tjerë të brendshëm ose të jashtëm, deri në momentin kur aktivitetet ose operacionet e rregullta janë rikthyer në nivelin e shërbimit që ofrohej para ndodhjes së incidentit madhor të lidhur me TIK-un. Kur ndërprerja e shërbimeve shkakton një vonesë në ofrimin e shërbimit pas rikuperimit të aktiviteteve ose operacioneve të rregullta, subjektet financiare do të matin kohën e ndërprerjes së shërbimeve që nga fillimi i incidentit madhor të lidhur me TIK-un, deri në momentin kur fillon të ofrohet ai shërbim i vonuar. Subjektet financiare që nuk janë në gjendje të përcaktojnë momentin kur ka filluar ndërprerja e shërbimit, do të matin kohën e ndërprerjes së shërbimit që nga momenti më i hershëm midis zbulimit të incidentit dhe momentit kur incidenti është regjistruar. Në rastin e raportimit të agreguar sipas nenit 38 të kësaj rregulloreje, subjektet financiare matin kohëzgjatjen më të gjatë të incidentit madhor të lidhur me TIK-un, në rast të diferencave në kohëzgjatjen e incidentit midis subjekteve të ndryshme financiare.	Jo	Po, nëse incidenti ka shkaktuar një ndërprerje të shërbimeve	Po, nëse incidenti ka shkaktuar një ndërprerje të shërbimeve	Ditë: Orë: Minuta
3.17 Informacion nëse të dhënat për kohëzgjatjen e incidentit dhe kohëzgjatjen e ndërprerjes së shërbimeve janë reale apo vlerësime	Informacion nëse vlerat e raportuara në fushat e të dhënave 3.15 dhe 3.16 janë reale apo vlerësime.	Jo	Po, nëse plotësohet kriteri "Kohëzgjatja dhe kohëzgjatja e ndërprerjes së shërbimeve"	Po, nëse plotësohet kriteri "Kohëzgjatja dhe kohëzgjatja e ndërprerjes së shërbimeve"	Opsionet: - Shifra reale; - Vlerësime; - Shifra reale dhe vlerësime; - Nuk ka informacion në dispozicion.
3.18 Llojet e ndikimit në shtete të tjera	Lloji i ndikimit në shtetet e tjera. Tregues nëse incidenti madhor i lidhur me TIK-un ka pasur ndikim në shtete të tjera (përveç Shqipërisë), në përputhje me nenin 23 të kësaj rregulloreje, dhe në veçanti në lidhje me rëndësinë e ndikimit në lidhje me: a)klientët dhe kundërpartitë financiare të prekur në shtete të tjera; b)degët ose subjektet e tjera financiare të grupit, që kryejnë veprimtari në shtete të tjera; ose c)infrastrukturat e tregut financiar ose ofruesit e palëve të treta, të cilët mund të prekin	Jo	Po, nëse përmbushet kufiri i kriterit "Shtrirja gjeografike"	Po, nëse përmbushet kufiri i kriterit "Shtrirja gjeografike"	Zgjedhja (e shumëfishtë): - klientët; - kundërpartitë financiare; - degë të subjektit financiar; - subjekte financiare brenda grupit, që kryejnë veprimtari në shtete të tjera; - infrastrukturë e tregut financiar; - ofrues shërbimi palë të treta që janë të përbashkëta me subjekte të tjera financiare.

	subjektet financiare në shtete të tjera, ku ofrojnë shërbime.				
3.19 Përshkrim se si incidenti madhor i lidhur me TIK-un ka ndikim në shtete të tjera	Përshkrimi i ndikimit dhe ashpërsisë së incidentit madhor të lidhur me TIK-un, në secilin vend të prekur, duke përfshirë një vlerësim të ndikimit dhe ashpërsisë mbi: a) klientët; b) kundërpartitë financiare; c) degët e subjektit financiar; d) subjekte të tjera financiare brenda grupit që ushtrojnë veprimtari në shtetin tjetër; e) infrastrukturat e tregut financiar; f) ofrues të palëve të treta që mund të jenë të përbashkët për subjekte të tjera financiare.	Jo	Po, nëse përmbushet kufiri i kriterit "Shtrirja gjeografike"	Po, nëse përmbushet kufiri i kriterit "Shtrirja gjeografike"	Alfanumerik
3.20 Kufiri i materialitetit për kriterin "Humbjet e të dhënave"	Lloji i humbjeve të të dhënave që përfshin incidenti madhor i lidhur me TIK-un, përsa i përket disponueshmërisë, autenticitetin, integritetin dhe konfidencialitetin e të dhënave. Subjektet financiare marrin parasysh gjatë vlerësimit edhe parashikimet e nenit 24 të kësaj rregulloreje. Në rastin e raportimit të agreguar sipas nenit 38 të kësaj rregulloreje, humbjet e të dhënave që prekin të paktën një subjekt financiar.	Jo	Po, nëse plotësohet kriteri "Humbjet e të dhënave"	Po, nëse plotësohet kriteri "Humbjet e të dhënave"	Zgjedhja (e shumëfishtë): - disponueshmëria; - autenticiteti; - integriteti; - konfidencialiteti.
3.21 Përshkrim i humbjes së të dhënave	Përshkrimi i ndikimit të incidentit madhor të lidhur me TIK-un, në disponueshmërinë, autenticitetin, integritetin dhe konfidencialitetin e të dhënave kritike në përputhje me nenin 24 të kësaj rregulloreje. Informacion mbi ndikimin në zbatimin e objektivave të biznesit të subjektit financiar ose në përmbushjen e kërkesave rregullatore. Si pjesë e informacionit të dhënë, subjektet financiare duhet të tregojnë nëse të dhënat e prekura janë të dhëna të klientit, të dhëna të subjekteve të tjera (p.sh. kundërpartive financiare) ose të dhëna të vetë subjektit financiar. Subjekti financiar, gjithashtu, mund të tregojë llojin e të dhënave të përfshira në incident – në veçanti, nëse të dhënat janë konfidenciale dhe çfarë lloj konfidencialiteti është përfshirë (p.sh. konfidencialiteti tregtar/biznesi, të dhënat personale, sekret profesional: sekret bankar, sekreti i sigurimeve, sekreti i shërbimeve të pagesave etj.). Informacioni mund të përfshijë, gjithashtu, rreziqe të mundshme që lidhen me humbjet e të dhënave, të tilla si nëse të dhënat e prekura nga incidenti mund të përdoren për të identifikuar individët dhe që mund të përdoren nga aktori i kërcënimit për të marrë kredi pa pëlqimin e tyre, për të kryer sulme *phishing*, për të zbuluar informacion publikisht. Në rastin e raportimit të agreguar sipas nenit 38 të kësaj rregulloreje, paraqitet një përshkrim i përgjithshëm i ndikimit të incidentit në subjektet financiare të prekura. Kur ka dallime të ndikimit, përshkrimi i ndikimit tregon qartë ndikimin specifik në subjektet e ndryshme financiare.	Jo	Po, nëse plotësohet kriteri "Humbjet e të dhënave"	Po, nëse plotësohet kriteri "Humbjet e të dhënave"	Alfanumerik
3.22 Kriteret e klasifikimit për "Shërbimet kritike të prekura"	Informacion në lidhje me kriterin "Shërbime kritike të prekura nga incidenti". Subjektet financiare do të marrin parasysh nenin 25 të kësaj rregulloreje në vlerësimin e tyre, duke përfshirë informacionin rreth: -shërbimeve ose veprimtarive të prekura që kërkojnë licencim, regjistrim ose që mbikëqyren nga Banka e Shqipërisë; ose -shërbimet e TIK-ut ose rrjetet dhe sistemet e informacionit që mbështesin funksionet kritike ose të rëndësishme të subjektit financiar; dhe -natyrën e aksesit me qëllime keqdashëse dhe të paautorizuar në rrjetin dhe sistemet e	Jo	Po	Po	Alfanumerik

	informacionit të subjektit financiar. Në rastin e raportimit të agreguar sipas nenit 38 të kësaj rregulloreje, ndikimi në shërbimet kritike që zbatohet për të paktën një subjekt financiar.				
3.23 Llojet e incidenteve madhore të lidhur me TIK	Klasifikimi i incidentit sipas llojit.	Jo	Po	Po	Zgjedhja (e shumëfishtë): -i lidhur me sigurinë kibernetike; -dështim i proceseve; -dështim i sistemeve; -ngjarje e jashtme; -i lidhur me pagesat; -të tjera (specifiko).
3.24 Lloje të tjera incidentesh	Lloje të tjera të incidenteve të lidhur me TIK: subjektet financiare që kanë zgjedhur opsionin "Të tjera" në fushën 3.23, duhet të specifikojnë dhe tipin e incidentit të lidhur me TIK-un që ka ndodhur.	Jo	Po, nëse është zgjedhur opsioni "Të tjera" në fushën 3.23	Po, nëse është zgjedhur opsioni "Të tjera" në fushën 3.23	Alfanumerik
3.25 Kërcënimet dhe teknikat e përdorura nga aktorët e kërcënimeve	Tregoni kërcënimet dhe teknikat e përdorura nga aktori i kërcënimit, duke përfshirë: a) inxhinieri sociale, përfshirë edhe *phishing*; b) sulm i shpërndarë/sulm i mohimit të shërbimit (D/DoS); c) vjedhje e identitetit; d) enkriptim i të dhënave për ndikim, duke përfshirë *ransomware*; e) rrëmbim i burimeve; f) nxjerrje dhe manipulim i të dhënave, duke përjashtuar vjedhjen e identitetit; g) shkatërrim i të dhënave; h) deformim; i) sulm i zinxhirit të furnizimit; j) të tjera (specifikoni).	Jo	Po, nëse lloji i incidentit të lidhur me TIK-un është "i lidhur me sigurinë kibernetike" në fushën 3.23	Po, nëse lloji i incidentit të lidhur me TIK-un është "i lidhur me sigurinë kibernetike" në fushën 3.23	Zgjedhja (e shumëfishtë): -inxhinieri sociale, përfshirë edhe *phishing*; -sulm i shpërndarë/sulm i mohimit të shërbimit (D/DoS); -vjedhje e identitetit; -enkriptim i të dhënave për ndikim, duke përfshirë *ransomware*; -rrëmbim i burimeve; -nxjerrje dhe manipulim i të dhënave, duke përjashtuar vjedhjen e identitetit; -shkatërrim i të dhënave; -deformim; -sulm i zinxhirit të furnizimit; -të tjera (specifikoni).
3.26 Lloje të tjera teknikash	Lloje të tjera teknikash Subjektet financiare që kanë zgjedhur opsionin "të tjera" në fushën e të dhënave 3.25 duhet të specifikojnë llojin e teknikës.	Jo	Po, nëse është zgjedhur opsioni "të tjera" në fushën e të dhënave 3.25	Po, nëse është zgjedhur opsioni "të tjera" në fushën e të dhënave 3.25	Alfanumerik
3.27 Informacion rreth zonave funksionale dhe proceseve të biznesit të prekura	Tregues të zonave funksionale dhe proceseve të biznesit që janë prekur nga incidenti, përfshirë produktet dhe shërbimet. Fushat funksionale përfshijnë, por nuk janë të kufizuara në: a)marketing dhe zhvillim biznesi; b)shërbimi i klientit; c)menaxhimi produktit; d)përputhshmëria me kuadrin rregullativ; e)administrim i rrezikut; f)financë dhe kontabilitet; g)burimet njerëzore dhe shërbime të përgjithshme; h)teknologjia e informacionit. Proceset e biznesit përfshijnë, por nuk janë të kufizuar në: -informimi i llogarisë; -pranimi i transaksioneve të pagesave; -autentifikimi/autorizimi; -blerja dhe shitja e paketave të policave të sigurimit ndërmjet siguracioneve; -pagesat me karta; -administrimi i *cash*-it; -depozitimi ose tërheqja e parave; -klerimi;	Jo	Po	Po	Alfanumerik

	-konglomeratet e kredive të korporatave; -transferta krediti; -ruajtja e sigurt e aseteve dhe kasat e sigurisë; -procesimi i të dhënave; -debitime direkte; -vendosja e instrumenteve financiare; -këmbimi valutor; -këshillimi për investimet; -administrimi i investimeve; -emetimi i instrumenteve të pagesave; -administrimi i kredidhënies; -dërgesat e parave; -urdhrat; -inicimi i pagesave; -administrimi i portofolit; -marrja/transmetimi/ekzekutimi; -shlyerja; -monitorimi i transaksioneve. Në rastin e raportimit të agreguar sipas nenit 38 të kësaj rregulloreje, fushat funksionale dhe proceset e biznesit të prekura në të paktën një subjekt financiar.				
3.28 Komponentët e infrastrukturës së prekur që mbështesin proceset e biznesit	Informacioni nëse komponentët e infrastrukturës (serverët, sistemet operative, *software*, serverët e aplikacioneve, pjesët ndërmjetëse *(middleware),* komponentët e rrjetit, të tjerë) që mbështesin proceset e biznesit, janë prekur nga incidenti madhor i lidhur me TIK-un.	Jo	Po	Po	Opsione: -Po; -Jo; -Informacion jo i disponueshëm.
3.29 Informacion mbi komponentët e infrastrukturës së prekur që mbështesin proceset e biznesit	Përshkrim mbi ndikimin e incidentit madhor të lidhur me TIK-un mbi komponentët e infrastrukturës (përfshirë pjesët fizike (*hardware*) dhe pjesët logjike (*software*)) që mbështesin proceset e biznesit. Pjesët fizike përfshijnë serverë, kompjuterë, qendra të dhënash, çelësa (*switches*), rutera, shpërndarës (*hubs*). Pjesët logjike përfshijnë sisteme operative, aplikacione, baza të të dhënave, mjete sigurie, komponentë rrjeti, të tjera). Përshkrimi duhet të përshkruajë ose emërtojë komponentët e infrastrukturës ose sistemet e prekur dhe, kur është e disponueshme: a)informacionin e versionit; b)infrastrukturën e brendshme/pjesërisht e kontraktuar/plotësisht e kontraktuar – emrin e ofruesit të palës së tretë; c)nëse infrastruktura përdoret ose ndahet në funksione të shumta biznesi; d)planet përkatëse të qëndrueshmërisë/vazhdimësisë/rimëkëmbjes/ zëvendësueshmërisë në fuqi.	Jo	Po, nëse incidenti ka prekur komponentët e infrastrukturës që mbështesin proceset e biznesit	Po, nëse incidenti ka prekur komponentët e infrastrukturës që mbështesin proceset e biznesit	Alfanumerik
3.30 Ndikimi në interesat financiare të klientëve	Informacion nëse incidenti madhor i lidhur me TIK-un ka pasur ndikim në interesat financiare të klientëve.	Jo	Po	Po	Opsione: -Po; -Jo; -Informacion jo i disponueshëm.
3.31 Raportimi tek autoritete të tjera	Specifikimi i autoriteteve që janë informuar për incidentin madhor të lidhur me TIK-un.	Jo	Po	Po	Zgjedhja(e shumëfishtë): -Policia/organet ligjzbatuese; -CSIRT; -Autoriteti për mbrojtjen e të dhënave; -Agjencia Kombëtare e Sigurisë Kibernetike; -Asnjë; -Të tjera (specifiko).

3.32 Specifikimi i autoriteteve "të tjera"	Specifikimi i autoriteteve "Të tjera" të informuara për incidentin madhor të lidhur me TIK-un. Nëse zgjidhet fusha e të dhënave 3.31 "Të tjera", përshkrimi duhet të përfshijë informacion të detajuar për autoritetin në të cilin subjekti financiar ka raportuar për incidentin madhor të lidhur me TIK-un.	Jo	Po, nëse autoritete "të tjera" janë informuar nga subjekti financiar për incidentin madhor të lidhur me TIK-un.	Po, nëse autoritete "të tjera" janë informuar nga subjekti financiar për incidentin madhor të lidhur me TIK-un.	Alfanumerik
3.33 Veprime/masa të përkohshme të ndërmarra apo të planifikuara për t'u ndërmarrë, për rikuperim nga incidenti	Tregues nëse subjekti financiar ka ndërmarrë (ose planifikon të ndërmarrë) ndonjë veprim të përkohshëm për t'u rikuperuar nga incidenti madhor i lidhur me TIK-un.	Jo	Po	Po	Po/Jo
3.34 Përshkrim i veprimeve/masave të përkohshme të ndërmarra apo të planifikuara për t'u ndërmarrë, për rikuperim nga incidenti	Informacioni duhet të përshkruajë masat e menjëhershme të ndërmarra, duke përfshirë izolimin e perimetrit të incidentit në nivel rrjeti, procedurat e vëna në zbatim (*workaround procedures activated*), bllokimi i portave USB, aktivizimi i planit të rimëkëmbjes nga fatkeqësitë apo edhe kontrolle të tjera sigurie të ndërmarra. Subjektet financiare duhet të tregojnë datën dhe orën e zbatimit të veprimeve të përkohshme dhe datën e parashikuar për t'u rikthyer në normalitet (në sitin primar). Për veprimet e përkohshme që nuk janë zbatuar, por janë ende të planifikuara, të tregohet data kur parashikohet zbatimi i tyre. Nëse nuk janë ndërmarrë veprime/masa të përkohshme, tregoni arsyet përkatëse.	Jo	Po, nëse veprime/masa të përkohshme janë ndërmarrë apo janë planifikuar për t'u ndërmarrë (fusha e të dhënave 3.33).	Po, nëse veprime/masa të përkohshme janë ndërmarrë apo janë planifikuar për t'u ndërmarrë (fusha e të dhënave 3.33).	Alfanumerik
3.35 Treguesit e kompromentimit	Informacion i lidhur me incidentin madhor të lidhur me TIK-un, që mund të ndihmojë në identifikimin e aktivitetit keqdashës brenda rrjetit ose sistemit të informacionit (treguesit e kompromentimit ose IoC, ku janë të zbatueshëm). Kjo fushë aplikohet vetëm për ato subjekte financiare që janë brenda fushës së zbatimit të Ligjit "Për sigurinë kibernetike" dhe për ato subjekte financiare të identifikuara si infrastruktura kritike dhe të rëndësishme sipas atij ligji. IoC i ofruar nga subjekti financiar duhet të përfshijë kategoritë e mëposhtme të të dhënave: a) adresat IP; b) adresat e *URL*-ve; c) domenet; d) *hash*-et e skedarëve; e) të dhënat mbi programet keqdashëse (*malware*) (emri i *malware*, emrat e skedarëve dhe vendndodhjet e tyre, çelësat specifikë të regjistrit të lidhur me aktivitetin e *malware*); f) të dhënat e aktivitetit të rrjetit (portat, protokollet, adresat, referuesit, agjentët e përdoruesve, titujt, regjistra specifikë ose modele dalluese në trafikun e rrjetit); g) të dhënat e mesazheve të postës elektronike (dërguesi, marrësi, subjekti, titulli, përmbajtja); h) të dhënat DNS-je dhe konfigurime të regjistrit; i) aktivitetet e llogarisë së përdoruesit (hyrjet, aktiviteti i llogarisë së përdoruesit të privilegjuar, përshkallëzimi i privilegjeve); j) trafiku i bazës së të dhënave (lexim/shkrim) kërkesat për të njëjtin skedar. Në praktikë, ky informacion mund të përfshijë të dhëna të lidhura me treguesit që përshkruajnë sjelljet në trafikun e rrjetit që u	Jo	Po, nëse lloji i incidentit është "i lidhur me sigurinë kibernetike" në fushën 3.23	Po, nëse lloji i incidentit është "i lidhur me sigurinë kibernetike" në fushën 3.23	Alfanumerik

	korrespondojnë sulmeve të njohura/komunikimeve të *botnet*, adresave IP të makinave të infektuara me programe keqdashëse (*bots*), të dhëna në lidhje me serverat "komanda dhe kontroll", të përdorur nga programe keqdashëse (zakonisht domain ose adresat IP) dhe URL-të në lidhje me faqet *phishing* ose faqe interneti të vëzhguara që mbajnë programe keqdashëse.				
Përmbajtja e raportit përfundimtar					
4.1 Klasifikimi në nivel të lartë i shkaqeve bazë të incidentit	Klasifikimi në nivel të lartë i shkaqeve bazë të incidentit madhor të lidhur me TIK-un, sipas llojit të incidentit, duke përfshirë kategoritë e niveleve të larta të mëposhtme: a) Veprime keqdashëse; b) Dështim i proceseve; c) Dështim i sistemeve; d) Gabim njerëzor; e) Ngjarje e jashtme.	Jo	Jo	Po	Zgjedhje (e shumëfishtë): -Veprime keqdashëse; -Dështim i proceseve; -Dështim i sistemeve; -Gabim njerëzor; -Ngjarje e jashtme.
4.2 Klasifikim i detajuar i shkaqeve bazë të incidentit	Klasifikim i detajuar i shkaqeve bazë të incidentit madhor të lidhur me TIK-un, sipas llojit të incidentit, duke përfshirë kategoritë e mëposhtme të detajuara, të lidhura me kategoritë e niveleve të larta të raportuara në fushën 4.1: **1. Veprime keqdashëse** (nëse është përzgjedhur në fushën 4.1, zgjidhni një ose disa nga opsionet e mëposhtme): a)veprime të brendshme të qëllimshme; b)dëmtime fizike të qëllimshme/manipulim/vjedhje; c)veprime mashtruese. **2. Dështim i proceseve** (nëse është përzgjedhur në fushën 4.1, zgjidhni një ose disa nga opsionet e mëposhtme): a)monitorim i pamjaftueshëm ose dështim i monitorimit dhe kontrollit; b)pamjaftueshmëri/paqartësi rolesh dhe përgjegjësish; c)dështim i procesit të administrimit të rrezikut të TIK-ut; d)pamjaftueshmëri ose dështim i veprimeve të TIK-ut dhe i veprimeve të sigurisë së TIK; e)pamjaftueshmëri ose dështim i administrimit të projekteve të TIK-ut; f)politika, procedura dhe dokumentacione të brendshme të papërshtatshme; g)blerje, zhvillim, mirëmbajtje sistemesh të papërshtatshme të TIK-ut; h)të tjera (specifikoni). **3. Dështim ose keqfunksionim i sistemit** (nëse është përzgjedhur në fushën 4.1, zgjidhni një ose disa nga opsionet e mëposhtme): a)kapaciteti dhe performanca fizike e pajisjeve (*hardware*): incidente madhore të lidhur me TIK-un, të shkaktuara pajisjet (*hardware*), të cilat rezultojnë të papërshtatshme për sa i përket kapacitetit ose performancës për të përmbushur kërkesat ligjore e rregullative në fuqi; b)mirëmbajtja fizike e pajisjeve (*hardware*): incidente madhore të lidhur me TIK-un që rezultojnë nga mirëmbajtja jo e përshtatshme apo e pamjaftueshme e pjesëve përbërëse fizike të pajisjeve (*hardware*), përveç vjetrimit të pajisjeve; c)vjetrimi i pajisjeve: ky lloj shkaku bazë përfshin incidente madhore të lidhur me TIK-un që e kanë zanafillën nga komponentë të vjetruar të pajisjeve; d)përputhshmëria/konfigurimi i programeve (*software*): incidentet madhore të lidhur me TIK-un të shkaktuara nga programet (*software*) që janë jo të përputhshëm me konfigurimet e	Jo	Jo	Po	Zgjedhje (e shumëfishtë): -veprime të brendshme të qëllimshme; -dëmtime fizike të qëllimshme/manipulim/vjedhje; -veprime keqdashëse: veprime mashtruese; -dështim i proceseve: monitorim i pamjaftueshëm ose dështim i monitorimit dhe kontrollit; -dështim i proceseve: pamjaftueshmëri/paqartësi rolesh dhe përgjegjësish; -dështim i proceseve: dështim i procesit të administrimit të rrezikut të TIK-ut; -dështim i proceseve: pamjaftueshmëri ose dështim i veprimeve të TIK-ut dhe i veprimeve të sigurisë së TIK; -dështim i proceseve: pamjaftueshmëri ose dështim i administrimit të projekteve të TIK-ut; -dështim i proceseve: politika, procedura dhe dokumentacione të brendshme të papërshtatshme; -dështim i proceseve: blerje, zhvillim, mirëmbajtje sistemesh të papërshtatshme të TIK-ut; -dështim i procesit: të tjera (specifikoni); -dështim i sistemit: kapaciteti dhe performanca fizike e pajisjeve (*hardware*); -dështim i sistemit: mirëmbajtja fizike e pajisjeve (*hardware*); -dështim i sistemit: vjetrimi i pajisjeve; -dështim i sistemit: përputhshmëria/konfigurimi i programeve (*software*); -dështim i sistemit: performanca e programeve (*software*); -dështim i sistemit: konfigurim i rrjetit; -dështim i sistemit: dëmtim

	sistemeve apo programeve të tjera, duke përfshirë incidentet madhore të lidhur me TIK-un që rezultojnë nga konfliktet e programeve (*software*), cilësime të pasakta, parametra të konfiguruara jo saktë që ndikojnë në funksionimin korrekt të sistemit; e)performanca e programeve (*software*): incidentet madhore të lidhur me TIK-un që rezultojnë si pasojë e performancës së dobët apo të pamjaftueshme të fragmenteve logjike (komponentëve *software*), për arsye të tjera nga ato të specifikuara në opsionin "përputhshmëria/konfigurimi i programeve (*software*)", duke përfshirë incidentet madhore të lidhur me TIK-un të shkaktuara nga koha e ulët e përgjigjes, konsumi i tepërt i burimeve ose ekzekutimi jo efikas i kërkesave, që ndikon në performancën e programit (*software*) ose sistemit; f) konfigurimi i rrjetit: incidente madhore të lidhur me TIK-un që vijnë si pasojë e cilësimeve ose infrastrukturës të pasakta ose të konfiguruara gabimisht së rrjetit, duke përfshirë incidente madhore të lidhura me TIK-un të shkaktuara nga gabimet e konfigurimit të rrjetit, problemet e rrugëzimit (*routing*), konfigurimet e gabuara të *firewall*-it ose probleme të tjera të lidhura me rrjetin që ndikojnë në lidhjet ose komunikimin; g)dëmtime fizike: incidente madhore të lidhur me TIK-un të shkaktuara nga dëmtimet fizike të infrastrukturave të TIK-ut, që çojnë në dështime të sistemeve; h)të tjera (specifikoni). **4. Gabime njerëzore** (nëse është përzgjedhur në fushën 4.1, zgjidhni një ose disa nga opsionet e mëposhtme): a)harresa (të paqëllimshme); b)gabime; c)aftësi dhe njohuri: incidente madhore të lidhur me TIK-un që vijnë si pasojë e mungesës së ekspertizës ose aftësisë në trajtimin e sistemeve ose proceseve të TIK-ut, të cilat mund të shkaktohen nga trajnimi i pamjaftueshëm, njohuritë e pamjaftueshme ose boshllëqet në aftësitë e nevojshme për të kryer detyra specifike ose për të adresuar sfidat teknike; d)burime njerëzore të pamjaftueshme: incidente madhore të lidhur me TIK-un të shkaktuara nga mungesa e burimeve të nevojshme, përfshirë edhe pajisjet (*hardware*), programet (*software*), infrastrukturat, ose personelin, dhe përfshirë situatat kur burimet e pamjaftueshme çojnë në dështime të sistemeve ose pamundësi për të plotësuar kërkesat e biznesit; e)keqkomunikim; f)të tjera (specifikoni). **5. Ngjarje të jashtme** (nëse është përzgjedhur në fushën 4.1, zgjidhni një ose disa nga opsionet e mëposhtme): a)fatkeqësi natyrore /forca madhore; b)dështime të palëve të treta; c)të tjera (specifikoni). Subjektet financiare duhet të mbajnë parasysh që, për incidentet madhore të përsëritura të lidhur me TIK-un, të merret parasysh shkaku rrënjësor i dukshëm specifik i incidentit dhe jo kategoritë e përgjithshme të përfshira në këtë fushë.				fizik; -dështim i sistemit: të tjera (specifikoni); -gabim njerëzor: harresa; -gabim njerëzor: gabime; -gabim njerëzor: aftësi dhe njohuri; -gabim njerëzor: burime njerëzore të pamjaftueshme; -gabim njerëzor: keqkomunikim; -gabim njerëzor: të tjera (specifikoni); -ngjarje të jashtme: fatkeqësi natyrore/forca madhore; -ngjarje të jashtme: dështim i palëve të treta; -ngjarje të jashtme: të tjera (specifikoni).
4.3 Klasifikim shtesë mbi shkaqet bazë të incidentit	Klasifikim shtesë i shkaqeve bazë të incidentit madhor të lidhur me TIK-un, sipas llojit të incidentit, duke përfshirë kategoritë shtesë të	Jo	Jo	Po	Opsione (të shumëfishta): -monitorim i zbatimit të politikës;

	klasifikimit të lidhura me kategoritë e detajuara të raportuara në fushën 4.2. Fusha është e detyrueshme për raportin përfundimtar, nëse kategoritë specifike që kërkojnë detajim të hollësishëm janë raportuar në fushën 4.2. 2(a) Monitorim i pamjaftueshëm ose dështim i monitorimit dhe kontrollit: a)monitorim i zbatimit të politikës; b)monitorim i ofruesve të shërbimeve të palëve të treta; c)monitorim dhe verifikim i korrigjimit të vulnerabiliteteve; d)menaxhim i identitetit dhe aksesit; e)enkriptimi dhe kriptografia; f)regjistrim i ngjarjeve/logimi. 2(c) Dështim i procesit të administrimit të rrezikut të TIK-ut: a)dështim në përcaktimin e niveleve të sakta të tolerancës ndaj rrezikut; b)vlerësime të pamjaftueshme të vulnerabiliteteve dhe kërcënimeve; c)masa të papërshtatshme të trajtimit të rreziqeve; d)administrim i dobët i rreziqeve të mbetura të TIK-ut. 2(d) Pamjaftueshmëri ose dështim i veprimeve të TIK-ut dhe i veprimeve të sigurisë së TIK: a)administrimi i vulnerabiliteteve dhe i *patch*-eve; b)administrimi i ndryshimeve; c)administrimi i kapaciteteve dhe performancës; d)administrimi i aseteve të TIK-ut dhe klasifikimi i informacionit; e)*backup* dhe rikuperimi; f)trajtimi i gabimeve. 2(g) Blerje, zhvillim, mirëmbajtje sistemesh të papërshtatshme të TIK-ut: a)blerja, zhvillimi dhe mirëmbajtja e sistemeve TIK të papërshtatshme; b)testimi i pamjaftueshëm i programeve (*software*) ose dështimi i testimit të programeve (*software*).				-monitorim i ofruesve të shërbimeve të palëve të treta; -monitorim dhe verifikim i korrigjimit të vulnerabiliteteve; -menaxhim i identitetit dhe aksesit; -enkriptimi dhe kriptografia; -regjistrim i ngjarjeve/logimi; -dështim në përcaktimin e niveleve të sakta të tolerancës ndaj rrezikut; -vlerësime të pamjaftueshme të vulnerabiliteteve dhe kërcënimeve; -masa të papërshtatshme të trajtimit të rreziqeve; -administrim i dobët i rreziqeve të mbetura të TIK-ut; -administrimi i vulnerabiliteteve dhe i *patch*-eve; -administrimi i ndryshimeve; -administrimi i kapaciteteve dhe performancës; -administrimi i aseteve të TIK-ut dhe klasifikimi i informacionit; -*backup* dhe rikuperimi; -trajtimi i gabimeve; -blerja, zhvillimi dhe mirëmbajtja e sistemeve TIK të papërshtatshme; -testimi i pamjaftueshëm i programeve (*software*) ose dështimi i testimit të programeve (*software*).
4.4 Lloje të tjera të shkaqeve bazë	Subjektet financiare që kanë zgjedhur opsionin shkaqe bazë "të tjera" në fushën 4.2, duhet të specifikojnë këto shkaqe bazë.	Jo	Jo	Po, nëse është zgjedhur opsioni shkaqe bazë "të tjera" në fushën 4.2.	Alfanumerik
4.5 Informacione mbi shkaqet bazë të incidentit	Përshkrim i rrjedhës së ngjarjeve që çuan në incidentin madhor të lidhur me TIK-un dhe përshkrim i mënyrës se si incidenti madhor i lidhur me TIK-un ka një shkak bazë të dukshëm të ngjashëm, nëse ai incident klasifikohet si incident i përsëritur, duke përfshirë një përshkrim të përmbledhur të të gjitha arsyeve themelore dhe faktorëve kryesorë që kontribuuan në ndodhjen e këtij incidenti madhor të lidhur me TIK-un. Në rastet kur ka pasur veprime keqdashëse, përshkruani mënyrën e kryerjes së veprimit keqdashës, duke përfshirë taktikat, teknikat dhe procedurat e përdorura, si dhe vektorin e hyrjes së incidentit madhor të lidhur me TIK-un, përfshirë një përshkrim të hetimeve dhe analizave që çuan në identifikimin e shkaqeve bazë, nëse është e zbatueshme.	Jo	Jo	Po	Alfanumerik
4.6 Përmbledhje e zgjidhjes së incidentit	Informacione shtesë mbi veprimet/masat e marra/të planifikuara, për të zgjidhur përfundimisht incidentin madhor të lidhur me TIK-un dhe për të parandaluar përsëritjen e incidentit.	Jo	Jo	Po	Alfanumerik

	Konkluzione/mësime të nxjerra nga incidenti madhor i lidhur me TIK-un. Përshkrimi duhet të përmbajë pikat e mëposhtme: **1. Përshkrim i veprimeve/masave për zgjidhjen e incidentit** a)veprimet/masat e marra për zgjidhjen përfundimtare të incidentit madhor të lidhur me TIK-un (duke përjashtuar çdo veprim të përkohshëm); b)për çdo veprim/masë të ndërmarrë, tregoni përfshirjen e mundshme të ndonjë ofruesi palë e tretë, si dhe të ndonjë subjekti financiar; c)tregoni nëse procedurat janë përshtatur pas incidentit madhor të lidhur me TIK-un; d)tregoni ndonjë kontroll shtesë të ndërmarrë ose të planifikuar për t'u kryer, me afatet përkatëse për implementimin e tyre. Çështje të mundshme të identifikuara në lidhje me qëndrueshmërinë e sistemeve të teknologjisë së informacionit të prekura nga incidenti /ose në lidhje me procedurat apo kontrollet ekzistuese, nëse është e zbatueshme. Subjektet financiare tregojnë qartë sesi veprimet korrigjuese të parashikuara do të adresojnë shkaqet bazë të identifikuara dhe kur pritet të zgjidhet përfundimisht incidenti madhor i lidhur me TIK-un. **2.Konkluzione/mësime të nxjerra** Subjektet financiare duhet të përshkruajnë gjetjet nga rishikimet pas incidentit.				
4.7 Data dhe ora kur shkaku bazë i incidentit u adresua	Data dhe ora kur u adresua shkaku bazë i incidentit.	Jo	Jo	Po	Standardi ISO 8601 (VVVV-MM-DD Ora: minutat:sekondat)
4.8 Data dhe ora kur incidenti u zgjidh	Data dhe ora e zgjidhjes së incidentit.	Jo	Jo	Po	Standardi ISO 8601 (VVVV-MM-DD Ora: minutat:sekondat)
4.9 Informacion nëse data e zgjidhjes përfundimtare të incidentit ndryshon nga data fillestare e planifikuar për implementim	Përshkrim i arsyes përse data e zgjidhjes përfundimtare të incidentit madhor të lidhur me TIK-un është e ndryshme nga data e planifikuar fillimisht për implementimin, kur është e zbatueshme.	Jo	Jo	Po	Alfanumerik
4.10 Vlerësimi i rrezikut në funksionet me rëndësi kritike për qëllime të ndërhyrjes së jashtëzakonshme	Vlerësim nëse incidenti madhor i lidhur me TIK-un paraqet rrezik për funksionet me rëndësi kritike, në kuptim të ligjit "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë". Subjektet e ligjit "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë", duhet të tregojnë nëse incidenti paraqet rrezik për funksionet me rëndësi kritike në kuptim të atij ligji.	Jo	Jo	Po, nëse incidenti paraqet rrezik për funksionet me rëndësi kritike, në kuptim të ligjit "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë".	Alfanumerik
4.11 Informacion i vlefshëm për autoritetin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme	Përshkrim nëse po dhe në ç'mënyrë incidenti madhor i lidhur me TIK-un ka ndikuar në ndërhyrjen e jashtëzakonshme të subjektit apo grupit. Subjektet e ligjit "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë", duhet të japin informacion nëse po dhe në ç'menyrë incidenti madhor i lidhur me TIK-un ka ndikuar në ndërhyrjen e jashtëzakonshme të subjektit apo grupit. Këto subjekte duhet të tregojnë, gjithashtu, nëse incidenti madhor i lidhur me TIK-un ndikon në qëndrueshmërinë financiare ose	Jo	Jo	Po, nëse incidenti ka ndikuar në ndërhyrjen e jashtëzakonshme të subjektit apo grupit	Alfanumerik

	likuiditetin e subjektit financiar dhe vlerësimin e mundshëm sasior të ndikimit. Këto subjekte duhet të japin, gjithashtu, informacion mbi ndikimin në vazhdimësinë operacionale, ndikimin në mundësinë e ndërhyrjes së jashtëzakonshme të subjektit, çdo ndikim shtesë në kostot dhe humbjet nga incidenti madhor i lidhur me TIK-un, duke përfshirë pozicionin e kapitalit të subjektit financiar, dhe nëse marrëveshjet kontraktuale mbi përdorimin e shërbimeve të TIK-ut janë ende të qëndrueshme dhe plotësisht të zbatueshme në rast të ndërhyrjes së jashtëzakonshme të subjektit.				
4.12 Kufijtë e materialitetit për klasifikimin e kriterit "Ndikimi ekonomik"	Informacion i detajuar mbi kufijtë që janë arritur nga incidenti madhor i lidhur me TIK-un, në lidhje me kriterin "Ndikimi ekonomik", i parashikuar në nenin 26 të kësaj rregulloreje.	Jo	Jo	Po	Alfanumerik
4.13 Shuma e humbjeve dhe kostove bruto direkte dhe indirekte	Shuma totale e kostove dhe humbjeve bruto direkte dhe indirekte të pësuara nga subjekti financiar si pasojë e incidentit madhor të lidhur me TIK-un, duke përfshirë: a)shuma e fondeve ose aktiveve financiare të përvetësuara (*expropriated*), për të cilat subjekti financiar është përgjegjës; b)shuma e kostove për zëvendësimin ose zhvendosjen e pajisjeve (*hardware*), programeve kompjuterike (*software*) ose infrastrukturës; c)shuma e kostove të personelit, përfshirë edhe kostot që lidhen me zëvendësimin ose zhvendosjen e personelit, rekrutimin e personelit shtesë, shpërblimet për punën jashtë orarit dhe rikuperimin e aftësive të humbura ose të dëmtuara të stafit; d)shuma e tarifave të detyrueshme për shkak të mosrespektimit të detyrimeve kontraktuale; e)shuma e kostove për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe kompensimin e klientëve; f)shuma e humbjeve për shkak të të ardhurave të munguara; g)shuma e kostove që lidhen me komunikimin e brendshëm dhe të jashtëm; h)shuma e kostove të konsulencës, duke përfshirë kostot që lidhen me këshillimin ligjor, shërbimet mjekoligjore dhe shërbimet e rehabilitimit; i)shuma e kostove dhe humbjeve të tjera, duke përfshirë: i. shpenzime të drejtpërdrejta në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, duke përfshirë zhvlerësimet dhe kostot e shitjes, si dhe fshirjet e kredive për shkak të incidentit madhor të lidhur me TIK-un; ii. provigjionet kontabël të pasqyruara në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kundrejt humbjeve të mundshme që lidhen me incidentin madhor të lidhur me TIK-un; iii. humbje të mbetura pezull (*pending losses*), në formën e humbjeve që rrjedhin nga incidenti madhor i lidhur me TIK-un, të cilat janë të regjistruara përkohësisht në llogari tranzitore/pezull dhe që nuk janë reflektuar ende në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, por që planifikohen të përfshihen brenda një periudhe kohore që përputhet me madhësinë dhe kohëzgjatjen e zërit të mbetur pezull; iv. të ardhura materiale të pambledhura, të lidhura me detyrime kontraktuale ndaj palëve të treta, duke përfshirë vendimin për të kompensuar një klient pas incidentit madhor të lidhur me TIK-un, jo përmes rimbursimit ose pagesës direkte, por përmes një rregullimi të të	Jo	Jo	Po	Monetare

	ardhurave, që përjashton ose ul tarifat kontraktuale për një periudhë të caktuar kohore në të ardhmen; v. humbje në kohë (*timing losses*), kur ato shtrihen në më shumë se një vit kontabël dhe sjellin rrezik ligjor. Subjektet financiare duhet të marrin parasysh në vlerësimin e tyre, kërkesat e nenit 26, pikat 1 dhe 2 të kësaj rregulloreje. Subjektet financiare nuk duhet të përfshijnë në këtë shifër asnjë vlerë të rikuperuar. Subjektet financiare duhet të raportojnë shumën monetare si një vlerë pozitive. Në rastin e raportimit të agreguar sipas nenit 38 të kësaj rregulloreje, subjektet financiare duhet të marrin parasysh shumën totale të kostove dhe humbjeve për të gjitha subjektet financiare. Subjektet financiare duhet të raportojnë shifrat në mijë njësi.				
4.14 Shuma e rikuperuar	Vlera totale e rikuperuar. Vlera e rikuperimeve duhet të lidhet me humbjen origjinale të shkaktuar nga incidenti i ndodhur, pavarësisht kohës së marrjes së vlerës së rikuperuar, në formë fondesh ose përfitimesh financiare. Subjektet financiare duhet të raportojnë shumën monetare si një vlerë pozitive. Në rastin e raportimit të agreguar, sipas nenit 38 të kësaj rregulloreje, subjektet financiare duhet të marrin parasysh vlerën totale të rikuperuar, për të gjitha subjektet financiare.	Jo	Jo	Po	Monetare Subjektet financiare duhet të raportojnë shifrat në mijë njësi.
4.15 Informacion nëse incidentet madhore kanë qenë të përsëritura	Informacion nëse disa incidente jo madhore të lidhura me TIK-un janë përsëritur dhe së bashku konsiderohen si një incident madhor në kuptimin e nenit 27, pika 2, të kësaj rregulloreje. Subjektet financiare duhet të tregojnë nëse incidentet jo madhore të lidhura me TIK-un janë të përsëritur dhe së bashku konsiderohen si një incident madhor i lidhur me TIK-un. Subjektet financiare duhet të tregojnë sa herë kanë ndodhur këto incidente jo madhore të lidhura me TIK-un.	Jo	Jo	Po, nëse incidenti madhor përbëhet nga disa incidente jo madhore të përsëritura.	Alfanumerik
4.16 Data dhe ora e ndodhjes së incidenteve të përsëritura	Nëse subjektet financiare raportojnë incidente të përsëritura të lidhura me TIK-un, paraqesin datën dhe orën kur ka ndodhur incidenti i parë i lidhur me TIK-un.	Jo	Jo	Po, për incidente të përsëritur	Standardi ISO 8601 (VVVV-MM-DD Ora: minutat:sekondat)

ANEKSI 3
FORMULARËT PËR NJOFTIMIN E KËRCËNIMEVE KIBERNETIKE TË RËNDËSISHME

Numri i fushës	**Fusha e të dhënave**	
1	Emri i subjektit financiar që paraqet njoftimin	
2	Kodi i identifikimit të subjektit që paraqet njoftimin	
3	Lloji i subjektit financiar që paraqet njoftimin	
4	Emri i subjektit financiar	
5	Kodi NUIS/LEI i subjektit financiar	
6	Emri i personit kryesor të kontaktit	
7	Adresa e postës elektronike të personit kryesor të kontaktit	
8	Numri i telefonit të personit kryesor të kontaktit	
9	Emri i personit dytësor të kontaktit	
10	Adresa e postës elektronike të personit dytësor të kontaktit	
11	Numri i telefonit të personit dytësor të kontaktit	
12	Data dhe ora e zbulimit të kërcënimit kibernetik	
13	Përshkrimi i kërcënimit të rëndësishëm kibernetik	
14	Informacion mbi ndikimin potencial	
15	Kriteret e klasifikimit të incidentit potencial	

16	Statusi i kërcënimit kibernetik	
17	Veprimet e ndërmarra për të parandaluar materializimin e kërcënimit	
18	Njoftimi i palëve të tjera të përfshira	
19	Treguesit e kompromentimit	
20	Informacion tjetër i lidhur me ngjarjen	

ANEKSI 4
UDHËZIME MBI PLOTËSIMIN E FORMULARËVE TË NJOFTIMIT PËR KËRCËNIMET KIBERNETIKE TË RËNDËSISHME

Fusha e të dhënave	Përshkrimi	Fushë e detyrueshme	Lloji i fushës
1. Emri i subjektit financiar që paraqet njoftimin	Emri i plotë ligjor i subjektit që paraqet njoftimin	Po	Alfanumerik
2. Kodi i identifikimit të subjektit që paraqet njoftimin	Kodi i identifikimit të subjektit që paraqet njoftimin Nëse njoftimin e bën subjekti financiar, kodi i identifikimit duhet të jetë NUIS ose Identifikuesi Ligjor i Subjektit (LEI), i cili është një kod unik alfanumerik prej 20 karakteresh i bazuar në standardet ISO 17442-1:2020. Nëse një ofrues i shërbimeve të palëve të treta paraqet njoftimin për një subjekt financiar, mund të përdorë një kod identifikimi të specifikuar sipas standardeve teknike të parashikuara në kuadrin nënligjor të Bankës së Shqipërisë, për regjistrin e informacionit në lidhje me marrëveshjet kontraktuale për përdorimin e shërbimeve të TIK-ut, të parashikuara në nenin 45 të kësaj rregulloreje.	Po	Alfanumerik
3. Lloji i subjektit financiar që paraqet njoftimin	Lloji i subjektit të parashikuar në pikën 1 të nenit 2 të kësaj rregulloreje, që paraqet njoftimin.		Opsionet (mund të zgjidhen disa opsione): -institucionet e kreditit; -institucionet e pagesave; -institucionet e pagesave që përjashtohen sipas ligjit "Për shërbimet e pagesave"; -ofruesit e shërbimit të informimit të llogarisë; -institucionet e parasë elektronike; -institucionet e parasë elektronike që përjashtohen sipas ligjit "Për shërbimet e pagesave"; -emetuesit e tokenave të aseteve dhe emetuesit e tokenave të parasë elektronike.
4. Emri i subjektit financiar	Emri i plotë ligjor i subjektit financiar që njofton për kërcënimin e rëndësishëm kibernetik.	Po, nëse subjekti financiar është i ndryshëm nga subjekti që paraqet njoftimin.	Alfanumerik
5. Kodi NUIS/LEI i subjektit financiar	Kodi NUIS/LEI i subjektit financiar që njofton për kërcënimin e rëndësishëm kibernetik, i caktuar në përputhje me Organizatën Ndërkombëtare të Standardizimit.	Po, nëse subjekti financiar që njofton për kërcënimin e rëndësishëm kibernetik, është i ndryshëm nga subjekti që paraqet raportin.	Kod unik alfanumerik prej 20 karakteresh i bazuar në standardet ISO 17442-1:2020.
6. Emri i personit kryesor të kontaktit	Emri dhe mbiemri i personit kryesor të kontaktit të subjektit financiar.	Po	Alfanumerik
7. Adresa e postës elektronike të personit kryesor të kontaktit	Adresa e postës elektronike të personit kryesor të kontaktit që mund të përdoret nga Banka e Shqipërisë për të ndjekur komunikimin.	Po	Alfanumerik
8. Numri i telefonit të personit kryesor të kontaktit	Numri i telefonit të personit kryesor të kontaktit që mund të përdoret nga Banka e Shqipërisë për të ndjekur komunikimin. Numri i telefonit që raportohet duhet të jetë i formatit si	Po	Alfanumerik

	p.sh. +3556XXXXXXXX (përfshirë edhe prefiksin e shtetit përkatës).		
9. Emri i personit dytësor të kontaktit	Emri dhe mbiemri i personit dytësor të kontaktit të subjektit financiar ose të subjektit që paraqet njoftimin në emër të subjektit financiar, kur është e zbatueshme.	Po, nëse emri dhe mbiemri i personit dytësor të kontaktit të subjektit financiar ose të subjektit që paraqet njoftimin në emër të subjektit financiar është i disponueshëm.	Alfanumerik
10. Adresa e postës elektronike të personit dytësor të kontaktit	Adresa e postës elektronike të personit dytësor të kontaktit ose një adresë funksionale e grupit përgjegjës, që mund të përdoret nga Banka e Shqipërisë për të ndjekur komunikimin, nëse është e disponueshme.	Po, nëse adresa e postës elektronike të personit dytësor të kontaktit ose një adresë funksionale e grupit përgjegjës, që mund të përdoret nga Banka e Shqipërisë për të ndjekur komunikimin, është e disponueshme.	Alfanumerik
11. Numri i telefonit të personit dytësor të kontaktit	Numri i telefonit i personit dytësor të kontaktit, që mund të përdoret nga Banka e Shqipërisë për të ndjekur komunikimin, nëse është i disponueshëm. Numri i telefonit që raportohet duhet të jetë i formatit si p.sh. +3556XXXXXXXX (përfshirë edhe prefiksin e shtetit përkatës).	Po, nëse numri i telefonit i personit dytësor të kontaktit, që mund të përdoret nga Banka e Shqipërisë për të ndjekur komunikimin, është i disponueshëm.	Alfanumerik
12. Data dhe ora e zbulimit të kërcënimit kibernetik	Data dhe ora kur subjekti financiar është vënë në dijeni për kërcënimin e rëndësishëm kibernetik.	Po	Standardi ISO 8601 (VVVV-MM-DD Ora: minutat:sekondat)
13. Përshkrimi i kërcënimit të rëndësishëm kibernetik	Përshkrimi i aspekteve më të rëndësishme të kërcënimit të rëndësishëm kibernetik. Subjektet financiare duhet të paraqesin: a)një përmbledhje të përgjithshme të aspekteve më të rëndësishme të kërcënimit të rëndësishëm kibernetik; b)rreziqet përkatëse që burojnë nga ky kërcënim, duke përfshirë vulnerabilitetet e mundshme të sistemeve të subjektit financiar, që mund të shfrytëzohen; c)informacion mbi probabilitetin e materializimit të kërcenimit të rëndësishëm kibernetik; dhe d)informacion mbi burimin e informacionit për kërcënimin kibernetik.	Po	Alfanumerik
14. Informacion mbi ndikimin potencial	Informacion mbi ndikimin e mundshëm/potencial të kërcënimit kibernetik mbi subjektin financiar, klientët e tij ose kundërparti të tjera financiare, nëse kërcënimi kibernetik është materializuar.	Po	Alfanumerik
15. Kriteret e klasifikimit të incidentit potencial	Kriteret e klasifikimit që mund të kishin shkaktuar një raportim për incident madhor, nëse kërcënimi kibernetik do të ishte materializuar.	Po	Zgjedhje (e shumëfishtë): - klientët, kundërpartitë financiare dhe transaksionet e prekura; - ndikimi reputacional; - kohëzgjatja e incidentit dhe kohëzgjatja e ndërprerjes së shërbimeve; - shtrirja gjeografike; - humbja e të dhënave; - shërbimet kritike të prekura; - ndikimi ekonomik.
16. Statusi i kërcënimit kibernetik	Informacion mbi statusin e kërcënimit kibernetik për subjektin financiar dhe nëse ka pasur ndonjë ndryshim në aktivitetin e kërcënimit. Në rastet kur kërcënimi kibernetik ka ndaluar komunikimin me sistemet e informacionit të subjektit financiar, statusi mund të shënohet si "joaktiv".	Po	Zgjedhje: - aktiv; - joaktiv.

	Nëse subjekti financiar ka informacion që kërcënimi vazhdon të jetë aktiv kundrejt palëve të tjera apo ndaj sistemit financiar në tërësi, statusi duhet të shënohet si "aktiv".		
17. Veprimet e ndërmarra për të parandaluar materializimin e kërcënimit	Informacion i përgjithshëm mbi veprimet e ndërmarra nga subjekti financiar për të parandaluar materializimin e kërcënimeve kibernetike të rëndësishme, nëse është e aplikueshme.	Po	Alfanumerik
18. Njoftimi i palëve të tjera të përfshira	Informacion mbi njoftimin e kërcënimit kibernetik të subjekte të tjera financiare ose autoriteteve të tjera.	Po, nëse subjekte financiare të tjera ose autoritete të tjera janë informuar mbi kërcënimin kibernetik.	Alfanumerik
19. Treguesit e kompromentimit	Informacion i lidhur me kërcënimin kibernetik që mund të ndihmojë në identifikimin e aktivitetit keqdashës brenda rrjetit ose sistemit të informacionit (treguesit e kompromentimit ose IoC, ku janë të zbatueshëm). Treguesit e kompromentimit (IoC) të paraqitur nga subjekti financiar mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në kategoritë e mëposhtme të të dhënave: a) adresat IP; b) adresat e *URL*-ve; c) domenet; d) *hash*-et e skedarëve; e) të dhënat mbi programet keqdashëse (*malware*) (emri i *malware*, emrat e skedarëve dhe vendndodhjet e tyre, çelësat specifikë të regjistrit të lidhur me aktivitetin e *malware*); f) të dhënat e aktivitetit të rrjetit (portat, protokollet, adresat, referuesit, agjentët e përdoruesve, titujt, regjistra specifikë ose modele dalluese në trafikun e rrjetit); g) të dhënat e mesazheve të postës elektronike (dërguesi, marrësi, subjekti, titulli, përmbajtja); h) të dhënat DNS-je dhe konfigurime të regjistrit; i) aktivitetet e llogarisë së përdoruesit (hyrjet, aktiviteti i llogarisë së përdoruesit të privilegjuar, përshkallëzimi i privilegjeve); j) trafiku i bazës së të dhënave (lexim/shkrim) kërkesat për të njëjtin skedar. Ky lloj informacioni mund të përfshijë të dhëna të lidhura me treguesit që përshkruajnë sjelljet në trafikun e rrjetit që u korrespondojnë sulmeve të njohura/komunikimeve të *botnet*, adresave IP të makinave të infektuara me programe keqdashëse (*bots*), të dhëna në lidhje me serverat "komanda dhe kontroll", të përdorur nga programe keqdashëse (zakonisht domain ose adresat IP) dhe URL-të në lidhje me faqet *phishing* ose faqe interneti të vëzhguara që mbajnë programe keqdashëse.	Po, nëse informacioni mbi treguesit e kompromentimit të lidhur me kërcënimin kibernetik është i disponueshëm.	Alfanumerik
20. Informacion tjetër i lidhur me ngjarjen	Informacion tjetër në lidhje me kërcënimin e rëndësishëm kibernetik.	Po, nëse aplikohet dhe nëse ka informacion tjetër të disponueshëm që nuk është përfshirë në formular.	Alfanumerik

ANEKSI 5
FORMULARI I RAPORTIMIT TË KOSTOVE DHE HUMBJEVE BRUTO DHE VLERAVE TË RIKUPERUARA GJATË VITIT REFERENCË

Emri i subjektit financiar	
NUIS/LEI	
Data e fillimit dhe fundit të vitit referencë të subjektit financiar	
Monedha	

Numri i incidentit	Data e paraqitjes së raportit përfundimtar të incidentit	Numri i referencës të incidentit	Kostot dhe humbjet bruto nga incidenti gjatë vitit referencë (në mijë njësi)	Vlerat e rikuperuara nga incidenti gjatë vitit referencë (në mijë njësi)
1				
2				
....				
Totali për vitin referencë	.....	.....		

VENDIM
Nr. 31, datë 1.7.2026

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN "PËR PËRDORIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE TË KOMUNIKIMIT NË SUBJEKTET E LICENCUARA NGA BANKA E SHQIPËRISË"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja "a", të nenit 43, shkronja "c", dhe nenit 70, pika 1, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Në rregulloren "Për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit në subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 32, datë 3.5.2006, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) përmbajtja e nenit 1 ndryshon si më poshtë:

"Neni 1
Baza ligjore

Kjo rregullore nxirret në zbatim të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe të ligjit 52/2016, "Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre".";

b) në nenin 3, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. në pikën 1, përmbajtja e shkronjave "a" dhe "b" ndryshon si më poshtë:

"a) subjektet financiare jobanka dhe institucionet financiare të mikrokredisë;

b) shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre.";

ii. pika 2 shfuqizohet;

c) neni 14 shfuqizohet;

d) përmbajtja e nenit 16 ndryshon si më poshtë:

"Neni 16
Masat korrigjuese dhe penalitetet

Banka e Shqipërisë, në rast të mosplotësimit të kërkesave të kësaj rregulloreje, zbaton masat mbikëqyrëse dhe/ose ndëshkimore ose penalitetet e parashikuara në ligjin "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" dhe në ligjin "Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre".".

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 1 janar 2028.

KRYETAR
Gent Sejko

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 416 lekë